RAPORT PERFUNDIMTAR I AUDITIMIT

(Auditim Financiar dhe i Përputhshmërisë)

AGJENCINA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE (AIDA)

Tiranë, Dhjetor 2019

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
(Auditim Financiar dhe Përputhshmërie)

Nr Përmbatja Faqe

I. PERMBLEDHJA EKZEKUTIVE.....
II. HYRJA..... ***2-5***
a. Objektivat dhe qëllimi. .....
b. Identifikimi i çështjes.....
c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese .....
d. Përgjegjësitë e audituesve.....
e. Kriteret e vlerësimit.....
f. Standardet e auditimit**.....**

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....**6 - 8**

IV. GJETJET SIPAS DREJTIMEVE TE AUDITIMIT..... .....***6- 84***

V. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT..... ***79 - 84***

VI. REKOMANDIMET..... ....***80 - 84***

VII. ANEKSE .... ***84 - 103***

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE:

I.a.-Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit.

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH", në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit **nr. 801/2**, datë **15.10.2019**, i miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nga data 16.10.2019 deri më 25.11.2019, në subjektin "Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve", (në vijim AIDA), për periudhën nga 01.01.2018 deri në datën 31.08.2019, u krye auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë, me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë dhe rregullshmërinë e operacioneve financiare të kryera nga ana e këtij institucioni, duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve qe lidhen me llogaridhënien vjetore, administrimin e fondeve buxhetore dhe zbatimin e procedurave të emërimit dhe largimit nga puna të arsimtarëve, aspektet e menaxhimit financiar dhe të vlerësimit të sistemeve të kontrollit, etj.

I.b-Një përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi:

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	*Nga auditimi i Planifikimit të buxhetit, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të shtetit dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar konstatohet se*; për periudhën objekt auditimi, mungojnë raportet periodike katër mujore për monitorimin e buxhetit të vitit 2018 si dhe katër mujori i parë i vitit 2019. Raportet e monitorimit të buxhetit për vitin 2018 dhe tetë mujorin e vitit 2019, nuk janë të plotësuara me një informacion të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar,__në nivel programi dhe artikulli, në kundërshtim me kreun IV "Monitorimi", të Udhëzimit nr. 9, dt. 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimin e buxhetit" të Ministrisë së Financave si dhe udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore", ku citohet se " Raporti i monitorimit i përgatitur nga institucionet duhet te përmbajë: - Shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli; - Shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë; - Argumentet që lidhen me mosrealizimin e produkteve duke paraqitur masat që parashi-kohen në të ardhmen për realizimin e tyre, si edhe analiza e kostos së produkteve, duke paraqitur shpjegimet përkatëse në rastin e kostove shtesë të realizuara; Në raportet e monitorimit mungojnë argumentet e plota në lidhje me mosrealizimet dhe masat që parashikohen në të ardhmen për realizimi e tyre. AIDA nuk ka bërë publikimin e raporteve të monitorimit në faqen zyratare.	*Trajtuar më hollësisht në faqet 9-14 të Raportit përfundimtar të Auditimit).*	*E LARTE*	AIDA të marrë masa që për periuudhën në vijim, Raportet e monitorimit të buxhetit të hartohen me një informacion të plotë si dhe me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar,_në përputhje me paketën ligjore në fuqi
2.	Nga auditimi u konstatua se, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në kundërshtim me kreu II, nenet 8, 9, kreu III neni 19 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, për vitin 2018, nuk ka hartuar "Deklaratën për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm", mbi zbatimin e sistemeve dhe komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit, për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të trasparencës. *Trajtuar më hollësisht në faqet 29-32 të Raportit përfundimtar të Auditimit).*	*Trajtuar më hollësisht në faqet 29-32 të Raportit përfundimtar të Auditimit).*	*E LARTE*	Në zbatim të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, për periudhën në vijim Agjencia të marrë masat e nevojshme për hartimin e "Deklaratës për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm", për zbatimin e sistemeve dhe komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit, për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të trasparencës.

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
3.	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, nuk ka hartuar "Kodin e Brendshëm Etik", në kundërshtim me kërkesat e nenit 20, pika 2 germa a, "Mjedisi i kontrollit" të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, dhe me Kap II, pika 2.5.1 "Mjedisi i Kontrollit", paragrafi "Integriteti dhe vlerat etike" të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financës. *Trajtuar më hollësisht në faqet 29-32 të Raportit përfundimtar të Auditimit).*	*Trajtuar më hollësisht në faqet 29-32 të Raportit përfundimtar të Auditimit).*	*E LARTE*	Agjencia në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të hartojë dhe miratojë "Kodin e Brendshëm Etik".
4.	Në rregulloren e brendshme të institucionit, janë përcaktuar rregullat e funksionimit të brendshëm lidhur me strukturën organike, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, marrëdhëniet ndërmjet strukturave të njësisë, orarin dhe kohën e punës etj, por kjo rregullore nuk është përditësuar që nga viti 2011 duke mos ju përshtatur strukturave të ndryshuar herë pas herë të institucionit. Nga institucioni nuk është bërë vlerësimi vjetor i punës për çdo punonjës, i cili i bashkëlidhet dosjeve personale të punonjësve.	*Trajtuar më hollësisht në faqet 29-32 të Raportit përfundimtar të Auditimit).*	*E LARTE*	AIDA të përditësojë rregulloren e brendëshme dhe ta përshtasë atë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe strukturën e miratuar nga bordi drejtues si dhe të bëjë vlerësimin vjetor të punës për çdo punonjës
5.	Nga auditimi në lidhje me identifikimi i riskut, vlerësimi i riskut, adresimi i riskut dhe shqyrtimi i riskut rezultoi se, Institucioni nuk ka hartuar strategjinë për menaxhimin e riskut, në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, ku citohet se.... "Titullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut". Strategjia e riskut duhet të përcaktojë mënyrën se si do të sillet njësia ndaj risqeve dhe të vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Gjithashtu nga auditimi u konstatua se agjencia nuk ka regjistër risku.Menaxhimi i riskut është nuk vlerësuar si një proces i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut. Pas planifikimit të fondeve buxhetore, institucioni nuk ka analizuar dhe identifikuar kontrollin e risqeve, të cilët mund të venë në rrezik realizimin e treguesve buxhetore.	*Trajtuar më hollësisht në faqet 29-32 të Raportit përfundimtar të Auditimit*	*E LARTE*	Agjencia në zbatim të nenit 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, të hartuojë strategjinë për menaxhimin e riskut si dhe regjistrin e rriskut me qëllim vlerësimin e menaxhimit të riskut si një proces i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit për realizimin e treguesve buxhetore**.**

OPINIONI I AUDITIMIT:

Opinion mbi përputhshmërinë(i pakualifikuar)

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Agjencisë së Zhvillimit të Investimeve në Shqipëri(AIDA), me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor,të AIDA-s rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

Mbështetur mbi punën audituese në përfundim rezultoi se, në opinionin tonë, aktiviteti i AIDA-s, me përjashtim të çështjeve të trajtuara përgjatë këtij projektraporti auditimi,në bazën e opinionit të pakualifikuar, është në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e vlerësimit, si dhe me parimet dhe rregullat e aplikueshme.

Baza për opinionin e përputhshmërisë

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs) mbështetur në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 "Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë". Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.208, të Kryetarit të KLSH-së.

Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve,duke vlerësuar materialitetin, risqet dhe kampionin e transaksioneve me kriteret e parashikuara.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti AIDA, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), bazuar në procedurat e kryera dhe evidencën e përftuar u evidentuan në përgjithësi zbatimi i tyre dhe nuk ka raste mospërputhjesh materiale për të raportuar *(Përjashtuar dokumentacionin e përgatitur për dhënien e statusit të "Investim/Investitor Strategjikë procedurë e veçantë" për projektin e investimit strategjik "J.E.P")*. Auditimi i përputhshmërisë në AIDA është kryer bazuar në kriteret e auditimit të përputhshmërisë dhe audituesit nën gjykimin profesional e të pavarur japin opinion të pakualifikuar,kur nuk rezultojnë devijime materiale mbi nivelin e materialitetit të llogaritur sipas Aneksit.1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, për të cilën japim **Opinion të pakualifikuar**[2].

Opinion mbi pasqyrat financiare (I pakualifikuar)

Ne audituam pasqyrat financiare të AIDA-s më datë 31.12.2018, të cilat përbëhen nga Bilanci, Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, Pasqyra e Fluksit të Arkës, dhe Pasqyra e Lëvizjes së Kapitalit si dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat.

Në opinionin tonë, veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike, përfshirë rregullat për prokurimet dhe ato të buxhetit. Megjithatë, nga auditimi i pasqyrave financiare, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Standardin ISSAI 1700, u konstatuan edhe anomali në plotësimin e pasqyrave financiare me devijanca të evidentuara përgjatë projektraportit të auditimit, por të cilat nuk konsiderohen materiale duke e krahasuar me pragun e llogaritur të tij prej 2%, ku në shumicën e tyre janë nga mosnjohja e stafit të AIDA-s të rregullave dhe standarteve të ndërtimit të pasqyrave financiare .

të konsideruara *jo* ***materiale, dhe jo të përhapura****, për të cilën japim* **opinion të pakualifikuar**[1]

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin *"Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare"*, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 1700 "Standardi i Auditimit të Financiar". Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.208, të Kryetarit të KLSH-së. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e **opinionit të pakualifikuar të auditimit.**

[1]- Sipas ***Manualit të Auditimit Financiar*** të KLSH-së, kapitulli IV, pika 4.2, "Opinioni me rezerve" do të jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Nëse efekti financiar i paqartësisë apo i mosmarrëveshjes është i përcaktuar si shumë nga audituesi, ndonëse nuk është gjithmonë e praktikuar ose e përshtatshme, atëherë kjo do të shërbente si ndihmë për përdoruesit e pasqyrave.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH", në zbatim të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 801/2, datë 15.10.2019 "Mbi zbatimin e auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë" në AIDA.

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit nr. 801/2, datë 15.10.2019 i miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe u përgatitur nga data 16.10.2019 deri më 25.11.2019.

Auditimi është kryer nga:
1-Znj. M. Ll. (*përgjegjës grupi*),
2-Z. A. K. anëtar,
3- Znj.M. Ll. anëtar
4-Znj. K. F. anëtar,

a) Titulli:
Auditimit Financiar dhe Përputhshmërisë në AIDA.
b) Marrësi:
Ky Raport i adresohet Drejtorit të AIDA-s Z.S.N.

METODOLOGJIA DHE OBJEKTIVAT E AUDITIMIT

a) Objektivat dhe qëllimi i auditimit:
Objekti i këtij auditimi ka për qëllim kryerjen e auditimi financiar dhe të përputhshmërisë (pajtueshmërisë) me qëllim një vlerësim të përgjithshëm të përputhshmërisë së aktivitetet të parashikuara në programin e auditimit me kaudrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe vlerësimin e mjedisit të kontrollit dhe procedurave të kontrollit të lidhura me transaksione individuale. Menaxhimi është përgjegjës për krijimin e një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm që siguron përputhshmërinë me ligjet dhe rregullat.
Çështjet të cilat do të trajtohen në këtë projekt, lidhen me auditimin mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit; zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave; administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare, si dhe auditimin e llogarive vjetore për institucionin (të mbyllura për vitin 2018).
Qëllimi i auditimit është dhënia e opinionit dhe hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Auditimi duke qenë pjesë jetike e një sistemi rregullator, *ka për qëllim* të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndosh financiar si edhe shfrytëzimin me eficencë, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ky sistem bën të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, rritjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara si dhe parandalimin e shkeljeve, me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve.
Objektivat e këtij auditimi konsistojnë në:
- Dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord. Nëse të ardhurat dhe shpenzimet kanë qenë në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin; nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik.
- Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e shpenzimeve dhe të ardhurave janë:

-Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si; përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullsia.

-Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si; ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi.

-Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese si; transaksione, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, klasifikimi dhe kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi.

b) Identifikimi i cështjes:

AIDA, në periudhën objekt auditimi, ka funksionuar me strukturën e miratuar nga Këshilli i Ministrave. Agjencia ka ushtruar veprimtarinë mbështetur në ligjin 10303 datë 27.07.2010 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve" si dhe akte të tjera nënligjorë në zbatim të ligjit.

Veprimtaria kryesore e agencisë është: lehtësimi dhe mbështetja e investimeve të drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë, rritja e aftësisë konkurruese të ndërmarrjeve të vogla e të mesme,si dhe nxitja dhe ndihma ndaj eksporteve të mallrave e të shërbimeve.

Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit nr. 801/2, datë 15.10.2019.

c) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

Drejtimi i AIDA-s është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Drejtimi i AIDA-s është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi menaxherial është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

d) Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të AIDA-s, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Gjithashtu ne krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

e) Kriteret e vlerësimit:

- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*"; nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* ligji nr. 130/2016, datë 15.12.2016 "*Për buxhetin e vitit 2017*", ligji nr. 109/2017, dt. 30.11.2017 "*Për buxhetin e vitit 2018*", ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare",* i ndryshuar, ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 "*Për sigurimet shoqërore në RSH*", të ndryshuar me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014, nr. 7870, datë 13.10.1994 "*Për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", ligji nr. 8869, dt. 22.05.2003 .

e) Standardet e Auditimit

Auditimi bazohet në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", Manualin e Auditimit Përputhshmërisë, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.2015, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit:

- ISSAI 100 (*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik)* që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;

- ISSAI 400 (*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë)* që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 "*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë";*
-ISSAI 1000-2999 "*Udhëzues të Auditimit Financiar*";
-ISSAI 1300 "*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*";
-INTOSAI GOV 9100 "*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik"*;
INTOSAI GOV 9110 "*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*";

i) Metodat e auditimit.

Për arritjen e objektivave, metoda e auditimit u bazua tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në kryerjen e auditimit janë përdorur metoda e bazuar në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, metoda e bazuar në procedurat bazë dhe në procedurat analitike. Pas testimit të kryer, për të kuptuar sesi funksionon sistemi i kontrollit të brendshëm dhe pas marrjes së informacionit në mënyre të përgjithshme, në ushtrimin e auditimit për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar u bënë teste lidhur me zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.
Puna e auditit të brendshëm u bë pjesë efektive e mjedisit të kontrollit, duke dhënë ndihmesë në drejtim të risqeve të punës në mënyrë të strukturuar dhe dha siguri për operacionet dhe procedurat e kontrollit.
Po kështu nga ana jonë u përshkrua legjislacioni autorizues, rregullat e vendosura sipas legjislacionit autorizues, shumat e autorizuara për vitet 2018 dhe 2019, caktimi i përgjegjësisë dhe autoritetit, etj.

j) Dokumentimi i rezultateve të auditimit.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, Manualit të Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.2015 si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 "*Dokumentimi i Auditimit*".

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.
Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesive dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.
Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, rezultateve të akt konstatimeve dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar u përgatit Projekt Raporti i Auditimit, i cili do të jetë materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në **ISSAI 1315**, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.
Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me **ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450,** i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet. Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c)

funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e **testeve të kontrolleve.**

Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vleresimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH aplikon, e konkretisht:

Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të **Riskut të Auditimit prej 5%,** duke shtuar nivelin e procedurave analitike **(ISSAI 1520**) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar si p.sh. krahasimet mes buxheteve dhe realizimit faktik,; *inspektime* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve ne regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/ procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur*; dhe së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

Metodat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:

1. *Kontrolli aritmetik.*

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, ndërkohë që midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)*

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk evidentuan ndonjë gabim aritmetik, regjistrimi mund të jetë i gabuar, nëse evidentimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar*.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u kryen sondazhe të kontrollit fizik të magazinave, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët,

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Dega e Thesarit.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "*jashtë normales*", që përbëjnë tregues të parregullsive kontabile. Mund të përmendim nëse ka: *mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.*

7. Intervistimi

8. Raporte dhe Informacione

9. Pyetësorët për vlerësimin e e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm.

Përputhshmëria me kërkesat ligjore për Raportimin Financiar:

a.-Përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare, në Universitetin e Shkodrës per periudhën 1.1.2018-31.12.2018, është realizuar në mbështetje të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi, në funksion të këtij ligji. Pasqyrat financiare janë dorëzuar brenda afateve të parashikuara në ligjet dhe aktet nënligjore të sipërcituara si edhe shoqërohen me relacion shpjegues (si lista e kreditorëve, e debitorëve, akt-rakordimet me sistemin e Thesarit, si edhe shpjegime të tjera sa i takon evidentimit të transaksioneve në llogaritë respektive).

b.- Për vitin 2018 është vepruar sipas kërkesave të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 "Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme"

II. PËSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm.

Agjencia Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve ka si veprimtari kryesore lehtësimin dhe mbështetjen e investimeve të drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë, rritjen e aftësisë konkurruese të ndërmarrjeve të vogla e të mesme,s i dhe nxitja dhe ndihma ndaj eksporteve të mallrave e të shërbimeve.

Aktivitetet që kanë qenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit nr. 801/2 prot, datë 15.10.2019.

Fushat e auditimit sipas parashikimit në planin e auditimit janë; auditimi i sistemit të kontrollit të brendshëm; auditimi i pajtueshmërisë dhe auditimi financiar.Veprimtaria e kësaj agencie bazohet në ligjin 10303 datë 27.07.2010 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të
Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve" si dhe akte të tjera nënligjorë në zbatim të ligjit.

Nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ky auditim ka një rëndësi të veçantë, për shkak të ndikimit në publik mbi transparencën dhe efektivitetin në përdorimin e fondeve publike dhe procedurave ligjore të ndjekura nga kjo Agjenci.

2. Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit:

a. Objekt i këtij auditimi është rregullshmëria dhe përputhshmëria e operacioneve financiare të AIDA-s përgjatë vitit 2018 dhe 8-mujori 2019;
b. Qëllimi i auditimit: Garantimi i sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të AIDA-s, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit

Fushëveprimi i auditimit: Vlerësimi i aktivitetit të AIDA-s me qëllim dhënien e opinionit,është shtrirë sipas drejtimeve të programit të auditimit. Janë audituar dokumentacionet dhe të dhënat në lidhje me subjektin për periudhën 01.01.2018 – 30.08.2019, ku janë mbuluar me auditim fondet e buxhetit të shtetit, si dhe janë audituar me përzgjedhje transaksionet e ndodhura në periudhën 01.01.2018 – 30.08.2019.

II/a. Përshkrim i shkurtër i Auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), lidhur me vlerësimin e aktivitetit ekonomiko-financiar për ligjshmërinë dhe rregullshmërinë

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi veprimtarinë e AIDA-s Tiranë, duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore, në menaxhimin financiar dhe kontrollin, në hartimin dhe zbatimin e buxhetit, në miratimin e respektimin e strukturës organike dhe të nivelit të pagave sipas klasifikimit të funksioneve, në organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, në administrimin e vlerave materiale e monetare, në prokurimin e fondeve publike etj.

Auditimi u krye me zgjedhje për pasqyrat financiare të vitit 01.01.2018, deri 31.12.2018.

Bazuar të dhënave të marra në subjekt, fondet e trajtuar, botimet në mediat e shkruara, ndjeshmërinë publike dhe të grupeve të interesit, riskun, u identifikuan fushat e auditimit të cilat janë;

a. planifikimi i buxhetit, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të shtetit dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar;

b. marrëdhëniet e punës dhe të pagave, realizimi i fondit të pagave, kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale, krijimi dhe përdorimi i fondit të veçantë, etj.;

c. hartimi dhe plotësimi i pasqyrave financiare përkatëse në përputhje me UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*". Ligjshmëria dhe saktësia e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit;

IV.GJETJET DHE REKOMANDIMET

1. MBI HARTIMIN DHE ZBATIMIN E BUXHETIT TË SHTETIT:

1.a *Zbatimi i kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.*

Pika 1 "Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit"

Auditimi u krye *për periudhën 01.01.2018 deri më 31.07.2019,* duke mbajtur parasysh legjislacionin e mëposhtëm:

- Ligjin me nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016;
- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015;
- Ligji nr.109/2017 "Për buxhetin e vitit 2018";
- Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit".
- VKM nr. 285, datë datë 01.04.2015 "Për tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2016-2018";
- VKM nr. 696, datë datë 31.07.2015 "Për tavanet përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2016-2018";
- Udhëzimi Standard i Ministrisë së Financave nr. 8, datë 02.03.2012 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm";
- Udhëzimi nr. 23, datë 22.11.2016 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm";
- Udhëzimi nr.4, datë 29.02.2016 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019";
- Udhëzimi nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të Zbatimit të Buxhetit" i ndryshuar me udhëzimin nr. 3, datë 16.01.2015;
- Udhëzim nr. 22, datë 17.11.2016 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore";
- Ligji nr.99/2018 "Për buxhetin e vitit 2019".

- Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.9, datë 20.03 2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit"

Hartimi i buxhetit për vitin 2018:

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) është themeluar dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 10303, datë 15.07.2010 "Për krijimin dhe organizimin e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve". Objektivat kryesore janë tërheqja e investimeve të huaja, rritja e konkurrshmërisë së ekonomisë shqiptare nëpërmjet mbështetjes së ndërrmarjeve të vogla dhe të mesme, si dhe inovacioni.

Në zbatim të Ligjit nr.109, datë 30.11.20172017 "Për buxhetin e vitit 2018", Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" me shkresën 19659/1, datë 20.02.2018, Agjencisë Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) i është dërguar detajimi i fondeve buxhetore dhe shpenzimeve kapitale në shumën totale 139,900,000 lekë. Këto fonde janë shpërndarë në programe buxetore.

Referuar ligjit nr. 109/2017 "Për buxhetin e vitit 2018", ndryshuar me Aktin Normativ nr.1 datë 26.07.2018 për vitin 2018, shumat e alokuara në fillim të vitit për secilin program buxhetor me ndryshimet përkatëse dhe realizimi, paraqiten si më poshtë:

Tabela nr.1 *në /lekë*

	Emri I projektit te investimit	Buxheti fillestar 2018	Ndryshimet AN	Buxheti 2018 (I ndryshuar)	Realizimi FAKT	%
-	a	b	c	d	e	f
1	Fondi I pagave	25 600 000	-2 000 000	23 600 000	21 230 225	90%
2	Sigurime shoqërore	5 000 000	-1 000 000	4 000 000	3 453 544	86%
3	Shpenzime operative	19 000 000	-11 000 000	8 000 000	7 377 413	92%
4	Fondi I konkurrueshmerise	28 000 000	-10 207 486	17 792 514	17 601 534	99%
5	Fondi inovacionit	15 000 000	-11 801 156	3 198 844	2 790 000	87%
6	Fondi Start Up	10 000 000	-3 850 000	6 915 000	6 915 000	100%
7	Studim per potencialet e investimeve	1 000 000	-1 000 000	0		
8	Mbeshtetje e biznesit kreativ	10 000 000	-4 000 000	6 000 000	5 893 600	98%
9	Publikim ne revistat ekonomike	2 000 000	-600 000	1 400 000	-	0%
10	Menaxhim I fondeve nepermjet nje moduli elektronik	1 000 000	-600 000	400 000	-	0%
11	Fond I ngrire	13 300 000		13 300 000	-	0%
12	Fond I ngrire	10 000 000	-5 000 000	5 000 000	-	0%
	Totali	**139, 900, 000**	**-61 858 642**	**89 606 358**	**65 261 316**	**73%**

Burimi i të dhënave Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

Gjatë këtij viti, me aktet ligjore e nënligjore, ky buxhet fillestar në vlerën 139,900,000 lekë, është ndryshuar duke u pakësuar me -61,858,642 lekë. Plani i buxhetit përfundimtar i AIDA për vitin 2018 është 89,606,358 lekë ku rezulton i realizuar në vlerën 65,261,316 lekë. Ndryshimet në pakësim të vlerës fillestare janë bërë në të gjitha zërat: Fondi i pagave është ulur në vlerën -2,000,000 lekë, Sigurimet në vlerën -1,000,000 lekë, Shpenzime operative në vlerën -11,000,000 lekë, Fondi inovacionit në vlerën -11,801,156, i Fondi i konkurrueshmerise -10,207,486 lekë, F.S.U -3,850,000 lekë, Studim për potencialet e investimeve ne Shqipëri -1,000,000 lekë, Mbështetje e biznesit kreativ -4,000,000 lekë, publikimet në vlerën -600,000 lekë, Menaxhim i fondeve nëpërmjet një moduli elektronik -600,000 lekë, Fond i ngrire është ulur në vlerë -5,000,000 lekë.

Referuar tabelës së mësipërme rezulton se në asnjë prej zëravë nuk ka tejkalim në realizimin faktik të buxhetit kundrejt planifikimit vjetor. Në total realizimi vjetor është realizuar 73 % e fondeve të alokuara.

Buxheti sipas artikujve buxhetorë paraqitet në tabelën nr.2

Tabela nr. 2 *Realizimi i shpenzimeve* *Viti 2018* *Në / lekë*

Nr.	EMERTIMI	VITI 2018		
		PLAN	FAKT	Në %
1	Paga, art. (600)	25 600 000	21 230 225	90 %
2	Sigurimet shoq. dhe shendets. art.(601)	5 000 000	3 453 544	86%
3	Shpenzime operative, art. (602)	19 000 000	7 377 413	92%
4	Transferta korente te brendshme (604)			
5	Shpenzime transferta me jashte, art. (605)			
6	Transf.per buxhete familjare&individee (606)			

	Nen-Totali Shpenzime Korrente			
1	Investime, art. (230)			
2	Investime , art. (231)	54 606 358	33 277 904	61%
	Nen-Totali Shpenzime Kapitale			
	BUXHETI	**90 206 358**	**65 339 086**	**72%**

Burimi i të dhënave Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

Referuar të dhënave të sipër cituara, artikujt buxhetor paraqiten me mosrealizim. Artikulli paga (600) është realizuar në vlerën 21,230,225 lekë kundrejt planifikimit me vlerë 25,600, 000 lekë ose 90 %, Sigurimet shoqërore art. (601) është realizuar në vlerën 3,453,544 lekë kundrejt planifikimit në vlerën 5,000,000 lekë ose 86 %, Shpenzime operative, art. (602) është realizuar në vlerën 7,377,413 lekë kundrejt planifikimit në vlerën 19,000,000 lekë ose 92 %. Nën totali shpenzime korrente rezulton i realizuar në vlerën 65 339 086 lekë kundrejt planifikimit me vlerë 90,206,358 lekë ose 72 %. Shpenzimet kapitale rezultojnë të realizuara në vlerën 33,277,904 lekë kundrejt planifikimit në vlerën 54,606,358 lekë ose 61 %. Në total buxheti është realizuar në vlerën 65,339,086 lekë kundrejt planifikimit në vlerën 90,206,358 lekë (-24,767,272 lekë) ose 72 %.

Realizimi i shpenzimeve korrente sipas programit paraqitet në tabelën nr.3.

Tabela nr.3 Realizimi i shpenzimeve operative *Në /lekë*

Nr.	Nr Llogari 602	Objekti i prokurimit	Planifikuar 2018	Realizuar 2018	Ne %
	602	**Materiale zyre dhe te pergjithshme**	**650,000**	**1,830,281**	**281%**
1	602.01	Kancelari	400, 000	348 972	87%
2	602.02	Materiale per pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim	100 000	984 203	980%
3	602.03	Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyres	150 000	497 106	331%
4	602.04	Materiale per funksionimin e pajisjeve speciale			
5	602.05	Blerje dokumentacioni			
6	602.09	Furnizime dhe materiale te tjera zyre dhe te pergjishme			
	602.1	**Materiale dhe sherbime speciale**	**100,000**	**-**	**-**
7	602.1001	Uniforma dhe veshje te tjera speciale			
8	602.1002	Plehra kimike, furnitura veterinare, farera, fidane e te tjera			
9	602.1003	Ilaçe, materiale dhe proteza mjekesore			
10	602.1007	Libra dhe publikime profesionale	100 000	-	-
11	602.1009	Materiale dhe pajisje labratorike te sherbimit publik			
12	602.101	Shpenzime per prodhim dokumentacioni specifik			
13	602.1011	Softe informatike me karakter te pergjithshem			
14	602.1099	Te tjera materiale dhe sherbime speciale			
	602.2	**Sherbime nga te trete**	**1,670,000**	**-**	**-**
15	602.2001	Elektricitet			
16	**602.2002**	**Uje**			
17	602.2003	Sherbime telefonike	500 000	-	-
18		Sherbim interneti	100 000	-	-
19		Telefoni Celulare			
20	602.2004	Posta dhe sherbimi korrier	120 000	-	-
21	602.2007	Sherbimet bankare			
22	602.2008	Sherbime te sigurimit dhe ruajtjes			
23	602.201	Sherbime te printimit dhe publikimit	800 000	-	-
24	602.2011	Kosto e trajnimit dhe seminareve			
25	602.2099	Sherbime te tjera	150 000	-	-
	602.3	**Shpenzime transporti**	**100,000**	**309,000**	309 %
26	602.31	Karburant dhe vaj			
27	602.32	Pjese kembimi, goma dhe bateri	30 000	-	
28	602.33	Shpenzimet e siguracionit te mjeteve te transportit	70 000	-	
29	602.39	Shpenzime te tjera transporti		309 000	
	602.4	**Shpenzime udhetimi**	**5,900,000**	**3,046,705**	52%
30	602.4	Udhetim i brendshem	400 000	-	
31	602.41	Udhetim jashte shtetit	5 500 000	3 046 705	86%
	602.5	**Shpenzime per mirembajtje te zakonshme**	**1,260,000**	**-**	**-**
32	602.5	Shpenzime per mirembajtjen e tokave			
33	602.52	Shpenzime per mirembajtjen e objekteve ndertimore			
34	602.53	Shpenzime per riparim i rrjetit te ajrit te kondicionuar			
35	602.54	Shpenzime per mirembajtjen e aparateve,	900 000	-	-
36	602.55	Shpenzime per mirembajtjen e mjeteve te transportit	60 000	-	-
37	602.58	Shpenzime per mirembajtjen e paisjeve te zyrave	300 000	-	-
	602.6	**Shpenzime per qeramarrje**	**1,820,000**	**107,200**	6%
38	602.61	Shpenzime per qeramarrje ambjentesh	1 260 000	107 200	
39	602.63	Shpenzime per qeramarrje per aparate	300 000	-	
40	602.64	Shpenzime qeramarrje mjetesh transporti	260 000	-	
	602.7	**Shpenzime per vendime gjygji**	-	-	
	602.9	**Shpenzime te tjera operative**	**4 500 000**	**219,910**	4.8%

41	602.9001	Shpenzime per pritje e percjellje	100 000	-	
	602.9001	Shpenzime gjygjesore	300 000	219 910	
42	602.9005	Shpenzime per honorare		-	
43	602.9007	Shpenzime per pjesmarrje ne konferenca	4 000 000	-	
44	602.9	Shpenzime per tatime & taksa	100 000	-	
Shuma Mallra dhe Sherbime			**16,000,000**	**5,516,096**	
Detyrime					
Totali Mallra dhe Sherbime					

Burimi i të dhënave Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

Referuar të dhënave të tabelës së mësipërme rezulton se për vitin 2018, për zërin shpenzime operative në nxjerrjen e të dhënave vjetore, nuk është reflektuar zbritja e vlerës -11,000,000 lekë në këto shpenzime ulur me aktin normativ nr.1 datë 26.07.2018 për vitin 2018, nga vlera fillestare 19,000,000 lekë të miratuar me ligjin nr.109, datë 30.11.20172017 "Për buxhetin e vitit 2018", dërguar nga Ministria e Financave me shkresën 19659/1, datë 20.02.2018. Si rrjedhojë e këtij veprimi, grupi i auditimit nuk është në gjendje të nxjerrë një përfundim të saktë mbi realizimin e shpenzimeve operative për vitin 2018. Nga auditimi mbi realizimin e shpenzimeve operative për faktin e vitit 2018, u konstatua se, në llogarinë 602.3 shpenzime transporti janë shpenzuar 309,000 lekë, në nënzërin shpenzime të tjera transporti të paplanifikuara ne buxhet. Institucioni nuk ka bërë asnjë likuidim të shpenzimeve për llogarinë 602.2001 Elektricitet dhe llogarinë 602.2002 Ujë.
Për veprimet e sipër cituara të kryera në kundërshtim me Ligjin nr.109, datë 30.11.20172017 "Për buxhetin e vitit 2018", Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", ngarkohet me përgjegjësi Stefani Sotiri, me detyrë ish Përgjegjëse e Sektorit të Financës.

Hartimi i buxhetit për vitin 2019:

Në zbatim të Ligjit nr.89/2018 "Për buxhetin e vitit 2019", Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.9, datë 20.03 2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" me shkresën 22760, datë 27.12.2018, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve i është dërguar nga MF detajimi i fondeve buxhetore dhe shpenzimeve kapitale në shumën totale 140,100,000 lekë.
Referuar ligjit nr.89/2018 "Për buxhetin e vitit 2019", shumat e alokuara në fillim të vitit për secilin zë buxhetor nuk kanë pësuar ndryshime dhe realizimi, paraqiten si më poshtë:

	PROGRAMET	Buxheti fillestar 2019	Ndryshimet AN	Plani 2019	Realizimi FAKT	%
	a	b	c	d	e	f
1	Planifikim menaxhim administrim	140 100 000		140 100 000	34 877 934	25%
2	Paga 600	25 860 000		25 860 000	12 942 366	50%
3	Sigurime 601	4 840 000		4 840 000	2 084 555	43%
4	Shpenzime operative 602	19 000 000		19 000 000	8 676 941	46%
5	Fondi I vecante 606	100 000		100 000	30 000	30%
6	Fondi Inovacionit 230	15 000 000		15 000 000	3 644 070	24%
7	Fondi Start up 231	10 000 000		10 000 000	4 000 000	40%
8	Fondi ekonomia kreative 231	10 000 000		10 000 000	3 500 000	35%
9	Fondi I konkurrueshmerise 231	38 000 000		38 000 000	0	0%
10	Fondi I ngrire (Pajisje kompjuterike) 231	17 300 000		17 300 000	0	0%
	Totali	**140 100 000**		**140 100 000**	**34 877 934**	**25%**

Burimi i të dhënave Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

Gjatë shtatë mujorit të vitit 2019, buxhet fillestar në vlerën 140,100,000 lekë, nuk ka pësuar ndryshime. Në total realizimi 7 mujor është realizuar 25 % e fondeve të alokuara.
Buxheti sipas artikujve buxhetorë paraqitet në tabelën nr.2

Tabela nr. 2 *Realizimi i shpenzimeve* *Viti 2019* 7 mujori *Në / lekë*

Nr.	EMERTIMI	VITI 2019		
		PLAN	FAKT	Në %
1	Paga, art. (600)	25 860 000	12 942 366	50%
2	Sigurimet shoq. dhe shendets. art.(601)	4 840 000	2 084 555	43%
3	Shpenzime operative, art. (602)	19 000 000	8 676 941	46%
4	Transferta korente te brendshme (604)			
5	Shpenzime transferta me jashte, art. (605)			
6	Transf.per buxhete familjare&individee (606)	100 000	30 000	30%
	Nen-Totali Shpenzime Korrente	**49,800,000**	**23,733,862**	**49**

1	Investime, art. (230)	15 000 000	3 644 072	24%
2	Investime , art. (231)	75 300 000	7 500 000	10%
	Nen-Totali Shpenzime Kapitale	**90,300,000**	**11,144,072**	12%
	BUXHETI	**140 100 000**	**34 877 934**	**25%**

Burimi i të dhënave Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

Referuar të dhënave të sipër cituara, artikujt buxhetor paraqiten me mosrealizim. Artikulli paga (600) është realizuar në vlerën 12,942,366 lekë kundrejt planifikimit me vlerë 25,860,000 lekë ose 50 %, Sigurimet shoqërore art. (601) është realizuar në vlerën 2,084,555 lekë kundrejt planifikimit në vlerën 4,840,000 lekë ose 43 %, Shpenzime operative, art. (602) është realizuar në vlerën 8,676,941 lekë kundrejt planifikimit në vlerën 19,000,000 lekë ose 46 %. Nën totali shpenzime korrente rezulton i realizuar në vlerën 23,733,862 lekë kundrejt planifikimit me vlerë 49,800,000 lekë ose 49 %. Shpenzimet kapitale rezultojnë të realizuara në vlerën 11,144,072 lekë kundrejt planifikimit në vlerën 90,300,000 lekë ose 12 %. Në total buxheti për shtatë mujorin e vitit 2019 është realizuar në vlerën 34,877,934 lekë kundrejt planifikimit në vlerën 140,100,000 lekë (-105,222,066 lekë) ose 25 %.

Tabela nr.3 Realizimi i shpenzimeve operative *Në /lekë*

Nr.	Nr Llogari 602	Objekti i prokurimit	Planifikuar 2019	Realizuar 2019	Ne %
	602	**Materiale zyre dhe te pergjithshme**	**425,880**	**218,820**	**51%**
1	602.01	Kancelari	73 200	73 200	100%
2	602.02	Materiale per pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim	52 680	0	0
3	602.03	Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyres	300 000	145 620	48%
4	602.04	Materiale per funksionimin e pajisjeve speciale			
5	602.05	Blerje dokumentacioni			
6	602.09	Furnizime dhe materiale te tjera zyre dhe te pergjishme			
	602.1	**Materiale dhe sherbime speciale**	**333,000**	**120,000**	**36%**
7	602.1001	Uniforma dhe veshje te tjera speciale			
8	602.1002	Plehra kimike, furnitura veterinare, farera, fidane e te tjera			
9	602.1003	Ilaçe, materiale dhe proteza mjekesore			
10	602.1007	Libra dhe publikime profesionale	300 000	120 000	40%
11	602.1009	Materiale dhe pajisje labratorike te sherbimit publik			
12	602.101	Shpenzime per prodhim dokumentacioni specifik			
13	602.1011	Softe informatike me karakter te pergjithshem			
14	602.1099	Te tjera materiale dhe sherbime speciale			
	602.2	**Sherbime nga te trete**	**990,000**	**91,782**	**0,92%**
15	602.2001	Elektricitet			
16	**602.2002**	**Uje**			
17	602.2003	Sherbime telefonike	155 000	75 797	49%
18		Sherbim interneti			
19		Telefoni Celulare			
20	602.2004	Posta dhe sherbimi korrier	35 000	16 185	46%
21	602.2007	Sherbimet bankare			
22	602.2008	Sherbime te sigurimit dhe ruajtjes			
23	602.201	Sherbime te printimit dhe publikimit	800 000	-	0
24	602.2011	Kosto e trajnimit dhe seminareve			
25	602.2099	Sherbime te tjera			
	602.3	**Shpenzime transporti**	**1,804,952**	**1,304,952**	**72%**
26	602.31	Karburant dhe vaj	810 000	810 000	100%
27	602.32	Pjese kembimi, goma dhe bateri			
28	602.33	Shpenzimet e siguracionit te mjeteve te transportit	174 000	174 000	100%
29	602.39	Shpenzime te tjera transporti	820 952	320 952	39%
	602.4	**Shpenzime udhetimi**	**6,619,436**	**3,792,395**	**57%**
30	602.4	Udhetim i brendshem	201 000	71 500	35%
31	602.41	Udhetim jashte shtetit	6 418 436	3 720 895	58%
	602.5	**Shpenzime per mirembajtje te zakonshme**	**125,000**	**75,000**	**60%**
32	602.5	Shpenzime per mirembajtjen e tokave			
33	602.52	Shpenzime per mirembajtjen e objekteve ndertimore			
34	602.53	Shpenzime per riparim i rrjetit te ajrit te kondicionuar			
35	602.54	Shpenzime per mirembajtjen e aparateve,			
36	602.55	Shpenzime per mirembajtjen e mjeteve te transportit	75 000	75 000	100%
37	602.58	Shpenzime per mirembajtjen e paisjeve te zyrave	50 000	0	0
	602.6	**Shpenzime per qeramarrje**	**2,211,700**	**1,321,700**	**60%**
38	602.61	Shpenzime per qeramarrje ambjentesh	2 011 700	1 121 700	56%
39	602.63	Shpenzime per qeramarrje per aparate			
40	602.69	Shpenzime te tjera qeraje			
	602.7	**Shpenzime per vendime gjygji**	200 000	200 000	100%
	602.9	**Shpenzime te tjera operative**	**6,523,032**	**1,840,016**	**28%**
41	602.9001	Shpenzime per pritje e percjellje	272 236	115 100	42%

	602.9001	Shpenzime gjygjesore			
42	602.9005	Shpenzime per honorare			
43	602.9007	Shpenzime per pjesmarrje ne konferenca	6 180 000	1 691 207	26%
44	602.9	Shpenzime per tatime & taksa	70 796	33 709	47%
Shuma Mallra dhe Sherbime			**19 000 000**	**8,827,865**	**46%**
Detyrime					
Totali Mallra dhe Sherbime					

Burimi i të dhënave: Sektori i Financës

Referuar të dhënave të mësipërme rezulton se për vitin 2019 nga 19,000,000 lekë të planifikuara për tu shpenzuar sipas zëravë janë shpenzuar për shtatë mujorin 8,827,865 lekë ose 46% e planifikimit. Konstatohet se Institucioni nuk ka bërë asnjë likuidim të shpenzimeve për llogarinë 602.2001 Elektricitet dhe llogarinë 602.2002 Ujë. Nuk konstatohet tejkalim i shpenzimeve ne asnjë zë të planifikuar.

Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi, mungojnë raportet periodike katër mujore për monitorimin e buxhetit të vitit 2018 si dhe katër mujori i parë i vitit 2019.
Raportet e monitorimit të buxhetit për vitin 2018 dhe tetë mujorin e vitit 2019, të cilat AIDA i ka paraqitur në Ministrisë e Financave, nuk janë të plotësuara me një informacion të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, në kundërshtim me kreun IV "*Monitorimi*", të Udhëzimit nr. 9, dt. 20.03.2018 "*Përprocedurat standarte të zbatimin e buxhetit*" të Ministrisë së Financave si dhe udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore", ku citohet se " *Raporti i monitorimit i përgatitur nga institucionet duhet te përmbajë:*
- Shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli;
- Shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë;
- Argumentet që lidhen me mosrealizimin e produkteve duke paraqitur masat që parashi-kohen në të ardhmen për realizimin e tyre, si edhe analiza e kostos së produkteve, duke paraqitur shpjegimet përkatëse në rastin e kostove shtesë të realizuara;
Në raportet e monitorimit mungojnë argumentet e plota në lidhje me mosrealizimet dhe masat që parashikohen në të ardhmen për realizimi e tyre. AIDA nuk ka bërë publikimin e raporteve të monitorimit në faqen zyrtare.

2. ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE PËR MARRËDHËNIET E PUNËS DHE PAGAVE RESPEKTIMIN E STRUKTURAVE ORGANIKE TË MIRATUARA DHE KRAHASIMIN ME FAKTIN.

Në zbatim të pikës nr. 2 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
- Struktura organizative e AIDA-s dhe krahasimi me faktin,
- Plani i nevojave për rekrutimin e personelit,
- Pagesa e përfituara nga fondi i veçantë,
-Vendimet e gjykatës për punonjësit e larguar nga shërbimi civil si dhe masat e marra nga institucioni në rastin ku punonjësi i larguar ka marrë një vendim të formës së prerë për pagesën e pagës deri në rikthimin e tij në punë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipër cituar, u konstatua se:

a.Ngritja dhe funksionimi i Bordit Drejtues.

Nga auditimi i dokumentacionit ligjor vënë në dispozion nga subjekti, nga audituesit e Klsh-së për ngritjen dhe funksionimin e Bordit Drejtues u konstatua se :
Me vendimin Nr.2, datë 04.02.2011 Bordi Drejtuesi AIDA- s, i ndryshuar me vendimin datë 25.03.2019, pasi ka shqyrtuar projektstatutin e AIDA-s në zbatim të nenit 12/c të ligjit nr.10303, datë 15.07.2011 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të AIDA-s ka vendosur miratimin e statutit të AIDA-s. Në kreun 1, neni 2 "statusi juridik", thekson që Agjencia është person juridik dhe drejtohet nga Bordi Drejtues, referuar nenenve 13,14,15,16,17,18,19,20. Më konkretisht:
Përbërja e Bordit Drejtues përbëhet nga përfaqësues të institucioneve qendrore dhe të sektorit ekonomik privat, i cili kryesohet nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë dhe ka në përbërje:
1-Ministrin përgjegjëssë Ekonomisë (nënkryetar)
2-Ministrin përgjegjës së Financave

3-Ministrin përgjegjës së Bujqësisë
4- Ministrin përgjegjës së Turizmit
5-Ministrin përgjegjës së punëve publike

Anëtarët e B.D zgjedhin dhe katër përfaqësues nga sektori ekonomik , privat, i cili bëhët në bazë të Nenit 12, Pika 13 e ligjit 10303, datë 15.07.2010 "Për krijimin dhe mënyrën e funksionimit të AIDA-s". Mandati i anëtarëve të B.D nga sektori privat zgjat 4 vjet, në përfundim të mandatit, mund të rizgjidhet në përputhje me kriteret dhe procedurat e VKM-së nr.78, datë 15.09.2010 " Për përcaktimin e procedurës dhe kritereve për përzgjedhjen e Anëtarëverë B.D të AIDA-s, nga sektori ekonomik privat dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të bordit."

Kompetencat e B.D referuar nenit 14 konsistojnë në:

- Përshtat politikat qeveritare në veprimtarinë e Agjencisë.
- Emëron dhe shkarkon D.E.
- Miraton programin financiar dhe vjetor të Agjencisë , duke ja dërguar Ministrisë së Financave për ta përfshirë në programin e saj buxhetor.
- Miraton statutin e Agjencisë dhe aktet më të rëndësishme dhe aktet më të rëndësishme për organizmin dhe funksionimin e saj
- Propozon politika të reja
- Miraton rregulloren e funksionimit të Agjencisë dhe kriteret bazë të punësimit të personelit
- I paraqet cdo muaj, Këshillit të Ministrave , një raport në lidhje me vështirësitë dhe pengesat të cilat vështirësojnë tërheqjen e investimeve të huaja ,rritjen e eksporteve,konkurrencë e lirë dhe rinovimin e bizneseve, shoqëruar me rekomandimet për masat që duhen marrë për eliminimin e këtyre pengesave.
- Vendos për cështjet e tjera, të parashikuara në ligjin në statut.

Në referencë të nenit 15, Bordi Drejtues është mbledhur në mënyrë periodike, të paktën një herë në tre muaj ose sa herë që e kërkon interesi i Agjencisë. Thirret nga Kryetari, i cili thërret mbledhjen e Bordit Drejtues, kur kjo kërkohet nga të paktën 3 anëtarë të Bordit, thirrje kjo e cila bëhet 10 (dhjetë) ditë para datës së caktuar për mbledhje. Mbledhjet e Bordit janë të vlefshme kur janë prezent më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Kryetari drejton mbledhjen e Bordit, në mungesë të tij , mbledhja drejtohet nga Nënkryetari i Bordit Drejtues, ose në mungesë të tij nga një anëtar , i caktuar nga Kryetari i Bordit Drejtues. Bordi Drejtues mblidhet në selinë e Agjencisë ose në një vend tjetër të caktuar në njoftim. Anëtarët kanë detyrim të ruajnë konfidencialitetin e të dhenave dhe informacioneve, objekt i njoftimit ose që diskutohen në mbledhje. Kryetari cakton një sekretar, i cili mban regjistrin e prezencës së anëtarëve dhe përpilon procesverbalin e mbledhjes së Bordit Drejtues, të cilët në fund të mbledhjes firmosen nga Kryetari dhe anëtarët e pranishëm dhe depozitohen në Agjenci në një regjistër të posacëm. Vendimet e Bordit Drejtues si dhe njoftimet e organeve të Agjencisë publikohen në faqen e internetit të Agjencisë, qoftë edhe në mënyrë të përmbledhur, brenda 10(dhjetë) ditëve nga data e mbajtjes ose marrjes së tyre.

Vendimarrja e Bordit bazuar në neni16, është bëre me konsensus dhe nuk paraqiten raste ku nuk është arritur ky konsensus,pasi vendimet e Bordit Drejtues janë të vlefshme kur votojnë pro më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

Për sa sipër cituar, nga auditmi u konstatua se është ngritur Bordi Drejtues dhe në përgjithësi ka funksionuar në bazë të ligjit nr.10303, datë 15.07.2011 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të AIDA-s.

b.Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin.

Në bazë të auditimit të kryer mbi "respektimin e strukturës organike të miratuar dhe krahasimi me faktin u konstatua se urdhëri i brendshëm Nr.69, datë 31.05.2019 është në përputhje me vendimin e Kryeministrit Nr.3, datë 07.06.2019, si ana e numrit të punonjësve por edhe të kategorisë së pagës.

Me vendimin Nr.1, datë 12.01.2016 në mbështetje të ligjit nr.10303, datë 15.07.2011 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të AIDA-s", statutit të AIDA, bordi drejtues ka vendosur miratimin e strukturës dhe organikës të AIDA.

Në strukturën e AIDA-s ka 39 punonjës ,por për vitin ushtrimor 2018 në strukturë ka vetem 32 punonjës, të cilët ushtrojne detyrën e tyre, ndërsa 7 vende të tjera pune gjatë gjithë vitit kanë qënë vakante. Vende të lira pune, për të cilat nuk është bërë kërkesë nga AIDA për tu plotësuar.
Organika e institucionit për vitin 2018 paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Organika e AIDA për vitin 2018				**Vende Vakante**	
Drejtori Ekzekutiv.					
1.Drejtoria BRIC & Marketing.					
Drejtori.					1
Sektorët.		**nr.i Punonjësve.**			
1.Sektori I Projekteve		2			
2.Sektori I Promocionit Inovativ.		2			1
3.Sektori PR 7 Marketing.		3			
2.Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.					
Drejtori					
1.Sektori Administrim dhe Financë		5			
2.Sektori ligjor &BNJ.		2			2
3.Drejtoria e Investimeve.					
Drejtori					
1.Sektori I Zhvillimit të Investimeve		5			1
2.Sektori After Care		3			1
3.Sektori I Pronësisë dhe Zhvillimit Rajonal		3			1
4.Sektori One-Stop-Shop		4			
4.Drejtoria SME dhe Eksporte.					
Drejtori					1
1.Sektori I SME.		3			
2.Sektori I Zhvillimit të Eksporteve.		2			
Totali I Sektorëve.	11	Totali I nr. Pnj.	39	Totali I v.vak.	7

Nga krahasimi i strukturës organike për vitin 2018 të miratuar me vendim të B.D me faktin u konstatua se :
Për periudhën e auditimit në AIDA, rezulton që detyrën e ka kryer vetëm Drejtori i Departamentit i "Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse", pasi Sektori Ligjor dhe i Burimeve Njerëzore nuk ka patur specialistët përkatës(vendi vakant). Konstatohet se në **sektorin e Projekteve. sektorin e Promocionit Inovativ, sektorin PR & Marketing, sektori Ligjor&BNJ** dhe në **sektorin e Zhvillimit të Eksporteve** të strukturës së vitit 2018 dhe për strukturën e vitit 2019 në **Drejtorinë Marketing dhe Kërkim Analize**, **Drejtorinë e Koordinimit**, si dhe **në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse** nuk ka pozicion pune për të kryer funksionin e përgjegjësit të sektorit.
Rekrutimi i punonjësve në AIDA përcaktohet në rregulloren e institucionit neni 9 *"kriteret e përzgjedhjes së punonjësve"*
-Punonjësit e AIDA-s punësohen mbi bazën e konkurrimit dhe intervistave nga një komision i ngritur nga Drejtori Ekzekutiv, rast pas rasti.
- Komisioni përbëhet nga 3 anëtarë. D. E. ka cilësinë e kryetarit të këtij komisioni
- Parimet bazë mbi të cilat mbështetet përzgjedhja e punonjësve janë formimi arsimor, professional, përvoja e tyre dhe specifikat e punës.

Nga auditimi i dokumenteve që na u vu në dispozicion nga stafi i AIDA nuk gjendeshin dokumentet e rekrutimit sipas fazave të sipërmendura pra procedurat e rekrutimit nuk janë kryer në përputhje me rregulloren.

Për periudhën në auditim Janar-Korrik 2019, duke u bazuar ne struktuën e AIDA-s , u konstatua se përbëhet nga 39 punonjës, vazhdon të ketë 7 vende vakante pune, por në pozicione të ndryshme. Gjatë kësaj periudhe numri i punonjësve është 32.

Tabela me të dhënat:

Organika e AIDA për 7-mujorin e parë të vitit 2019				**Vende Vakante**	
Drejtori Ekzekutiv.					
1.Drejtoria e Investimeve					
Drejtori.					
Sektorët.		**nr.i Punonjësve.**			
1.Sektori I Investimeve dhe After Care		8		3	
2.Sektori One Stop.		4		1	
2.Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë					
Drejtori					
		5			
3.Drejtoria Koordinimit					
Drejtori					
		4			
4.Sektori One-Stop-Shop		4			
4.Drejtoria e NVM dhe Projekteve					
Drejtori				1	
1.Sektori INVM dhe Eksporteve		4			
2.Sektori I Inovacionit dhe Projekteve		3			
5.Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.					
		8		2	
Totali I Sektorëve.	11	Totali I nr. Pnj.	39	Totali I v.vak.	7

Ndryshimi i strukturës me vendim nr.3, datë 17.06.2019 " Për miratimin e niveleve të pagave dhe të strukturës e organikës së AIDA-s" ka sjellë ndryshim për specialistin e Burimeve Njerëzore, pasi është caktuar në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse si : specialist i Burimeve Njerëzore. Nga shqyrtimit i dosjeve personale me përzgjedhje të punonjësve të AIDA-s, rezultoi se pozicioni i punës që ato ushtrojnë përputhet me kualifikimin e tyre.

Në rregulloren e brendshme është përcaktuar përshkrimi i punës. U konstatua që dosja me përshkrimin e punës dhe klasifimin e pozicioneve të punës është në pëputhje me përmbajtjen e rregullores së brendshme.

c.Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve.

Në bazë të auditimit në AIDA në zbatim të pikës nr. 2 të programit të auditimit, u kërkua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Kontratat e punës për secilin punonjës.
- Listë prezencat në punë.
- Listëpagesat dhe libri i pagave për periudhën ushtrimore të vitit 2018 dhe 7-mujorin e parë të vitit 2019.
-Shkresa për ndryshimin e statusit , nga Shërbimi Civil në Kod pune.

Nga auditimi mbi rregullshmërinë financiare në AIDA-s në zbatim të pikës 2 të drejtimeve kryesore të programit të auditimit, mbi "Respektimin e dispozitave ligjore për pagat e punonjësve" ka rezultuar si më poshtë:

Nga auditimi me përzgjedhje i listë pagesave të vitit 2018 dhe periudhën Janar-Korrik 2019, rezultoi që kishte përputhshmëri në përllogaritjen e pagave të punonjësve me pozicione të ndryshme, konkretisht :

1- Drejtor Ekzekutiv
2- Drejtor drejtorie
3- Përgjegjës sektori
4- Specialist
5- Arkiv/Protokoll
6- Punonjës pastrimi
7- Shofer

Tabela me të dhënat:

Pozicioni	Kategoria
Titullari I AIDA-s	II-a
Drejtor Drejtorie	II-b
Përgjegjës Sektori në sektorët e përmbajtjes	III-a
Përgjegjës sektori	III-a/1
Specialist në sektorët e përmbajtjes.	IV-a
Specialist	IV-b

Në bazë të vendimi nr.1, datë 14.02.2018 "*Për Miratimin E Nivelit Të Pagave Të Punonjësve Të Agjencisë Shqiptaretë Zhvillimit Të Investimeve*", në mbështjetje të pikës 2,të nenit 4, të Ligjit nr.10303,datë 15.07.2010 " Për krijimin dhe mënyrën e Organizmit dhe të Funksionimit të AIDA-s dhe Statutit të AIDA-s , Bordi Drejtues I AIDA-s ka vendosur që:

1-Pagat e nëpunësve të AIDA të jenë të njëjta me pagat e punonjësve të institucioneve të tjera të grupit të parë të varësisë së ministrisë së linjës, sipas lidhjes nr.6 të VKM nr.187/2017, I ndryshuar.

2- Pagat e stafit mbështetës të AIDA të jenë të njëjta me pagat e punonjësve të institucioneve të tjera në varësi të ministrisë së linjës, sipas lidhjes nr.1 të VKM nr.717/2009, I ndryshuar.

3-Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi I kërij vendimi, përballohen nga buxheti I AIDA.

Referuar vendimit nr.1, datë 25.03.2019 për një ndryshim në vendimin nr.2, datë 04.01.2011,"Për Miratimin E Statutit Të Agjencisë Shqiptare Të Zhvillimit Të Investimeve", në mbështetje të pikës 1, të nenit 4 dhe 11, të Ligjit nr.10303, datë 15.07.2010," Për krijimin dhe mënyrën e funksionimit dhe organizimit të AIDA-s", Bordi Drejtues ka vendosur :

1-Neni 25, "Administrata e Agjencisë", zëvendësohet si vijon :

Neni 25, " Marrëdhëniet e punës për punonjësit e Agjencisë"

Marrëdhëniet e punës së punonjësve të AIDA-s të rregullohen me Kodin e Punës.

Kërkesat specifike të pozicioneve të punës së AIDA-s, miratohen me urdhër të Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë.

Përzgjedhja e kandidatëvepëe punësim në AIDA,kryhet si rregull nëpërmjet konkurrimit bazuar në kërkesat specifike të pozicioneve të punës. Procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve menaxhohet nga njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të AIDA-s.

Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, shpall njoftimin për vendet e lira ne faqen zyrtare të AIDA-s jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë para ditës së caktuar për zhvillimin e konkursit.

Njoftimin për vende të lira.

Referuar vendimit nr.3, datë 17.06.2019 për "Miratimin e nivelit të pagave dhe të strukturës e organikës së AIDA-s në mbështetje të pikës 2, të nenit 4 dhe të nenit 11, të ligjit Nr.10303, datë 15.07.2010 "Për krijimin dhe mënyrën e Organizmit dhe të Funksionimit të AIDA-s", Bordi Drejtues i AIDA-s ka vendosur që:

1-Kategoritë e pagave dhe grupet e diplomave për nëpunesit e AIDA, të jenë sipas lidhjeve nr.1 dhe 2 ,që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2-Elementët e pagës janë si vijon:

a.Pagat e grupit; b.Shtesa për vjetërsi në punë; c.Shtesa për pozicion.

3-Për natyrë të vëcantë pune i jepet një shtesë mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse si vijon:

a.Nëpunësi ne pozicion 'Titullar i AIDA-s' në masën 20.000 (njëzetëmijë) lekë/muaj.

Nëpunësi ne pozicionet 'Drejtor Drejtorie', të drejtorive të përmbajtjes, në masën 15.000 (pesëmbëshjetëmijë) lekë/muaj.

c.Nëpunësi në pozicionet 'Përgjegjës Sektori'në sektorët apo drejtoritë e përmbajtjes, në masën 15.000(pesëmbëdhjetëmijë) lekë/muaj.

Nëpunësi në pozicionet 'Specialist', në sektorët apo drejtoritë e përmbajtjes në masën 15.000(pesëmbëdhjetëmijë) lekë/muaj.

4-Struktura dhe organika e AIDA-s,miratuar me vendimin Nr.1,datë 12.01.2016, të Bordit Drejtues, shfuqizohet

Nga auditimi me zgjedhje i listëpagesave rezultoi se janë shoqëruar me listë prezencat në punë, të përgatitura nga sektori i personelit dhe janë nënshkruar nga secili punonjës ,drejtuar drejtorit të drejtorive përkatëse dhe firmosur më pas nga drejtori i shërbimeve mbështetëse. Për vitin 2018 dhe 2019 ka ndjekur procesin e vlerësimit 6-mujor të performancës për punonjësit e AIDA. Nga 39 punonjës në fakt që janë në stukturën e AIDA-s,ku specilalistët vlerësohen nga pergjegjësit e tyre dhe përgjegjësit nga drejtorët përkates sipas drejtorive, në fund të 6 mujorit të parë dhe të dytë të vitit 2018 është bërë vlerësimi përkatësisht për 32 punonjës , nga të cilët për 6 mujorin e parë të vitit 2018, 70% e tyre janë vlerësuar nga eprorët me nivelin "2" mirë dhe 30% e tyre janë vlerësuar me nivelin "1" shumë mire, dhe për 6 mujorin e dytë të vitit 2018, kanë patur këto vlerësime.Vlerësimi për 6 mujorin e vitit 2019 ka të njëjtën vazhdimësi sikurse në vitin 2018.

Për shkak se marrëdhëniet e punës së punonjësve të AIDA-s rregullohen me Kodin e Punës sopas vendimit nr.1, datë 25.03.2019 të Bordit Drejtues për një ndryshim në vendimin nr.2, datë 04.01.2011,"Për Miratimin E Statutit Të Agjencisë Shqiptare Të Zhvillimit Të Investimeve", në mbështetje të pikës 1, të nenit 4 dhe 11, të Ligjit nr.10303, datë 15.07.2010," Për krijimin dhe mënyrën e funksionimit dhe organizimit të AIDA-s",Neni 25, " Marrëdhëniet e punës për punonjësit e Agjencisë" konstatohet se përgjatë vitit 2018 në varësi të nevojave për rekrutim në shërbimin civil u konstatua se, AIDA nuk ka dërguar në DAP planin e konsoliduar të nevojave të Agjencisë, në kundërshtim me VKM nr. 108, datë 26.02.2014 "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil", Pika 6 "*Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në... ministri hartojnë planin e konsoliduar të nevojave për rekrutim për të gjithë sistemin përkatës që përfshin aparatin e tij dhe institucionet e varësisë*", si dhe Pika 7 "..... brenda muajit nëntor, i dërgon *Departamentit të Administratës Publike planin e konsoliduar të nevojave për pranim për të gjithë sistemin përkatës*".

Për vitin 2018 nuk është dërguar një plan vjetor nevojash për rekrutim për aparatin në drejtim të DAP nuk janë dërguar në mënyrë të njëpasnjëshme shpalljet për vende të lira për AIDA-n në aplikacionin e krijuar nga DAP administrata.gov.al për publikimin e vendeve vakante. Mos dërgimi i një plani fillestar vjetor të nevojave bie në kundërshtim me VKM nr. 108, datë 26.2.2014, Pika 6 "*Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në... ministri hartojnë planin e konsoliduar të nevojave për rekrutim për të gjithë sistemin përkatës që përfshin aparatin e tij dhe institucionet e varësisë*".

- *Zbatimi i vendimeve të gjykatës*

Në zbatim të nenit 66/1 të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar dhe Urdhrit nr. 5151, datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike "*Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil*", AIDA nuk ka krijuar bazën e të dhënave si dhe nuk ka ndonjë urdhër "Për ngritjen e komisionit të posaçëm për zbatimin e vendimeve të formës së prerë në AIDA", *"Për shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave të reja të lindura pas marrjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë.*

Ky komision me cilësinë e organit kolegjial për çdo vit duhet të marrë në shqyrtim të gjitha faktet dhe rrethanat e lindura për ekzekutimin e vendimeve për punonjësit e larguar padrejtësisht nga puna si dhe t'i drejtohej DAP për të regjistruar gjyqëfituesit në listë pritje deri në mundësinë e sistemimit të tyre.

U audituan me zgjedhje listëpagesat e muajve janar, AIDA, qershor, shtator, tetor dhe dhjetor për vitin 2018, si dhe listëpagesat janar-AIDA-qershor-korrik 2019. Në listëpagesat e zgjedhura u audituan numri i punonjësve të paguar me kohë të plotë dhe kontratë të përkohshme, paga sipas funksionit, shtesat e veçanta, prezenca, vjetërsia, llogaritja e ndalesave të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhrat personale, etj. Nga auditimi me zgjedhje i listëpagesave rezultoi se për vitin 2019, listëpagesa është përgatitur nga sektori i financës (konfirmuar nga specialist, përgjegjësi dhe Drejtori) por e pashoqëruar me listëprezencat e drejtorive përkatëse.

3. ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE PËR ADMINISTRIMIN, RUAJTJEN, DOKUMENTIMIN DHE QARKULLIMIN E VLERAVE MATERIAL E MONETARE.

***a**. Ligjshmëria sdhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës në lekë dhe në valutë.*
Sipas Programit të Auditimit nr. 801/2 datë 15.10.2019, është audituar ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës, arkës dhe inventarizimi i pronës, për vitin 2018 dhe 6- mujorin e parë të vitit 2019.
Për auditimin e kësaj pike, grupi i auditimit është mbështetur në:

- VKM nr. 870, datë 14.12.2011 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit", i ndryshuar;
- VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin e punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës" i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar; - Ligji 10296, datë 08.07.2010 "Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 3, datë 27.01.2015 "Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël" i ndryshuar;
- VKM nr. 28, datë 14.01.2015 "Ngarkimin e agjencisë së blerjeve të përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime", i ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar
- Udhëzimi nr. 22, datë 10.07.2013 "Mbi zbatimin e vendimit nr. 870, datë 14.12.2011 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit"

Nga auditimi me zgjedhje për periudhën objekt auditimi, për veprimet e kryera nëpërmjet bankës rezultoi se, në përgjithësi veprimet kontabël janë kryer në përputhje me aktet ligjore e nënligjore. Regjistrimi dhe kontabilizimi në ditar është bërë i rregullt dhe në fund të çdo muaji, shuma e pagesave të bankës është e njëjtë me nxjerrjen e llogarisë në fund të viteve ushtrimore. Veprimet e kryera janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarët përkatës. Pagesat e kryera me urdhër shpenzimi, në përgjithësi janë të shoqëruara me dokumente të rregullta justifikuese. Të gjithë urdhër shpenzimet janë plotësuar në përputhje me kërkesat e formatit të përcaktuar nga Ministria e Financave.
Përsa ju përket shpenzimeve për udhëtim e dieta jashtë vendit, pagesat janë përllogaritur dhe kryer në zbatim të VKM nr. 870, datë 14.12.2011 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit", të ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 22, datë 10.07.2013, në zbatim të tij. Bashkëngjitur mandate arkëtimit/ pagesës është ftesa nga organizatorët, autorizimi i NA, urdhër shërbimi, preventivi i shpenzimeve, fatura e biletave dhe akomodimit në hotel. Çdo urdhër shpenzimi është vulosur nga D.TH. Tiranë.
Nga auditimi i urdhër shpenzimeve u konstatua se:janë kryer shpenzime për evente të ndryshme kryesisht takime me investitorë, ku pavarsisht se pagesat janë kryer kundrejt dokumentit financiar të lëshuar nga furnitori i shërbimit dhe miratuar nga titullari, nuk ka asnje dokument justifikues si në fazën paraprake të krijimit të shërbimit ,mënyrën e përzgjedhjes së furnitorit të shërbimit si dhe tarifat e miratuar, duke mos ju nënshtruar në asnjë fazë rregullave të prokurimit publik.
Nga auditimi i veprimeve të kryera nëpërmjet arkës në lekë dhe valutë, për periudhën objekt auditimi rezultoi se, regjistrimet kontabël në ditarin e arkës janë bërë në mënyrë të rregullt, bazuar në

dokumentet justifikuese dhe çdo muaj është bërë kuadrimi i ditarit të arkës me gjendjen e librit të arkës. Të gjitha mandat-arkëtimet dhe mandat-pagesat janë të firmosur nga dy palët, janë plotësuar në përputhje me kërkesat e formatit të përcaktuar në urdhrin e Ministrit të Financave dhe mbështeten në dokumentet justifikues ligjorë. Pagesat janë kryer duke u mbështetur në dokumentacionin justifikues, bashkëngjitur urdhër pagesës. Veprimet kontabël janë kryer në përputhje me dispozitat ligjore. Gjendja e arkës në valutë në fund të çdo viti, paraqitet zero.

b. Saktësia dhe rregullariteti i veprimeve të kryera në magazinë.

Mbështetur në dokumentacionin e magazinës, fletë hyrjet dhe fletë daljet, kartelat limit, librin e magazinës dhe ditarin analitik të lëvizjes së vlerave materiale, u konstatua se lëvizja e mallrave, materialeve e inventarëve nëpërmes magazinës, *nuk është shoqëruar me urdhra dorëzimi dhe dokumentacionin mbështetës*. Nga auditimi i dokumentimit u konstatua se nuk janë zbatuar drejt kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin" dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Fletë hyrjet e mallrave dhe materialeve nuk janë dokumentuar brenda afatit ligjor dhe të shoqëruara me dokumente mbështetëse nga furnitori, ndërsa fletë daljet ishin të shoqëruara pa dokumente mbështetëse si urdhra dorëzimi, plan shpërndarje, kartela limit, preventiva, situacione, procesverbale, etj. Kontabilizimi i veprimeve të magazinës është i azhornuar për çdo veprim ekonomik, hyrje, dalje, si për aktivet e qëndrueshme dhe për aktivet qarkulluese.

Lidhur me ndarjen e punëve dhe papajtueshmërinë midis funksioneve, nga grupi i auditimit konstatohet se funksionet e financës si mbajtja e ditarëve, mbajtjen e arkës në valutë, plotësimi dhe kontabilizimi i urdhër shpenzimeve miratimi i tyre bëhej nga nënpunsi zbatues Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse pasi vendi i përgjegjësit të financës është i paplotësuar. Mbajtja e të gjithë veprimeve nga i njëjti person është në papjtueshmri me kryerjen e funksioneve dhe mbartin rrisk në fushën e menaxhimit financiar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin" dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

c. Inventarizimi i pronës shtetërore.

Nga auditimi u konstatua se AIDA përpara mbylljes së llogarive vjetore të vitit 2018 nuk ka kryer procesin e inventarizimit, në bazë të të cilit të evidentohej gjendja fizike e aktiveve dhe krahasimi i tyre me gjendjen kontabël, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, Kreu IV Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, Pika 74, ku citohet… "*Cdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.*"

Për vitin 2019 ky proces nuk është kryer ende, pavarsisht se urdhrat nga Titullari i Agjencisë janë nxjerre para mbylljes së pasqyrave financiare. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar Neni 7 Inventari i aktiveve dhe detyrimeve Pika 1. "*Njësitë ekonomike, subjekte të këtij ligji, duhet të kontrollojnë, të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe evidencës se tyre mbështetëse*" dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeversijes së përgjithshme", Kreu 3.1 Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, Pika 30 *"Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementëve të tjerë, konform kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabile për llogari të vitit kontabël që mbyllet".*

Sipas Ligjit pëe Menaxhimin financiar dhe kontrollin procesi i inventarizimit duhet të kryhet nga një komision i përbërë nga 5 punonjës, dhe rezultatet e inventarizimit duhet të përmblidhen në relacion .

Komisioni në përbërje të tij nuk duhet të ketë specialist i sektorit të financës. Në këtë proces duhet të konstatohet qartazi firmosja e deklaratave të mungesë së konfliktit të interesit në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i

ndryshuar, kreu Përgjegjësitë për inventarizimin, Pika 82… "Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi". Pasi përfshirja e tyre bie në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Neni 22 Veprimtaritë e kontrollit, Pika 3/b "*ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrit të Financave*".

Mos ngritja e Komisionit të inventarizimit për vitin 2018 nuk ka bërë të mundur verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në përdorim të personelit dhe magazinës; krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave të sektorit të financës për aktivet dhe së fundmi plotësimin e raportit përfundimtar me listën e materialeve që rezultojnë me diferencë dhe aktivet që vlerësohen pa vlerë dhe propozohen për nxjerrje jashtë përdorimit.

Nga auditimi i regjistrit të aktiveve të AIDA-s, u konstatua se institucioni nuk ka një regjistër të aktiveve të plotë për të gjithë zërat e aktiveve, në të cilin të evidentohet qartësisht data e hyrjes në institucion, amortizimi akumuluar, amortizimi vjetor dhe vlera e mbetur në vitin 2017 dhe 2018, sipas formatit të rregjistrit të aktiveve, i cili hartohet në vartësi të llojit të tyre, si dhe grupit përkatës brenda llojit. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, Kreu Rregjistri i aktiveve të njësive të sektorit publik, Pika 26… **"***Cdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo kanë administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Rregjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar***"***. Pika 28,… "Regjistri i aktiveve të një njësie, duhet të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra material dhe monetare si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë", dhe Pika 30… "Formati i rregjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë rregjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia."*

Titulli i gjetjes nr. 1	Inventarizimi i pakryer përpara mbylljes së pasqyrave financiare, për dy vjet rresht
Situata:	Nga auditimi u konstatua se AIDA përpara mbylljes së llogarive vjetore të vitit 2018 nuk ka kryer procesin e inventarizimit, në bazë të të cilit të evidentohej gjendja fizike e aktiveve dhe krahasimi i tyre me gjendjen kontabël. Për vitin 2019 ky proces nuk është kryer ende, pavarsisht urdhrave të Titullarit të Agjencisë para mbylljes së pasqyrave financiare. Duke bërë që AIDA për 2 vjet rresht në pasqyrat e veta financiare të mos ketë raportuar gjendjen kontabile pas krahasimit të saj me gjendjen fizike. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar Neni 7, Pika 1 dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeversijes së përgjithshme", Kreu 3.1, Pika 30.
Kriteri:	Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar Neni 7, Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme", Kreu 3.1 Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, Pika 30.
Ndikimi/Efekti:	Risku i monitorimit të gjendjes reale të aseteve në institucion
Shkaku:	Mos rakordim nga komisioni i çdo zëri të aseteve me regjistrin kontabël.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi:	AIDA të marrë masat që përpara raportimit të pasqyrave financiare të institucionit,

	të bëjë rakordimin e gjendjes fizike me gjendjen kontabël, në funksion të ruajtjes dhe mbrojtjes së aktiveve në pronësi të saj.

Titulli i gjetjes nr. 2	Konflikti i interesit në ndarjen e punëve dhe papajtueshmërinë midis funksioneve,
Situata:	Gjatë auditimit u konstatua se Lidhur me ndarjen e punëve dhe papajtueshmërinë midis funksioneve, nga grupi i auditimit konstatohet se funksionet e financës si mbajtja e ditarëve, mbajtjen e arkës në valutë, plotësimi dhe kontabilizimi i urdhër shpenzimeve miratimi i tyre bëhej nga nënpunsi zbatues Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse pasi vendi i përgjegjësit të financës është i paplotësuar. Mbajtja e të gjithë veprimeve nga i njëjti person është në papjtueshmri me kryerjen e funksioneve dhe mbartin rrisk në fushën e menaxhimit financiar njësitë e sektorit publik".Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Neni 22 Veprimtaritë e kontrollit, Pika 3/b dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar,
Kriteri:	Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Neni 22 Veprimtaritë e kontrollit, Pika 3/b dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, kreu Përgjegjësitë për inventarizimin, Pika 82.
Ndikimi/Efekti:	Realizimi i inventarizimit në kushtet e konfliktit të interesit
Shkaku:	punonjës në kushtet e konfliktit të interesit
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi:	AIDA të marrë masat që në ngritjen e komisionit të inventarizimit të verifikojë dhe vërtetojë mungesën e konfliktit të interesit, për të ruajtur plotësinë e aktiveve dhe regjistrimin e duhur në dokumentet kontabël.

Titulli i gjetjes nr. 3	Mungesa e një regjistri të plotë aktivesh
Situata:	Nga auditimi i regjistrit të aktiveve të AIDA, u konstatua se institucioni nuk ka një regjistër të plotë të aktiveve që zotëron apo ka në administrim, në të cilin të evidentohet qartësisht data e hyrjes në institucion, amortizimi akumuluar, amortizimi vjetor dhe vlera e mbetur, sipas formatit të rregjistrit të aktiveve. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, Kreu Rregjistri i aktiveve të njësive të sektorit publik, Pika 26, 28 dhe Pika 30.
Kriteri:	Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" Pika 26, 28, 30.
Ndikimi/Efekti:	Vështirësi në evidentimin e plotë të aktiveve në pronësi dhe llogaritjen e amortizimit vjetor
Shkaku	Mungesa e nxjerrjes së një regjistri të plotë të aktiveve.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi:	AIDA të marrë masa për nxjerrjen e një regjistri të plotë të aktiveve që zotëron, sipas llojit, grupit dhe formatit të dispozitave ligjore në fuqi në funksion të evidentimit të jetëgjatësisë së përdorimit të aktiveve nga institucioni dhe monitorimit të llogaritjes së amortizimit vjetor.

4. AUDITIMI I LLOGARIVE VJETORE TË INSTITUCIONIT (PASQYRAT FINANCIARE).

<u>Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit.</u>

a. *Mbi auditimin e bilancit kontabël dhe plotësimit të pasqyrave financiare përkatëse në zbatim të Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme"*

Në AIDA mbajtja e kontabilitetit për vitin 2018, është bërë në bazë të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"* ndërsa, struktura, funksionimi dhe mbyllja e llogarive vjetore është bërë në bazë të VKM dhe udhëzimeve të MFE për mbylljen e llogarive të vitit 2018.
Pasqyrat financiare vjetore të AIDA-s për vitin 2018 kanë ndryshuar format në bazë të Udhëzimit të MFE dhe përbëhen nga:

1. Formati 1- Pasqyra e pozicionit financiar;
2. Formati 2- Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve;
3. Formati 3- Pasqyra e flukseve monetare;
4. Formati 4- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto;
5. Formati 5- Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.
6. Formati 6- Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre;
7. Formati 7- Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto.
8. Formati 8- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave

Nga auditimi u konstatua se AIDA për vitin 2018 nuk ka të plotësuar në mënyrë të plotë dhe të qartë pasqyrën e shënimeve shpjeguese, e cila jep informacion mbi hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare. Veprimi i mësipërm cënon raportimin e AIDA-s në lidhje me Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme të cilat përmbajnë informacion sqarues, përveç atij që paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e flukseve monetare dhe pasqyrën e ndryshimit të aktiveve neto/fondeve neto. Shënimet japin përshkrime me fjalë apo zbërthime të zërave të paraqitur në këto pasqyra apo evidentojnë problemet që mund të kenë rezultuar gjatë fazës së përgatitjes apo paraqitjes së pasqyrave financiare vjetore. AIDA ka përfshirë në pasqyrat fiannanciare të dorëzuara shënimet shpjeguese sipas formatit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të emërtuar "Pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore", i cili përbëhet nga 19 pyetje, që mbulojnë elementë të ndryshëm të raportimit financiar të njësive, por nuk ka plotësuar asnjë nga këto pyetje. Veprimi i mësipërm bie në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme", Kreu 3.7 Rregullat për dhënien e shënimeve shpjeguese për pasqyrat financiare individuale.

b. *Auditimi i llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve.*
Gjatë dy viteve në auditim formati i raportimit të pasqyrave financiare ka pësuar një ndryshim në renditje, konform udhëzimeve të nxjerra nga MFE. Kështu nëse në vitin 2017 pasqyra e shpenzimeve mban nr. 3/1, prej vitit 2018 kjo pasqyrë mban nr. 2 dhe përfshin si të ardhurat edhe të shpenzimet e vitit ushtrimor, të renditura njëra pas tjetrës.
Formatet e miratuara që shoqërojnë llogarinë vjetore të aparatit të vitit 2018, janë plotësuar si më poshtë:

Për vitin 2018 *Formati 2 "Pasqyra e performancës financiare"* është plotësuar si më poshtë:

Llogaritë e seksionit A "Të ardhurat" për vitin 2018 paraqiten në shumën 34,044,639 mijë lekë dhe përbëhet nga këto poste:
- - Në postin "G.K" shuma 34,044,639 mijë lekë paraqet: transfertat nga buxheti i shtetit për AIDA-n në vlerën 30 427 003 mijë lekë dhe Financimi i pritshëm nga buxheti (7206) në vlerën 3,617,636 mijë lekë. Nga krahasimi i të dhënave midis pasqyrave fiananciare të vitit 2017 dhe 2018 konstatohet se ka diferenca midis *llogarisë 7200 "Transferta nga buxheti i shtetit*" për vitin 2017. Nga krahasimi i të dhënave të vitit të mëparshëm në pasqyrat e vitit 2018, me pasqyrat financiare të dorëzuara për vitin

2017 konstatohet se ka diferenca, kështu nëse të grantet e brendshme për vitin 2017 rezultojnë në shumën 52,762,829 mijë lekë , kemi pakësim të këtyre fondeve nga financimi i buxhetit të shtetit. E cila flet për më pak fonde për financimin e projekteve nga AIDA.

Llog. 600 "Paga e shpenzime personeli" për 21,485,289 mijë lekë, në këtë post janë paraqitur pagat e personelit, e marra nga dokumentat justifikuese sipas detyrimeve të konstatuara dhe listë pagesat e ekzekutuara, ndihma ekonomike dhe shpërblimet e dhëna gjatë vitit ushtrimor 2018.
Seksioni B "Shpenzimet" paraqiten në shumën 34,355.086 lekë, analizuar si më poshtë:
Llogaria 600 "Pagat dhe përfitimet e punonjësve" në vlerën 21,485,289 mijë lekë paraqet shpenzimet për pagat e punonjesve për vitin 2018.
Llogaria 601 "Kontribute të Sigurimeve Shoqërore" për 3,494,344 mijë lekë,që paraqet shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, pjesa e paguar nga punëdhënësi.
Llog. 602 "Blerje mallra e shërbime për 9,065.006 mijë lekë praqet shpenzimet e AIDA-s për nevojat funksionale të veprimtarisë së saj.
Llog. 6020 "Materiale dhe shërbime zyre të përgjithshme" për 984,203 mijë lekë e cila nga vetë emërtimi paraqet shpenzimet që institucioni ka kryer për blerje dhe kancelari etj gjatë vitit 2018.
Llog. 6021 "Materiale dhe shërbime speciale" për 348,972 mijë lekë e cila paraqet shpenzimet që institucionet kanë kryer për blerje dhe kancelari etj gjatë vitit 2018.
Llog. 6022 "Shërbime nga të tretët"për shumën 0 mijë lekë përfaqëson shpenzimet që institucionet tona kryejnë realizuar me shërbime nga të tretët energji elektrike, ujë, postë, komunikim si dhe ruajtje objektesh me roje civile të cilat kjo njësi i përfiton nga ushtrimi i veprimtarisë së saj në godinen e Kryeministrisë.
Llog. 6023 "Shërbime transporti" për shumën 309,000 mijë lekë përfaqësojnë shpenzime për automjetet e institucioneve si naftë, vaj, pjesë këmbimi etj.
Llog. 6024 "Shpenzime udhëtimi" për shumën 3,046,705 mijë lekë përfaqësojnë shpenzimet që të gjithë institucionet e varësisë kryejnë për pagesën e dietave të punonjësve të tyre që largohen me punë jashtë vendbanimit të tyre.
Llog. 6025 "Mirëmbajtje të zakonshme" për shumën 107,200 mijë lekë janë shpenzimet që janë bërë për mirëmbajtje dhe riparime të zakonshme të AQT-ve të tyre.
Llog. 6027 "Detyrime për kompesime legale" për shumën 219,910 mijë lekë paraqet shpenzimet që institucioni ka kryer për vendimet gjyqësore të ekzekutuara gjatë vitit për punonjësit e larguar nga puna.
Llog. 6029 "Shpenzime të tjera Operative" për shumën 111,473 mijë lekë përfaqëson shpenzime të tjera që nuk janë përfshirë në zërat e sipërpërmendur sipas kritereve të klasifikimit buxhetor.

Në AIDA në nxjerrjen e rezultatit financiar është përfshirë efekti i ndryshimit i gjendjeve inventariale pasqyruar në llog. 63 në vlerën 310,447 mijë lekë duke ndikuar në rritjen e të shpenzimeve të vitit 2018. Për vitin 2018 AIDA sipas pasqyrave financiare rezulton me rezultat debitor në vlerën -310,447 mijë lekë. Sipas kësaj pasqyre, për vitin e mëparshëm 2017 rezultati i periudhës është 15,502.892 mijë lekë, ndërsa sipas pasqyrave financiare të vitit 2018 kjo rezulton 0. Nga grupi i auditimit u përmblodhën të dhënat ë mëposhtme në lidhje me rezultatin e veprimtarisë gjatë vitit ushtrimor 2017 dhe 2018.

Tabela nr. 1 "Rezultati i veprimtarisë për vitin 2017, 2018"

Në lekë

	Viti 2017 (PF 2017)	***Viti 2018 (PF 2018)***
Shpenzimet	52.762.829	34 355 086
Të ardhurat	52.762.829	34,044,639
Rezultati i veprimtarisë	***-***	***-310 447***

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, Neni 10 Bazat dhe parimet mbështetëse... "1. Pasqyrat

financiare sigurojnë transparencën përmes te *dhënave te plota* dhe *paraqesin, me vërtetësi, te dhënat e nevojshme* për vendimmarrje. Ato përgatiten bazuar ne një kontabilitet ushtrimor dhe ne vijueshmërinë e veprimtarisë se njësisë ekonomike, për një te ardhme te parashikueshme. " dhe Neni 11 Krahasueshmeria... "1. *Pasqyrat financiare duhet t'u japin mundësi përdoruesve qe te bëjnë krahasime ndërmjet ushtrimeve te ndryshme kontabël*"

***c**. Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur dhe kontabilizuar saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.*
Nga auditimi u konstatua se:
Bilanci i vitit 2018 i AIDA është dorëzuar në Degën e Thesarit Tiranë me shkresën nr. 111 prot, datë 19.03.2019, të vulosur dhe nënshkruar nga Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, pra brenda afateve ligjore.
Veprimet kontabël janë kryer konform dispozitave ligjore në fuqi, ku çdo regjistrim është bërë në bazë të dokumenteve justifikuese, si dhe janë zbatuar parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Të gjitha veprimet regjistrohen në librat kontabël në mënyrë sistematike dhe kronologjike të marra nga dokumentet bazë. Nga auditimi me zgjedhje rezultoi se dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi. Sistemi i kontabilitetit në këtë institucion nuk mbahet në asnjë prej programeve financiare por vetem në "EXEL" gjë e cila cënon sigurinë e rregjistrimeve të rregullta të veprimeve kontabël,të njohura ndryshe si gabime të mundëshme njerzore, të cilat fare mire mund të shmangen duke u integruar në sistemin qeveritar SIFQ ose vetë AIDA të programojë investimin e një programi financiar.

Nga verifikimi i llogarive të bilancit rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me pasqyrat financiare dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike.

Bilanci Kontabël për grupet e llogarive **të Aktivit** gjendje më 31.12.2018, krahasuar gjendjen e tyre më 31.12.2017, paraqiten si më poshtë:

në lekë

Grupet	***Emërtimi***	***Viti 2017***	***Viti 2018***
A.	Aktive Afatshkurtra	3.997.091	5.949.573
B.	Aktive afatgjata	20,931,107	57,790,623
Totali		**24.928.198**	**63.740.196**

Burimi: AIDA, Përpunuar nga grupi i auditimit
Në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017, *Aktivet afatgjata materiale* janë rritur në vlerën 3 685 562 lekë, që ka ardhur si rezultat i pasqyrimit të blerjeve të aktiveve në këtë vit. Në vitin 2018, aplikimit të normave të Amortizimit bazuar në Udhëzimin Nr 8 datë 09.03.2018 "Për Procedurat e Përgatitjes ,Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme"
"- Për aktivet afatgjata, materiale si: ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit dhe makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur;
- Kompjuterët, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softe e sisteme informacioni të amortizohen mbi bazë grupimi me normën 25%;
- Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi; dhe
- Për aktivet afatgjata jomateriale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%.".
Zëri i amortizimit të Aktiveve të Qëndrueshme krahasuar në vite ka pësuar rritje, konstatohet se amortizimi është llogaritur sipas normave të miratuara.
- *Aktivet qarkulluese* në fund të vitit 2018 rezultojnë me gjendje në vlerën 1,854,537 lekë, me një pakësim për 310,447 lekë, krahasuar me gjendjen në fund të vitit 2017, për të cilën nuk jepen spjegime sqaruese.

Nga verifikimi me zgjedhje i *llogarive debitore* rezultoi se, evidentimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre nuk është kryer konform rregullave. Lidhur me rakordimin dhe kuadrimin e tyre si për llogarinë sintetike dhe ato analitike nuk na u vunë në dispozicion dokumentacion kontabël për të shqyrtuar vërtetësinë e tyreper periudhën objekt auditimi.

Bilanci Kontabël për grupet e llogarive të **Pasivit** më 31.12.2018, paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. "Pasivi i bilancit AIDA

në lekë

Grupet	*Emërtimi*	*Viti 2018*
A.	Pasivet afatshkurtra	5,949.,573
B.	Llogari të pagueshme	4.095,036
C.	Llogari të tjera	0
Totali		**10,044,609**

Burimi: AIDA, Përpunuar nga gurpi i auditimit

Në krahasim me vitin 2017, në vitin 2018*"Fondet e veta"* janë rritur në vlerën 1,952,482 lekë, detyrimet të cilat përbëhen nga detyrimet afatshkurtra në krahasim me vitin 2017 në vitin 2018 janë rritur në vlerën 2,262 929 lekë, kjo si rezultat i pasqyrimit në evidencën kontabile i detyrimeve ndaj të tretëve ashtu sikurse përcaktohet në udhëzimin e Ministrisë së Financën për mbylljen e llogarive vjetore 2018.
Llogaria 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)" është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike te tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm.

Posti "Detyrime" përbëhet vetëm nga detyrimet afatshkurtra të cilat arrijnë në vlerën 4,095.036 lekë Për vitin 2018, detyrimeve afatshkurtra e përbën artikulli 401-408 Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" ,artikulli 42 "Të tjera operacione me shtetin (kreditor)". Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" ka pësuar ritje 1,724,507 lekë, si rezultat i pasqyrimit në evidencën kontabile i detyrimeve ndaj të tretëve ashtu sikurse përcaktohet në udhëzimin e Ministrisë së Financën për mbylljen e llogarive vjetore 2018. Të cilat në fakt janë të rregjistruara por të pakalauar nëpërmjet bankës e pasqyruar kjo dhe në aktrakordimin me Thesarin.
Llogaria "Personeli e llogari te lidhura me to" në shumat 1,529,756 lekë për vitin 2018, përfaqëson detyrimin për pagat e personelit të AIDA-s të të muajit Dhjetor 2017 që paguhen në Janar 2018 që i përgjigjet listëpagesave përkatëse.
Llogaria "Detyrime ndaj shtetit per tatim-taksa" në shumat 118,283 lekë përkatësisht për vitin 2018 dhe përfaqëson detyrimet e AIDA-s ndaj degës së tatim-taksave për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi të punonjësve, detyrime që shlyhen në muajin Janar 2018.
Llogaria 467 "Kreditor të ndryshëm"në shumën 444,100 , për vitin 2018. Këto përfaqësojnë detyrimet ndaj furnitorëve për të cilën nuk na u vunë në dispozicionë evidenca kontabël dhe dokumenti shoqërues.
Nga auditimi mbi rakordimet ndërmjet situacionit të shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2018, datë 31.01.2019 me nr.prot nr 52,sipas kodit të Institucionit 1010276 mbajtur me Degën e Thesarit Tiranë dhe gjendjes së llogarive ekonomike në pasqyrat financiare, u konstatuan diferenca.

Llog. 600 "Paga e shpenzime personeli" për 21,485,289 mijë lekë, në këtë post janë paraqitur pagat e personelit, e marra nga dokumentat justifikuese sipas detyrimeve të konstatuara dhe listë pagesat e ekzekutuara, ndihma ekonomike dhe shpërblimet e dhëna gjatë vitit ushtrimor 2018. Ndërkohë që në formatin e rakordimit shpenzimi faktik rezulton të jetë 21 230.225 lekë

Llogaria 601 "Kontribute të Sigurimeve Shoqërore" për 3,494,344 mijë lekë,që paraqet shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, pjesa e paguar nga punëdhënësi. Ndërkohë që në formatin e rakordimit shpenzimi faktik rezulton të jetë 3,453.554 lekë

Llog. 602 "Blerje mallra e shërbime për 9,065.006 mijë lekë praqet shpenzimet e AIDA-s për nevojat funksionale të veprimtarisë së saj. Ndërkohë që në formatin e rakordimit shpenzimi faktik rezulton të jetë 7.377.413 lekë ku sipas aktrakordimit paraqiten xhirime te brendshme 75,535 lekë(600+602) si dhe 1,629,675 leke fatura të pakaluara nga banka në vitin 2018 si dhe tepric arke në shumën 462.521 lekë.

Titulli i gjetjes nr. 1	Pasaktësi e të dhënave të vitit ushtrimor të mëparshëm, reflektuar në pasqyrat financiare të vitit 2018
Situata:	Nga krahasimi i të dhënave të reflektuara në lidhje me raportimin e pasqyrave financiare të vitit 2018, me pasqyrat financiare të dorëzuara për vitin 2018 konstatohet se ka diferenca në disa zëra shpenzimesh referuar rakordimit ndërmjet situacionit të shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2018, mbajtur me Degën e Thesarit Tiranë dhe gjendjes së llogarive ekonomike në pasqyrat financiare, u konstatuan diferenca. Llog. 600 "Paga e shpenzime personeli" për 21,485,289 mijë lekë, në këtë post janë paraqitur pagat e personelit, e marra nga dokumentat justifikuese sipas detyrimeve të konstatuara dhe listë pagesat e ekzekutuara, ndihma ekonomike dhe shpërblimet e dhëna gjatë vitit ushtrimor 2018. Ndërkohë që në formatin e rakordimit shpenzimi faktik rezulton të jetë 21 230.225 lekë Llogaria 601 "Kontribute të Sigurimeve Shoqërore" për 3,494,344 mijë lekë,që paraqet shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, pjesa e paguar nga punëdhënësi. Ndërkohë që në formatin e rakordimit shpenzimi faktik rezulton të jetë 3,453.554 lekë Llog. 602 "Blerje mallra e shërbime për 9,065.006 mijë lekë praqet shpenzimet e AIDA-s për nevojat funksionale të veprimtarisë së saj. Ndërkohë që në formatin e rakordimit shpenzimi faktik rezulton të jetë 7.377.413 lekë ku sipas aktrakordimit paraqiten xhirime te brendshme 75,535 lekë(600+602) si dhe 1,629,675 leke fatura të pakaluara nga banka në vitin 2018 si dhe tepric arke në shumën 462.521 lekë. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, Neni 10, 11 Krahasueshmeria.
Kriteri:	Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, Neni 10, 11 Krahasueshmeria.
Ndikimi/Efekti:	Mungesë saktësie në raportimin e të dhënave krahasimore të pasqyrave financiare
Shkaku:	Ndryshimi i formatit të raportimit financiar
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	AIDA të marrë masat e nevojshme në sistemimin e diferencave të të ardhurave dhe rezultatit të veprimtarisë së institucionit për vitin 2018.

6. MBI VLERËSIMIN E FUNKSIONIMIT TË SITEMEVE TË MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT

Në zbatim të pikës 6 të programit të auditimit "Mbi vlerësimin e funksionimit të sitemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit" auditimi u fokusua në lidhje me: Zbatimin e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, hartimin e objektivave dhe zbatimi i planit strategjik dhe vjetor në përputhje me objektivat e miratuara nga titullari, të pyetësorëve të vetëvlerësimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, deklaratat e

cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm si dhe mbi politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Agjencine Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizmit të objektivave të institucionit, për të gjithë komponentët si: "*Mjedisi i kontrollit*", "*Menaxhimi i riskut*", "*Aktivitetet e kontrollit*", "*Informimi dhe Komunikimi*" si dhe "*Monitorimi*", në referim të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 "*Për disa shtesa dhe ndryshime*", ku titullari i njësisë në sektorin publik krijojn dhe vlerëson sistemet e MFK-së, nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Me synimin e implementimit të këtij ligji dhe të akteve rregullatore është kërkuar: regjistri i riskut, pyetësorët e vetëvlerësimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, deklarata e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, shkresat mbi ndarjen dhe delegimin e kompetencave, caktimit të Nëpunësit Zbatues, koordinatorit të riskut, sekretarit të GMS, procesverbalet e mbledhjeve të GMS, rishikimi i regjistrit të riskut, rivlerësimi dhe plani i veprimit me masa korrigjuese etj.

Grupi i auditimit në zbatim të përgjegjësive menaxheriale, sipas nenit 11 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, zotëroi disa informacione lidhur me përgjegjësitë dhe raportimin që nëpunësi zbatues ka si detyrim ndaj nëpunësit autorizues. Mbështetur në të dhënat e gjetura gjatë procesit të auditimit në Agjencine Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit dhe përgjegjshmërisë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve publike.

1.Mjedisi i kontrollit

Agjencine Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, ushtron veprimtarinë e saj bazuar në ligjin nr. 10303, datë 27.7.2010 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e te funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve", në statusin e agjencisë, në vendimet e Këshillit të Ministrave, si dhe në rregulloren e brendshme të agjencisë.

Mjedisi i kontrollit është konsideruar si një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, në fushën e zbatimit të rregullave të brendëshme dhe të jashtme, të menaxhimit të fondeve për mbështetjen dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si dhe eksporteve shqiptare. Mjedisi i kontrollit është konsideruar nga AIDA si një element i rëndësishën në integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike, në politikat menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

Agjencia për vitin 2018, në kundërshtim me kreu II, nenet 8, 9, kreu III neni 19 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, nuk ka hartuar "Deklaratën për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm", mbi zbatimin e sistemeve dhe komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit, për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të trasparencës.

a. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, nuk ka hartuar "Kodin e Brendshëm Etik", në kundërshtim me kërkesat e nenit 20, pika 2 germa a, "Mjedisi i kontrollit" të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, dhe me Kap II, pika 2.5.1 "Mjedisi i Kontrollit", paragrafi "Integriteti dhe vlerat etike" të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financës,.

b. Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit. Agjencine Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, në periudhën objekt auditimi, ka funksionuar me strukturën e miratuar nga Bordi i administrimit. Ajo ka ushtruar veprimtarinë mbështetur në aktet ligjore e nënligjore si dhe mbi bazën e Rregullores së Brendshme, të miratuar me Urdhër nr. 11, datë 21.07.2011 "Mbi organizimin dhe funksionimin e Agjencise Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve", e cila nuk është rishikuar që nga miratimi i saj. Njësia ka hartuar për cdo vit kalendarik programin buxhetor me qëllim përdorimin me eficenncë dhe efektivitet të burimeve njerëzore dhe financiare. Nga drejtuesi i institucionit, është kryer mbikëqyrja e monitorimi i punës për secilin punonjës, në mënyrë që të sigurohet si duhet integriteti personal dhe etika profesionale, duke përjashtuar konfliktet e interesit në kryerjen e detyrave funksionale, në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar si dhe ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.
Në lidhje me kryerjen e transaksioneve financiare është kryer ndarja e detyrave, për të cilën është përdorur sistemi me dy firma, ku janë përcaktuar rregulla të qarta për ruajtjen e pronës. Përcaktimi i NZ është bërë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor të RSH". Në lidhje me ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit nuk është aplikuar ajo formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin". Konstatohet se Nëpunësi Zbatues, ish Përgjegjsja e Sektorit të Financës ka kryer njëkohësisht edhe detyrën e përgjegjësit të materialeve, (magazinjerit) në kundërshtim me ligjin 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve të njësisë së sektorit publik" neni 12, në të cilin citohet: aktivet jepen në ngarkim të punonjësve të cilët kanë përgjegjësi ligjore për humbjet, dëmtimet e shpërdorimet, pasqyrimin me saktesi në dokumentacionin përkatës të të dhënave si dhe për gjendjen e lëvizjen e aktiveve që kanë në ngarkim.
c. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit. Punonjësit e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, për periudhën objekt auditimi (01.01.2018-25.03.2019) marrëdhëniet e punës me punëdhënësin i kanë rregulluar në bazë të ligjit nr. 152/2013 "Për nënpunsin civil", i ndryshuar, të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor, ligjit për prokurimin publik, ligjit për kontabilitetin. Për periudhën nga data 25.03.2019 e në vijim këto marrëdhënje rregullohen në bazë të dispozitave të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1999 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" etj. Titullari i institucionit, në rast të shkeljes së normave ligjore apo të rregullave ka të drejtë të ndërmarrë hapat e duhura duke propozuar masa disiplinore dhe administrative për punonjësit, deri në largim nga puna.

d. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.
Në rregulloren e brendshme të institucionit, janë përcaktuar rregullat e funksionimit të brendshëm lidhur me strukturën organike, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, marrëdhëniet ndërmjet strukturave të njësisë, orarin dhe kohën e punës etj, por kjo rregullore është e pa përditësuar që nga viti 2011 duke mos ju përshtatur strukturave të ndryshuar herë pas herë të institucionit. Nga institucioni nuk është bërë vlerësimi vjetor i punës për çdo punonjës, i cili i bashkëlidhet dosjeve personale të punonjësve. Stafi i AIDA është në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas kërkesave të vendit të punës. Stafi është rekrutuar nëpërmjet konkurrimit për rastet kur rekrutimi i punonjësit është kryer sipas ligjit të nëpunësit civil si dhe me kërkesat e kodit të punës për punonjësit jashtë shërbimit civil. Punonjësit kanë zhvilluar trajnime, të realizuara nga Ministria e Financave, ku kryesisht kanë të bëjnë për trajnimin e punonjësve në lidhje me përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm (PBA), me modulin e menaxhimit të investimeve publike(MIP), për përdorimin e sistemit SIMF, ASPA. Institucioni ka bërë planifikime trajnimesh për menaxherët apo stafin të cilët janë përgjegjës për menaxhimin financiar dhe kontrollin, duke përfshire trajnimin lidhur me ndryshimet në legjislacion, mbi procedurat e prokurime publike, mbi menaxhimin e burimeve njerëzore, mbi menaxhimin e financave dhe kontabilitetit.

2. Menaxhimi i riskut.

Nga auditimi në lidhje me identifikimi i riskut, vlerësimi i riskut, adresimi i riskut dhe shqyrtimi i riskut rezultoi se*:* Institucioni nuk ka hartuar strategjinë për menaxhimin e riskut, në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, ku citohet se.... "Titullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut". Strategjia e riskut duhet të përcaktojë mënyrën se si do të sillet njësia ndaj risqeve dhe të vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Gjithashtu nga auditimi u konstatua se agjencia nuk ka regjistër risku.

Menaxhimi i riskut është nuk vlerësuar si një proces i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut. Pas planifikimit të fondeve buxhetore, institucioni nuk ka analizuar dhe identifikuar kontrollin e risqeve, të cilët mund të venë në rrezik realizimin e treguesve buxhetore.

Menaxhimi i riskut është një komponent thelbësor në implementimin e një sistemi modern të MFK, për të cilin institucionet publike kanë nevojë për asistencë teknike dhe rritje ndërgjegjësimi në periudhën në vijim. Nga AIDA nuk janë bërë hapa në drejtim të ngritjes dhe funksionimit të sistemit të menaxhimit të risqeve, në mënyrë që ky sistem të mos jetë i fokusuar vetëm në strukturat e financës, por të shtrihet në të gjithë institucionin, për parandalimin e risqeve që ndikojnë në realizimin e objektivave.

3. Aktivitetet e kontrollit.

Veprimtaria kryesore e agjencisë është lehtësimi dhe mbështetja e investimeve të drejtëpërdrejta, rritja e aftësisë konkuruese të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si dhe nxitja dhe ndihma ndaj eksporteve të mallrave dhe shërbimeve. Për rregullimin e veprimtarisë së brendëshme në përputhje me ligjin dhe strukturën organizative Agjencia ka hartuar rregulloren e brendshme të funksionimit të administratës së saj. Në rregullore janë përcaktuar parimet e administrimit të burimeve njerëzore, marrëdhënjet e punës, të drejtat dhe detyrat e strukturës. Në rregulloren e brendëshme përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësive nuk janë sipas strukturës së miratuar nda bordi i administrimit për vitin 2018 dhe 7 mujorin e përë të vitit 2019. Sipas strukturës Agjencia është organizuar në 4 drejtori dhe 11 sektorë. Përshkrimi i funksioneve në rregulloren e brendëshme është për 4 departamente dhe 7 sektorë. Kontrolli i aktivitetit realizohet nga Drejtori i ekzekutiv, nëpërmjet sistemeve të vendosura që nga hartimi i planeve, ndarja e detyrave për çdo drejtori e sektor dhe punonjës të Agjencisë, nëpërmjet raportimeve ditore për punën që kryhet dhe të sistemit të raportimeve periodike mujore e vjetore.

Lidhur me ndarjen e punëve dhe papajtueshmërinë midis funksioneve, nga grupi i auditimit konstatohet se funksionet e financës si mbajtja e ditarëve, mbajtjen e arkës në valutë, plotësimi dhe kontabilizimi i urdhër shpenzimeve miratimi i tyre bëhej nga nënpunsi zbatues Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse pasi vendi i përgjegjësit të financës është i paplotësuar. Mbajtja e të gjithë veprimeve nga i njëjti person është në papjtueshmri me kryerjen e funksioneve dhe mbartin rrisk në fushën e menaxhimit financiar.

4. Informim komunikimi.

Nga auditimi u konstatua se nga AIDA, informimi dhe komunikimi janë vlerësuar si faktorë që ndikojnë në zbatimin e të gjithë objektivave. Në institucion, funksionon shkëmbimi i informacionit dhe kanalet e komunikimit si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht. Ato funksionojnë sipas nivelit të hierarkisë në mënyrë shkresore dhe elektronike, sipas përcaktimeve në rregulloren e brendshme. Drejtori ekzekutiv informohet rregullisht nëpërmjet komunikimit gojor, memove, raporteve dhe analizave. Mënyra e komunikimit dhe raportimit tek bordi drejtues janë formalizuar në nenin 24 të Rregullores së Brendëshme. Komunikimi me palët e treta është rregulluar në nenet 20 dhe 21 të rregullores së brendëshme.

5. Monitorimi.

Monitorimi dhe raportimi është konsideruar si tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili ka synuar të afrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për

të cilin është ngritur kjo agjenci. Agjencia ka një sistem monitorimi dhe raportimi të qarte të pasqyruar në ndarjen e detyrave sipas strukturës organizative, nëpërmjet drejtorive, sektorëve dhe cdo punonjësi. Sistemi i raportimit nuk është i rregulluar për mënyrën e administrimit të dokumentacionit, protokollimit dhe arkivimit.
Në institucion, Titullari është informuar vazhdimisht nga menaxherët e tjerë të varësisë direkte mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë me anë të takimeve, informacioneve apo, raporteve të ndryshme. Menaxherët nën mbikëqyrjen e Titullarit, kanë raportuar realizimin e çdo objektivi në përgjegjësinë e gjithsecilit. Krahas arritjeve janë analizuar dhe shkaqet e mosrealizimeve.
Në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar kreut II "Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit", neni 8, pika 8, gërma b, njësia nuk ka të dokumentuar ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) për periudhën objekt auditimi. Njëkohësisht nuk janë ngritur ekipet për menaxhimin e programeve.
Njësia nuk ka dokumentuar mbledhjet e GMS, në kundërshtim me kërkesat e nenit 27 të ligjit "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Manualin mbi zbatimin e MFK-së.
Njësia nuk ka hartuar pyetësorin e vetëvlerësimit për komponentët e MFK-së, në kundërshtim me Kap. V, Shtojca 2 –Pyetësori i vetë-vlerësimit për komponentët e MFK-së, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin,. Agjencia nuk ka hartuar raportet periodike katër mujore te monitorimit të shpenzimeve buxhetore si dhe nuk ka aktive adresën zyrtare në internet.

7.Probleme të ndryshme që mund të dalingjatë auditimit në lidhje me organizimin funksionimin dhe veprimtarinë e AIDA-s në përputhje me legjislacionin në fuqi me statusin e saj.

7.1.Mbi menaxhimin e Fondit Shqiptar të konkurrueshmërisë nga AIDA 2018

Në raporti trajtohen çështjet në lidhje me menaxhimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë nga AIDA ku përfshihet promovimi, ndërmarrjet përfituese dhe impakti që ka patur Fondi mbi këto ndërmarrje. AIDA është një partner i rëndësishëm për NVM-të Shqiptare që kërkojnë të zgjerojnë tregjet e tyre të eksportit, dhe NVM-ve të huaja në kërkim të partneriteteve lokale në vend. Nga ky këndvështrim AIDA synon të ofrojë shërbime profesionale, cilësore për SME-të Shqiptare duke i ndihmuar ato të kapërcejnë këto pengesa si dhe duke i përgatitur për të qënë më konkuruese në tregjet ndërkombëtare.
Në vitin 2018, gjatë periudhës (Janar - Nëntor) nga Fondet e AIDA-s, janë asistuar mbi 300, kompani nga ku kanë përfituar 48 prej tyre, që ju përkasin sektorëve të ndryshëm si: agro-përpunimi, plastika, druri ICT, fason tekstil, artizanat, turizëm në drejtim të promovimit të produkteve: "Made in Albania" Ky suport është dhënë nëpërmjet pjesëmarrjes në panaire ndërkombëtare, takime B2B, çertifikimit, dhe përmirësimit të produktit, etj.
1. Promovimi i Fondeve të Konkurueshmërisë.
Gjatë muajve Janar – Nëntor 2018 , është bërë promovimi i fondeve që menaxhohen nga AIDA, në qarqet kryesore të vendit si Kukës, Pogradec, Korçë, Gjirokastër, Pukë, Shkodër,Tiranë, Përmet,Sarandë, ku janë asistuar mbi 200 kompani të sektorëve të ndryshëm.
Gjatë vitit 2018, në fondin e Konkurrueshmërisë, aplikuan 17 kompani të sektorëve të ndryshëm, dhe përfituan gjithse, 15 kompani.
Kompanitë që aplikuan gjatë vitit 2018, janë: "E-G." shpk, " Sh. Sh", "LF I." shpk, "E. T", "Xh" shpk, "A-E", "A. Gj." P/f, " Fe. Z," P/f, "L. D." Pf, "A-M-C" shpk, "I. Shpk", "B" shpk, "M. shpk", "E.D.A 2016", "D.-A" P/f, " M. T", "B" shpk.
Më poshtë janë kompanitë përfituese për vitin 2018**:**

Nr	**Kompania**	**Sektori**	**Projekti Aplikues**	**Qyteti**	**Financimi (ALL)**
1	E. G. shpk	Prodhim pije alkolike, vere,raki etj	Ambalazhim,(shishe qelqi,tapa,etiketa),	Reshen, Mirdite	1,400,000
2	Sh. shpk	Prodhim Vaji Ulliri	Ambalazhim,(shishe qelqi,tapa,etiketa),	Tirane	1,400,000
3	LF I.	Prodhim PVC	Certfikim ISO 9001:2015 dhe 18001:2007	Tirane	1,232,000

4	E. T.	Fason	Certfikim ISO 9001:2015 dhe 18001:2007	Elbasan	1,323,000
5	Xh. shpk	Perpunim mielli	Ambalazhim,(kuti Kartoni,dhe qeska transparente)	Berat	1,122 ,832
6	A. E	Prodhim dyer/dritare	Certfikim ISO 9001:2015 DHE14001:2015	Tirane	700,000
7	F. Z.	Perpunim Ulliri	Certifikim ISO 9001:2015 dhe Certifikim HACCP	Berat	1,400,000
8	L.D (N&N.) Pf	Punime alumini&PVC	Konsulence dhe Certifikim OHSAS 18001 dhe Konsulence dhe Certifikim ISO 14001-2015	Tirane	1,050,000
9	A.M.C.	Grumbullim dhe perpunim I bimeve mjekesore	Ambalazhim (thase letre me stampe dhe propileni te permasave te ndryshme me shirita)	Tirane	1,192,800
10	I.Shpk	Perpunim I rushit dhe frutave, prodhon 9 lloje te Vererave	Ambalazhim (Shishe,Tapa,ambalazhe druri dhe Amblalazhe dekorative)	Sarande	1,348,718
11	B.shpk	Prodhim mobiljesh	Ambalazhim,paketim(karton I valezuar me shtresa,,karton kendor, qese buke peshku	Tirane	1,119,790
11	E.D.A 2016	Prodhim sandale dhe kepuce te perfunduara	Konsulence dhe Certifikim ISO 9001 -2015, Konsulence dhe Certifikim OHSAS 18001-2007	Fushe-Kruje	1,309,000
13	M. shpk	Prodhime te ndryshme, (dysheke,durale,plastike)	Konsulence dhe Certifikim ISO 9001-2015	Lushnje	700,000
14	M.T	Prodhim tekstile te ndryshme	Konsulence dhe Certifikim ISO 9001 -2015, Konsulence dhe Certifikim OHSAS 18001-2007	Tirane	1,337,000
15	B. shpk	Prodhim vetrata,import eksport te xhamit punimit dhe tregtimit te tij	Konsulence dhe Certifikim 14001, Konsulence dhe Certifikim ISO 9001-2015	Tirane	1,050,000
				Totali	**17,685,140**

Në lidhje me kompanite mbi realizimin projekteve:

1. E. G. shpk,
Projekti i propozuar për financim konsiston në: Ambalazhim produkti, (shishe qelqi, tapa, etiketa). Kompania "E.G" shpk, mbasi ka realizuar projektin e blerjes se ambalazheve dhe te paketimit,tregon se vazhdon te jetë akoma prezent dhe te realizoje kërkesat e klientëve në kohë duke prezantuar një produkt cilëesor në sajë të etketave të personalizuara, Gjithashtu cilesia e produktteve tështë përmiresuar ne saje të ambalazhimit të shisheve dhe tapave,të cilat bëjnë të mundur eleminimin e kontaktit me jashtë të lëngut duke ruajtur të gjithë parametrat e produktit edhe në vjetërimin e tyre. Falë këtij investimi do të ulen kostot dhe dhe do të rriten automatikisht të ardhurat për vitin 2019.
2. "Sh.SH" shpk
Projekti i propozuar për financim konsiston në: Ambalazhim produkti, (shishe qelqi,tapa,etiketa) dhe Çertifikim produkti BIO.
Kompania "Sh. Sh" shpk gjatë periudhës Gusht-Tetor 2018, ishte në procesin e realizimit të projektit "Ambalazhim produkti, (shishe qelqi,tapa,etiketa) dhe Çertifikim produkti BIO. Perfitimet nga zhvillimi i projektit te aplikuar nga fondi i konkurences ne fondet e kompanise "SH.SH" shpk janë paraqitur ne forme të përmbedhur:
-Ritja e kapacitetit prodhues,

-Ritja e treguesve te eksportit,

Shoqëria "SH.SH" nga analizat e tregut të eksportit ka përcaktuar edhe elementët e suksesit të saj në realizimin e eksportit në tregun e BE-së. Këta elementë janë të lidhur me certifikimin e produktit si prodhim BIO, dhe financimi i certifikimit eshte mundësia për të konkurruar me çmim më të favorshëm. Nëpërmjet strategjisë së marketingut kompania "SH.SH" synon rritjen e sasisë së produktit të eksportuar, duke zgjeruar shtrirjen në tregun evropian, kryesisht përmes përmirësimit të cilësisë dhe përshtatjes së produktit me kerkesat e tregut.

3. "L.F I." shpk,

Projekti i propozuar për financim konsiston në: 'Konsulence dhe Çertifikim ISO 9001-2015 dhe BS OHSAS 18001-2007". Kompania "L.F I." shpk gjatë periudhës Gusht-Tetor 2018, ishte në procesin e konulencës, implementimit dhe certifikimit me certifikatën e sistemit të menaxhimit të cilësisë 9001-2018 dhe BS OHSAS 18001-2007".

Lidhur me Standartin BS OHSAS 18001-2007, e ndihmon kompaninë pëe të siguruar një performancë më të mirë të sigurisë në punë për punonjësit e tyre, gjithashtu e ndihmon në:

-Identifikimin konstant dhe kontrolin e shëndetit dhe risqet e sigurisë

-Uljen e mundësisë së aksidenteve në punë

-Ndihmon pajtueshmërinë legjislative dhe përmirësimin e performancës së përgjithshme.

Certifikimi dhe implementimi i këtyre standarteve sjell avantazhe si:

-Besueshmëri ndaj klientëve aktual, duke plotësuar kërkesat e tyre, si dhe ndaj klientëve potencial, duke i ofruar shërbim korrektësi dhe cilësi.

-Përforcim dhe menaxhim në të gjitha hallkat e biznesit duke bërë të mundur rritjen e bashkëpunimit eficent dhe produktiv midis proceseve të ndryshme.

4. "E. T." shpk,

Projekti i propozuar për financim konsiston në: 'Konsulence dhe Çertifikim ISO 9001-2015 dhe 18001-2007". Kompania "E.T" gjatë peridhës Gusht-Tetor 2018, ishte në procesin e konulencës, implementimit dhe certifikimit me certifikatën e sistemit të menaxhimit të cilësisë 9001-2018 dhe 18001-2007". Certifikimi dhe implementimi i këtyre standarteve sjell avantazhe:

-Besueshmëri ndaj klientëve aktual, duke plotësuar kërkesat e tyre, si dhe ndaj klientëve potencial, duke i ofruar shërbim korrektësi dhe cilësi.

-Përforcim dhe menaxhim në të gjitha hallkat e biznesit duke bërë të mundur rritjen e bashkëpunimit eficent dhe produktiv midis proceseve të ndryshme.

5. "Xh." shpk,

Projekti i propozuar për financim konsiston në: Ambalazhim produktesh (kuti kartoni dhe qeska transparente me spesorë). Kompania "Xh." shpk, mbasi ka realizuar projektin e blerjes se ambalazheve (kuti kartoni +dhe qese transparente me spesor) ,tregon se vazhdon te jetë akoma prezent dhe te realizoje kërkesat e klientëve në kohë duke prezantuar një produkt cilëesor në sajë te ambalazhimeve cilesore. Falë këtij investimi do të ulen kostot dhe dhe do të rriten automatikisht të ardhurat për vitin 2019.

6. "A.E" shpk,

Projekti i propozuar për financim konsiston në: Konsulencë dhe Çertifikim ISO 9001-2015. Kompania A.E gjatë peridhës Gusht-Tetor 2018, ishte në procesin e konulencës, implementimit dhe certifikimit me certifikatën e sistemit të menaxhimit të cilësisë 9001-2018. Përmes këtij sistemit të menaxhimit cilësor tashmë të implementuar, kompamia do të rrisë besimin në tregun e huaj të klientëve të tyre,ti kënaqë vazhdimisht, tju demonstrojë atyre aftësinë e përmirësimit dhe të vendosë në nivel më të lartë menaxhimin e saj.

7. "F.Z" p/f,

Projekti i propozuar për financim konsiston në: 'Konsulencë dhe Çertifikim ISO 9001-2015, dhe Konsulencë dhe Çertifikim HACCP". Subjekti "F.Z" P/F gjatë periudhës Gusht-Tetor 2018, ishte në procesin e Konsulencë dhe Çertifikim ISO 9001-2015, dhe Konsulencë dhe Çertifikim HACCP". Përfitimet e implementimit të certfikimeve:

Është përmirësuar administrimi i cilësisë duke nënkuptuar administrimin e dhe të eficencës së proceseve të veta përmes:

- Njohjes, menaxhimit dhe monitorimit të proceseve,

- Aftësisë së përfshirjes së burimeve njerëzore,
- Centralizimi i rolit drejtues në nivele të larta të firmës,

Rritja e efikasitetit dhe e efektshmërisë ka si rrjedhojë zvogëlimin e kostove.
Me aplikimin e cilësisë së plotë,pra arrihet një zotërim i tregut më lehtë me një cilësi më të mirë dhe me cmime të ulta.

8. "L.D" Pf,

Projekti i propozuar për financim konsiston në: Konsulence dhe Certifikim OHSAS 18001 dhe Konsulence dhe Certifikim ISO 14001-2015. Kompania "L.D" P/f, (N&N A.), ka realizuar projektin e Konsulence dhe Certifikim OHSAS 18001 dhe Konsulence dhe Certifikim ISO 14001-2015. Falë certifikimeve të mësipërme prtshmëritë e këtij biznesi janë realizuar, duke u bërë kështu i mundur perfeksionimi i mëtejshëm i metodave të mënaxhimit, bashkëpunimi me klientët dhe furnitorët dhe standartizimi i te gjithave proceseve të punës në bazë të normave dhe lehtësimit të proceseve te punës pëe stafin.Me implemetimin e tyre kompania ka rritur jo vetëm vlerën e saj por dhe të produkteve që ajo prodhon.

9. "A.M.C." shpk,

Projekti i propozuar për financim konsiston në: Ambalazhim (thase letre me stampe dhe propileni te permasave të ndryshme me shirita). Kompania "A.M. c" shpk, ka realizuar projektin e blerjes se ambalazheve dhe te paketimit. Efektet pozitive te implementimit të këtij projekti paraqiten si më poshtë:

- Rritja e cilësisë së produktit
- Permirësimi i paraqitjes Vizive të produktit
- Ulja e rrezikut të kontaminit të produktve nga pesticidet
- Rritja e prodhimit të qëndrueshëm dhe cilësor.

10. "I. Shpk",

Projekti i propozuar për financim konsiston në: Ambalazhim (Shishe,Tapa,ambalazhe druri dhe Amblalazhe dekorative). Kompania "I" shpk, mbasi ka realizuar projektin e blerjes se ambalazheve dhe te paketimit,tregon se vazhdon te jetë akoma prezent dhe te realizoje kërkesat e klientëve në kohë duke prezantuar një produkt cilëesor. Financimi i kryer, zbatuar ne fushen e marketingut te Kompanise, do te synoje zgjerimin e exportit ne tregun vendas dhe evriopian.
Si mundësi për të zgjeruar tregun e saj vendas dhe evropian, Kompania shikon financimin nga fondi i konkurrences si nje forme marketingu miks i cili do te synoje të realizojë përshtatjen e produktit, veçanërisht në drejtim të amabalazhimit dhe etiketimit, si dhe realizimin e promocionit të nevojshëm nëpërmjet realizimit të misioneve të shitjes për të garantuar realizimin me sukses të hyrjes në tregun e ri.

11. "B" shpk,

Projekti i propozuar për financim konsiston në: Ambalazhim,paketim (karton I valëzuar me shtresa,, karton këndor, qese buke peshku. Kompania "B" shpk, mbasi ka realizuar projektin e blerjes së ambalazheve dhe të paketimit,tregon se vazhdon te jetë akoma prezent dhe të realizojë kërkesat e klientëve në kohë duke prezantuar një produkt cilëesor në sajë të etketave të personalizuara:

- Ritja e kapacitetit prodhues
- Buxheti i fondit te konkurences do te sjelle rritjen e kapacitetit prodhues te kompanise përmes ambalazhimit me mënyra të ndryshme dhe metoda sa më bashkohore ,jo vetëm brenda vendit por edhe jashtë vendit
- Ritja e treguesve te eksportit

Nga financimi ne fushen e marketingut,treguesit e eksportit ,përmes ambalazhimit me mënyra të ndryshme dhe metoda sa më bashkohore mund të rriten ne vitet ne vijim.

- Permiresimi i treguesve SËOT

Permiresimi i paraqitjes se produktit, veçanërisht ne ambalazhimin dhe etiketimin e tij, me dizenjimin dhe permiresimin e ambalazhit. Sigurimi i lendes se pare ne rast fluksi kerkese per produktet. Promovimin më të gjërë të kompanisë ndaj tregut të jashtëm për të shpërndarë dhe tregtuar produktet.

12. "M. shpk",

Projekti i propozuar për financim konsiston në: Konsulencë dhe Certifikim ISO 9001-2015. Kompania "M" shpk, mbasi ka realizuar projektin e Konsulencë dhe Certifikim ISO 9001-2015.Nepermjet realizimit te projektit kompania rendit nje sere perfitimesh si me poshte:
Permiresimin e administrimit të cilësisë duke nënkuptuar administrimin e efikasitetit dhe eficencës së proceseve nëpërmjet:
- Njohjes, menaxhimit dhe monitorimit te proceseve
- Aftësisë së përfshirjes së burimeve njerëzore
- Centralizimin e nivelit drejtues në nivele të larta të firmës. Falë këtij investimi do të ulen kostot dhe dhe do të rriten automatikisht të ardhurat për vitin 2019.

13. "E.D.A" shpk,
Projekti i propozuar për financim konsiston në: Konsulence dhe Certifikim ISO 9001 -2015, Konsulence dhe Certifikim OHSAS 18001-2007. Kompania "E.D.A" shpk, ka realizuar projektin Konsulence dhe Certifikim ISO 9001 -2015, Konsulence dhe Certifikim OHSAS 18001-2007. Nga implementimi dhe çertifikimi i ISO 9001, kompania arriti që të:
- Ofrojë për drejtuesit kryesorë proçese efikase të manaxhimit;
- Përcaktojë fushat e përgjegjësive në gjithë kompaninë;
- Komunikojë një mesazh pozitiv për stafin dhe klientët;
- Identifikojë dhe inkurajojë proçese më efiçiente dhe që kursejnë kohë;
- Evidentojë mangësitë;
- Reduktojë kostot. Lidhur me standardin OHSAS 18001:2007 i cili i vjen në ndihmë kompanisë për të siguruar një performancë më të mirë të sigurisë në punë për punonjësit e tyre. Standardi në bazë të manualit dhe procedurave siguron një mjedis pune të sigurtë dhe të shëndetshëm duke siguruar kështu një strukturë e cila ndihmon kompaninë në:
- Identifikimin konstant dhe kontrollin e shëndetit dhe risqet e sigurisë;
- Uljen e mundësisë së aksidenteve në punë;
- Ndihmon pajtueshmërinë legjislative dhe përmirësimin e performancës së përgjithshme.

14. "M.T" shpk,
Projekti i propozuar për financim konsiston në: Konsulence dhe Certifikim ISO 9001 -2015, Konsulence dhe Certifikim OHSAS 18001-2007. Kompania "M.T" shpk, ka realizuar projektin Konsulence dhe Certifikim ISO 9001 -2015, Konsulence dhe Certifikim OHSAS 18001-2007. Nga implementimi dhe çertifikimi i ISO 9001, kompania arriti që të:
- Identifikojë dhe inkurajojë proçese më efiçiente dhe që kursejnë kohë;
- Evidentojë mangësitë;
- Reduktojë kostot. Standardi OHSAS 18001:2007 mundësoi kompanisë elementët efektiv për sistemin e saj të sigurisë në punë të cilët duke u integruar me kërkesat e tjera të manaxhimit do t'i mundësojë organizatës një performancë më të mirë dhe arritje të objektivave të saj. Çertifikimi dhe implementimi i standardeve sjell avantazhe si:
- Besueshmëri ndaj klientëve aktual, duke i plotësuar kërkesat e tyre, si dhe ndaj klientëve potencial, duke i ofruar shërbim, korrektësi dhe cilësi.
- Përforcim i manaxhimin në të gjithë hallkat e biznesit, duke bërë të mundur arritjen e bashkëpunimit efiçent dhe produktiv midis proceseve të ndryshme.

15. "B" shpk,
Projekti i propozuar për financim konsiston në Konsulence dhe Certifikim 14001, Konsulence dhe Certifikim ISO 9001-2015. Kompania "B" shpk. ka realizuar projektin e Konsulence dhe Certifikim 14001, Konsulence dhe Certifikim ISO 9001-2015. Nga Implementimi dhe certifikimi ISO 9001:2015 subjekti arriti që të:
- Ofrojë për drejtuesit kryesorë procese efikase të menaxhimit
- Përcaktojë fushat e përgjegjsive për cdo pozicion
- Komunikojë një mesazh pozitiv për stafin dhe klientët
- Identifikojë dhe inkurajojë procese më eficente që kursejnë kohë
- Evidentojë mangësitë
- Reduktojë kostot. Nga Implementimi dhe certifikimi ISO 14001 subjekti arriti që të:
- Risë performancë mjedisore

- Të përmbushë detyrimet e pajtueshmërisë
- Të përmbushë arritjen e objektivave mjedisore
- Të përmirësojë efikasitetin për uljen e kostos së drejtimit të biznesit
- Të përmbushë detyrimet ligjore për të fituar besimin e palëve të interesuara

Mbi menaxhimin e Fondit të Inovacionit.

Vlera totale e Fondit të Inovacionit për vitin 2018 ishte 15,000,000 Lekë.

Fondit të Inovacionit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) përfshin promovimi, ndërmarrjet përfituese dhe impakti që do të ketë Fondi mbi ndërmarrjet.

Gjatë 2018 janë paraqitur gjithësej 13 aplikime, të cilët janë trajtuar në 2 mbledhje të Komisionit të Aprovimit të Grantit të Fondit të Inovacionit, nga të cilët 6 janë miratuar për t'u mbështetur me fond.

Numri i kompanive të cilat kanë përfituar nga Fondi i novacionit për vitin 2018 është 6 dhe vlera totale e përfituar është 3,089,334 Lekë, ndërsa vlera totale e disbursuar është 2,790,000 Lekë, pasi një prej aplikimeve fituese u tërhoq nga përfitimi i fondit për arsye personale.

Fondi është realizuar në masën 70%, pasi pas aktit normativ të buxhetit të vitit 2018 nr. 1 datë 26.07.2018, buxheti total vjetor i këtij fondi u shkurtua nga 15, 000, 000 Lekë në 5, 000, 000 Lekë dhe më pas në 4, 000, 000 deri në fund të vitit, pas një rialokimi të dytë, sipas tabelës më poshtë:

Fondet e AIDA-s	Buxheti në /mln Lekë (në Janar 2018)	Buxheti në /mln Lekë (pakësimi në buxhet pas aktit normativ)	Rialokim (1, 000, 000 të marra nga F. Inovac. dhe kaluar F. të Ek. Kreative)	Nr. i aplikimeve	Nr. i përfituesve	Vlera e disbursuar	% e realizuar
Fondi i Inovacionit	15, 000, 000	5, 000, 000	4, 000, 000	13	6	2,790,000	70%

Subjektet kanë aplikuar për të përfituar nga Fondi i Inovacionit kryesisht për blerje pajisjesh teknologjike ose softëare.

Kompanitë përfituese operojnë në sektorë të ndryshëm si më poshtë, ku 2 biznese drejtohen nga sipërmarrëse femra (gati 33 % e përfituesve):

- Fason (tekstil-veshje) – 1 kompani;
- Ekspertizë mjekësore – 1 kompani;
- Sektori i pastrimit/dezinfekstimit – 1 kompani;
- Agjenci punësimi, kërkimi dhe teknologjie – 1 kompani;
- Prodhim, përpunim vaj ulliri – 1 kompani;
- Instalime fotovoltaike, auditim energjie – 1 kompani.

Më poshtë paraqiten kompanitë aplikuese:

Nr.	**Subjekti**	**Administratori**	**Sektori**	**Qyteti**	**Viti i krijimit**	**Projekti aplikues**
1	K. Sh.P.K	L. Sh	Shërbime ekselence dhe ekspertize mjekësore	Lezhë	2008	Blerje pajisjesh teknologjike
2	A Sh.P.K	A.M	Dezinfektim, dezinsektim, deratizim i ambienteve publike dhe private	Tiranë	2015	Blerje pajisjesh teknologjike,
3	A & G.Sh.P.K	K. G	Fason, tekstil	Shkodër	2015	Blerje pajisjesh teknologjike,
4	V. P P.F	V. P	Prodhim i produkteve PVC dhe druri	Lezhë	2013	Blerje pajisjesh teknologjike,

5	S. J P.F	S.J	Prodhim dhe montim dyer dhe dritare duralumini	Vlorë	2003	Blerje pajisjesh teknologjike,
6	E.2006 Sh.P.K	E.K	Tregtim, përpunim dhe montim i profileve të aluminit, bronxit dhe plastikës	Korçë	2006	Blerje pajisjesh teknologjike,
7	S. D. P.F	S. D	Prodhim dhe montim dyer dhe dritare plastike	Lezhë	2008	Blerje pajisjesh teknologjike,
8	A. I P.F	A.I	Prodhim dhe montim i provileve alumini dhe plastike, fasada të ventiluara, grila	Tiranë	2012	Blerje pajisjesh teknologjike,
9	A.D P.F	A.D	Punime duralumini, plastike, parmakë dhe kangjella	Shkodër	2014	Blerje pajisjesh teknologjike,
10	ICTSM. Sh.P.K	E. Sh	Media, Publikime, Trajnime në fushën e teknologjisë së informacionit	Tiranë	2012	Blerje pajisjesh teknologjike,
11	H.M P.F	J. C	Agjenci punësimi, qendër trajnuese, kërkim tregu	Tiranë	2016	Softëare
12	M. P.F	M. S	Përpunim, ambalazhim, paketim, (vaj sallate, vaj ulliri)	Tiranë	2009	Blerje pajisjesh teknologjike,
13	S.Sh.P.K	J.D	Instalime Fotovoltaike, Konsulencë Fotovoltaike, Auditime Energjie	Tiranë	2015	Blerje pajisjesh teknologjike,

Më poshtë është tabela me kompanitë përfituese:

Nr.	**Kompania Përfituese**	**Projekti**	**Vlera e disbursuar (Lekë)**
1	K.Sh.P.K	Blerje pajisjesh teknologjike	600,000
2	A. Sh.P.K	Blerje pajisjesh teknologjike	600,000
3	A&G Sh.P.K	Blerje pajisjesh teknologjike	600,000
4	J. C.P.F	Softëare	390, 000
5	M.S.P.F	Blerje pajisjesh teknologjike	600, 000
6	S. Sh.P.K	Blerje pajisjesh teknologjike	tërhequr
	TOTALI		**2,790,000**

Impakti dhe projekti aplikues i secilës kompani përfituese:

K. Sh.P.K –aplikoi për blerjen e një pajisje e cila shërben për matjen e zhurmave (N. Cl.1 (PTB) N. M. K). Kjo do të bëjë të mundur plotësimin e një pjese të aktivitetit mjedisor që ky subjekt zhvillon që është monitorimi dhe analizat mjedisore. Duke parë se vitet e fundit aktiviteti i shoqërisë është shtuar, kompania mendoi të investojë në fushën e laboratorit duke zhvilluar analiza në matjen e zhurmave në ambiente nëpërmjet kësaj pajisje. Kjo pajisje do të sjellë rritjen e numrit të stafit si dhe aplikimin e metodave inovative në përputhje me standartet europiane në fushën e ekspertizës mjedisore.

A. Sh.P.K –aplikoi për blerjen e një makinerie që futet në procesin e dezinfektimit (Thermal gog cart 7-20) e cila shkurton një proces nga 1 deri në 2 orë krahasuar me makineritë që kompania përdor

aktualisht. Kjo makineri do të bëjë të mundur të arrihen 8 klientë në ditë nga 4 që arrihen aktualisht nga kompania.

A&G Sh.P.K – aplikoi për blerjen e një paisje (Kompresor XL 10 A dhe Tharëse ajri) me qëlim rritjen e kapacitetit të prodhimit dhe përmirësimin e cilësisë. Kjo paisje shërben për të prodhuar presionin e ajrit të nevojshëm për punën në makinat qepëse duke përmirësuar kushtet e punës dhe duke shkurtuar kohën e prodhimit të një produkti.

J.C P.F – aplikoi për krijimin dhe mbajtjen e një softëare për trajnimin e punonjësve dhe headhunting, me disa procesorë dhe për përdorim të jashtëm dhe të brendshëm. Kjo do të sjellë për kompaninë risi në tregun e punësimit, punësimin dhe angazhimin e të rinjve në projekte të kompanisë, module dhe informacione online të trajnimeve të ndryshme si Soft Skills, Leadership, Human resources etj., këshillim karriere online dhe këshillim mbi kërkim tregu për vendet e punës.

M. S P.F – aplikoi për blerjen e pajisjes Printer Domino Ax 350i. Kjo pajisje dhe ky investim për kompaninë do të sjellë lehtësimin e procedurave të punës, rritjen e cilësisë së etiketimit të produktit, uljen e kostove të konsumit të printerit, shtimin e numrit të klientëve dhe rritje e numrit të fuqisë punëtore.

S. Sh.P.K – aplikoi për blerjen e pajisjes Termokamera dhe softëare analitik, matës për sigurinë, funksionalitetin dhe performancën e impianteve fotovoltaike, matës i rrezatimit diellor global, temperaturës dhe këndit. Kompania pas nënshkrimit të marrëveshjes u tërhoq nga përftimi i fondit për arsye personale dhe riktheu këstin e parë të disbursuar.

7.2.Në zbatim të pikës nr. 8 të programit të auditimit mbi 801/2, datë 15.10.2019, u shqyrtua dokumentacioni i miratimit për status *"Investim/Investitor Strategjikë procedurë e vecantë" për projektin e investimit me potencial strategjik "J. E. P".*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për Investimin Strategjik "**J.E.P***"*, në mënyrë të hollësishme konstatohet se:

bazuar në Ligjit Nr. 55/2015, "*Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë*", referuar VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 "*Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike*", *bazuar në gjithë në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se subjekti **"S&S",** nuk ka plotësuar kushtet, kapacitetet dhe kriteret e kërkuara nga legjislacioni në fuqi për miratimin e statusit të investorit strategjik,. për projektin e paraqitur si investimin strategjik "J. E. P", ky konkluzion arrihet pasi:*

Me Vendimin nr. 20/5, date 01.08.2019 të Komitetit të Investimeve Stategjike, realizohet miratimi i statusit "Investim/Investitor strategjik procedurë e veçantë", për projektin e investimit me potencial stategjik "J. E. P.". Miratimi i statusit investitor startegjik është realizuar në mbështetje të nenit 9,17,18 dhe 22 të ligjit nr. 55/2015 "Për investimet strategjike", kreu II, pika 8 e VKM nr. 1026 datë 16.12.2015 "Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike", me propozim të Agjensisë Komisioni i Investimeve Strategjike vlerësoi:

- Vlera e Investimit të projektit "J.E.P.", plotëson kriteret e parashikuara nga legjislacioni për investimet strategjike dhe parashikohet të jetë 67,000,000 Euro.
- Projekti plotëson kriteret e punësimit të kërkuar nga legjislacioni për investimet strategjike. Përgjatë fazes së realizimit të investimit dhe operimit, numri i të punësuarve parashikohet të jetë 620 persona.
- Projekti do të realizohet nga subjekti "S&S"
- Për këtë projekt është miratuar Vendim të KKT nr. 26 datë 16.10.2017 "Leje Zhvillim për objektin "Kompleks Turistik, hoteleri dhe shërbime, me vendndodhje në Jalë, Bashkia Himarë dhe Leje Ndërtimi nr. 887/10, date 21.09.2018. "Resort Turistik "S.2", me vendndodhje në Jalë, Bashkia Himarë", sipas Vendimit nr. 14 datë 27.04.2018 të Këshillit Kombëtar të Territorit.
- Projekti parashikon ndërtimin e një kompleksi turistik me sipërfaqe truall **22 ha në zonën kadastrale 3844, në Jalë-Vuno, Himarë.**

Komiteti i Investimeve Strategjike ***është organi administrativ kolegjial pranë Këshillit të Ministrave,*** **në përbërje të të cilit është Kryeministri, në rolin e Kryetarit të KIS-s dhe anëtarë**

zv/Kryeministri, Ministri i MFE, Ministri i MIE, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Ministri i MBZHR dhe Avokati i Përgjithshëm i Shtetit bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga Sekretariati Teknik(AIDA) dhe raportit të vlersimit të pregatitur nga Grupi Operacional me përbërje nga specialist të ministrive të linjës *"është grupi i posaçëm i punës, i cili përbëhet nga ekspertë të ministrive të linjës, të fushave në të cilën/at kërkohet të realizohet investimi strategjik për të asistuar dhe mbështetur profesionalisht në ndjekjen e të gjitha procedurave dhe përgatitjen e të gjitha akteve e dokumenteve ligjore, me qëllim përgatitjen, zbatimin, zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik të veçantë* bazuar në rekomandimin e dhënë prej këtij grupi,ka vendosur:

1. Miratimin e statusit "Investim/Investitor strategjik procedurë e vecantë", për projektin e investimit me potencial stategjik "J.E.P", me subject S&S shpk.
2. Projketi përfshin ndërtimin e një kompleksi turistik, i cili shtrihet në një sipërfaqe totale prej 22 ha, të ndodhur në zonën kadastrale 3844, në Jalë-Vuno, Himarë.
3. Statusi "Investim/Investitor strategjik procedure e vecantë" i jepet projektit të investimit "J. E. P", për një periudhë 2 vjecare.
4. Në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike, masat mbështetëse që i jepen projektit janë si me poshtë:

a) Miratimin në parim dhe lejimin e përdorimit të bregut të detit dhe të zones përkatëse së plazhit përpara kompleksit në përputhje me Vendimin e KKT nr, 26 datë 16.10.2017 "Leje Zhvillimi për objektin "Kompleks turistik, hoteleri dhe shërbime, me vendndodhje në Jalë, Bashkia Himarë" dhe leje ndërtimi nr. 887/10, date 21.09.2018, "R. Turistik "S. 2", me vendndodhje në Jalë, Bashkia Himarë" sipas Vendimit nr. 14 datë 27.04.2018 të Këshillit Kombëtar të Territorit, pasi plazhi të përfshihet në listen e plazheve.

Miratimin përfundimtar, si mënyra, afatet, kostot e lejimit të përdorimit të brigjeve të detit dhe të zones përkatëse së plazhit në funksion të realizimit të projektit investues strategjik do të përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, sipas procedurave të legjislacionit për investimet strategjike, pasi zona e plazhit do të jetë përfshirë në listen e plazheve të Bashkisë Himarë referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 369, date 18.05.2016 "Për Miratimin e Rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit".

b) Infrastrukturë ndihmëse, për sa i përket nevojave për furnizim dhe përshtatje të rrjetit elektrik dhe furnizimit me ujë të pishëm, sipas përcaktimeve të planit të veprimit për realizimin e projektit. c) Asistencë për kryerjen e veprimeve në lidhje me konsolidimin e tokës. Për këtë arsye ngarkohet Agjensia Shtetërore e Kadastrës për fillimin e procesit të regjistrimit fillestar të zones së zhvillimit.

d) Pas regjistrimit fillestar të zones së zhvillimit, në bazë të legjislacionit të investimeve strategjike dhe përcaktimeve ligjore për zonat me prioritet zhvillimin e turizmit, përcaktohen nëpërmjet një Vendimi të Këshillit të Ministrave, mënyra, afatet dhe kostos e lejimit të marrjes me qira "1 (një) Euro" të pronës shtetërore.

e) Në rast se, pas kryerjes së regjistrimit fillestar të zones së zhvillimit, rezultojnë tituj pronësie të palëve të treta private, atëherë investimi/investitori strategjik përfiton mbështetje në përputhje me procedurat e parashikuara në VKM nr. 1032, date 16.12.2015 "Mbi dokumentimin e marrëveshjeve të investitorëve strategjike me pronarët e pasurive të paluajtshme, prone private", sipas të cilës parashikohet se: "Investitorët strategjikë të cilët kanë përfituar statusin "Investim/investitor strategjik, procedure e vecantë", *përpara se të kërkojnë shpronësimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, prone private, të cilat preken nga investimi strategjik, duhet të kryejnë dhe dokumentojnë procedurat për arritjen e një marrëveshje me pronarët, duke u ofruar atyre instrumente të përshtatshme alternative dhe/ose kompesuese.*

f) Në rast se, investitorit strategjik i cënohet prona që disponon nga pale të treta, invetitori, sipas rastit, përfiton të drejtën e shpronësimit ose të marrjes me qera me kontratën "1 (një) Euro", sipas planit të rilevimit të pronës që disponon aktualisht.

5. Në rast se përgjatë zhvillimit dhe zbatimit të projektit investues strategjik "J. E. P." konstatohen të dhëna të pavërteta, të rreme apo ndryshime të të dhënave të dala rishtazi, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për miratimin e statusit strategjik të këtij projekti me procedurën e asistuar, Komiteti I Investimeve Strategjike, ka të drejtë të revokojë vendimin për dhënien e statusit strategjik.

6. Vendimi i njoftohet investitorit si dhe publikohet në regjistrin e investimeve strategjike.

7. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Bashkia Himarë për nisjen e procedurave për përfshirjen e plazhit në listen e plazheve.
8. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Bashkia Himarë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Vlorë dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.
Ndërkohë sipas parashikimeve të ligjit 55/2015 neni *18 Përmbajtja e vendimit me anë të të cilit Komiteti i Investimeve Strategjike miraton statusin "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë",* ***<u>në përmbajtje të tij duhet të parashikojë</u>****, gjithashtu, edhe elementet e mëposhtme: a) titullin e projektit investues; b) vlerën e parashikuar të kapitalit që do të investohet; 11 c) emrin e investitorit të interesuar dhe partnerëve të tij; ç) llojin e projektit investues; d) vendin/zonën ku do të zhvillohet ky projekt investues; dh) afatin për të cilin jepet statusi "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë".*

<u>Bazuar Raportit të Vlerësimit të grupit operacional konstatohet:</u>

Projekti i plotë i investimit të synuar zë një sipërfaqe prej 22,02 Ha, me vlerë investimi prej 67 milion Euro, 620 vende punësimi.

Pronësia	Sipërfaqja	Investimi	Punësimi	Hoteleri
Shtetërore Truall, pyll dhe kullotë	22,02 Ha	67 milionë euro total	620 total	4 hotele - 262 dhoma, 1 hotel vip - 90 dhoma, 79 Dhoma pushimi, 60 Vila 60 Dhoma hoteli

A. Faza e vlerësimit paraprak të projektit të investimit dhe përshkrimi i projektit
Sipas legjislacionit të investimeve strategjike, faza e vlerësimit paraprak të projektit realizohet nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).
Pranë AIDA, pas konsultimeve paraprake, më datë **09.04.2019**, është depozituar për aplikim dokumentacioni i një projekti me potencial strategjik për realizimin e një projekti investimi në sektorin e turizmit "J.E.P".
Subjekti aplikues S&S sh.p.k, kërkon përfitimin e Statusit të Investitorit Strategjik/ Investim Strategjik Procedurë e Veçantë, në zbatim të Nenit 8, pika 3, c, i, të Ligjit Nr. 55/2015 "Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë", dhe Kreut I, pika 3, c të VKM Nr. 1023, datë 16.12.2015 për "Nënsektorët strategjikë dhe zonat me përparësi zhvillimi".

<u>Procesi i vlerësimit të projektit nga grupi operacional, i përbërë nga ekspertët e ministrive të linjës, të fushave të cilat prekën nga projekti i paraqitur, përkatësisht nga MFE, MIE, MTM, MBZHR, AKZM, AKUM dhe Bashkia Himarë.</u>
Procesi i identifikimit të qartë kadastral dhe situatës juridike të pronës e cila synohet të preket nga projekti i J.E.P ka filluar nga AIDA që në muajin AIDA 2019.
Projekti synon të realizohet në 4 zona sipas
<u>Faza 1</u> – J. B. (hotel); S= 2.72 ha (leje zhvillimore, ende e pazbardhur leja e ndërtimit)
- 1.6 ha në pronësi
- 1.12 ha pa identifikim

<u>Faza 2</u> – J. S (blloqet C, D, E, F); S= 2.25 ha
- **<u>951 m2 janë përfituar me legalizim</u>**, VKM, Vërtetime Hipotekore (VH);
- 2.15 ha pa identifikim

<u>Faza 3</u> – J.V.Hotel (hotel, klub nate, beach bar, pishinë); S= 4.16 Ha
- 0.7 ha përfituar me legalizim (VKM dhe VH)
- 0.6 ha sipërfaqe trualli është përfituar me legalizim (ende jo VKM dhe VH)
- 0.09 ha në pronësi
- **<u>2.69 ha pa identifikim</u>**

Faza 4 – J. N.H (vila, pishinë, ambjente argëtimi, bar, restorant); **S= 12.89 ha pa identifikim kdastral**

Faza 5 – J. S. Dh (vila, restorant, beach bar).

AIDA, referuar masave mbështetëse të kërkuara nga subjekti për t'i vënë në dispozicion subjektit tokë shtetërore, i ka adresuar Institucioneve përkatese shkresat duke kërkuar verfikim kadastral.
Me datë 18/03/2019 AIDA ka adresuar shkresat për institucionet e mëposhtme:

1. AIDA i është drejtuar me shkresë Nr. 107/5 prot. datë 18.03.2019 Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI VLORË), për të bërë verifikime nëse ka në proces pasuri të ndërtuara pa leje në zonën e sipërcituar.
ALUIZNI VLORË me shkresë Nr. 3079/1 Prot. dt. 01/04/2019, sqaroi se nga verifikimi i koordinatave ka konstuar objekte të vetëdeklaruara nga subjektet

- J.L.K, K shpk, të aplikuar me formularin Nr. 3288, pajisur me leje legalizimi Nr. 107008 datë 08/03/2017, për objektin, ndërsa pronësia mbi tokën është miratuar me VKM Nr. 810 datë 29/12/2017.
- J. L. K., K shpk, të aplikuar me formularin Nr. 3290, pajisur me leje legalizimi Nr. 107264 datë 20/03/2017, për objektin, ndërsa pronësia mbi tokën është miratuar me VKM Nr. 810 datë 29/12/2017.
- A. B.B, S dhe S shpk, të aplikuar me formularin Nr. 3289, pajisur me leje legalizimi Nr. 106707 datë 10/02/2017, për objektin, ndërsa pronësia mbi tokën është në process miratimi.

Në fakt nga ***auditimi i ushtruar në DVASHK Vlorë (ish-ALUIZNI Vlorë) në bazë të programit të auditimit nr.554/1, datë 30.07.2019, dhe akt konstatimit të mbajtur në datë 04.10.2019, nga Audituesit të KLSH*** në zbatim të pikës 6 të programit të auditimit "Nr. nr.554/1, datë 30.07.2019", në lidhje me verifikimin e ankesave të paraqitura për tjetërsimin e paligjshëm të pronave dhe lëshim të lejeve të legalizimit në kundërshtim me ligjin në zonën bregdetare të Jalës, u auditua dokumentacioni i vënë në dispozicion, ka rezultuar se :

1. **Dosja nr. 3288, J.L. K (K SHPK) (Jalë, Himarë)**

Sipas vetëdeklarimit nr.3288, datë 23.12.2014, poseduesi i objektit informal deklaron përfshirjen në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje.
-Vendimi për kualifikimin e ndërtimit informal me nr.9996, datë 06.03.2017 sipas të cilit legalizohen këto objekte pa leje është nënshkruar nga A. B, D. M dhe E. V.
Leja e Legalizimit me nr.107008, në emër të J. L. K. (K shpk). Objekti "Objekt shërbimi 2 kate + dy objekte shërbimi 1 kat". Parcela ndërtimore 951m^2, sipërfaqja e bazës së ndërtimit është 317m^2 (232m^2 + 60m^2 + 25m^2), pasuri nr.1/137, ZK 3844. Leja e legalizimit është nënshkruar nga përgjegjësi i sektorit të legalizimit D. M dhe ish-Drejtori E. V. Parcela ndërtimore është në pritje të miratimit me VKM.
-Sipas procesverbalit të verifikimit në terren, datë 21.12.2016 janë përcaktuar vetëm nr. e pasurive të kufitarëve (të pasaktësuara me shkrim) dhe nuk është përcaktuar distanca nga bregu i detit. Po ashtu, **nga shqyrtimi i skicës fushore rezulton se nuk është evidentuar dhe pasqyruar distanca e objektit nga bregu i detit, e cila rezulton më e vogël se 100m**.
Procesverbali i verifikimit në terren nuk ka nënshkrimin e asnjë specialisti të terrenin dhe nga sektori i hartografisë pavarësisht se verifikimi në terren duhet të kryhet nga jo më pak se dy specialistë të ALUIZNI.
-Veprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me Urdhrin nr. 846, datë 11.10.2012 "Për miratimin e manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (gen-plani dhe planimetri) të objektit që legalizohet" shfuqizuar me Udhëzimin nr.30, datë 15.01.2016 "Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet".
-Në përpunimin hartografik të përpunuar nga ish-specialisti Arbër Jaupi dhe ish-përgjegjësi i sektorit të hartografisë A. Ll. nuk është evidentuar dhe paraqitur distanca e objektit nga bregu i detit.

-Nga verifikimi i hartës dixhitale në G. A. rezulton se **distanca e objektit të legalizuar me sipërfaqe 232m^2 nga shtrati i detit është 56m, ndërsa distanca e objektit tjetër me sipërfaqe prej 25m^2 nga shtrati i detit është 44m.**

-Vendimi "Për kualifikimin për legalizim, të Objektit informal" është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe në këtë rast objekti duhet të ishte skualifikuar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet e mëposhtme të Ligjit Nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar:

Neni 4 pika 8:

"Brigjet" janë rripat anësorë të tokës përgjatë deteve, liqeneve, rezervuarëve, lagunave dhe pellgjeve, si dhe përgjatë rrjedhës së shtratit të lumenjve e përrenjve që, në funksion të përdorimit, përfshijnë të paktën dy zona:

a) me gjerësi 5 m në drejtim normal me tokën nga brinja e sipërme e shtratit natyror në brigjet e pjerrëta dhe 20 m nga vija e nivelit maksimal të plotave me probabilitet përsëritjeje, një herë në 25 vjet, të ujit në brigjet e sheshta, që përdoret për qëllime publike me dispozita të veçanta;

b) me gjerësi 100 m në drejtim normal me tokën nga brinja e sipërme e shtratit natyror në brigjet e pjerrëta dhe 200 m nga vija e nivelit maksimal të plotave me probabilitet përsëritjeje një herë në 25 vjet të ujit në brigjet e sheshta, në të cilën çdo veprimtari e zhvilluar përcaktohet nga organet e administrimit a menaxhimit të burimeve ujore. Kufiri i ndarjes së bregut të pjerrët me bregun e sheshtë është pjerrësia 10 për qind në drejtim normal me bregun.

-neni 84, pika a dhe b, ku përcaktohet: "Në tokat, pronë private dhe shtetërore, përbri brigjeve të lumenjve, përrenjve, kanaleve, liqeneve, pellgjeve, rezervuarëve, lagunave bregdetare dhe deteve duhet, detyrimisht, të lihet:

a) një sipërfaqe toke e lirë për përdorim publik, me gjerësi nga 5 deri në 100 metra nga këto brigje, sipas përkufizimit të bërë në këtë ligj. Gjerësia e saj mund të shtrihet më tej në afërsi të grykës së lumenjve, në rrethinat e ngushta të rezervuarëve ose kur kushtet topografike dhe hidrologjike të lumenjve, liqeneve ose rezervuarëve e bëjnë të nevojshme për sigurimin e njerëzve dhe të pasurisë. Veprimtaritë në këto zona përcaktohen me akte të Këshillit Kombëtar të Ujit.

b) **një sipërfaqe toke e lirë** për zhvillimin e veprimtarive që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Ujit, **me gjerësi** nga 100 m deri në 200 m.

Neni 5 "Pronësia e burimeve ujore":

1. Janë në pronësi të shtetit dhe në administrim të organeve shtetërore:

a) të gjitha burimet ujore të Republikës së Shqipërisë;

b) të gjithë shtretërit dhe brigjet e lumenjve, përrenjve dhe rrjedhave të tjera natyrore, qofshin të përkohshme apo të përhershme, ujërat kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale, kanalet, liqenet, pellgjet, lagunat dhe ujëmbledhësit natyrorë apo artificialë, ishujt dhe grumbullimet e rërës, gurëve dhe dherave në shtretërit e lumenjve, liqeneve dhe ujëmbledhësve, si dhe formacionet gjeologjike të ujërave nëntokësore;

c) toka e përftuar nga tërheqja e ujit ose nga përparimi i tokës në drejtim të ujit, kur ajo lidhet me tokën, që është në pronësi të shtetit;

ç) të gjitha strukturat dhe punimet hidroteknike të realizuara nga shteti, si digat, sistemet e ujitjes, kullimit dhe lundrimit, stacionet e ujit të pijshëm dhe kanalet, si dhe punimet që lidhen me to.

2. **E drejta e pronësisë së shtetit, sipas përcaktimeve në shkronjat "a", "b" dhe "c" të pikës 1 të këtij neni, është e patjetërsueshme dhe paparashkrueshme.**

-Mungon vërtetimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Në këtë rast Vendimi "Për kualifikimin për legalizim të objektit informal në posedim të shtetasve" është marrë në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, neni 27 "Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit", pika "ç" –"*vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi"* si dhe me VKM nr. 411, datë 19.05.2010 i ndryshuar "Për kriteret procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit" Kreu I, pikën 1,c ku përcaktohet –"*c) për objektin/shtesën pa leje në ndërtime me leje është plotësuar dokumentacioni tekniko-ligjor, i parashikuar në nenet 27 e 37 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar;* si dhe pika 2, ku përcaktohet se –*"Drejtoritë e ALUIZNI-t pranë qarqeve,*

pas verifikimit të dokumentacionit dhe vlerësimit të përmbushjes ose jo të kushteve të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, për objektin informal/shtesën pa leje në ndërtime me leje, vendosin kualifikimin për legalizim ose përjashtimin nga legalizimi. Vendimi, i cili shoqërohet me aktin përkatës, të argumentuar, administrohet si pjesë përbërëse e dosjes së legalizimit.".

Për sa më lartë mbajnë përgjegjësi ish-përgjegjësi i sektorit të legalizimit D. M, ish-Drejtori E. V,specialisti A.B, specialisti i hartografisë A. J dhe përgjegjësi i hartografisë A. Ll.

2. Dosja nr. 3290, J. L. K. (K. shpk) (Jalë, Himarë)

Sipas vetëdeklarimit nr.3290, datë 23.12.2014, poseduesi i objektit informal deklaron përfshirjen në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje.

-Vendimi për kualifikimin e ndërtimit informal me nr.10201, datë 16.03.2017 sipas të cilit legalizohen këto objekte pa leje është nënshkruar nga A. B, D. M. dhe E. V.

-Leja e Legalizimit me nr.107264, në emër të J.L. K (K shpk). Objekti "3 objekte shërbimi 3 kate + 2 objekte shërbimi 2 kate + 3 objekte shërbimi 1 kat + 1 kat nëntokë + 1 objekt shërbimi 1 kat". Leja e legalizimit pasqyron parcelën ndërtimore 7494m^2 dhe sipërfaqen e ndërtimit 2498m^2, pasuri nr. 1/123, ZK 3844. Leja e legalizimit është nënshkruar nga përgjegjësi i sektorit të legalizimit D. M. dhe ish-Drejtori E. V. Parcela ndërtimore është në pritje të miratimit me VKM.

-Sipas procesverbalit të verifikimit në terren, pa datë janë përcaktuar vetëm nr. e pasurive të kufitarëve (të pasaktësuara me shkrim) dhe nuk është përcaktuar distanca nga bregu i detit. Po ashtu dhe **nga shqyrtimi i skicës fushore dhe përpunimi hartografik rezulton se nuk është evidentuar dhe pasqyruar distanca e objektit nga bregu i detit.**

Procesverbali i verifikimit në terren, pa datë është nënshkruar vetëm nga një ish-specialist terreni A. J, si dhe ka nënshkrimin e përgjegjësit të sektorit të hartografisë A. Ll, pavarësisht se verifikimi në terren duhet të kryhet nga jo më pak se dy specialistë të ALUIZNI.

-Veprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me VKM nr.589, datë 10.09.2014 "Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtime me leje, të organeve dhe dokumentacionit për propozimin dhe miratimin e zonave informale", i ndryshuar, Urdhrin nr. 846, datë 11.10.2012 "Për miratimin e manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (gen-plani dhe planimetri) të objektit që legalizohet" shfuqizuar me Udhëzimin nr.30, datë 15.01.2016 "Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet".

-Nga verifikimi i hartës dixhitale në geoportalin A. dhe Google Earth rezulton se asnjë nga depot e ujit (të pasqyruara në lejen e legalizimit si objekte shërbimi), jo vetëm që nuk ka qenë e ndërtuar në datë 27.06.2014, por nuk duket të jenë ndërtuar as në hartën e vitit 2015. Këto objekte janë legalizuar në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, neni 2 "Fusha e zbatimit" ku citohet "*1. Ky ligj zbatohet për ndërtimet pa leje të ndërtuara deri më 27.6.2014, me funksione banimi, veprimtari ekonomike apo funksione të tjera social-kulturore, dhe që disponohen nga individë apo persona juridikë të regjistruar, përfshirë dhe ndërtimet pa leje, për të cilat subjektet nuk kanë kryer procedurën e vetëdeklarimit për legalizim, sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj.*" **Për pasojë është tjetërsuar në mënyrë të paligjshme toka (433m^2 llogaritur mbi bazën e planimetrive të ndodhura në dosje) mbi të cilën ato objekte supozohet të jenë ndërtuar duke rritur fiktivisht sipërfaqen e parcelës ndërtimore për të kaluar në pronësi të subjektit privat "Kempixh shpk".**

-Nga shqyrtimi i planimetrive të nënshkruara për 6 objektet e shërbimit (hotele) (pa përfshirë depot e ujit) rezultoi si më poshtë:

1. Objekt me dy kate me sipërfaqe të bazës së ndërtimit 66m^2, e cila po aq është evidentuar në planimetri
2. Objekt me 2 kate me sipërfaqe të bazës së ndërtimit 317m^2, e cila po aq është evidentuar në planimetri
3. Objekt me sipërfaqe të bazës së ndërtimit prej 236m^2, e cila po aq është evidentuar në planimetri
4. Objekt me sipërfaqe të bazës së ndërtimit prej 202m^2, e cila po aq është evidentuar në planimetri
5. Objekt të pasqyruar në planimetrinë e katit të parë me sipërfaqe të ndërtimit prej 452m^2, ndërkohë që në planimetrinë e katit përdhe baza e ndërtimit është pasqyruar 773m^2 (**pjesa e mbetur prej 321m^2** (773-452) në katin përdhe, **në hartën dixhitale të A. G rezulton që të mos jetë e zënë me**

ndërtim). Planimetria është punuar dhe përditësuar nga ish-specialisti A. J, nënshkruar nga ish-përgjegjësi i sektorit të legalizimit A.Ll dhe nga ish-Drejtori E.Velaj.

6. Objekt me sipërfaqe faktike të bazës së ndërtimit prej 172m^2 (sipas matjes nga planimetria e ndodhur në dosje dhe krahasimi me hartën dixhitale të vitit 2015), ndërkohë që në planimetri është evidentuar 472m^2 (**pjesa e mbetur prej 300m^2, në hartën dixhitale të vitit 2015 të A. G rezulton që të mos jetë e zënë me ndërtim**)), punuar dhe përditësuar nga ish-specialisti A. J, nënshkruar nga ish-përgjegjësi i sektorit të legalizimit A.Ll dhe nga ish-Drejtori E. V.

-Nga sa më sipër rezulton se sipërfaqja totale e bazës së ndërtimit është 1445m^2 (66 m^2 + 317 m^2 + 236m^2 + 202m^2 + 452m^2 + 172m^2) dhe jo 2498m^2 sa është dhënë me lejen e legalizimit. Pra, **kemi të bëjmë me një rritje fiktive të bazës së ndërtimit me një sipërfaqe prej 1053m^2, si pasojë e të cilës është rritur fiktivisht edhe sipërfaqja e parcelës ndërtimore me 3159m^2.**

-Në përpunimin hartografik të përpunuar nga A.J dhe A. Ll nuk është evidentuar dhe paraqitur distanca e objektit nga bregu i detit.

-Nga verifikimi i hartës dixhitale në G. A rezulton se **distanca e objekteve të legalizuara nga shtrati i detit (nisur nga më i afërti) është 9m, 9.5m, 20m, 21m, 22m, dhe 39m.**

-Vendimi "Për kualifikimin për legalizim, të Objektit informal" është dhënë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe në këtë rast objekti duhet të ishte skualifikuar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet e mëposhtme të Ligjit Nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar:

Neni 4 pika 8:

"Brigjet" janë rripat anësorë të tokës përgjatë deteve, liqeneve, rezervuarëve, lagunave dhe pellgjeve, si dhe përgjatë rrjedhës së shtratit të lumenjve e përrenjve që, në funksion të përdorimit, përfshijnë të paktën dy zona:

a) me gjerësi 5 m në drejtim normal me tokën nga brinja e sipërme e shtratit natyror në brigjet e pjerrëta dhe 20 m nga vija e nivelit maksimal të plotave me probabilitet përsëritjeje, një herë në 25 vjet, të ujit në brigjet e sheshta, që përdoret për qëllime publike me dispozita të veçanta;

b) me gjerësi 100m në drejtim normal me tokën nga brinja e sipërme e shtratit natyror në brigjet e pjerrëta dhe 200m nga vija e nivelit maksimal të plotave me probabilitet përsëritjeje një herë në 25 vjet të ujit në brigjet e sheshta, në të cilën çdo veprimtari e zhvilluar përcaktohet nga organet e administrimit a menaxhimit të burimeve ujore. Kufiri i ndarjes së bregut të pjerrët me bregun e sheshtë është pjerrësia 10% në drejtim normal me bregun.

-neni 84, pika a dhe b, ku përcaktohet: "Në tokat, pronë private dhe shtetërore, përbri brigjeve të lumenjve, përrenjve, kanaleve, liqeneve, pellgjeve, rezervuarëve, lagunave bregdetare dhe deteve duhet, detyrimisht, të lihet:

a) një sipërfaqe toke e lirë për përdorim publik, me gjerësi nga 5 deri në 100 metra nga këto brigje, sipas përkufizimit të bërë në këtë ligj. Gjerësia e saj mund të shtrihet më tej në afërsi të grykës së lumenjve, në rrethinat e ngushta të rezervuarëve ose kur kushtet topografike dhe hidrologjike të lumenjve, liqeneve ose rezervuarëve e bëjnë të nevojshme për sigurimin e njerëzve dhe të pasurisë. Veprimtaritë në këto zona përcaktohen me akte të Këshillit Kombëtar të Ujit.

b) **një sipërfaqe toke e lirë** për zhvillimin e veprimtarive që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Ujit, **me gjerësi** nga 100 m deri në 200 m.

Neni 5 "Pronësia e burimeve ujore":

1. Janë në pronësi të shtetit dhe në administrim të organeve shtetërore:

a) të gjitha burimet ujore të Republikës së Shqipërisë;

b) të gjithë shtretërit dhe brigjet e lumenjve, përrenjve dhe rrjedhave të tjera natyrore, qofshin të përkohshme apo të përhershme, ujërat kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale, kanalet, liqenet, pellgjet, lagunat dhe ujëmbledhësit natyrorë apo artificialë, ishujt dhe grumbullimet e rërës, gurëve dhe dherave në shtretërit e lumenjve, liqeneve dhe ujëmbledhësve, si dhe formacionet gjeologjike të ujërave nëntokësore;

c) toka e përftuar nga tërheqja e ujit ose nga përparimi i tokës në drejtim të ujit, kur ajo lidhet me tokën, që është në pronësi të shtetit;

ç) të gjitha strukturat dhe punimet hidroteknike të realizuara nga shteti, si digat, sistemet e ujitjes, kullimit dhe lundrimit, stacionet e ujit të pijshëm dhe kanalet, si dhe punimet që lidhen me to.

2. **E drejta e pronësisë së shtetit, sipas përcaktimeve në shkronjat "a", "b" dhe "c" të pikës 1 të këtij neni, është e patjetërsueshme dhe paparashkrueshme.**

Për sa më lartë mbajnë përgjegjësi ish-përgjegjësi i sektorit të legalizimit D.M, ish-Drejtori E. V, ish-specialisti A.B, ish-specialisti i hartografisë A.J dhe ish-përgjegjësi i hartografisë A Ll.

3. Dosja nr. 3289, A. B. B (S&S SHPK) (Jalë, Himarë)

Sipas vetëdeklarimit nr.3289, datë 23.12.2014, poseduesi i objektit informal deklaron përfshirjen në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje.

Leja e Legalizimit me nr.106707, në emër të A. B. B (S&S SHPK). Objekti "Kompleks shërbimi me 24 objekte shërbimi 3 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë". Parcela ndërtimore 6300m^2, sipërfaqja e ndërtimit është 2100m^2, pasuri nr. 1/129, ZK 3844. Leja e legalizimit është nënshkruar nga përgjegjësi i sektorit të legalizimit D.M. dhe ish-Drejtori E. V. Parcela ndërtimore është në pritje të miratimit me VKM.

-Sipas procesverbalit të verifikimit në terren, datë 21.12.2016 janë përcaktuar vetëm nr. e pasurive të kufitarëve (të pasaktësuara me shkrim).

-Në skicën fushore të përgatitur nga V. S më datë 21.12.2016 janë pasqyruar në total 26 objekte (2 prej të cilave janë depo uji të cilat ndodhen në taracën e objektit impianti i ujërave të zeza) ndërkohë që faktikisht janë 24 objekte.

-Veprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me Urdhrin nr. 846, datë 11.10.2012 "Për miratimin e manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (g-plani dhe planimetri) të objektit që legalizohet" shfuqizuar me Udhëzimin nr.30, datë 15.01.2016 "Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (g.plan dhe planimetri) të objektit që legalizohet", përsa më lart ky procesverbal është nënshkruar nga ish-specialistët e terrenit V. S dhe A. J si dhe ish-përgjegjësi i sektorit të hartografisë A. Ll.

-Vendimi për kualifikimin e ndërtimit informal me nr.9540, datë 06.02.2017 sipas të cilit legalizohen këto objekte pa leje është nënshkruar nga A.B, D.M dhe E.V.

-Në një planvendosje të panënshkruar dhe pa datë, objekti pasqyrohet si objekt me dy kate, ndërsa në një planvendosje tjetër pasqyrohet si objekt ende në ndërtim (pra i papërfunduar).

-Nga verifikimi i hartës dixhitale në geoportalin A. dhe Google Earth rezulton se objekti i mësipërm, nuk ka qenë i përfunduar si karabina në hartën e vitit 2015 sepse duken qartë konturet e mureve të objektit dhe objekti nuk është i mbuluar.

Pra ky objekt është legalizuar në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, neni 2 "Fusha e zbatimit" ku citohet "*1. **Ky ligj zbatohet për ndërtimet pa leje të ndërtuara deri më 27.06.2014**, me funksione banimi, veprimtari ekonomike apo funksione të tjera social-kulturore, dhe që disponohen nga individë apo persona juridikë të regjistruar, përfshirë dhe ndërtimet pa leje, për të cilat subjektet nuk kanë kryer procedurën e vetëdeklarimit për legalizim, sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj.*" dhe nenin 3, gërma a ku citohet ***"Ndërtim pa leje" është objekti, për të cilin është përfunduar karabinaja**, i destinuar për banim, veprimtari ekonomike dhe/ose funksione të tjera, (si, për shembull, social-kulturor, arsim, shëndetësi e të tjera të këtij lloji), për të cilin nuk janë respektuar procedurat e përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi për planifikimin e territorit.*";

-VKM nr.589, datë 10.09.2014 "Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtime me leje, të organeve dhe dokumentacionit për propozimin dhe miratimin e zonave informale", pika 3 ku përcaktohet "*Verifikimi i ndërtimeve informale, brenda periudhave kohore të përcaktuara në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, bëhet nëpërmjet të paktën njërës prej formave të mëposhtme:*

a) Përdorimit të produktit të fotografimit ajror të territorit të Republikës së Shqipërisë, për periudhën kohore që ai mbulon.

b) Imazheve satelitore ose ajrore të përdorimit të përgjithshëm, sipas kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara nga subjektet disponuese.

c) Përdorimit të planrilevimeve në kuadër të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme, të administruara nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

ç) Vërtetimit me mënyra alternative, nëpërmjet çdo dokumenti tjetër, juridikisht të vlefshëm, që provon ekzistencën e ndërtimit informal në momentin kohor të dhënë (në një datë dhe vend të caktuar).

Dokumentacioni, i cili provon periudhën në të cilën është ngritur ndërtimi informal, administrohet në praktikën dokumentare të legalizimit."

Pra, leja e legalizimit paraqet në mënyrë fiktive një deri në dy kate më tepër të objektit nga gjendja reale, duke dhënë pronësinë në mënyrë të paligjshme për katet të pandërtuara ende.

-Për sa më lart, nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se realisht deri në vitin 2015 (sipas hartës A. G) nuk ka patur të ndërtuar asnjë objekt me 3 kate. Gjithsesi, kjo leje e legalizimit është lëshuar edhe në mënyrë evazive për faktin se nuk ka të cilësuar për secilin objekt katet mbi tokë apo nën tokë, duke nënkuptuar kështu sikur të gjitha objektet janë 3 kate mbi tokë dhe një nëntokë, pavarësisht faktit se shumica e objekteve janë vetëm 1 kat. Kjo praktikë lë hapësirë për vazhdimësinë e paligjshmërisë për shkak se subjekti përfitues mundet të bëj shtesa të paligjshme në lartësi të objekteve (tashmë të ligjëruara) nga leja e legalizimit e cila paraqet në mënyrë fiktive deri në dy kate më tepër të objekteve nga gjendja reale.

-Nga shqyrtimi i planimetrive të nënshkruara për 24 objektet e shërbimit, rezultoi se në kundërshtim me Ligjin nr.9482, datë 03.04.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, në sipërfaqen totale të bazës së ndërtimit është përfshirë edhe sipërfaqja e katit nëntokë të "Impiantit të Pastrimit të UZ" me sipërfaqe prej 464m^2.

-Objekti i pasqyruar në planimetrinë e katit përdhe me sipërfaqe të bazës së ndërtimit prej 387m^2 (fleta me nr.56 sipas inventarit), nga verifikimi **në hartën dixhitale të A. G rezulton që të mos jetë ndërtuar pjesa veri-perëndimore e saj me sipërfaqe 84m^2**). Planimetria është punuar nga ish-specialisti A.J, përditësuar nga ish-specialisti V. S, ish-përgjegjësi i sektorit të legalizimit A Ll dhe nga ish-Drejtori E.V.

-Nga shqyrtimi i planimetrive dhe hartës dixhitale A.G rezulton se sipërfaqja totale e bazës së ndërtimit është 1552m^2 dhe jo 2100m^2 sa është dhënë me lejen e legalizimit. Pra, **kemi të bëjmë me një rritje fiktive të bazës së ndërtimit me një sipërfaqe prej 548m^2, si pasojë e të cilës është rritur fiktivisht edhe sipërfaqja e parcelës ndërtimore me 1644m^2.**

-Nga verifikimi i hartës dixhitale në G. A rezulton se objekti nr.12 i pasqyruar në planvendosje si **"Impianti i Pastrimit të UZ" dhe objekti nr.16 me sipërfaqe 23m^2 i pasqyruar si "ambient shërbimi", janë ndërtuar mbi rrjedhën natyrore të ujit që zbret nga mali.**

-Vendimi "Për kualifikimin për legalizim, të Objektit informal" është dhënë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe në këtë rast objekti duhet të ishte skualifikuar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet e mëposhtme të Ligjit Nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar:

Neni 5 "Pronësia e burimeve ujore":

1. Janë në pronësi të shtetit dhe në administrim të organeve shtetërore:

a) të gjitha burimet ujore të Republikës së Shqipërisë;

b**) të gjithë shtretërit dhe brigjet e** lumenjve, përrenjve dhe **rrjedhave të tjera natyrore**, qofshin të përkohshme apo të përhershme, ujërat kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale, kanalet, liqenet, pellgjet, lagunat dhe ujëmbledhësit natyrorë apo artificialë, ishujt dhe grumbullimet e rërës, gurëve dhe dherave në shtretërit e lumenjve, liqeneve dhe ujëmbledhësve, si dhe formacionet gjeologjike të ujërave nëntokësore;

c) toka e përftuar nga tërheqja e ujit ose nga përparimi i tokës në drejtim të ujit, kur ajo lidhet me tokën, që është në pronësi të shtetit;

ç) të gjitha strukturat dhe punimet hidroteknike të realizuara nga shteti, si digat, sistemet e ujitjes, kullimit dhe lundrimit, stacionet e ujit të pijshëm dhe kanalet, si dhe punimet që lidhen me to.

2. **E drejta e pronësisë së shtetit, sipas përcaktimeve në shkronjat "a", "b" dhe "c" të pikës 1 të këtij neni, është e patjetërsueshme dhe paparashkrueshme.**

-Si konkluzion, të gjitha objektet e legalizuara [me Leje Legalizimi nr.107008, në emër të J.L. K (K. shpk), Leje Legalizimi nr.107264, në emër të J.L.K (K. shpk) dhe Leje Legalizimi nr.106707, në emër të A. B. B. (S& S SHPK)] ndodhen brenda kufirit të brezit bregdetar të miratuar me Vendim

nr. 1, datë 08.10.2013, të KKT-së. Këto leje legalizimi janë dhënë në kundërshtim me VKM nr.280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje", i ndryshuar me VKM Nr. 756 datë 26.10.2016, pika 6 ku citohet "*Ndërtime informale brenda kufirit të vijës turistike, në kuptim të nenit 38/1, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, janë ato të ngritura brenda "vijës bregdetare" (jashtë qendrave urbane), të miratuar me Vendimin nr. 1, datë 8.10.2013, të KKT-së. Këto ndërtime u nënshtrohen kritereve të legalizimit sipas këtij vendimi dhe projekteve të infrastrukturës rrugore, të parashikuara në dokumentet e miratuara të planifikimit të territorit*. Në pikën 4 të Vendimit nr. 1, datë 8.10.2013, të KKT-së përcaktohet se brenda brezit bregdetar (bashkëlidhur këtij vendimi) lejohen ndërtime vetëm për interes publik, shtetëror dhe kombëtar.

-Lejet e legalizimit janë dhënë në kundërshtim flagrant me ligjin duke rritur fiktivisht (në total) sipërfaqen e bazës së ndërtimit me 1601m^2 (548m^2 për S& S SHPK + 1053m^2 për K. SHPK) dhe si pasojë është rritur fiktivisht edhe sipërfaqja e parcelës ndërtimore me 4803m^2 (1644m^2 për S & S SHPK + 3159m^2 për K. SHPK), duke mundësuar kështu tjetërsimin e paligjshëm të këtyre sipërfaqeve në favor të këtyre subjekteve private.

-Leje Legalizimi nr.107008, Leje Legalizimi nr.107264 dhe Leje Legalizimi nr.106707 duhet të konsiderohen si akte absolutisht të pavlefshme të nxjerrë në kundërshtim me:

-Ligj nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar

- VKM nr.280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje", i ndryshuar me VKM Nr. 756 datë 26.10.2016.

- Vendim nr. 1, datë 08.10.2013, të KKT-së "Masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese mjedisore në disa zona me rëndësi kombëtare dhe procedurën e hartimit të planit të integruar sektorial për bregdetin"

-Ligjit Nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar

-VKM nr.589, datë 10.09.2014 "Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtime me leje, të organeve dhe dokumentacionit për propozimin dhe miratimin e zonave informale", i ndryshuar

-Ligj nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të RSh", i ndryshuar.

Nga verifikimi i problematikave të paraqitura si në *ankesën e protokolluar në KLSh me nr.436, datë 11.06.2019 dhe në ankesën së protokolluar në KLSH me nr.698, datë 18.09.2018 për regjistrimin e paligjshëm të pronës në emër të shtetasit Sotir Andoni dhe Jani Kosta, u verifikua* deri në origjinë nga ku rezulton se në Zonën Kadastrale 3844, Jalë, në emër të J. K janë regjistruar dhe lëshuar vërtetime hipotekore (VH) në emër të S. A me nr.28, datë 13.02.2007. Kjo pasuri më pas ka kaluar në pronësi të J. K sipas VH nr.110, datë 18.04.2008 me sipërfaqe 16000m^2 dhe më pas është ndarë më datë 17.02.2011 për pasuritë e llojit "Kullotë" me sipërfaqe totale prej 16000m^2 si më poshtë:

-VH nr.27 me sipërfaqe 4880m^2
-VH nr.28 me sipërfaqe 4970m^2
-VH nr.29 me sipërfaqe 1950m^2
-VH nr.30 me sipërfaqe 4200m^2

Nga Taskforca e Kryeministrisë me shkresë nr.5447, datë 24.06.2014 është kufizuar në origjinë (VH nr.27, datë 13.02.2007) prona me sipërfaqe 16000m^2 kullotë.

Përsa i përket regjistrimit të kësaj prone në emër të S. A, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë në Vendimin me nr.119, datë 06.02.2013 për pushimin e çështjes për procedimin penal nr.494, ka konstatuar se prona është regjistruar në emër të S. A me dokumente që "*përmbajnë të dhëna të rreme, pra të falsifikuar*".

2. AIDA i është drejtuar me shkresë Nr. 107/3 prot. datë 18.03.2019 **Bashkisë Himarë,** për të mundësuar:

Informacion nëse zhvillimi i turizmit në zonën e sipërcituar është në përputhje me PPV Bashkia Himarë; Informacion nga regjistrat e Bashkisë Himarë mbi situatën juridike të pronës; Informacion

nëse ka AMTP (akte të marrjes së tokës në pronësi) të mundshme në parcela, të lëshuara në emër të subjekteve të tretë, në pronësi apo përdorim.

Bashkia Himarë me shkresë Nr. 767/2 Prot. dt. 03/04/2019 sqaroi se në zonimin e pasqyruar, zona 1 është pjesërisht një zonë që lejohet zhvillimi me Kod të Njësisë Strukturore HI.N.755(*ndërkohë që sipas pasaportës/parashikimeve për parcelat ndalohen përdorimet për a-Banim;s-Shërbimr*, zona 2 bën pjesë në zonë që lejohet zhvillimi me Kod të Njësisë Strukturore HI.UB.9.420 dhe HI.UB.9.893, zona 3 bën pjesë pjesërisht në zonë natyrore me Kod të Njësisë Strukturore HI.UB.9.214 dhe zonë që lejohet zhvillimit me Kod të Njësisë Strukturore HI.UB.9.428, HI.UB.9.757, si dhe zonë infrastrukturore HI.UB.9.758 dhe HI.IN.1134, Zona 4 bën pjesë në zonë natyrore ku nuk lejohet zhvillimit me Kod të Njësisë Strukturore HI.N.1186.

Gjithashtu, Bashkia Himarë lidhur me situatën juridike të tokës shprehet se nuk është kryer procesi i regjistrimit të parë fillestar sistematik dhe nuk disponojnë hartë treguese të regjistrimit (HTR), si rezultat nuk shprehen për juridiksionin dhe vendndodhjen e pronave.

Bashkia ka vënë në dispozicion fotokopje të Formularit Nr. 6 copë 24 dhe dhe fotot kopje të AMPT copë (2) të trajtuar me ligjin 7501 datë 19.07.1991 "Për tokën" I ndryshuar në vendin e quajtur "Jal" Vuno, ku jane perfshire ne tituj pronesi formular 6 te ndarjes se tokes, akte te cilat nuk shoqeron me AMTP dhe jane te paregjistruara, pra konsiderohen te palvefshme nga ana ligjore.

Në fakt *në zbatim të programit të auditimit nr. 366/5, datë 06.8.2019, ndryshuar me nr. 366/6, datë 07.11.2019, pika (E) "Auditim në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Organizimi dhe funksionimi i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në Njësisë Vendore (IMTV), për periudhën nga data 01.01.2019 deri më 30.09.2019" dhe pikës H "Të ndryshme të dala gjatë auditimit (verifikimi i ankesave të protokolluara në KLSH me nr. 698, datë 18.09.2018, nr. 436, datë 11.06.2019, nr. 840, datë 22.10.2019 dhe nr 904, datë 07.11.2019)".*

Objekti i këtij akt konstatimi është: Aktiviteti i Bashkisë Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Himarë, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, lidhur me procedurat e kryera nga këto struktura për subjektin "S&S" shpk, si dhe verifikimi i ankesave drejtuar KLSH-së për problematikën e konstatuar në territorin pjesë e të cilit ngrihen objektet e zhvilluara nga shoqëria "S&S".

Komente paraprake nga grupi i auditimi lidhur me ankesën nr. 904 (*Më poshtë paraqitet e skanuar ankesa e fundit drejtuar KLSH-së, por që rezulton të jetë drejtuar edhe 21 institucioneve të tjera).*

Pavarësisht referimeve të bëra nga subjekti ankues lidhur me shkeljet dhe parregullsitë e prezurmuara për drejtues të institucioneve të ndryshme shtetërore por dhe subjekte private apo përfaqësues të tyre, fakte të cilat sipas ankuesit janë në vlerësim nga organet kompetente; referimit në vendimin gjyqësor nr. 568, datë 25.09.2019, sipas të cilit është vendosur fshirja e pasurive të qytetarit "S. A" dhe "J. K", dhe kalimi i tyre në pronësi shtet për një sipërfaqe prej 16000 m^2;

Problematikës me ASHK Vlorë lidhur me ekzekutimin apo jo të vendimit të Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil nr. 246, datë 23.04.2019, për pezullimin e vendimit nr. 18, datë 12.02.2019 të Gjykatës së Apelit Vlorë, vendim i cili rezulton i pa aplikueshëm përsa vendimi nr. 18, datë 12.02.2019 ka prodhuar efektet duke u regjistruar nga ASHK Vlorë (vërtetimi pronësor nr. 141, datë 27.02.2019 nga trashëgimtarët e G.Gj);

Përdorimi nga subjekti i dokumenteve të falsifikuara dhe të pa dala nga ish-ZVRPP Vlorë me nr. 27, 28, 29 dhe 30, datë 17.02.2011, për sipërfaqet prej 4880 m^2, 4970 m^2, 1950 m^2, 4200 m^2 në zonën kadastrale 3844, J.V, në emër të J.K, dokumente për të cilat pretendohet edhe se janë përdorur për të marrë miratimin nga KKT për lejen e ndërtimit nr. 14, datë 27.04.2018;

Grupi i auditimit rezervon të drejtë për tu shprehur mbi saktësinë dhe rregullshmërinë e veprimeve apo mosveprimeve të institucioneve shtetërore, vetëm pas ushtrimit të auditimit mbi procedurat dhe dokumentacionin e disponuar nga këto institucione apo edhe instritucione të tjera të cilësuara në ankesë, edhe pse për një pjesë të dokumenteve dhe këtu referimi është për aktet e prodhuara nga organet gjyqësore, shkeljet dhe parregullsitë janë lehtësisht të provueshme dhe dokumentueshme.

Më konkretisht lidhur me sa vepruar deri më tani nga Bashkia Himarë, nga auditimi i plotë i dokumentacionit të prodhuar nga Bashkia, atij të kërkuar prej tij, dokumentacionit të paraqitur nga institucionet shtetërore, apo edhe vet subjekti privat, është konstatuar se:

Leja ndërtimit miratuar nga KKT: Me shkresën nr. 887/7, datë 22.06.2018, të Kryeministrisë, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Drejtoria për Zhvillimet në Territor, me lëndë: "Dërgohet për pagesë takse të objektit të miratuar me vendimin nr. 14 "Për miratimin e Lejes së ndërtimit për objektin: "Resort turistik "S.2", me vendndodhje në Jal, Bashkia Himarë", me subjekt zhvillues "S& S" shpk", administruar nga Bashkia Himarë me shkresën nr. 1986, datë 25.06.2018, është bërë me dije Bashkia mbi Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 14, datë 27.04.2018.

Sipas shkresës, në vendimin e KKT nr. 14, datë 27.04.2018, pika 3 përcaktohet se:"Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Himarë".Po ashtu në shkresë theksohet se: "...në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, për përmbushjen e detyrimeve të përbashkëta ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, lutemi në llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë, për objektin "Resort turistik "S.2", me vendndodhje në Jal, Bashkia Himarë".

Në shkresë është cituar gjithashtu se bashkëlidhur gjenden:

-Vendimin nr. 14, datë 27.04.2018 "Për miratimin e Lejes së ndërtimit për objektin: "Resort turistik "S.2", me vendndodhje në Jal, Bashkia Himarë", me subjekt zhvillues "S & S" shpk".
-Harta e planvendosjes së strukturave për objektin "Resort turistik "S.2", me vendndodhje në Jal, Bashkia Himarë", me subjekt zhvillues "S& S" shpk".
Shkresa në fletën e fundit (faqe 2) ka shënimin: *"Të gjitha dokumentacionet e nevojshme mund ti aksesoni në sistemin online e-leje, aplikimi me nr. AN04042018005", protokolluar pranë AZHT me nr. 887, datë 05.04.2018.*
Sipas vendimit të KKT me nr. 14, datë 27.04.2018 "Për miratimin e Lejes së ndërtimit për objektin: "Resort turistik "S. 2", me vendndodhje në Jal, Bashkia Himarë", me subjekt zhvillues "S& S" shpk", në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 107/2017, datë 31.07.2014 "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar, VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, si dhe VKM nr. 519, datë 20.09.2017 "Për përcaktimin e përbërjes së KKT", i ndryshuar, me propozim të shoqërisë "S& S" shpk", është vendosur:

1. "Miratimin me **kusht** të lejes së ndërtimit për objektin: ""Resort turistik "S. 2", me vendndodhje në Jal, Bashkia Himarë", me subjekt zhvillues "S & S" shpk".
2. Harta e planvendosjes së strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i **jepet subjektit vetëm pas**:
   a. Plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
   b. Pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Bashkisë Himarë".
4. Ngarkohet AZHT në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sipas planvedosjes për objektin: "Resort turistik "S.2", me vendndodhje në Jal, Bashkia Himarë", me subjekt zhvillues "S & S" shpk", dokumrnt i cili rezulton i miratuar nga Kryetari i KKT-së dhe Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, dhe i punuar nga projektuesi A. A (Nr. Lic A-0026/3, për llogari të porositësit njëherazi dhe zhvillues, "S& S" ShPK", , titulli i dokumentit është "Leje ndërtimi", ndërsa po sipas të njëjtit dokument në pjesën e legjendës është përshkruar si "Leje Zhvillimi".

Sipas këtij dokumenti, treguesit e zhvillimit për projektin Soleil 2 janë si më poshtë:
Sipërfaqe e përgjithshme e truallit **7494 m^2**
Sipërfaqe e truallit e zënë nga struktura ekzistuese (gjurma) 2066 m^2
Sipërfaqe e truallit e zënë nga struktura e reja (gjurma) **2034 m^2**
Sipërfaqe e truallit e zënë nga strukturat në total (gjurma) 4100 m^2
Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit (ekzistues) 3528 m^2
Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit (të reja) **3972 m^2**
Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit (total) 7500 m^2

Koeficenti i shfrytëzimit të truallit për ndërtim **54.71%**
Intensiteti i ndërtimit: 1.0
Lartësia maksimale e strukturës nga niveli i kuotës së sistemimit: 10.00 m
Numri i kateve mbi tokë: 1, 2 dhe **3 kate**
Numri i kateve nëntokë: ma x2 kate
Sipas treguesit teknik, prona ndodhet në zonën kadastrale 3844
Nr. Pasurie: Nr. Regj. Hip 564/VKM nr. 810, datë 09.12.2017
Kufizimet:
Veri: Rrugë ekzistuese
Jugu: Deti
Lindje:-
Perëndimi: Rrugë ekzistuese
Distanca nga kufiri i pronës: 2 m nga volumi 1 kat dhe 3 m nga volumi 2 kat

Komente nga grupi i auditimit: Sipas VKM nr. 810, datë 29.12.2017 "Për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi parcelat e objekteve të legalizuara dhe kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme që preken prej tyre", me numër rendor 1069 dhe 1070 në favor të J. L. K (K ShPK) për lejet e legalizimit nr. 107264 datë 20.3.2017 dhe nr. 104596 datë 29.6.2016, për pasuritë me pronar "shtet" me sipërfaqe respektive 7494 m^2 dhe 951 m^2, është bërë kalimi i pronësisë në favor të subjektit.

VKM nuk ka përcaktuar vlerën e kalimit të parcelës ndërtimore, duke mos u kuptuar se mbi çfarë refence apo ku është bazuar ALUIZNI kur ka dërguar për miratim VKM-në në KM.

A.1 Konfirmimi i lejes së ndërtimit

Me shkresën nr. 887/11, datë 15.10.2018, të Kryeministrisë, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Drejtoria për Zhvillimet në Territor, me lëndë: "Njoftim mbi miratimin e lejes për objektin: "Resort turistik "S. 2", me vendndodhje në Jal, Bashkia Himarë", administruar nga Bashkia Himarë me shkresën nr. 2994, datë 22.10.2018, është bërë me dije Bashkia se nga AZHT, si Sekretariat Teknik i KKT, në përmbushje të detyrimit ligjor dhe përputhje ligjit nr. 107/2017, datë 31.07.2014 "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar, VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, si dhe VKM nr. 725, datë 02.09.2015 "Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të AZHT", ka lëshuar **Dokumentin e Lejes së Ndërtimit nr. 887/10 prot, datë 21.09.2018.**

Po nëpërmjet shkresës AZHT ka kërkuar nga Bashkia: "Në këto kushte në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, për përmbushjen e detyrimeve të përbashkëta ligjore në fushën e zhvillimit të territorit, mbështetur në ligjin nr. 8402, datë 10.09.2018 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, dhe UK nr. 143, datë 03.11.2015 "Për ngritjen dhe funksionimin e strukturave përgjegjëse për bashkërendimin e punës me AZHT, **kërkojmë bashkëpunimin tuaj për monitorimin e zbatimit të lejes së ndërtimit nr. 887/10, datë 21.09.2018, për objektin "Resort turistik "S. 2", me vendndodhje në Jal, Bashkia Himarë", me zhvillues shoqërinë "S & S" shpk".**

Bashkëlidhur shkresës AZHT ka konfirmuar lejen e ndërtimit nr. 887/10 prot, datë 21.09.2018, kopje e njësuar me vulën e Sekretarisë së AZHT.

Shkresa e AZHT ka të bashkëlidhur shkresën e AZHT, Drejtoria e Monitorimit e Zhvillimeve në Territor nr. 887/12, datë 15.10.2018, me lëndë: "Njoftim për miratimin e lejes për objektin: Resort turistik "S.2", drejtuar IMT pranë Bashkisë Himarë, dhe dijeni IKMT, ku behët me dije për lëshimin nga AZHT për Dokumentin e Lejes së Ndërtimit nr. 887/10, datë 21.09.2018, për objektin "Resort turistik "S. 2", me vendndodhje në Jal, Bashkia Himarë", me zhvillues shoqërinë "S & S" shpk".

Bashkëlidhur shkresës AZHT ka konfirmuar lejen e ndërtimit nr. 887/10 prot, datë 21.09.2018, kopje e njësuar me vulën e Sekretarisë së AZHT.

Sipas dokumentit nr. 887/10, datë 21.09.2018, (Leje Ndërtimi), i jepet zhvilluesit "S & S" shpk", sipas vendimit të KKT nr. 14, datë 27.04.2018, me afat kohor 24 muaj.

Leja ka pjesë përbërëse të saj tabelën me të dhëna si më poshtë:

Prona që zhvillohet	**Vërtetim nga Dokumentet Hipotekore nr. 125, datë 21.03.2018, ndodhur në zonën kadastrale 3844, në pronësi të shoqërisë "Kempixh" shpk**
Sipërfaqe e përgjithshme e truallit	7494 m^2
Sipërfaqe e truallit e zënë nga struktura ekzistuese (gjurma)	2066 m^2
Sipërfaqe e truallit e zënë nga struktura e reja (gjurma)	2034 m^2
Sipërfaqe e truallit e zënë nga strukturat në total (gjurma)	4100 m^2
Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit (ekzistues)	3528 m^2
Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit (të reja)	3972 m^2
Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit (total)	7500 m^2
Koefiçenti i shfrytëzimit të truallit për ndërtim	54.71%
Intensiteti i ndërtimit:	1.0
Lartësia maksimale e strukturës nga niveli i kuotës së sistemimit:	10.00 m
Numri i kateve mbi tokë:	1, 2 dhe 3 kate
Numri i kateve nëntokë:	Maksimumi 2 kate

Shkresa mban dhe Shënimin (1):

-"Vërtetimi nga Dokumentet Hipotekor nr. 125, datë 21.03.2018 ndodhur në zonën kadastrale 3844, leja e legalizimit nr. 107264, datë 20.03.2017, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 7494 m^2, në bazë të VKM nr. 810, datë 29.12.2017 në pronësi të "K" ShPK. Zhvilluesi "S&S" ShPK ka lidhur marrëveshje "Kontratë Sipërmarrje për Zhvillim dhe Investim nr. 500 rep, nr. 177/1 kol, datë 27.0.2018, lidhur me palën pronare shoqërinë "K.", ShPK, shoqëruar nga dokumenti i pronësisë, për pasurinë objekt kontrate".

-"Leja e ndërtimit jepet me këto kushte:

1. Të respektohet destinacioni i zhvillimit për ndërtimin e infrastrukturës, si dhe treguesit e zhvillimit, sipas hartës bashkëlidhur vendimit nr. 14, datë 27.04.2018 të KKT.

2. Të respektohet radha e punimeve sipas projektit të miratuar dhe grafikut të punimeve.

3. Të rrethohet zona ku ndërtohet dhe të mbahet pastër ambienti përreth".

4. Për çdo ndërhyrje në rrjetin infrastrukturë publike sipas projektit të miratuar të kontaktohet me institucionet përkatëse, në mënyrë që të mos krijohen shqetësime në rrjetin publik.

5. Të respektohen normat dhe standardet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi mbi kryerjen e punimeve dhe sigurisë në punë.

6. Gjatë zbatimit të punimeve objekti do të kontrollohet nga autoritetet e kontrollit të zhvillimit dhe inspektorati përkatës në fushën e ndërtimit.

7. Në shkelje të kushteve ligjore të kësaj leje do të merren masa konform ligjit deri në prishje të saj.

Afati i fillimit të punimeve është 1 (një) vit nga data e lëshimit të kësaj leje.

9. Kjo leje është e vlefshme për një periudhë 24 mujore nga data e fillimit të punimeve, referuar grafikut të punimeve bashkëlidhur.

Komente të grupit të auditimit: Lidhur me miratim fillimisht nga AZHT dhe më tej konfirmimin e lejes ndërtimore nga KKT, rezulton se për zonën objekt vendimmarrje te KKT nuk ka nisur e për rrjedhojë nuk ka të miratuar nga Bashkia Himarë, Këshilli Bashkiak dhe Kryetari i Bashkisë "Nisëm për miratimin e planave të detajuara vendore". Në këto kushte nuk kuptohet se mbi çfarë reference ka punuar AZHT, kur nuk ka një nisëm të tillë dhe kur nuk ka PDV të miratuar më parë.

Nuk rezulton se mbi çfarë reference ka vepruar AZHT kur konstatohet se leja kalon kufirin e njësisë strukturore HI.UB 9.420 pasi leja e ndërtimit në kufirin jugor e kalon këtë strukturë duke shkelur në një strukturë tjetër për të cilën ndalohet realizimi i çfarëdolloj ndërtimi (HI.N 11.40 dhe 11.41).

Po ashtu nuk rezulton se mbi çfarë reference ka vepruar AZHT në pranimin për trajtim të kërkesës së propozuesit, kur zona objekt zhvillimi, sipas PPV nuk është miratuar si zonë për investime strategjike.

Lidhur me objektin në fjalë ka rezultuar se IMTV nuk ka përmbushur detyrimin ligjor duke inspektuar objektin ndërtimit, për plotësimin e kushteve dhe kritereve të lejes.

Po edhe DPZHT nuk ka përmbushur detyrimin ligjor duke mos kryer piketimin e objektit dhe truallit si dhe duke mos mbajtur aktet e kontrollit.

Leja shprehet për pronësinë mbi tokën por nuk rezulton që subjekti të jetë bërë pronar i ligjshëm i saj përsa VKM nr. 810, datë 29.12.2017 "Për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi parcelat e objekteve të legalizuara dhe kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme që preken prej tyre", me numër rendor 1069 dhe 1070 në favor të J. L. K (K. ShPK) për lejet e legalizimit nr. 107264 datë 20.3.2017 dhe nr. 104596 datë 29.6.2016, për pasuritë me pronar "shtet" me sipërfaqe respektive 7494 m^2 dhe 951 m^2, nuk rezulton e regjistruar në ish-ZVRPP Vlorë.

A.2 Pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë

Me shkresën nr. 2119, datë 06.07.2018, të Bashkisë Himarë, Dretjoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, është bërë: "Njoftim me tarifat e shërbimit dhe pranimin me leje ndërtimi", drejtuar subjektit: "S&S" ShPK, për objektin "Resort turistik S.2, Jal, Himarë". (Shkresë e punuar nga Ark. E. R dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë J. G).

Sipas shkresës në referim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" dhe VKB nr. 130, datë 06.12.2017 "Për paketën fiskale 2018",

1) vlera e taksës së lejes së ndërtimit ....në zonën A=3% të vlerës së investimit = 7,970,636.52 lekë.
2) vlera e taksës së lejes së ndërtimit për punimet e sistemimit =3% e preventivit= 0.03 x 11,894,356 =356,830.08 lekë
3) tarifë shërbimi për aplikim leje ndërtimi të çdo lloji =20 lekë/m^2= 20 x 8173 m^2=163,460 lekë
4) azhornim trualli 36 lekë x 7494 m^2 truall = 269,784 lekë
7) tarifë shërbimi për kontrollin e piketimit të objektit 8,000 lekë
8) tarifë shërbimi për kontrollin e përfundimit të themelit
9) tarifë shërbimi për kontrollin e karabinasë
10) tarifë shërbimi për kontrollin e përfundimit të fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re 5,600 lekë
11) tarifë shërbimi për kontrollin e përfundimit të objektit dhe sistemimin e ambientit përreth dhe lidhja me infrastrukturën publike ekzistuese 5,600 lekë

Konkluzione lidhur me vijueshmërinë e aktit:

Përllogaritja e taksës është bërë sipas refencës të EKB pasi vlera e investimit të deklaruar nga subjekti, sipas preventivit të dosjes (dokument në gjuhën angleze) vlera e projektit është 2,400,000 euro. Sipërfaqja e ndërtimit është 8173 m^2 x 32516 = 265,753,268 lekë/3% = 7,970,636 lekë, ndërsa po të ishte përllogaritur taksa në vlerën prej 2,400,000 euro/35 = 72,000 euro. Shumë e cila po të konvertohet me vlerën e shkëmbimit të monedhës euro në Korrik 2018. 1 euro = 126 lekë), atëherë vlera e projektit është 302,400,000 lekë.

Duke qenë se përllogaritja është bërë për vlerën prej 265,753,268 dhe jo për vlerën prej 302,400,000 lekë, rezulton se është përllogaritur gabimisht vlera e detyrimit për tu paguar për taksën e ndikimit në infrastrukturë për diferencën ndërmjet preventivit të hartuar nga subjekti dhe vlerës të përllogaritur nga DPZHT Bashkia Himarë (302,400,000 - 265,753,268 = 36,646,732 lekë/3%) në shumën prej **1,099,402 lekë, efekt financiar negativ me dëm për bashkinë Himarë.**

Përllogaritja e gabuar e Bashkisë Himarë, nuk rezulton të jetë konstatuar nga AZHT, në momentin e miratimit/zbardhjes së lejes së ndërtimit *(sipas dokumentacionit të administruar nga bashkia dhe nga sistemi online e-leje, aplikimi me nr. AN04042018005", protokolluar pranë AZHT me nr. 887, datë 05.04.2018).*

Lidhur me pagesën e këtij detyrimi ligjor, përmbushja ose jo e të cilit përcakton zbardhjen e lejes nga AZHT, në Bashkinë Himarë (dokumentacionin e administruar nga DPZHT) nuk rezulton të ketë kopje të mandateve bankare të paguara në një nga bankat e përcaktuara në formularin e lëshuar më datë 09.07.2018 me nr. 54, nga Drejtori i Drejtorisë së të Ardhurave, (njoftim i vlerësimit të detyrimit tatimor) në njërën prej degeve/filialeve të bankës P., A. apo R., me kod institucioni 2160001 dhe kod thesari 3737.
Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga DPZHT, nxjerrë nga *online e-leje, aplikimi me nr. AN04042018005", protokolluar pranë AZHT me nr. 887, datë 05.04.2018* në bankën "C." më datë 13.08.2018, subjekti ka bërë pagesën e taksave, sipas shkresës nr. 887/9 të AZHT, referuar në formularin për arkëtim nr. 54, datë 09.07.2018 të lëshuar nga Bashkia Himarë.

Lidhur me kryerjen e akteve të kontrollit (pika 4, 7, 8 dhe); sipas deklarimeve verbale të punonjësve z. G. S. Drejtor i DPZHT dhe z. E. M. me detyrë Topograf i Drejtorisë së Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës dhe z. F. eci, me detyrë Specialist Ndërtimi në DPZHT, nga Bashkia Himarë, deri më datën e mbajtjes së këtij akt-konstatimi nuk është bërë asnjë procedurë, dhe bashkia nuk ka dijeni lidhur me zhvillimin, pasi subjekti edhe pse është duke punuar nuk ka njoftuar bashkinë lidhur me fillimin e e punimeve etj.

Po ashtu nga deklarimi verbal i Kryeinspektorit të IMTV Bashkia Himarë z. R H, nga kjo strukturë nuk është bërë asnjë lloj akti konstatimi përsa subjekti nuk ka bërë me dije IMTV për fillimin e punimeve, po ashtu nga kjo strukturë nuk është bërë kontrolli kryesisht me iniciativën e saj.

A.3 Lidhur me titullin e pronësisë

Nga shqyrtimi i dokumenteve të ngarkuara në sistemi online e-leje, aplikimi me nr. AN04042018005", protokolluar pranë AZHT me nr. 887, datë 05.04.2018, rezulton se në folder-in "Kopje Dokumentit të Pronësisë" rezulton se janë ngarkuar në sistem 3 file dhe konkretisht:Leja e Legalizimit nr. 107624, datë 20.03.2017, lëshuar në favor të "K" ShPK për parcelën ndërtimore prej 7494 m^2, sipërfaqe ndërtimore prej 2498 m^2 dhe sipërfaqe totale ndërtimi/për aktivitet 3960 m^2, me nr. katesh mbi tokë 3, ndodhur në ZK 3844, pasuria 1/123.

Sipas dokumentit Titulli i Pronësisë mbi Tokën do të Miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave. Po ashtu nga genplani pjesë integrale e lejes së legalizimit rezulton se prona është pasuri me pronar "Shtet" përbëhet nga 9 objekte me sipërfaqe përkatësisht 317, 236, 472, 6, 773, 202, 123, 123 dhe 186 m^2 dhe kufizohet nga V-pasuria 1/124, J-pasuria 1/125, 1/126 dhe 1/135, L-pasuria 1/124 dhe P-pasuria 1/126, 1/16, 1/127 dhe 1/128.

Shkresa e ALUIZNI, Drejtoria Vlorë nr 8730/1, datë 25.10.2017, drejtuar ZVRPP Vlorë, sipas të cilës në lejen e legalizimit nr. 107624, datë 20.03.2017, lëshuar në favor të "K" ShPK, gabimisht është shënuar edhe emri i administratorit të saj z. J. K.

Vërtetim nga dokumentet hipotekore të lëshuar nga ZVRPP Vlorë, sipas të cilit në regjistrin hipotekor nr. 125, datë 21.03.2018, në emër të shoqërisë "K" ShPK, në zonën kadastrale 3844, figuron e regjistruar pasuria **nr.s'ka**, me sipërfaqe **s'ka** me adresë Jal, Himarë, me shënimin: "lëshuar sipas lejes së legalizimit nr. 107624, datë 20.03.2017. Sipërfaqja e parcelës ndërtimore 7494 m^2 në bazë të VKM nr. 810, datë 29.12.2017.
Akti mban po ashtu shënimin: "Mbi këtë pasuri ngrihet pasuria me numër hipotekor 564, datë 28.06.2017". Vërtetimi, rezulton i lëshuar në bazë të kërkesës nr. 3999, datë 19.03.2017.

Komente nga grupi i auditimit:

-Nuk kuptohet si AZHT ka marrë për të mirëqenë një dokument pronësor i cili nuk ka të përcaktuar numrin e pasurisë dhe mbi të gjitha nuk ka të përcaktuar sipërfaqen e saj.

-Nuk kuptohet po ashtu se si AZHT ka marrë për të mirëqenë shënimin se pasuria ngrihet mbi pasurinë me numër hipotekor 564, datë 28.06.2017, kur në fakt ky dokument shprehet vetëm për regjistrimin e objekteve të legalizuara.

-Nuk kuptohet se si AZHT ka marrë për bazë një dokument të pa noterizuar (vërtetimi hipotekor) dhe mbi të gjitha një dokument të pa shoqëruar me Hartën Treguese të Regjistrimit (HTR), çka e bën atë të cenueshëm pse jo dhe të pavlefshëm për të përfituar shërbime të tilla.

Nuk kuptohet se si është marrë për bazë VKM nr. 810, datë 29.12.2017, kur rezulton se ky akt ka përcaktuar vetëm përfituesin nga VKM dhe sipërfaqen e parcelës ndërtimore, por nuk ka evidentuar vlerën e truallit/tokës e cila do ti kaloj në pronësi, përkundrejt pagesës. Po aq sa nuk kuptohet se si ZVRPP Vlorë ka pranuar dhe regjistruar këtë akt të hartuar dhe paraqitur me mangësi nga ALUIZNI Vlorë, por të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

B. Leja e Zhvillimit miratuar nga KKT



Nga Këshilli Kombëtar i Territorit me vendimin nr. 26, datë 16.10.2017 "Për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin: "Kompleks Turistik, Hoteleri dhe Shërbime, me vendndodhje në Jalë, Bashkia Himarë", në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 107/2017, datë 31.07.2014 "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar, VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, si dhe VKM nr. 519, datë 20.09.2017 "Për përcaktimin e përbërjes së KKT", i ndryshuar, me propozim të shoqërisë "S & S" ShPK", ka vendosur:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: "Kompleks Turistik, Hoteleri dhe Shërbime, me vendndodhje në Jalë, Bashkia Himarë".
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërë e këtij vendimi.
3. Ngarkohet AZHT dhe Bashkia Himarë për Zbatimin e këtij vendimi

Sipas planvedosjes për projektin: "Kompleks Turistik, Hoteleri dhe Shërbime, me vendndodhje në Jalë, Bashkia Himarë", me subjekt zhvillues "S & S" ShPK", dokument i cili rezulton i miratuar nga Kryetari i KKT-së dhe Ministri i Turizmit dhe Mjedisit dhe i punuar nga projektuesi A. A (Nr. Lic A-0026/3, NIPT K61718002H, për llogari të porositësit njëherazi dhe zhvillues, "S & S" ShPK", me NIPT L21926005F, titulli i dokumentit është "Leje ndërtimi", ndërsa po sipas të njëjtit dokument në pjesën e legjendës është përshkruar si "Leje Zhvillimi", leja ka këto të dhëna:

Treguesit e zhvillimit për projektin (VIP Hotel), janë si më poshtë:
Sipërfaqe e përgjithshme e truallit **16000 m^2**
Sipërfaqe e përgjithshme e truallit që përdoret për zhvillim **16000 m^2**
Sipërfaqe e truallit e zënë nga struktura ekzistuese 6785 m^2

Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit 18300 m^2
Koeficenti i shfrytëzimit të truallit për ndërtim 42.41%
Koeficenti i shfrytëzimit të truallit për rrugë dhe hapësira publike 57.59%
Intensiteti i ndërtimit: 1.1
Lartësia maksimale e strukturës nga niveli i kuotës së sistemimit: 10.20 m
Numri i kateve mbi tokë: 1, 2 dhe 3 kate
Numri i kateve nëntokë: nga 1 deri 3 kate

Sipas treguesit teknik, prona ndodhet në zonën kadastrale 3844
Nr. Pasurie: Nr. Regj. Hip 27, 28, 29, 30
Kufizimet:
Veri: Rrugë ekzistuese
Jugu: Deti
Lindje:-
Perëndimi: -
Distanca nga kufiri i pronës: 2 m nga volumi 1 kat dhe 3 m nga volumi 2 kat
Distanca nga aksi i rrugës: 36 m

Treguesit e zhvillimit për projektin (Soleil 2), janë si më poshtë:
Sipërfaqe e përgjithshme e truallit **7494 m^2**
Sipërfaqe e përgjithshme e truallit e zënë nga strukturat ekzistuese **2066 m^2**
Sipërfaqe e truallit e zënë nga strukturat e reja 2034 m^2
Sipërfaqe e truallit e zënë nga strukturat në total (gjurma) 4100 m^2
Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit (ekzistuese) 3528 m^2
Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit (të reja) 3972 m^2
Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit (total) 7500 m^2
Koeficenti i shfrytëzimit të truallit për ndërtim 54.71%
Intensiteti i ndërtimit: 1.0
Lartësia maksimale e strukturës nga niveli i kuotës së sistemimit: 10.00 m
Numri i kateve mbi tokë: 1, 2 dhe 3 kate
Numri i kateve nëntokë: max 2 kate

Sipas treguesit teknik, prona ndodhet në zonën kadastrale 3844
Nr. Pasurie: Nr. Regj. Hip 564/VKM 810, datë 29.12.2017
Kufizimet:
Veri: Rrugë ekzistuese
Jugu: Deti
Lindje:-
Perëndimi: Rrugë ekzistuese
Distanca nga kufiri i pronës: 2 m nga volumi 1 kat dhe 3 m nga volumi 2 kat
Distanca nga aksi i rrugës: 7 m

Treguesit e zhvillimit për projektin (S. 1), janë si më poshtë:
Sipërfaqe e përgjithshme e truallit 7200 m^2
Sipërfaqe e përgjithshme e truallit e zënë nga strukturat ekzistuese 2100 m^2
Sipërfaqe e truallit e zënë nga strukturat e reja 893 m^2
Sipërfaqe e truallit e zënë nga strukturat në total (gjurma) 2993 m^2
Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit (ekzistuese) 3064 m^2
Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit (të reja) 1567 m^2
Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit (total) 4631 m^2
Koeficenti i shfrytëzimit të truallit për ndërtim 41.57%
Intensiteti i ndërtimit: 0.6
Lartësia maksimale e strukturës nga niveli i kuotës së sistemimit: 10.00 m

Numri i kateve mbi tokë: 1, 2 dhe 3 kate
Numri i kateve nëntokë: max 2 kate

Sipas treguesit teknik, prona ndodhet në zonën kadastrale 3844
Nr. Pasurie 83/19: Nr. Regj. Hip 130
Kufizimet:
Veri: Rrugë ekzistuese
Jugu: Deti
Lindje:-
Perëndimi: Rrugë ekzistuese
Distanca nga kufiri i pronës: 2 m nga volumi 1 kat dhe 3 m nga volumi 2 kat

Konkluzione dhe Komente nga grupi i auditimit:

Për objektin "S.2" nuk kuptohet pse gjurma e ndërtimit zënë nga ndërtime ekzistuese sipas ALUIZNI është 2498 m^2 ndërsa sipas planvendosjes së subjektit është 2066, pra duke deklaruar se ka më pak ndërtim prej 432 m^2, po ashtu nuk ka vendim, leje për prishje objekti të legalizuar nga Bashkia Himarë. Në këto kushte nuk rezulton e sqaruar se pse ALUIZNI ka legalizuar një sipërfaqe prej 2498 m^2, ndërkohë kur subjekti deklaron dhe fakton me planvendosje/genplan 2066 m^2, pra 432 m^2 më pak.


Një pjesë e studimit ka përfshirë pasuri të cilat nuk disponohen me dokument pronësor pasi rezultojnë jashtë pronës dhe konkretisht janë 8 objekte 2 kt të cilat ndodhen në pasurinë nr. 1/124, pasuri e cila rezulton kufitare me pasuritë të cilat "disonohen" nga propozuesi.

Po ashtu rezulton se një pjesë e studimit për pasuritë 1/24, 1/130, 1/131 dhe 1/132 ndodhet jashtë studimit të miratuar me Planin e Përgjithshëm Vendor. Për këtë kostatim nuk rezulton të këtë një ndryshim pjesor të PPV, pasi rezulton se leja e zhvillimit daton po në të njëjtën ditë edhe me miratimin nga KKT të PPV për Bashkinë Sarandë, miratuar me vendimin nr. 2 dhe hyrë në fuqi më datë 16.10.2017.


Theksojmë se sipas Raportit të Vlerësimit Teknik të AZHT, saktësohet se:
-Sipas PPV se miratuar, Projekt –Propozimi ndodhet ne:
-Njësia HI.UB.9.420
Kategori 1 S Lartesia (k) 4
Lartësia (m) 14.5
PDV PO
- Projekt – Propozimi, "Kompleks turistik, hoteleri dhe shërbime - .oleil 2", me vendodhje në Bashkine Himare, ndodhet ne Zonat e Urbanizuara të Vendimit, nr. 5 Datë 29.12.2014 të KKT-së.
Ky referim nga AZHT, nuk është plotësisht i saktë përsa sipas planvendosjes së propozuar studimi për projektin "S. 1" studimi bie në më të shumtën jo në zonën/njësinë e referuar prej saj (HI.UB.9.420), por në njësinë strukturore HI.UB.9.214, si dhe për projektin e propozuar "V. H." studimi bie pjesërisht (sipërfaqe të vogël) në njësinë strukturore HI.N 11.40 dhe HI.N 11.41. Në dosje e disponuar nga Bashkia Himarë, marrë nga sistemi online e-leje, aplikimi me nr. AN04042018005", protokolluar pranë AZHT me nr. 887, datë 05.04.2018, nuk rezulton të këtë asnjë të dhënë e cila sqaron/justifikon këtë vendimarrje në kundërshtim me PPV të AZHT, si dhe tjetërsimin e fakteve lidhur me strukturat që prek studimi.

Zonat të cilat prek studimi, njësitë struktore HI.UB.9.214, HI.N 11.40 dhe HI.N 11.41, janë zona në të cilat sipas Rregullores së Planit nuk lejohet ndërtimi e për rrjedhojë edhe vendimmarrja e AZHT është në tejkalim të përcaktimeve të PPV për Bashkinë Himarë.

Më poshtë paraqiten të mbivendosura leja e zhvillimit miratuar me vendimin nr. 26, datë 16.10.2017 të konturuara me vijë të kuqe, me Planin e Përgjithshëm Vendor, miratuar nga KKT me vendimin nr. 2, datë 16.10.2017, nga ku rezulton se të tri komplekset turistike janë në shkelje të plotë (S.1) apo të pjesëshme (Hotel V. dhe S.2) të këtij plani.




Më poshtë paraqiten të mbivendosura leja e zhvillimit miratuar me vendimin nr. 26, datë 16.10.2017 të konturuara me vijë të kuqe, me Planin e Përgjithshëm Vendor, miratuar nga KKT me vendimin nr. 2, datë 16.10.2017, nga ku rezulton se objekti në ndërtim është në shkelje të plotë të lejes së ndërtimit pasi mbi objektet me leje, në pjesën veriore të pronës dhe kufi me rrugën kryesore është duke u ndërtuar një tjetër objekt me 2 kate nëntokë dhe 2-3 mbi tokë (konturuar me ngjyrë rozë), objekt për të cilin vetëm është fotografuar gjendja (faza e ndërtimit) deri më datë 19.11.2019, pa përcaktuar sipërfaqen dhe formës gjeometrike të tij për shkak të mos lejimit të verifikimit nga pronarët e objektit/ve.



Në figurën e mësipërme paraqitet Leja e zhvillimit dhe objekti ndërtimor i ngritur në kundërshtim me lejen ndërtimore të miratuar nga KKT me vendimin nr. 887/7, datë 22.06.2018, dhe me ngjyrë rozë në objektin (S. 2), jashtë kufirit të pronës dhe në veri të saj, si dhe buzë rrugës kryesore, paraqitet objekti i ndërtuar pa leje ndërtimit (objekti i cili nuk paraqitet në formën reale dhe sipërfaqe për shkak të moslejimit të grupit të përbashkët Bashki/KLSH për verifikimin e tyre).

Po ashtu nga planvendosja e Raportit të Vlerësimit të Grupit Operacional, pranë AIDA (Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve), lidhur me projektin e pretenduar për tu realizuar rezulton se objekti "H. C", në fakt është duke u ndërtuar (përfunduar faza konstruktive), pra jemi para faktit të realizimit të një ndërtimi të kundërligjshëm të realizuar, por te deklaruar sikur do të realizohet në të ardhmen (pas marrjes së lejes).

PROJEKTI JALA ENTERTAIMENT PARK



Objekti i ndërtuar aktualisht pa leje ndërtimi **(objekt i paligjshëm)** dhe paraqitur sikur do të realizohet pas miratimit të lejes (foto 1-2)

Më poshtë paraqiten dy foto të objektit të ndërtuar pa leje dhe të sipër përshkruar (Foto 1-2):



C. Procedura e miratimit të lejes së rikonstruksionit

Me vendimin nr. 31, datë 17.04.2018 të Kryetarit të Bashkisë Himarë, z. J. G, është lëshuar leja e ndërtimit për objektin: "Rikonstruksion Objekt shërbimi 2-kate +2 objekte shërbimi 1-kate", në adresën Jal, Vuno, Bashkia Himarë, paraqitur nga zhvilluesi "J. 5" shpk.

Sipas lejes së ndërtimit miratimi është bërë sipas dokumentacionit shoqërues të kërkesës:
Prokurë për autorizim aplikuesi
Marrëveshje me pronarin e tokës
Kopje e dokumentit të pronësisë
Deklarata e projektuesit të licencuar, për përputhshmërinë e projektit me dokumentet e planifikimit dhe legjislacionin në fuqi, sipas sistemit online.
Polica e sigurimit
Kopje e licencës
Projekti i rikonstruksionit, i nënshkruar nga projektues të licencuar
Dokuemeti që vërteton pronësinë apo të drejta të ligjshme të aplikuesit mbi pasurinë private apo publike që ka në përdorim, në përputhje me legjislacionin në fuqi
Formati i aplikimit i nënshkruar elektronikisht si dhe pas marrjes zyrtarisht të mendimeve/pëlqimeve nga institucionet publike të parashikuara nga ligji, si vijon:
OSHEE Vlorë; PMNZSH Himarë; UK Himarë dhe **ZVRPP Vlorë**.
1. Leja e ndërtimit rezulton e lëshuar për zhvilluesin "J.5" ShPK (NUIS/NID L72226029O) të cilin i lejohet ndërtimi i objektit: "Rikonstruksion Objekt shërbimi 2-kate +2 objekte shërbimi 1-kate", **në pasurinë me nr. 1/137, ZK 38, në pronësi të "S&S" ShPK me kufij (V/J/L/P), me sipërfaqe trualli 951m^2** dhe adresë Jal, Vuno, Bashkia Himarë, sipas kushteve të zhvillimit:

1.1. Sipërfaqe e parcelës/parcelave e zënë ndërtimi:	443 m^2
1.2. Sipërfaqe totale e ndërtimi (m^2):	548 m^2
1.3. Lartësia maks e ndërtimit nga niveli zero i ndërtimit (m):	6.6 m
1.4. Numri i kateve mbi nivelin e tokës:	1 dhe 2
1.5. Numri i kateve nën nivelin e tokës:	0
1.6. Përdorimet e lejuara në objekt/objekte (funksioni):	Shërbime

2. Kjo leje është e vlefshme për një periudhë **6 mujore nga data e fillimit të punimeve**, referuar grafikut të punimeve.
3. Afati i fillimit të punimeve është deri në 1 (një) vit nga data e lëshimit të kësaj lejeje. Kjo leje është e pavlefshme nëse zhvilluesi nuk fillon punimet e ndërtimit brenda afatit njëvjeçar pas lëshimit të saj, bazuar në nenin 40 të ligjit nr. 107/2014.
4. Nëse ndërtimi ka filluar pas kalimit të afatit njëvjeçar apo vijon edhe pas përfundimit të afatit të përfundimit të punimeve, punimet konsiderohen të paligjshme.
5. Në rast shkelje të kushteve të kësaj leje do të merren masa në përputhje me ligjin, deri në prishje të punimeve të kryera. Zhvilluesi, zbatuesi dje mbikëqyrësi i punimeve janë përgjegjës solidarisht më rast kryerje punimesh në shkelje të kësaj lejeje apo të ligjeve që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në RSH, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 107/2014.
6. Zhvilluesi është i detyruar që të njoftojë paraprakisht bashkinë për fillimin e punimeve si dhe të komunikojnë emrat e zbatuesit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve, së bashku me licencat profesionale. **Në mungesë, punimet konsiderohen të paligjshme**.
7. Zhvilluesi është i detyruar që, pas përdorimit të ndërtimit dhe përpara përdorimit të tij të kërkoj nga bashkia që të lëshoj certifikatën e përdorimit.
8. Kundër kësaj lejeje, zhvilluesi mund të paraqesë ankim brenda 15, ditëve nga data e marrjes njoftim.
Për lëshimin e kësaj leje rezulton se Bashkia Himarë me shkresën nr. 831, datë 28.03.2018 të AZHT, ka marrë kontrollin e konformitetit për pajisjen me leje ndërtimi për objektin: "Rikonstruksion Objekt shërbimi 2-kate +2 objekte shërbimi 1-kate", në adresën Jal, Vuno, Bashkia Himarë, paraqitur nga zhvilluesi ".oni 5" ShPK. Sipas shkresës së AZHT, Bashkia Himarë si autoriteti përgjegjës i zhvillimit

të territorit, mund të vijojë, sipas fushës së kompetencës, me vazhdimin e procedurave për shqyrtimin dhe vlerësimin e këtij projekt-propozimi për pajisjen me leje ndërtimi.

Për lejen e ndërtimit Bashkia Himarë me shkresën nr. 1242, datë 16.04.2018, "Njoftim me tarifat e shërbimit për pranimin me lej ndërtimi", ka lëshuar subjektit zhvillues "J. 5" ShPK, formularin e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për:
Sipas shkresës në referim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" dhe VKB nr. 130, datë 06.12.2017 "Për paketën fiskale 2018",
1) vlera e taksës së lejes së ndërtimit për ndërtime të ndryshme që nuk përfshihen në pikën e mësipërme, hoteleri të ndryshe, shërbime tregtare në turizëm industri, rezidenciale turistike, resorte, komplekse turistike etj, në zonën A=3% të vlerës së investimit =0.03 x 32508 x 548m^2= 534,431.52 lekë.
2) tarifë shërbimi për aplikim leje ndërtimi të çdo lloji =20 lekë/m^2 = 20 x 548 m^2=10,960 lekë
3) azhornim trualli 36 lekë x 951 m^2 truall = 34,236 lekë
4) tarifë shërbimi për kontrollin e piketimit të objektit 8,000 lekë
5) tarifë shërbimi për kontrollin e përfundimit të themelit
6) tarifë shërbimi për kontrollin e karabinasë
7) tarifë shërbimi për kontrollin e përfundimit të fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re 5,600 lekë
7) tarifë shërbimi për kontrollin e përfundimit të objektit dhe sistemimin e ambientit përreth dhe lidhja me infrastrukturën publike ekzistuese 5,600 lekë
Detyrimet e subjektit ndaj Bashkisë Himarë rezultojnë të jenë shlyer më datë 16.04.2018 pranë bankës "C", sipas mandat-pagesave të depozituara në dosje.

Komente nga grupi i auditimit:
Dokumenti i pronësisë përshkruhet për 951 m^2, por ky dokument nuk rezulton të jetë në emër të kërkuesit, përsa Leja Legalizimit të objekteve, shprehet se "Titulli i pronësisë do të miratohet me VKM".

Nuk ka asnjë dokument që të vërtetoj afatin e fillimit të lejes, pra a ka filluar në afat leja e ndërtimit, pra fillimin dhe përfundimin e saj, edhe pse nga verifikimi në terren objektet rezultonin të përfunduara dhe në funksion.

Nuk ka asnjë dokument që të konfirmoj nëse nga zhvilluesi janë respektuar apo janë shkelur kushtet e lejes, edhe pse nga verifikimi në terren, objektet rezultonin me ndryshime/shtesa si dhe për dy objekte nuk rezultonte të kishte leje të miratuar për ndërtimin e tyre (objekte pa leje).

Në dosjen e adminstruar nga Bashkia Himarë nuk ka asnjë dokument që të provojë/vërtetoj se nga zhvilluesi në zbatim të lejes së ndërtimit janë bërë të gjitha njoftimet përkatës (detyrim ligjore dhe të përcaktuara në leje).

Në dosjen e adminstruar nga Bashkia Himarë dhe në sistemin e-leje, nuk ka asnjë dokument që të vërtetoj nëse zhvilluesi ka aplikuar për marrjen e certifikatës së përdorimit, edhe pse nga verifikimi në terren objekti rezultojë i përfunduar dhe funksional.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i tyre, por dhe verifikimet përkatëse, ka rezultuar se nga Bashkia Himarë, nuk është aplikuar penaliti për vënien në përdorim të objektit, pa u pajisur më parë me leje përdorimi, referuar nenit 40, të Ligjin nr.107, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, në të përcaktohet që:
Neni 52 ***Kundërvajtjet administrative:***
1. *Në kuptim të këtij ligji, shkeljet e mëposhtme, pavarësisht nëse përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:*

dh) shkelja e afatit të fillimit apo përfundimit të punimeve, sipas nenit 40 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 100 000 lekë deri në 500 000 lekë;
f) përdorimi i objektit pa lëshimin e certifikatës së përdorimit dënohet me gjobë nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë;

Mos realizimi i kësaj procedure duke mos përcaktuar të gjitha objektet ndërtimore të cilat kanë përfunduar dhe janë vënë në përdorim pa u pajisur me parë me certifikatën e përdorimit, ka sjellë për pasojë mos respektim të ligjit nga zhvilluesi dhe krijuar ***mungesë të ardhurash me dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë si pasojë e mosllogaritjes së tyre, në vlerën prej 500,000 lekë.***
Nga fotot e bëra më datë 19.11.2019 rezulton se vetëm objekti "depo uji" rezulton i pa ndryshuar si në dokument ashtu edhe në fakt ndërsa dy objektet e tjera rezultojnë si në formë ashtu edhe në dimensione të ndryshme nga ato të miratuara me leje legalizimi dhe leje rikonstruksioni nga Bashkia Himarë. (referimi bëhet vetëm në foto nisur nga pengesa e bërë nga subjekti për verifikimin e gjendjes aktuale nga grupi i përbashkët Bashki/KLSH)

Në përfundim, duke qenë se subjekti nuk ka përmbushur asnjë prej kushteve të lejes së rikonstruksionit dhe konkretisht pikave 5, 6 dhe 7, ndërtimi, ashtu siç edhe theksohet në vet lejen e dhënë "...Punimet konsiderohet të paligjshme", i tërë objekti konsiderohet i paligjshëm.

Përveç ndërtimeve të bëra në shkelje të lejes së dhënë nga bashkia, nga fotot e bëra rezulton se subjekti ka ndërtuar edhe një pishinë dhe dy ambiente ndihmëse, në jug të parcelës, dhe në kufij me bregun e detit, ndërtime për të cilat nuk ka një akt të mbajtur deri më tani nga IMTV Bashkia Himarë.







<u>Shënim</u>: Të konturuara paraqiten kufiri "i pronës" sipas lejes së legalizimit, objektet ndërtimore sipas lejes së rikonstruksionit (dhe legalizimit) dhe gjendja faktike e tyre, nga ku rezulton se është e totalisht e ndryshme nga dokumentacioni.

D. Deklarata për Kryerjen e Punimeve

Me vendimin nr. 119, datë 3677, datë 30.11.2017 të Kryetarit të Bashkisë Himarë, "Për miratimin e deklaratës për kryerje punimesh", subjektit aplikues/zhvillues "S&S" ShPK, i është miratuar kërkesa, për lëshim e deklaratës paraprake për punime riparimi, mirëmbajte dhe rehabilitimi të kullimit e mbrojtjes nga përmbytja.

Deklarata është lëshuar me kushtin e përfundimit të saj deri më datë 01.03.2018, si dhe detyrimin e IMTV për të respektuar vendimin.

Sipas deklaratës paraprake për kryerje punimesh, aplikuar nga Ark. A.A, në shënimet/rubrikën mbi parcelën ndërtimore është vendosur shënimi:

Pronë Private; ndodhur në ZK 3844; pasuria 1/23; sipërfaqja e parcelës në më: 7494 m^2;

Emërtimi i projektit dhe Përshkrimi i Punimeve: Punime riparimi, mirëmbajtje dhe rehabilitimi të kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja

Zhvilluesi: "S&S" ShPK

Kopje e dokumenteve të pronësisë: (K. ShPK; saktësim për pronën; vërtetim)

Deklarata përfundon me shënimin e znj. A se: "deklaroj nën përgjegjësinë time ligjore, se të gjitha të dhënat dhe dokumentet e paraqitura përmes kësaj kërkese janë të vlefshme dhe të njëjta me dokumentet origjinale të lëshuara nga autoritetet/subjektet kompetente. *<u>Jam i ndërgjegjshëm se deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale, sipas ligjit, dhe pasi sjell përjashtimin tim nga çdo procedurë e mëtejshme".</u>*

Konkluzione nga grupi i auditimit:

Nga aplikuesi dhe subjekti zhvillues është deklaruar se kanë në pronësi sipërfaqen prej 7494 m^2, pjesërisht mbi të cikën do të kryhen punimet, kur rezulton se deklarimi nuk është i vërtetë, pasi sipas dokumentacionit të pronësisë të depozituar (pjesë e dosjes) subjekti disponon vetëm një leje legalizimi

nr. 107264, datë 20.03.2017, për sipërfaqen e ndërtimit prej 3960 m^2, ndërkohë kur trualli prej 7494 m^2 nuk rezulton në pronësi të tij por po sipas lejes Titulli i pronësisë mbi tokën do të miratohet me VKM.

Referuar sa sipër rezulton se deklarata për kryerje punimesh është kërkuar për një pronë jo në pronësi të zhvilluesit dhe po ashtu miratimi i saj nga bashkia është bërë në kushtet e mosdisponimit të titullit pronësor mbi tokën.

Sipas dokumentacionit teknik (projekti teknik i punimeve që do të kryhen) pjesë e dosjes, rezulton se punimet e deklaruara për legalizim, nuk janë punime gërmimi dhe ndërtimi Punime riparimi, mirëmbajtje dhe rehabilitimi të kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja por kryesisht punime gërmimi dhe ndërtimi, pra jo sipas përcaktimeve të bëra nga VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", neni 20, dhe në mospërputhje me nenin 7 "Punime që kryhen me deklaratë paraprake punimesh" si dhe nenin 8 pika "Dokumentacion për punime me deklaratë paraprake", sipas të cilit "b) Dokumenti që vërteton pronësinë apo të drejtat e ligjshme të deklaruesit mbi pasurinë në të cilën kryhen punimet, në përputhje me legjislacionin në fuqi, përfshirë kontratë sipërmarrjeje/porosie, leje legalizimi e të ngjashme".

Nga IMTV Bashkia Himarë nuk është kryer inspektimi i punime sipas urdhërimit me Vendimin nr. 119, datë 30.11.2017, duke mos u kryer verifikimi i zbatimit të tij sipas deklaratës të miratuar. Mos veprim i justifikuar nga IMTV Bashkia Himarë me deklarimet verbale të tyre se në asnjë rast nuk janë lejuar nga subjekti zhvillues të inspektojnë objektet/pronat e kompleksit.

E. Procedurat e realizuara nga IMTV Bashkia Himarë

Nga dokuemtacioni i vënë në dispozicion dhe informacionet verbale të Kryeinspektorit të IMTV Bashkia Himarë z. R .H, ka rezultuar se kjo strukturë për gjitha sa trajtuar më sipër nuk ka vepruar për ndërtimet (me apo pa leje) të zhvilluara nga shoqëria "S&S", "Kempixh", "J.5" dhe J. K, përjashtim për një objekt pa leje ndërtimi, të përshkruar si më poshtë:

1) Më datë 26.06.2018, IMTV Bashkia Himarë ka konstatuar se në Vuno, Jal, subjekti "S&S" ka realizuar "Ndërtim me konstruksion metalik 3 kate me mure gipsi me përmasa 20x7, në fazën e veshjes më gips, ndarje të mureve të brendshme".
Me kryerjen e këtij akt-verifikimi brenda datës 29.06.2018 duhet të paraqiten dokumentet përkatëse për objektin pranë IMTV Bashkia Himarë
2) Më datë 02.07.2018, sipas procesverbalit nr. 30 dhe nr. serie 0000300, "Për konstatimin e kundërvajtjes", IMTV Bashkia Himarë ka konstatuar se në Vuno, Jal, subjekti "S&S" me adminstrator A. B ka realizuar:
"Ndërtim me konstruksion metalik 3 kate me përmasa 20 x 7, në fazën e veshjes më gips", pa leje nga organet kompetente.
3) Më datë 09.07.2018, sipas vendimit nr. 13 dhe nr. serie 0000283, "Për dënimin me gjobë", IMTV Bashkia Himarë ka vendosur dënimin e kundërvajtësit "Soleil & Sea" me gjobë në masën 500,000 lekë.
4) Më datë 09.07.2018, sipas vendimit nr. 16 dhe nr. serie 0000286, "Për prishjen e objektit të kundërligjshëm", IMTV Bashkia Himarë ka vendosur dënimin e kundërvajtësit subjekti "S&S" me adminstrator A. B se në Vuno, Jal, për prishjen e objektit:
"Ndërtim 3 kate me konstruksion metalik".
5)Shkresa Kryeinspektorit të IMTV nr. 2350, datë 01.08.2018 "Njoftim për fillim procedure", drejtuar shoqërisë "S&S" ShPK dhe administratorit A. B, nga ku rezulton se është bërë me dije subjekti se nuk ka paraqitur asnjë dokument edhe pse është pretenduar se i dispononte (sipas komunikimeve) si dhe se ndodhur përpara kësaj situate bëhet me dije se ka filluar procedura për ndërtim pa leje.

6)Shkresa e Kryeinspektorit të IMTV nr. 62, datë 28.12.2018 "Njoftim për ekzekutimin e gjobave të IMTV pranë Bashkisë Himarë për vitin 2018", drejtuar z. Th. S, Përgjegjës i Zyrës Juridike në Bashkinë Himarë.
Sipas shkresës, IMTV në bazë t kompetencave ngarkuar nga ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" dhe ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit ndërtimet e kundërligjshme", si dhe VKM nr. 40, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", për vitin 2018 ka kryer 25 procedura të dënimit me gjobë për subjektet kundërvajtës. Sipas listës, me numër rendor 23, evidentohet edhe subjekti "S& S" ShPK. Për të gjithë këto subjekte IMTV ka kërkuar nga që në zbatim të ligjeve të sipërpërmendura, të vihen në ekzekutim si dhe ndjekjen e procedurave përkatëse ligjore me Padi në Gjykatë ose Përmbarim nga Zyra Juridike për vjeljen e këtyre gjobave.

Konkluzioni i grupit të auditimit:

Nga IMTV nuk janë zbatuar drejtë referencat ligjore të sipërpërmendura pasi ka rezultuar se aplikimi i penalitetit është bërë me referencë fikse (500,000 lekë) dhe jo sipas sipërfaqes së ndërtimit shumëzuar me vlerën e ndërtimit për 1(një)/m^2 në Bashkinë Himarë, çka ka sjell për pasojë të ardhura të munguara më dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë si më poshtë"

Çmimi për 1/m^2 në Bashkinë Himarë rezulton të jetë 32,516 lekë/m^2 dhe sipërfaqja e ndërtimit të kundërligjshëm është 20 x 7 ose 140 m^2 x për 3 kate=420 m^2, pra nga IMTV aplikimi i dënimit me gjobë duhej bërë duke shumëzuar sipërfaqen e përgjithshme të ndërtimit me vlerën për m2, dhe konkretisht 420 m^2 ndërtim x 32,516 lekë/m^2=13,656,720 lekë, kur IMTV ka vendosur dënim me gjobë për vlerën prej 500,000 lekë. Sa më sipër ***shuma prej 13,156,720 lekë (diferenca ndërmjet 13,656,720 lekë vlerës prej – 500,000 lekë (gjobë e vendosur=13,156,720 lekë), përbën dëm ekonomik krijuar buxhetit të Bashkisë Himarë***. Veprimet e kryera nga IMTV Bashkia Himarë nuk janë në përputhje të plotë me nenet 3, 5, 9 dhe 12 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", nenit 52 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" dhe VKM-së nr. 89, datë 04.11.2015, veprime apo mos veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi Kryeinspektori i IMTV z. R. H.

IMTV Bashkia Himarë nuk ka ndjekur rrugët ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin e ndërtimit" i ndryshuar, VKM-së nr. 862, datë 05.12.2007 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga INUK dhe INUV" i ndryshuar, për arkëtimin e vlerës së gjobës të vendosur ndaj subjektit shkelës, edhe pse vendosja e saj, përsa i përket vlerës së saj nuk ka rezultuar në masën e përcaktuar nga ligji (***13,656,720 lekë***) .
Përgjegjësia për mosarkëtimin e saj bie mbi Kryeinspektorin e IMTV z. Renato Hodaj dhe Përgjegjësin e Zyrës Juridike z. Th. S, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative" dhe konkretisht nenin 44-Përgjegjësia e punonjësit të organit administrative, ku parashikohet se: "*Në rast se gjobat dhe detyrimet e tjera, të vendosura nga vendimi për kundërvajtjen administrative, nuk paguhen për mosveprim të punonjësit të organit administrativ, i cili ka miratuar vendimin përkatës dhe detyrimin që të kërkojë arkëtimin e shumave, apo për shkak se punonjësi nuk nis procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ, atëherë ndaj tij fillojnë procedurat e largimit nga detyra".*

Konstatohet se IMTV Bashkia Himarë ka vepruar në papajtueshmëri me pikën 8 të VKM-së nr. 862, datë 05.12.2007 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga INUK dhe INUV" i ndryshuar, për dënimin me gjobë të këtyre kundërvajtjeve sa parashikuar dhe nuk ka kryer kallëzim penal për këto raste.

IMTV Bashkia Himarë nuk ka bërë kallëzim penal në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara nga neni 5 i ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin e ndërtimit" i ndryshuar, VKM-së nr. 862, datë 05.12.2007 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga INUK dhe INUV" i ndryshuar, apo të këtë referuar çështjen në Policinë e Shtetit.

Për këto objekt më datë 19.11.2019, nga auditimi në terren edhe pse nuk u lejuam nga subjekti për të kryer matjet faktike të tij, u konstatua se gjendja e tij zhvillimore ishte e përfunduar, funksionale (edhe pse jo në punë për shkak të përfundimit të sezonit turistik). Më poshtë paraqitet një imazh i gjendjes faktike të tij më datë 19.11.2019, bërë nga grupi i përbashkët i verifikimit.



F. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike

Me shkresën nr. ska, datë 16.10.2019, administratori i shoqërisë "S&S" ShPK, drejtuar Bashkisë Himarë, me lëndë: "Kërkesë për përfshirjen në planin e përgjithshëm vendor të Bashksië Himarë".

Sipas shkresës me vendimin nr. 20/5, datë 01.08.2019 të Komitetit të Investimeve Strategjike, kompania S&S" ShPK, ka fituar statusin e "Investim, Investitor Strategjik, Procedurë e Veçantë" dhe referuar në sa vendosur nga KIS, subjekti ka kërkuar nga bashkia që referuar masterplanit të paraqitur dhe miratuar nga KIS, ky masterplan të përfshihet në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Himarë, me zonat e reja për ndërtim si dhe me rrugët lidhëse me rrugën kryesore nacionale.

Komente nga grupi i auditimit:

Duke qenë se kjo vendimmarrje nuk është objekti vendimmarrje e Bashkisë Himarë, por institucioneve të tjera, grupi i audimit ashtu si më sipër rezervohet vetëm në bërjen e disa komenteve lidhur me sa disponohet nga bashkia për rastin dhe më konkretisht:

1. Sipas Planit të Përgjithshëm Vendor të miratuar nga KKT me vendimin nr. 2, datë 16.10.2017, zonat ku kërkohet të realizohet projekti nuk është në listën e zonave të përcaktuara si zona për investime strategjike (zonat e përcaktuara për investime strategjike rezultojnë B.1 Draleos-Palasë; B.2 Drimadhes; B.3 Dhërmi; B.4 Jala; B.5 Porto Palermo; B.6 Lukova-Kakome). Sipas dokumentit për Investime Strategjike, zona B.4-Jala, ka përfshirë vetëm njësinë strukturore HI.UB 9.1205, me një sipërfaqe prej 15.80 ha, me pronësi private, njësi e cila nuk ka lidhjen me parcelat strukturore ku kërkohet të realizohet projekti "J. E. P".

2. Sipas Planit të Përgjithshëm Vendor të miratuar nga KKT me vendimin nr. 2, datë 16.10.2017, zonat ku kërkohet të realizohet projekti nuk është në listën e zonave të përcaktuara si zona për ndërtim. Po ashtu nuk ka asnjë nisëm të Kryetarit të Bashkisë dhe miratim të Këshillit Bashkiak për fillimin dhe hartimin e Planeve të Detajuara Vendore.

3. Projekti i miratuar "J. E. P", është deklaruar nga investitori që do të kap një vlerë investimi të parashikuar në shumën prej 67 milion euro. Duke qenë se bashkia nuk disponon dosjen e plotë të vendimit 20/5, datë 01.08.2019 të KIS (apo nuk ju vu në dispozicion grupit të auditimit), në mungesë të Raportit të Vlerësimit nga grupi Operacional i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), nuk mund të vlerësohet roli apo përmbushje e detyrime nga ana e Bashkisë Himarë lidhur me konfirmimet e mundshme ligjore të bëra nga bashkia.

4. Nuk mund të vlerësohet pozicioni dhe përqindja që zë në vlerën e investimit prej 67 milion euro-sh investimi në proces zhvillimi miratuar me Vendimin e KKT nr. 887/10 prot, datë 21.09.2018 (projekti S. 2), vlera e të cilit është deklaruar në shumën prej 2.4 milion euro. Po ashtu nuk mund të vlerësohet pozicioni dhe përqindja që zënë pjesët e tjera të pasurive ekzistuese të cilat janë/duhet të jenë përfshirë në projektin "J. E. ark".

5. Gjithashtu nuk mund të vlerësohet se mbi çfarë bazë të dhënash, dokumentesh apo korrespondencash zyrtare me institucionet të cilat administrojnë titujt pronësor, apo kanë të dhëna për to dhe statuset e tyre, ka vepruar AIDA, kur në më të shumtën tokat që kërkohen të zhvillohen figurojnë në zërin kadastral "Kullotë", si dhe trajtimi që i është bërë pasurive të disponuara me titull pronësor nr. 141, datë 27.02.2019 nga trashëgimtarët e G. Gj. 6.

6. Sipas Raportit të Vlerësimit të Grupit Operacional të AIDA, nga ku bashkia është përfaqësuar nga G S, është theksuar se: "**Bashkia Himarë rekomandon pozitivisht projektin dhe është Pro Statusit Strategjik** projekti përputhet me kriteret mjedisore të zonës; projekti është në përputhje me PPV Bashkia Himarë dhe dokumentet e tjerë të planifikimit të territorit. Ky investim do te rrisë numrin e të punësuarve, do të ofroje shërbime cilësore për turizmin vendas dhe të huaj. Brenda këtij kompleksi duke u bazuar në numrin e aktiviteteve të hapura në funksion të plotësimit të aktivitetit te tij, bëhet burim i konsiderueshëm taksash për pushtetin vendor. Gjithashtu projekti do të sjellë zhvillimin e zonës dhe turizmin si qëllim prioritar i pushtetit vendor".
   Në Bashkinë Himarë nuk rezulton të disponohet ndonjë akt i Kryetarit apo Këshillit Bashkiak, nga ku institucioni të rezultojë të ketë dhënë pëlqimin/rekomandimin për realizimin e projektit, duke mos u kuptuar nga ka dal ky konstatim i Grupit Operacional.
7. Sipas Raportit rezulton se: "**Bashkia Himarë** me shkresë Nr. 767/2 Prot. dt. 03/04/2019 sqaron se në zonimin e pasqyruar, zona 1 është pjesërisht në zonë që lejohet zhvillimi me Kod të Njësisë Strukturore HI.N.755, zona 2 bën pjesë në zonë që lejohet zhvillimi me Kod të Njësisë Strukturore HI.UB.9.420 dhe HI.UB.9.893, zona 3 bën pjesë pjesërisht në zonë natyrore me Kod të Njësisë Strukturore HI.UB.9.214 dhe zonë që lejohet zhvillimit me Kod të Njësisë Strukturore HI.UB.9.428, HI.UB.9.757, si dhe zonë infrastrukturore HI.UB.9.758 dhe HI.IN.1134, Zona 4 bën pjesë në zonë natyrore ku nuk lejohet zhvillimit me Kod të Njësisë Strukturore HI.N.1186. Gjithashtu, Bashkia Himarë lidhur me situatën juridike të tokës shprehet se nuk është kryer procesi i regjistrimit të parë fillestar sistematik dhe nuk disponojnë hartë treguese të regjistrimit (HTR), si rezultat nuk shprehen për juridiksionin dhe vendndodhjen e pronave. Bashkia ka vënë në dispozicion fotokopje të Formularit Nr. 6 dhe fotokopje të AMPT të trajtuar me ligjin 7501.
   Shkresa e Bashkisë Himarë, nuk rezulton të paraqesë drejtë çfarë lejohet apo nuk lejohet sipas PPV, pasi në njësitë strukturore (HI.N) dhe konkretisht: HI.N.755, HI.IN.1134 dhe HI.N.1186, nuk lejohet ndërtimi, por dhe zona të tjera të cilat janë trajtuar më sipër.
   Bashkia ka bërë të qartë se nuk diponon kopje origjinale të formularit nr. 6 por vetëm fotokopje të tij. Nuk rezulton se si mund/apo janë marrë për të mirëqena aktet kur bëhet fjalë për toka bujqësore por "kullotë", të pa regjistruara në ZVRPP dhe për më tepër fotokopje të cilat nuk tregojnë nëse përfituesve të tyre u është lëshuar AMTP.

G. Lejet e legalizimit nga ALUIZNI Vlorë

Nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI Vlorë në favor të subjektit "Kempixh", sot "Soleil&Sea" ShPK kanë dalë 3 leje legalizimi për objekte informale të ndërtuara në pronat objekt verifikimi nga KLSH dhe më konkretisht:

1. Leja e legalizimit nr. 107008, datë 10.02.2017, për subjektin "K" ShPK, lëshuar për pasurinë e ndodhur në zonën kadastrale 3844, pasuria nr. 1/137, me sipërfaqe ndërtimi 232 m^2, sipërfaqe totale ndërtimi 443 m^2 dhe sipërfaqe të parcelës ndërtimore 951 m^2. Leje e lëshuar më shënimin në Titullin e pronësisë mbi tokën "Do të miratohet me VKM".

2. Leja e legalizimit nr. 107264, datë 20.03.2017, për subjektin "K" ShPK, lëshuar për pasurinë e ndodhur në zonën kadastrale 3844, pasuria nr. 1/123, me sipërfaqe ndërtimi 2498 m^2, sipërfaqe totale ndërtimi 3960 m^2 dhe sipërfaqe të parcelës ndërtimore 7494 m^2. Leje e lëshuar më shënimin në Titullin e pronësisë mbi tokën "Do të miratohet me VKM".

3. Leja e legalizimit nr. 106707, datë 20.03.2017, për subjektin "S&S" ShPK, lëshuar për pasurinë e ndodhur në zonën kadastrale 3844, pasuria nr. 1/129, me sipërfaqe ndërtimi 2100 m^2, sipërfaqe totale ndërtimi 3064m^2 dhe sipërfaqe të parcelës ndërtimore 6300 m^2. Leje e lëshuar më shënimin në Titullin e pronësisë mbi tokën "Do të miratohet me VKM".

Komente nga grupi i auditimit:

Në Bashkinë Himarë, lidhur me të tri këto leje legalizimi nuk disponohej shkresa e ALUIZNI Vlorë për llogaritjen e pagesa e taksës së legalizimit, taksë e cila sipas vendimeve respektive (2017-2019) të Këshillit Bashkiak Himarë është në vlerën prej 0.5% të investimit.

Për rrjedhojë nuk ka të konfirmuar pagesën e kësaj takse, si dhe për llogari të Bashkisë Himarë, nëpërmjet degës së thesarit, nuk ka kaluar asnjë pagesë e bërë nga subjektet "K" shpk dhe "S&S" ShPK, apo administratorët e tyre për pagesën e kësaj takse. Në këto kushte nuk mund të vlerësohet niveli i përllogaritjes së saj dhe nuk mund të vlerësohet se mbi çfarë dokumenti pagese/mandatesh ka vepruar ALUIZNI Vlorë.

Më datë 19.11.2019, me qëllim përmbushjen e programit të auditimit dhe verifikimit të ankesës, u ngrit një grup i përbashkët pune ndërmjet përfaqësuesve të KLSH-së dhe Bashkisë Himarë, me objekt pune:

1. Verifikimi i në terren i lejeve të ndërtimit të dhëna nga KKT dhe Bashkia Himarë për subjektin "S&S" ShPK, zbatimi i tyre sipas kushteve të lejeve në drejtim, faza aktuale e ndërtimit (proces apo përfunduar).
2. Evidentimin faktik të parcelës ndërtimore, dhënë leje ndërtimi nga Bashkia Himarë
3. Gjendja e objektit të konstatuar si ndërtim të kundërligjshëm nga IMTV, ndërtuar nga subjekti, "S&ea" ShPK, *sipas vendimit për prishje objekti nr. 16, datë 09.07.2019.*
Kryerja e këtij akt-verifikimi bëhet e nevojshme/domosdoshme pasi për sa cituar subjekti zhvillues edhe është në fazën e realizimit të investimeve apo i ka përfunduar pjesërisht ato, deri në datën e mbajtjes të këtij akti nuk ka përmbush asnjë detyrim ligjor, duke mos njoftuar bashkinë Himarë dhe strukturat përkatëse të saj lidhur me vijueshmërinë e ndërtimeve, sipas kushteve të lejeve respektive dhe përcaktimeve ligjore.

Leja ndërtimit miratuar nga KKT nr. 887/7, datë 22.06.2018, të miratuar me vendimin nr. 14 datë 27.04.2018, "Për miratimin e Lejes së ndërtimit për objektin: "Resort turistik ".S. 2", me vendndodhje në Jal, Bashkia Himarë", me subjekt zhvillues "S& S" ShPK", konfirmuar me Dokumentin e Lejes së Ndërtimit nr. 887/10 prot, datë 21.09.2018.

Leja e Zhvillimit miratuar nga KKT me vendimin nr. 26, datë 16.10.2017 "Për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin: "Kompleks Turistik, Hoteleri dhe Shërbime, me vendndodhje në Jalë, Bashkia Himarë", me propozim të shoqërisë "S& S" ShPK".

Leja e rikonstruksionit miratuar me vendimin nr. 31, datë 17.04.2018 të Kryetarit të Bashkisë Himarë, z. J. G, është lëshuar leja e ndërtimit për objektin: "Rikonstruksion Objekt shërbimi 2-kate +2 objekte shërbimi 1-kate", në adresën Jal, Vuno, Bashkia Himarë, paraqitur nga zhvilluesi "J.5" ShPK.

Procedurat e realizuara nga IMTV Bashkia Himarë, lidhur me objektin "Ndërtim me konstruksion metalik 3 kate me mure gipsi me përmasa 20 x 7, në fazën e veshjes më gips, ndarje të mureve të


brendshme", për të cilën IMTV ka mbajtura edhe procedurat e konstatimit, dënimit me gjobë dhe prishje, sipas procesverbaleve nr. 30 dhe nr. serie 0000300, "Për konstatimin e kundërvajtjes", IMTV Bashkia Himarë ka konstatuar se në Vuno, Jal, subjekti "S&S" me administrator A. B; nr. 13 dhe nr. serie 0000283, "Për dënimin me gjobë", IMTV Bashkia Himarë ka vendosur dënimin e kundërvajtësit "S&ea" me gjobë në masën 500,000 lekë; vendimit nr. 16 dhe nr. serie 0000286, "Për prishjen e objektit të kundërligjshëm", IMTV Bashkia Himarë ka vendosur dënimin e kundërvajtësit subjekti "S&S" me administrator A. B se në Vuno, Jal.

Lejet e legalizimit të lëshuara nga ish-ALUIZNI Vlorë (*Dosja nr. 3288, J. L. K (K SHPK) (Jalë, Himarë) dhe Dosja nr. 3289, A. B. B (S& S SHPK) (Jalë, Himarë), në drejtim të ekzistencës të objekteve të legalizuara dhe dimesionet faktike të tyre, si dhe nëse ka ndryshuar (rritur) sipërfaqja e ndërtimeve të legalizuara, pas miratimit të lejeve të legalizimit.*
Verifikimit të pretendimeve të subjekteve ankuese se ndërtimet e realizuara bien pjesërisht në pronë private jo në pronësi të zhvilluesit, duke cënuar të drejtat e pronësisë; një pjesë e zhvillimit realizohet pa pasur marrëdhënie me truallin, pra në pronësi shtet, si dhe objekti i miratuar nga KKT nuk është duke u zhvilluar aty ku edhe është miratuar sheshi i ndërtimit por është spostuar drejt zonës lindore.

Përfaqësuesit e atyshëm të subjektit (S&S) (punonjës të cilat kishin në ruajte, administrim, mirëmbajtje dhe zhvillim, të objekteve/komplekseve) fillimisht shprehën gatishmërinë për lejimin e ushtrimit të verifikimeve (të jashtme, pra vetëm matje nga jashtë të tyre), më vonë pas komunikimeve telefonike me drejtues/administrator apo pronar të shoqërisë, urdhëruan mos lejimin e punonjësve të bashkisë dhe audituesve të KLSH, për kryerjen e verifikimeve.
Në këto kushte grupi i përbashkët i verifikimit Bashki/KLSH nuk është lejuar në ushtrimin e detyrave ligjore të përcaktuara në ligjet respektive.

Grupi i përbashkët me qëllim për të dokumentuar praninë e punonjësve të Bashkisë dhe audituesve të KLSH në subjekt dhe mos lejimin e këtij të fundit për kryerjen e detyrës/ave, ka mbajtur në bashkinë Himarë edhe akt-verifikimin nr. 2, datë 19.11.2019, protokolluar nga Bashkia Himarë me nr. 1574/32, datë 19.11.2019, si dhe bërë edhe foto të objekteve të ndërtuara me apo pa leje, apo në tejkalim të lejeve të miratuara, pjesë integrale e këtij akt-konstatimi.







Shënimi nr. 1
Akti i konstatimit i mbajtur nga grupi i auditimit të KLSH-së në subjektin Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, lidhur me procedurat e kryera nga ish-ALUIZNI Vlorë, bashkëlidhur Aneksi H/1.

Shënimi nr.2
Raporti i auditimit (pjesa takuese) të KLSH-së në subjektin Bashkia Himarë, realizuar në vitin 2015, lidhur me ndërtimet pa leje në zonat në afërsi të brigjeve, bashkëlidhur Aneksi H/2.

3. AIDA i është drejtuar me shkresë Nr. 107/6 prot. datë 18.03.2019 ***Agjencisë së Trajtimit të Pronave (ATP***), për verifikime nëse ka vendime për njohje, kthim apo kompesim apo pretendime nga pronarë mbi pronën e lartëpërmendur për projektin potencial të investimit.
ATP me shkresë Nr. 2898/1 Prot. dt. 25/032019 bëri me dije se:

Referuar sistemit ËEB-G. pranë ATP-së, nga të dhenat e pasqyruara deri më tani, rezulton se pronën në fshatin Vuno janë administruar vendimet Nr. 231 datë 25.07.2006, me anë të të cilit ish-KKKP Vlorë dhe vendimi Nr. 799 datë 13.06.2019 i ATP.
Vendimi ish KKKP Vlorë parashikon:
1. Të njohë të drejtën e pronënisë subjektit të shpronësuar S. Th. A për një sipërfaqe toke kullotë, 1.6 ha të ndodhur në vendin "bregu i Jalit" fshati Vuno Vlorë.
2. Ti kthejë subjektit S. Th. A për një sipërfaqe toke kullotë, 1.6 ha të ndodhur në vendin "bregu i Jalit" fshati Vuno Vlorë.
Vendimi i ATP parashikon:
Rrëzimin e kërkesës dhe mosnjohjen e të drejtës së pronësisë në emër të subjektit të pretenduar si i shpronësuar N, T dhe G Gj (trashëgmtarëve të tij ligjor) për pronën me sipërfaqe 169,600 m^2, kullotë të ndodhur në vendin Perrar, fshati Vuno Bashkia Himarë, si dhe 5,600 m^2 të ndodhur në vendin Karkaniq, fshati Vuno Bashkia Himarë.
ATP nuk garanton faktin nëse vendimi i sipërcituar të jetë ndryshuar gjyqësisht.

4. AIDA me shkresë Nr. 107/4 Prot, dt. 18.03.2019 iu drejtua me shkresë zyrtare Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) ku iu kërkua informacion nëse zona e identifikuar nga vetë subjekti, për realizimin e projektit të investimit, prek apo klasifikohet sipas ndonjë kategorie zonimi në bazë të legjislacionit të ri të zonave të mbrojtura, statusin e saj si dhe nivelin e mbrojtjes së zonës. AKZM me shkresë Nr. 349/1 Prot., dt. 01.04.2019 sqaroi se sipërfaqja ku kërkohet të kryhet ky investim ndodhet jashtë zonave të mbrojtura dhe nuk prek monumente natyrore.
Sipas shkresë 328/01 prot. Date 28.03.2019, kthim përgjigje të Agjencisë së planifikimit të territorit rezulton se ky plan jep orientime për përdorimin e tokës përgjatë Brezit Bregdetar, por nuk ka si mission të tij të japë kushte zhvillimi të detajuar për ndërtimet në bregdet, të cilat jepen nga planet e përgjithsme vendore, apo planet e detajuara për zonat e rëndësisë kombëtare. Plani i përgjithshëm Kombëtar i territorit nuk jep tregues për zhvillim pasi:
- Zona1, njësia strukturore HI.N.755, tregon se është zonë e mbrojtur peisazhike, me përdorim tokë bujqësore primare kodrinore (ullishte, pemëtore, vreshtë) dhe është i ndaluar për banim dhe shërbime. Tipologjia ZN2- ***tokë natyrore të mbrojtura. Zonë recreative natyrore, vija bregdetare, zona të mbrojtura peisazhike… ku nuk lejohet asnjë aktivitet përvec punimeve për ruajtjen***.
- Njësia strukturore HI.N.756, tregon se është zonë natyrë, me përdorim të ndaluar për banim dhe shërbime. Tipologjia ZN1- ***zonë natyrore strikte e mbrojtur. Park Kombëtar, ku nuk lejohet asnjë aktivitet përvec punimeve për ruajtjen, promovimin, administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit.***
- Njësia strukturore HI.N.1140, tregon se është zonë natyrë, me përdorim të ndaluar për banim dhe shërbime. Tipologjia ZN2- ***tokë natyrore të mbrojtura. Zonë recreative natyrore, vija bregdetare, zona të mbrojtura peisazhike… ku nuk lejohet asnjë aktivitet përvec punimeve për ruajtjen.***
- Zona2, njësia strukturore HI.N.756, tregon se është zonë natyrë, me përdorim të ndaluar për banim dhe shërbime. Tipologjia ZN1- zonë natyrore strikte e mbrojtur. ***Park Kombëtar, ku nuk lejohet asnjë aktivitet përvec punimeve për ruajtjen, promovimin, administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit.***

5. AIDA me shkresë Nr. 107/2 Prot., dt. 18.03.2019 i është drejtuar Zyrës Vendore të Pasurive të Paluajtshme, Vlorë (ZVRPP) ku i është kërkuar informacion lidhur me statusin juridike të pronës.
ZVRPP Vlorë me shkresë Nr. 2530/1 Prot. datë 06.04.2019 ktheu përgjigje duke sqaruar se ZK 3844, Vuno, Vlorë është zonë që nuk i është nënshtruar regjistrimit fillestar sistematik, pra nuk disponojnë një hartë ligjore të miratuar dhe si rrjedhojë nuk mund të vënë në dispozicion statusin juridik të zonës.

6. AIDA i është drejtuar me shkresë zyrtare Nr. 107/8 Prot., dt.18.03.2019 Institutit të monumenteve të kulturës "G. S" (IMK) ku iu kërkua informacion nëse zona e identifikuar nga vetë subjekti, për realizimin e projektit të investimit, prek apo klasifikohet sipas ndonjë kategorie të veçantë të ruajtjes së trashegimisë kulturore në bazë të legjislacionit në fuqi, statusin e saj si dhe nivelin e mbrojtjes së zonës.

IMK, me shkresë Nr. 595/1 Prot., dt. 26.03.2019 sqaroi se në zonën ku do te shtrihet kompleksi turistik nuk ndodhen objekte me status "monument kulture", "qendër historike" dhe as sipërfaqe me status "zonë arkeologjike" ose "zonë e mbrojtur". Në zbatim te Ligjit Nr. 27/2018 "Për trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", dhe VKM Nr. 30 date 20.01.2016, projekti duhet të shqyrtohet pranë Këshillit Kombëtar të Restaurimeve dhe Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë.

7. AIDA me shkresë Nr. 107/7 Prot. dt. 18.03.2019 iu drejtua Agjencisë Kombetare të Planifikimit të Territorit (AKPT) ku iu kërkua informacion mbi pasaportën e zonës sipas planeve kombëtare dhe sektoriale të planifikimit te territorit.
AKPT me shkresë Nr. 328/1 Prot. dt. 28.03.2019 sqaroi se me Vendimin Nr. 1, dt. 14.06.2016 Këshilli Kombëtar i Territorit ka vendosur "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit dhe sipas përcaktimit në Ligjin Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar, ky dokument është miratuar më tej në Këshillin e Ministrave me Vendimin Nr. 881 dt. 14.12.2016.
Sipas Dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë Himarë, i miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 2, dt. 16.10.2017, rezulton se zonat e Jalës shtrihen në disa njësi strukturore. Ku specifikisht: këto zona janë zona në konservim natyror, zona të katëgorisë së mbrojtur pisazhike, ose zona **strikte të mbrojtura Park Kombëtar**, dhe ku ndalohet përdorimi i tyre për banim apo shërbime.

Sipas shkresë 328/01 prot. Date 28.03.2019, kthim përgjigje Të Agjencisë së planifikimit të tërritorit rezulton se ky plan jep orientime për përdorimin e tokës përgjatë Brezit Bregdetar, por nuk ka si mission të tij të japë kushte zhvillimi të detajuar për ndërtimet në bregdet, të cilat jepen nga planet e përgjithsme vendore, apo planet e detajuara për zonat e rëndësisë kombëtare. Plani i përgjithshëm Kombëtar i territorit nuk jep tregues për zhvillim. pasi:
Në fakt njësitë strukturore ku kërkohet të zhvillohet projekti, rezultojnë të mos jenë pjesë e Planit të Përgjithshëm Vendor të miratuar nga KKT me vendimin nr. 2, datë 16.10.2017, ku zonat që kërkohet të realizohet projekti nuk është në listën e zonave të përcaktuara si zona për investime strategjike (zonat e përcaktuara për investime strategjike rezultojnë B.1 D-P; B.2 Drimadhes; B.3 Dhërmi; **B.4 Jala**; B.5 Porto Palermo; B.6 Lukova-Kakome). Sipas dokuementit për Investime Strategjigje, zona B.4-Jala, ka përfshirë vetëm njësinë strukturore HI.UB 9.1205, me një sipërfaqe prej 15.80 ha, me pronësi private, njësi e cila nuk ka lidhjen me parcelat strukturore ku kërkohet të realizohet projekti "J. E. P". Të cilat në fakt rezultojnë toka të mbrojtura një pjesë në konservim natyror dhe ku nuk lejohen ndërtime banimi sipas shkresave që disponononhen në dosjen përkatëse. Po ashtu nuk rezulton ndonjë nisëm të Kryetarit të Bashkisë dhe miratim të Këshillit Bashkiak për fillimin dhe hartimin e Planeve të Detajuara Vendore.

8. AIDA i është drejtuar me shkresë Nr. 225 Prot., dt. 03.08.2018 ***Këshillit të Qarkut Vlorë***, për të kërkuar ndihmën e Komisionit Vendor të Verifikimit të Titujve të Pronesisë për të bërë verifikime nëse ka Akte të Marrjes së Tokave në Pronësi, në zonën e interesit.
Këshillit të Qarkut Vlorë, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës me shkresë Nr. 602/02 datë 01.04.2019 ktheu përgjigje duke kërkuar t'i vihen në dispozicion materiali arkivor analitik me plan vendosjen me parcela me nr/kadastral dhe në shkallën 1:5000 sipas Arkivit të DAMT. Pra pas kthimit të përgjigjes nuk rezulton letër këmbime të tjera.

9. AIDA iu drejtua me shkresë Nr. 224 Prot., datë 11.06.2019 ***Avokaturës së Shtetit*** për të na vënë në dispozicion informacione më të plota lidhur me procesin gjyqësor në fjalë; dhe për të dhënë orientime të nevojshme ligjore lidhur me procedimin e aplikimit për status strategjik të projektit në fjalë.
Avokatura e Shtetit me shkresë **Nr. 2182, datë 12.06.2019** sqaroi se kundër vendimit të ATP Nr. 799 datë 13.06.2018, trashëgimtarët e subjektit pretendues si të shpronësuar Z. K Gj, i është drejtuar Gjykatës së Apelit Vlorë, me objekt gjykimi "Ndryshimin e vendimit Nr. 799 datë 13.06.2018 të ATP. Njohjen e të drejtës së pronësisë dhe kompesimin fizik në emër të trashëgimtarëve ligjorë të subjektit të shpronësuar G dhe N Gj". Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur pranimin e padisë dhe

ndryshimin e vendimit Nr. 799 datë 13.06.2018 të ATP si vijon: Njohjen e së drejtës së pronësisë së subjekteve të shpronësuara G dhe N Gj mbi pasurinë e llojit kullotë, me sipërfaqe 144.832 m2 të ndodhur në vendin "Perrar", fshati Vuno Bashkia Himarë dhe pasurisë e llojit kullotë e ndodhur në vendin "Kakariq" fshati Vuno, Bashkia Himarë, me sipërfaqe 5600m2. Kompesimi fizik brenda pronës së njohur në favor të trashëgimlënësve të subjektëve të shpronësuar G e N Gj, në masën 142.879 m2 të ndodhur në vendin e quajtur "Perrar", Vuno, Bashkia Himarë ndarë në parcela si vijon: Parcela SI me sip 24.291 m2, S2 me sip 99.027 m2, S3 me 11.462 m2, S4 me sip. 8.099 m2, pasqyruar në planimetrinë nr.6 e cila bëhet pjesë e këtij vendimi gjyqësor.
Avokatura e Shtetit, e cila ka përfaqësuar këtë cështje në gjyq me shkresën Nr. 397/1 datë 05.04.2019, brenda afatit ligjor ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë Tiranë, ku është kërkuar prishja e vendimit Nr. 18 datë 12.02.2019 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe kthimin e cështjes për rishqyrtim pranë Gjykatës së Aplelit Vlorë me tjetër trup gjykues.
Avokatura e Shtetit me shkresën Nr. 1064/2 datë 16.04.2019 ka paraqitur pranë Gjykatës së Lartë kërkesën për pezullim ekzekutimi të vendimit Nr. 18 datë 12.02.2019, të Gjykatë së Apelit, Vlorë.
Gjykata e Lartë me vendimin e saj Nr. 246 datë ***23.04.2019 ka vendosur pezullimin e ekzektutimit të vendimit Nr. 18 datë 12.02.2019 të Gjyktës së Apelit Vlorë, derisa të shprehet me vendim përfundimtar gykata.***
Rekursi i ushtruar nga Avokatura e Shtetit kundërt vendimit Nr. 18 datë 12.02.2019 të Gjykatë së Apelit Vlorë, është akoma pa u shqyrtuar nga Kolegji Civil i Gjykatë së Lartë, Tiranë, në këtë kushte Avokatura e Shtetit është në pamundësi për të dhënë një mendim në lidhje me pronësisë objekt gjykimi deri në dhënien e vendimit nga Gjykata e Lartë.
Subjekti ka vënë në dispozicon një vërtetim të Gjykatës Administrative të Apelit, ku është administruar cështja civile me Paditës ishte T Dh dhe i pa ditur Shoqëria "S& S", ALUIZNI Vlorë, .rdit B dhe Person i tretë: Avokatura e Shtetit dhe Zyra Vendore, Vlorë, me Objekt: "1. Shfuqizimin pjesërisht të lejes së legalizimit Nr. 106707, datë 10.02.2017" për sipërfaqen e pasurisë prej 1800m2 në pronësi të paditësit. 2. Fshirjen nga regjistri i pasurive të paluajtshme në ZVRPP Vlorë, të pasurisë së legalizuar me lejen Nr. 106707, datë 10.02.2017 në emër të të padituri "S & S" shpk".
Gjithashtu, në Gjykatën Adminsitrative të Apelit është shqyrtuar cështja me Paditës Shoqëria "S & ea", i Paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, Komisioni për shqyrtimin e Apelimeve Tatimore pranë MFE, me Objekt: "1. Dekalarimin absolutisht të pavlefshëm të të dy akteve të konstatimit të mbajtur nga pala e paditur DRT, Vlorë. 2. Shfuqizimin e akteve administrative: Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore Nr. 38253 date 19.07.2017 nxjerrë nga DRT, Tiranë, lënë pjesërisht në fuqi me Vendimin e Komisionit për Shqyrtimin e Apelimit Tatimor Nr. 3, datë 16.10.2017 për detyrimet në shumën 5.009.121 lekë"

Avokatura e Shtetit konstaton si problematike në shkresën e nisur se: "Duke qenë se një ndër masat mbështetëse që kërkon subjekti është *konsolidimi i tokës dhe vënia në dispozicion të realizimit të projektit e disa parcelave në ZK. 3844*, AIDA në cilësinë e sekretaritit teknik asiston Ministrin përgjegjës për ekonominë, i cili në bazë dhe zbatim të VKM Nr. 1030, datë 16.12.2015, Kreu II, pika 7, ka të drejtën të kërkojë informacion vërtetues organeve shtetërore me qëllim shqyrtimin e dokumentacionit të dosjes së pasurive të paluajtshme duke verifikuar nëse këto prona janë:
a) objekt i procedurave administrative të kthimit ose kompensimit të pronës;
b) objekt i një procesi gjyqësor për titullin e pronësisë;
c) objekt i procedurave administrative të legalizimit.
Referuar përgjigjeve të shkresave të më sipërme, jemi informuar zyrtarisht se:

- për sipërfaqen në të cilën synohet të zhvillohet i gjithë projekti, ZK. Nr. 3844, nuk ka filluar ende procesi i rregjistrimit fillestar;
- për një pjesë të sipërfaqes së tokës, subjekti është i pajisuar me leje legalizimi, ndërkohë pronësia mbi tokën i ka kaluar sipas VKM Nr. 810, datë 29.12.2017.
- Nga drejtoria e ALUIZNI-t Vlorë, informohemi gjithashtu se është në proces edhe miratimi i një vendimi tjetër të Këshillit të Ministrave për kalim pronësie mbi tokën në favor të subjektit të interesuar;

- Njëkohësisht, nga ATP njoftohemi se ka një sipërfaqe të njohur me Vendim Gjyqësor Nr. 549, datë 02.03.2009, Z. G. Gj, në ZK 3844, për një sipërfaqe prej 169,600 m2 në fshati Vuno, vendi Perrar dhe një sipërfaqe prej 5,600 m2 në Kakariq.

Duke qenë se sipërfaqet të cilat njihen nga vendimi gjyqësor mbivendosen me sipërfaqet që janë trajtuar me leje legalizimi dhe kalim pronësie sipas një Vendimi të Këshillit të Ministrave, rezultoi se:
Zona 1

Subjekti është i pajisur me leje zhvillimi, e cila përfshin të 3 zonat që synon të investojë

Në zonën 1 subjekti është pajisur me leje legalizimi nga Aluizni Vlorë ndërkohë pronësia mbi tokën i ka kaluar sipas VKM Nr. 810, datë 29.12.2017.

Nga verifikimi kadastral qe kreu AIDA rezulton se ka një Vendim i ATP ku njoftohemi se ka një sipërfaqe të njohur me Vendim Gjyqësor Nr. 549, datë 02.03.2009, Z. G. Gj, në ZK 3844, për një sipërfaqe prej 169,600 m2 në fshati Vuno, vendi Perrar dhe një sipërfaqe prej 5,600 m2 në Kakariq. ATP në vendimin e saj rrezon kërkesën e subjektit dhe nuk i njeh të drejtën e pronësisë subjekti të pretenduar si i shpronësuar.

Duke qenë se sipërfaqet të cilat njihen nga vendimi gjyqësor mbivendosen me sipërfaqet që janë trajtuar me leje legalizimi dhe kalim pronësie sipas një Vendimi të Këshillit të Ministrave, çështje e cila është objekt i një procesi gjyqësor ku Avokatura e Shtetit është e përfaqësuar, AIDA iu drejtua me shkresë zyrtare Avokatit të Përgjithshëm i Shtetit, si anëtar i Komitetit të Investimeve Strategjike, ku iu kërkua bashkëpunim:

- për të na vënë në dispozicion informacione më të plota lidhur me procesin gjyqësor në fjalë;
- orientime të nevojshme ligjore lidhur me procedimin e aplikimit për status strategjik të projektit në fjalë.

Avokatura e shtetit na sqaroi se Vendimi i ATP ishte ankimuar në Gjykatën e Apelit Vlorë. Gjykata Apelit Vlorë e ka pranuar padinë dhe ka kërkuar ndryshimin e vendimit të ATP, duke i njohur të drejtën e pronësisë subjekti të pretenduar si i shpronësuar.

Avokatura e Shteti brenda afateve ligjore ka realizuar Rekurs në Gjykatën e Lartë me objekt "Kërkesë për pezullim ekzektutimi vendimi, per vendimin e Gjykatës Administrative Vlorë." Gjykata e lartë ka vendosur pezullimin e ekzektutimit të vendimit të Gjyktës së Apelit Vlorë, derisa të shprehet me vendim përfundimtar gykata.

Meqenese Rekursi është ende në fazë shqyrtimi, Avokatura e Shtetit është shprehur se është në pamundësi për të dhënë një mendim në lidhje me pronësisë objekt gjykimi deri në dhënien e vendimit nga Gjykata e Lartë.

Zona 2

Subjekti është pajisur me Vendim të KKT, Nr. 26 datë 16.10.2017 me "Leje Zhvillimi për objektin "Kompleks turistik, hoteleri dhe shërbime, me vendndodhje në Jalë, Bashkia Himarë"" dhe Leje Ndërtimi Nr. 887/10, datë 21.09.2018. "Resort Turistik "S. 2", me vendndodhje në Jalë, Bashkia Himarë", sipas Vendimit Nr. 14, datë 27.04.2018 të Këshillit Kombëtar të Territorit.

Ndërkohë subjekti është pajisur me leje ndërtimi vetëm për zonën 2. Pronësinë mbi tokën subjekti e ka fituar me VKM.

Zona 3

Subjekti ka paraqitur një vërtëtim nga Gjykata Administrative Apelit nga ku rezulton se subjekti S. është në një proces gjyqësor, ku paditës ishte T. Dh dhe i pa ditur Shoqëria "S & S", ALUIZNI Vlorë, A. B dhe Person i tretë: Avokatura e Shtetit dhe Zyra Vendore, Vlorë, me Objekt: **"***1. Shfuqizimin pjesërisht të lejes së legalizimit Nr. 106707, datë 10.02.2017" për sipërfaqen e pasurisë prej 1800m2 në pronësi të paditësit. 2. Fshirjen nga regjistri i pasurive të paluajtshme në ZVRPP Vlorë, të pasurisë së legalizuar me lejen Nr. 106707, datë 10.02.2017 në emër të të paditurit "S & S" shpk".*

Meqënese zona 1 dhe zona 3 ndodhen aktualisht në proces gjyqësore, çështja ka ngecur edhe në AZHT, pasi AZHT nuk mund të japë leje ndërtimi nëse prona nuk është e pastër dhe ka problematika.

Nga ana tjetër Avokatura e Shtetit nuk shprehet me procedimin e aplikimit për status strategjik të projektit në fjalë, pasi çështja është në proces gjyqësor ne Gjykatë të Lartë.

Zona 4

Referuar ZVRPP Vlore e gjithe zona kadastrale ZK 3844, Vuno, Vlorë është zonë që nuk i është nënshtruar regjistrimit fillestar sistematik, pra ZVRPP Vlore nuk dispono një hartë ligjore të miratuar dhe si rrjedhojë nuk mund të na vënë në dispozicion statusin juridik të zones.

Vlerësimi përfundimtar nga grupi operacional

Në bazë dhe zbatim të legjislacionit të investimeve strategjike, specifikisht Nenit 21 dhe Neni 22 të Ligjit Nr.55/2015**,** masat mbështetëse që mund t'i ofrohen investitorit në rastin e procedurës së veçantë janë:

Neni 21

Pas marrjes së vendimit për dhënien e statusit "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar", investitori, nëpërmjet "dritares unike" (Agjencia), mund të përfitojë, në përputhje me parashikimet e këtij ligji, shërbime dhe lehtësi të llojit:

a. kryerje e veprimeve përgatitore, përgatitje e dokumenteve dhe aplikim administrativ

b. me procedurë të përshpejtuar nga agjenti asistues, përfshirë dokumentet e nevojshme që shoqërojnë aplikimin, kur ato lëshohen nga një organ i administratës shtetërore, me kërkesë të një organi tjetër të administratës shtetërore;

c. trajtim me prioritet të përgatitjes së dokumentacionit, dhënies së mendimeve apo ndjekjen e procedurave, të cilat përfshihen në fushën e veprimtarisë së organeve të administratës shtetërore, të përfaqësuar në grupin operacional, për përgatitjen dhe realizimin e investimit strategjik;

d. konsolidim i tokës;

e. programe mbështetëse;

f. mbështetje me infrastrukturë ndihmëse;

g. vënie në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore për zhvillimin dhe realizimin e projekteve investuese strategjike, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 22

Pas marrjes së vendimit për dhënien e statusit "Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë", investitori mund të përfitojë, në përputhje me parashikimet e këtij ligji, përveç sa parashikohet në ***nenin 19****, të këtij ligji, shërbime që kanë të bëjnë me:*

a) shpronësimin e pasurive të paluajtshme, pronë private, për të mundësuar zhvillimin dhe realizimin e projekteve investuese strategjike;

b) miratimin nga ana e Kuvendit, kur vlerësohet nga Këshilli i Ministrave, të kontratave përkatëse të investimit strategjik, me kërkesë të investitorit strategjik për të rritur sigurinë e marrëdhënies juridike të rregulluar përmes tij dhe shtetit shqiptar

Ndërkohë, neni 19 citon: Rastet e revokimit të vendimit për dhënien e statusit "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë"

Në rast se përgjatë përgatitjeve, zhvillimit dhe zbatimit të projektit investues strategjik, Komiteti i Investimeve Strategjike konstaton dhe vërteton se në projektin investues ka të dhëna të pavërteta apo ndryshim të të dhënave të dala rishtazi, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për përfshirjen e këtij projekti në procedurën e asistuar/e veçantë, Komiteti i Investimeve Strategjike revokon vendimin për dhënien e statusit "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë".

Vlerësimi i kritereve ligjore të aplikimit nga grupi operacional është miratuar se subjekti plotëson kriteret ligjore.

Vlerësimi i kapacitetit financiar

Ministria Financave dhe Ekonomisë vlerëson me **PO me kusht**

Shoqeria S & S ka nje kapital prej 2,700,867 leke me nje aktivitet ne sipermarrje turistike, nepermjet hapjes se hoteleve, fshatrave turistike etj. Referuar shkreses se datesd 15.05.2019. Dorezimi i dokumentave shtese" rezulton se shoqeria S & S ka nje bilanc pozitiv me nje vlere 1,226,160 leke ne vitin 2016 dhe me rritjë të ne kete periudhe. Edhe për vitin 2017 ka nje bilanc pozitiv me vlere 1,464,707 leke. E njejta situate eshte per vitin 2018 me nje bilanc pozitiv prej 1 729 032 leke si dhe me shtim te aktiveve. Gjithashtu edhe kompania partnere Joni 5 me NIPT L21926005F me aktivietet

ne fushen e bareve dhe restoranteve ka nje bilanc pozitiv i cili ne vitin 2017 rezultone me nje kapital prej 100 000 leke dhe me bilanc pozitiv prej 118 437 leke, ndersa per vitin 2018 rezulton me nje bilanc pozitiv prej 1 693 727 leke dhe me nje vlere ne rritje te aktiveve. Referuar shkreses nr. 1435, date 10.05.2019 te Drejtorise se Pergjithshme te Tatimve Kompania S & S rezulton me nje detyrim total (gjoba) prej 3 419,707 leke nga te cilat

a. 1,500,000 leke jane kontribute per sigurimet shoqerore dhe shendetesore
b. 1,659,707 leke jane per tatimin m,bi vleren e shtuar
c. 260,000 leke jane denime pa tatime

Gjithashtu me shkresen nr. 11405/1, date 09.05.2019 te Drejtorise se pergjithshme te Doganave rezulton te jete debito ndaj Doganes Kapshtice ne shumen toale prej 520,914 leke paperfshire kamatevonesat.

Përfaqësuesit e MFE shprehen pro Statusit Strategjik me kusht per shlyerjen e detyrimeve qe ka ndaj Tatimeve dhe Doganave ose me paraqitjen e nje vendimi Gjykate qe subjekti nuk ka detyrime ndaj tatime dhe doganave.

Nga auditimi i dokumentacioneve financiare të vëna në dispozicion grupit të auditimit, nga të dhënat financiare të shoqërisë konstatohet:

Projekti i miratuar "J. E. P", është deklaruar nga investitori që do të kap një vlerë investimi 67 milion euro (vendimi 20/5, datë 01.08.2019 të KIS), bazuar në pjesën financiare të Raportit të Vlerësimit nga grupi Operacional i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), nuk mund të vlerësohet mënyra e financimit të parashikuar në shumën prej 67 milion euro. Në fakt në dosje ekziston vetëm një konfirmim bankar me nr. 19064 prot. Datë 29.03.2019, lëshuar nga divizioni I zhvillimit të biznesit, nga zv/drejtori i këtij divizioni i bankës "C" sha, ku *konfirmon se shoqëria "S & S" përfaqësuar nga z. A. B, është klient I konsideruar me reputacion të mirë për bankën dhe se banka "C" është e gatshme të financojë cdo kërkesë të këtij klienti, me kusht që nga ana e shoqërisë të përmbushen kriteret e parashikuara në politikat e kredidhënies*.

Pra nuk ka asnjë plan konkret se si ky investitor ka siguruar burime të besueshme financiare për këtë investim kur në fakt bilancet financiare të të dy kompanive nuk paraqesin kapitale apo të ardhura të cilat mund të justifikojnë ndërmarrjen e investimeve të tilla. Shoqeria S & S ka nje bilanc pozitiv me nje vlere 1,226,160 leke ne vitin 2016 dhe me rritjë të ne kete periudhe. Edhe për vitin 2017 ka nje bilanc pozitiv me vlere 1,464,707 leke. E njejta situate eshte per vitin 2018 me nje bilanc pozitiv prej 1 729 032 leke si dhe me shtim te aktivevepor gjithashtu rezulton se detyrimet afatgjata (huamarrje afatgjata) janë në vlerë të konsiderueshme . Në dosje nuk ka asnjë marrëveshje konkrete me banka të cilat kanë studiuar një plan biznesi të tillë dhe kanë marrë një vendim pozitiv angazhimi për të mbështetur financimin e projektit. Kjo dhe për faktin se tashmë kompania rezulton si subject huamarrës referuar bilancit të vitit 2018 në shumën 653,885,039 lekë në fund të periudhës.

Gjithashtu nga dokumentacioni rezulton se ky investitor ka detyrime të papaguara pranë tatim taksave kryesisht në fushën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore si dhe tatim mbi vlerën e shtuar, të cilat cënojnë besueshmërinë e subjektit përgjatë veprimtarisë së tij, në përputhje sipas kërkesave të pikësë 4. të Ligjit Nr.55/2015 e cila parashikon "Përveç sa parashikohet në pikën 3, të këtij neni, për realizimin e projektit, subjekti investues, për procedurën e asistuar/e veçantë në momentin e aplikimit dhe/ose të kontratës, në rastet kur sipas ligjit të aplikueshëm nënshkruhet një e tillë për partneritetin publik privat me shtetin shqiptar, duhet të paraqesë të dhëna financiare, të cilat provojnë aftësinë e tij për përmbushjen e garancive financiare për realizimin e investimit, në masën jo më pak se ***10 për qind të vlerës së investimit***." E cila në fakt nuk rezulton se plotësohet nga subjekti.

Si dhe në përputhje me nenin 3 Paraqitja e projektit dhe dokumentacioni përkatës 1. Subjekti investues i interesuar, në zbatim të këtij ligji, i cili kërkon përfshirjen e projektit investues në procedurat administrative të investimeve strategjike, me qëllim marrjen e statusit "Investim/ investitor strategjik, procedurë e asistuar", apo "Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë", duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim pranë Agjencisë, duke i bashkëlidhur dokumentacionin e mëposhtëm: 9 a) planin e biznesit të investimit, planin e financimit të investimit dhe programin e punës për realizimin e projektit/investimit strategjik; b) vlerësimin e ndikimit social dhe ekonomik e strategjik të projektit; c) listën me të gjitha incentivat dhe kërkesat për mbështetje dhe shërbime që

subjekti investues kërkon nga shteti shqiptar për realizimin e projektit investues; **ç) dokumentacionin që provon kapacitetet financiare për realizimin e projektit investues, si mënyrë garancie për zbatimin dhe zhvillimin e projektit në fjalë, sipas kërkesave të nenit 8, të këtij ligji**;

Vlerësimi i kritereve teknike

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit rekomandon pozitivisht projektin dhe është Pro Statusit Strategjik me kushtin që subjekti duhet të aplikojë për VNM paraprake.

- **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Sektori i Administrimit te Tokave, Inspektoriati Shteteror i Tokes, shprehet se nuk mundet të jap një rekomandim,** në lidhje me vendimin përfundimtar, në lidhje më miratimin apo jo të statusit strategjik sepse në materialin e ardhur nga subjekti "S & S" sh.p.k nuk jepet informacion i saktë mbi statusin juridik, të prones objekt i zhvillimit të invenstimit "J. E. P ' me aplikues S & ea sh.p.k,. kete e konfirmon:

1**. Bashkia Himarë** me shkresën e saj nr 767/2, date 3.4.2019 drejtuar AIDA thekson që:

- Realizimi i kompleksit turistik ndodhet në vendin me emërtim popullor "Jalë" të cilin është zbatuar ligji nr 7501, datë 19.7.1991 " Për tokën" , i ndryshuar, ku një pjesë e fermerëve janë trajtuar me tokë.
- Bashkia Himarë, disponon 24, fotokopje te formularit nr. 6, dhe 2 fotokopje të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi, në vendin me emërtim popullor"Jalë" ku do të kryhet investimi " J. E. P.", me subjekt aplikues S. & S shpk NIPT L21926005F
- Në zonën kadastrale 3844, ku do të kryhet investimi nuk është kryer procesi i regjistrimit fillestar dhe nuk bashkia nuk disponon Harta Treguese të pronave.

2. **Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës**, pranë Këshillit të Qarkut Vlorë me shkresën nr. 602/02, datë 1.4.2019 drejtuar AIDA thekson që:

-Në zbatim të ligit nr 7501, datë 19.7.199 "Për tokën" i ndryshuar, ekzistojnë formularët nr.6, të pronësisë analitike të fermerëve për fshatin Vuno.

-DAMT Vlorë për të dhënë informacion mbi statusin juridik të pasurive tokë bujqësore sipas ligjit nr.8752, datë 26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës" i ndryshuar, ka kërkuar vënien në dispozicion të planvendosjeve grafike të 4 zonave pr zhvillim si dhe numrat kadastralë të parcelave. Kërkesa e DAMT është përsëritur dhe nga MBZHR, por nuk është realizuar nga subjekti.

3. Qeveria shqiptare, në bashkëpunim me 61 Bashki, ka filluar nismën ligjore për ta kthyer tokën si një nga prioritetet kryesore të Qeverisë, për t'i dhënë fund procesit të regjistrimit të tokës bujqësore, përfituesve në territoret e fermave shtetërore dhe kooperativave bujqësore, konform legjislacionit në fuqi:

-Ligji nr. 171/2014 "Për përfundimin e procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", i ndryshuar dhe akteve në zbatim të tij.

-Nenit 17/1, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", i ndryshuar dhe akteve në zbatim të tij.

Në bashkinë Himarë, janë gjithsej 525, kërkesa të bëra nga familjet bujqësore për 1455 AMTP, nga ku 11 familje jane nga fshati VUNO. Ky proces në Bashkinë Himarë dhe disa bashki të tjera është pezulluar referuar VKM nr 138, datë 23.2.2018 Bashkia Himare duhet të konfirmoje që sipas pikes 3 te VKM nr 138/2018, të ndryshuar, pasuritë që preken nga zbatimi i këtij projekti janë në territori në hartën e këtij vendimi, janë në zonën me rëndësi për fondin e mbështetjes së investimeve strategjike, pavarësisht nga faza procedurale, menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

Sa më sipër MBZHR nuk shpreh rekomandimin pa patur një informacion të saktë mbi statusin juridik të pronave ku do zhvillohet ky projekt.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë rekomandon pozitivisht projektin dhe është Pro Statusit Strategjik me kushtin nëse merren në konsideratë kërkesat e paraqitura.
- Bashkia Himarë rekomandon pozitivisht projektin dhe është Pro Statusit Strategjik projekti pëputhet me kriteret mjedisore të zonës; projekti është në përputhje me PPV Bashkia Himarë dhe dokumentet e tjerë të planifikimit të teritorrit. Ky investim do te rrisë numrin e të punësuarve, do të ofroje shërbime cilesore për turizmin vendas dhe të huaj. Brenda këtij kompleksi duke u bazuar në numrin e

aktiviteteve të hapura në funksion të plotësimit të aktivitetit te tij, bëhet burim i konsiderueshëm taksash për pushtetin vendor. Gjithashtu projekti do të sjellë zhvillimin e zonës dhe turizmin si qëllim prioritar i pushtetit vendor.

Përmbledhje:

Potenciali strategjik i projektit	Rekomandohet PO
Kapaciteti financiar	Rekomandohet PO
MTM	Rekomandohet PO me Kusht
MIE	Rekomandohet PO me Kusht
MBZHR	**Nuk mund të shprehet**
Bashkia Himarë	Rekomandohet PO

Nga sa më sipër bazuar në Ligjit Nr. 55/2015, "*Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë*", referuar VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 "*Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike*", *referuar të gjithë trajtimit të mësipërm dhe bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se subjekti "S & S", për investimin strategjik "J. E. P", nuk ka plotësuar kushtet, kapacitetet dhe kriteret e kërkuara nga legjislacioni në fuqi për miratimin e statusit të investorit strategjik.*

Për sa trajtuar më sipër , nga grupi i auditimit është mbajtur Akt Konstatimi nr. 3 më datë 22 .11.2019 me personat e mëposhtëm.

Përfaqësuesit e AIDA-së: Drejtori Ekzekutiv S. N, dhe specialistet G. C, L. S,si dhe Përfaqësuesit e Grupit Operacional:*A. C. – MIE,B. L – MIE, N. B. – MBZHR,M. Sh. – MZHBR-(përfaqësuesit e MBZHR kanë refuzuar dhenie mendimi),E. S. – MTM,E. S. – AKZM,A. V. – MFE,E. T – MFE,G. S. – Bashkia Himare,J. Gj. - AKUM .*

Për sa trajtuar më sipër nga Titullari i Agjencisë AIDA përpos sqarimeve lidhur me rolin si Sekretariat teknik të cilin në fakt nga grupi i auditimit është trajtuar qartësisht në akt roli dhe përgjegjësi ligjore e ndarë nga subjektet e tjera të trajtuar përgjatë materialit.

Për sa ju shtroni kërkesën për sqarime lidhur me:"*Referuar në sa më sipër, lutemi për sqarime të mëtejshme nga ana juaj:*

1. *Referenca e saktë ligjiore se ku bazohet auditimi juaj;*
2. *Arsyetime të dejatuara ligjore/proceduriale dhe teknike se ku bazohet konstatimi juaj se projekti strategjik "J. E. P." nuk ka plotësuar kushtet, kapacitetet dhe kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për miratimin e statusit investitor strategjik;*
3. *Orientimin e qartë të aktit tuaj të konstatimit, pasi në akt konstatimi vlerësoni të gabuar vendimin për miratimin e statusit strategjik, por i'a komunikoni këtë konstatim sekretariatit teknik dhe grupit operacional, struktura të cilat nuk kanë tagër vendimarrjeje.*

Përgjigja e grupit të auditimit:

Lidhur me pyetjen e parë është e qartësuar saktësisht në programin e auditimit.

Lidhur me pyetjen e dytë sërisht përgjatë materialit është i argumentuar cdo konkluzion i yni,mbi dokumentacionin që na u vu në dizpozicion nga ana Juaj.

Lidhur me pyetjen e trete, jeni ju sekretariati teknik i cili ka për detyrë pregatitjen e dosjes për miratim jo vetëm fizikisht por duke vlerësuar cdo dokument të paraqitur tek ju.

IV. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Në përfundim të auditimin rezultuan gjetje me rekomandimet përkatëse si më poshtë vijon:

A. OPINIONI I AUDITIMIT:

Opinion mbi përputhshmërinë(i pakualifikuar)

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Agjencisë së Zhvillimit të Investimeve në Shqipëri(AIDA), me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor,të AIDA-s rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

Mbështetur mbi punën audituese në përfundim rezultoi se, në opinionin tonë, aktiviteti i AIDA-s, me përjashtim të çështjeve të trajtuara përgjatë këtij projektraporti auditimi,në bazën e opinionit të pakualifikuar, është në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e vlerësimit, si dhe me parimet dhe rregullat e aplikueshme.

Baza për opinionin e përputhshmërisë

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs) mbështetur në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 "Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë". Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.208, të Kryetarit të KLSH-së.

Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve,duke vlerësuar materialitetin, risqet dhe kampionin e transaksioneve me kriteret e parashikuara.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti AIDA, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), bazuar në procedurat e kryera dhe evidencën e përftuar u evidentuan në përgjithësi zbatimi i tyre dhe nuk ka raste mospërputhjesh materiale për të raportuar *(Përjashtuar dokumentacionin e përgatitur për dhënien e statusit të "Investim/Investitor Strategjikë procedurë e veçantë" për projektin e investimit strategjik "J. E. P")*. Auditimi i përputhshmërisë në AIDA është kryer bazuar në kriteret e auditimit të përputhshmërisë dhe audituesit nën gjykimin profesional e të pavarur japin opinion të pakualifikuar,kur nuk rezultojnë devijime materiale mbi nivelin e materialitetit të llogaritur sipas Aneksit.1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, për të cilën japim **Opinion të pakualifikuar**[2].

Opinion mbi pasqyrat financiare (I pakualifikuar)

Ne audituam pasqyrat financiare të AIDA-s më datë 31.12.2018, të cilat përbëhen nga Bilanci, Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, Pasqyra e Fluksit të Arkës, dhe Pasqyra e Lëvizjes së Kapitalit si dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat.

Në opinionin tonë, veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike, përfshirë rregullat për prokurimet dhe ato të buxhetit. Megjithatë, nga auditimi i pasqyrave financiare, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Standardin ISSAI 1700, u konstatuan edhe anomali në plotësimin e pasqyrave financiare me devijanca të evidentuara përgjatë projektraportit të auditimit, por të cilat nuk konsiderohen materiale duke e krahasuar me pragun e llogaritur të tij prej 2%, ku në shumicën e tyre janë nga mosnjohja e stafit të AIDA-s të rregullave dhe standarteve të ndërtimit të pasqyrave financiare .

të konsideruara *jo* ***materiale, dhe jo të përhapura****, për të cilën japim* **opinion të pakualifikuar**[2]

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin *"Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare"*, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 1700 "Standardi i Auditimit të Financiar". Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.208, të Kryetarit të KLSH-së. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e **opinionit të pakualifikuar të auditimit.**

B.MASA ORGANIZATIVE:

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit, të vënë në dispozicion për miratimin dhe dhënien e statusit "Investim/Investitor Strategjikë procedurë e veçantë" për projektin e investimit me potencial strategjik "J. E. P"konstatohet se: bazuar në gjithë në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se subjekti "oleil & S", nuk ka plotësuar kushtet, kapacitetet dhe kriteret e kërkuara nga legjislacioni në fuqi për miratimin e statusit të investitorit strategjik, për projektin e paraqitur si investimin strategjik "J. E. ark".Ky konkluzion arrihet pasi,me Vendimin nr. 20/5, date 01.08.2019 të Komitetit të Investimeve Stategjike, i cili është organi administrativ kolegjial pranë Këshillit të Ministrave, në përbërje të të cilit është Kryeministri, në rolin e Kryetarit të KIS-s dhe anëtarë zv/Kryeministri, Ministri i MFE, Ministri i MIE, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Ministri i MBZHR dhe Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga Sekretariati Teknik(AIDA) dhe raportit të vlerësimit të përgatitur nga Grupi Operacional me përbërje nga specialist të ministrive të linjës, ka dhënë miratimin e statusit të mësipërm ndërkohë që rezulton se përgjatë procesit të mbledhjes së dokumentacionit kërkuar zyrtarisht nga AIDA, ky dokumentacion nga një sërë institucionesh është paraqitur me të dhëna dhe dokumente të cilat nuk janë në përputhje me statusin reale të pronës, janë paraqitur në mënyrë kontradiktore, i pavërtetë dhe në shkelje të ligjit, *më hollësisht trajtuar në faqet 39-79 të Raportit përfundimtar të Auditimit.*

1.1.Rekomandimi:

-AIDA në rolin e sekretariatit teknik përgjatë procesit të mbledhjes së dokumentacionit në bazë të procedurave të miratuara për shpalljen e dhe përfitimin e statusit të Investitorit Strategjik përpara përgatitjes së relacionit përmbledhës i cili i paraqitet Komitetit të Investimeve Strategjike duhet të shqyrtojë me përgjegjshmëri çdo të dhënë të paraqitur nga institucionet e çdo sektori dhe nëse ato kanë të dhëna kontradiktore,duhet të thellohet në procesin e vlerësimit të këtyre dokumenteve me qëllim dhënien e një pasqyre të qartë dhe reale të projekteve të propozuara nga pala investitore.

Në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: *Nga auditimi i Planifikimit të buxhetit, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të shtetit dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar konstatohet se*; për periudhën objekt auditimi, mungojnë raportet periodike katër mujore për monitorimin e buxhetit të vitit 2018 si dhe katër mujori i parë i vitit 2019.

Raportet e monitorimit të buxhetit për vitin 2018 dhe tetë mujorin e vitit 2019, nuk janë të plotësuara me një informacion të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, në kundërshtim me kreun IV

[2]- Sipas ***Manualit të Auditimit Financiar*** të KLSH-së, kapitulli IV, pika 4.2, "Opinioni me rezerve" do të jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Nëse efekti financiar i paqartësisë apo i mosmarrëveshjes është i përcaktuar si shumë nga audituesi, ndonëse nuk është gjithmonë e praktikuar ose e përshtatshme, atëherë kjo do të shërbente si ndihmë për përdoruesit e pasqyrave.

"Monitorimi", të Udhëzimit nr. 9, dt. 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimin e buxhetit" të Ministrisë së Financave si dhe udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore", ku citohet se " Raporti i monitorimit i përgatitur nga institucionet duhet te përmbajë:

- Shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli;
- Shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë;
- Argumentet që lidhen me mosrealizimin e produkteve duke paraqitur masat që parashi-kohen në të ardhmen për realizimin e tyre, si edhe analiza e kostos së produkteve, duke paraqitur shpjegimet përkatëse në rastin e kostove shtesë të realizuara;

Në raportet e monitorimit mungojnë argumentet e plota në lidhje me mosrealizimet dhe masat që parashikohen në të ardhmen për realizimi e tyre. AIDA nuk ka bërë publikimin e raporteve të monitorimit në faqen zyratare. *(Trajtuar më hollësisht trajtuar në faqet 9-14 të Raportit përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandimi:

-AIDA të marrë masa që për periudhën në vijim, Raportet e monitorimit të buxhetit të hartohen me një informacion të plotë si dhe me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në kundërshtim me kreu II, nenet 8, 9, kreu III neni 19 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, për vitin 2018, nuk ka hartuar "Deklaratën për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm", mbi zbatimin e sistemeve dhe komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit, për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të trasparencës, *më hollësisht trajtuar në faqet 29-32 të Raportit përfundimtar të Auditimit.*

3.1. Rekomandimi:

- Agjencia të marrë masat e nevojshme për hartimin e "Deklaratës për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm", për zbatimin e sistemeve dhe komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit, për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës në zbatim të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.

Menjëherë

4.Gjetje nga auditimi: Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, nuk ka hartuar "Kodin e Brendshëm Etik", në kundërshtim me kërkesat e nenit 20, pika 2 germa a, "Mjedisi i kontrollit" të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, dhe me Kap II, pika 2.5.1 "Mjedisi i Kontrollit", paragrafi "Integriteti dhe vlerat etike" të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financës, *më hollësisht trajtuar në faqet 29-32 të Raportit përfundimtar të Auditimit.*

4.1.Rekomandimi:

Agjencia të marrë masat e nevojshme për hartimin në të hartojë dhe miratojë "Kodin e Brendshëm Etik", në zbatim të ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin,si dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi:Në rregulloren e brendshme të institucionit, janë përcaktuar rregullat e funksionimit të brendshëm lidhur me strukturën organike, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, marrëdhëniet ndërmjet strukturave të njësisë, orarin dhe kohën e punës etj, por kjo rregullore nuk është përditësuar që nga viti 2011 duke mos ju përshtatur strukturave të ndryshuara të institucionit. Nga institucioni nuk është bërë vlerësimi vjetor i punës për çdo punonjës, i cili i bashkëlidhet dosjeve personale të punonjësve, *më hollësisht trajtuar në faqet 29-32 të Raportit përfundimtar të Auditimit.*

5.1.Rekomandimi:

AIDA të përditësojë rregulloren e brendshme dhe ta përshtasë atë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe strukturën e miratuar nga bordi drejtues si dhe të bëjë vlerësimin vjetor të punës për çdo punonjës.

Në vijimësi

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në lidhje me identifikimi i riskut, vlerësimi i riskut, adresimi i riskut dhe shqyrtimi i riskut rezultoi se, Institucioni nuk ka hartuar strategjinë për menaxhimin e riskut, në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, ku citohet se.... "Titullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut". Strategjia e riskut duhet të përcaktojë mënyrën se si do të sillet njësia ndaj risqeve dhe të vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Gjithashtu nga auditimi u konstatua se agjencia nuk ka regjistër risku.Menaxhimi i riskut është nuk vlerësuar si një proces i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut. Pas planifikimit të fondeve buxhetore, institucioni nuk ka analizuar dhe identifikuar kontrollin e risqeve, të cilët mund të venë në rrezik realizimin e treguesve buxhetore, *më hollësisht trajtuar në faqet 29-32 të Raportit përfundimtar të Auditimit.*

6.1.Rekomandimi:

Agjencia, të marrë masat e nevojshme për hartimin e strategjisë për menaxhimin e riskut si dhe regjistrin e rriskut me qëllim vlerësimin e menaxhimit të riskut si një proces i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit për realizimin e treguesve buxhetore në zbatim kjo të nenit 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

Menjëherë

7.Gjetje nga auditimi:. Agjencia, nuk ka të dokumentuar ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) për periudhën objekt auditimi, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, kreut II "Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit", neni 8, pika 8, gërma b. Njëkohësisht nuk janë ngritur ekipet për menaxhimin e programeve. Njësia nuk ka dokumentuar mbledhjet e GMS, në kundërshtim me kërkesat e nenit 27 të ligjit "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" dhe Manualin mbi zbatimin e MFK-së.

Agjencia, nuk ka hartuar pyetësorin e vetëvlerësimit për komponentët e MFK-së, në kundërshtim me Kap. V, Shtojca 2 –Pyetësori i vetë-vlerësimit për komponentët e MFK-së, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Agjencia nuk ka hartuar raportet periodike katër mujore te monitorimit të shpenzimeve buxhetore si dhe nuk ka aktive adresën zyrtare në internet, *më hollësisht trajtuar në faqet 29-32 të Raportit përfundimtar të Auditimit.*

7.1.Rekomandimi:

Agjencia, të marrë masa për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik, ekipet për menaxhimin e programeve, të hartojë pyetësorin e vetëvlerësimit për komponentët e MFK-së, raportet periodike katër mujore të monitorimit të shpenzimeve buxhetore si dhe të aktivizojë adresën zyrtare në internet

Menjëherë

8.Gjetje nga auditimi: *Nga auditimi i pasqyrave financiare* të vitit 2018 rezulton se, nga subjekti për vlerën e klientëve dhe furnitorëve nuk është dërguar letër konfirmimi për llogaritë e pagueshme, për të verifikuar nëse vlerat e tyre janë në përputhje me shënimet e kontabilitetit. Mosrakordimi me klientët dhe furnitorët mundëson edhe riskun e pagesave të parregullta, si dhe prezantimin jo të saktë e të plotë të detyrimeve në pasqyrat financiare, *më hollësisht trajtuar në faqet 24-28 të Raportit përfundimtar të Auditimit.*

8.1.Rekomandimi:

Drejtuesit e AIDA-s, sektori i financës në miratimin e pasqyrave financiare, duhet të konfirmojnë (Rakordojnë) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër me qëllim, rregullaritetin e operacioneve të origjinës së tepricave të regjistruara në kontabilitet që të sigurohet se këto operacione kanë të bëjnë me kuadrin normal të lidhjeve të furnitorit me klientin, dhe të sigurohet nëse shumat përkatëse janë transferuar në llogaritë e debitorëve sipas natyrës së operacioneve.

Të përcaktojnë rregullat që forcojnë kontrollet e brendshme lidhur me rakordimin dhe raportimin e detyrimeve për faturat e papaguara dhe raportimin e tyre në mënyrë rigoroze mbi baza mujore e vjetore, sipas përkatësisë së vitit buxhetor kur ato krijohen dhe likuidohen.

Në vijimësi

9.Gjetje nga auditimi: *Nga auditimi i pasqyrave financiare* të vitit 2018 ,konstatohet se Tepricat e llogarisë 520, "*Disponibilitete në thesar"* dhe të llogarisë 466, "*Kreditorë për mjete në ruajtje*" si llogari specifike në sektorin publik, në kredi të saj përfaqësohen të hyrat (të ardhurat) që vijnë në llogarinë e thesarit të institucioneve që në një periudhë tjetër do t'u kthehen nga kjo llogari të tretëve dhe duhet të vërtetohen me aktrakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në aktrakordim, tepricat nuk janë paraqitur dhe strukturuara sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet). *(Trajtuar më hollësisht në faqet 24-28 të Raportit përfundimtar të Auditimit).*

9.1.Rekomandimi:

Në aktrakordim me thesarin, tepricat duhet të paraqiten të strukturuara sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet. Tepricat e llogarisë 520, "*Disponibilitete në thesar*" dhe të llogarisë 466, "*Kreditorë për mjete në ruajtje*" duhet të vërtetohen me aktrakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: *Nga auditimi i pasqyrave financiare* të vitit 2018 , Formati 5 "*Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore*" është plotësuar relacioni shpjegues por nuk janë përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen për të gjitha llogaritë dhe ndonjë herë plotësimi është jo i saktë, jo në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar ku të japin informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 24-28 të Raportit përfundimtar të Auditimit).*

10.1.Rekomandimi:

Të merren masat për plotësimin e pasqyrave financiare me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare vjetore me informacion sqarues, përveç atij që paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e flukseve monetare dhe pasqyrën e ndryshimit të aktiveve. Shënimet të japin përshkrime me fjalë apo zbërthime të zërave të paraqitur në këto pasqyra apo evidentojnë problemet që mund të kenë rezultuar gjatë fazës së përgatitjes apo të paraqitjes së pasqyrave financiare vjetore, për të arritur paraqitjen e drejtë në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Në veprimtarinë e Komisionit të Inventarizimit për vitin 2019, i ngritur me Urdhrin e Titullarit të AIDA-s "Për inventarizimin e vlerave materiale", në praktikën e inventarizimit u konstatua që nuk janë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit, në kushtet ku është verifikuar ekzistenca dhe plotësia e aktiveve nga punonjësit që i kanë në ngarkim apo i kontabilizojnë ato. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Neni 22 Veprimtaritë e kontrollit, Pika 3/b dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, kreu Përgjegjësitë për inventarizimin, Pika 82. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 24-28 të Raportit përfundimtar të Auditimit).*

11.1.Rekomandimi:

-AIDA të marrë masat që në ngritjen e komisionit të inventarizimit të verifikojë dhe vërtetojë mungesën e konfliktit të interesit, për të ruajtur plotësinë e aktiveve dhe regjistrimin e duhur në dokumentet kontabël.

Në vijimësi

12.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i regjistrit të aktiveve të AIDA, u konstatua se institucioni nuk ka një regjistër të plotë të aktiveve që zotëron apo ka në administrim, në të cilin të evidentohet qartësisht data e hyrjes në institucion, amortizimi i akumuluar, amortizimi vjetor dhe vlera e mbetur, sipas formatit të rregjistrit të aktiveve. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimin nr.

30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, Kreu Rregjistri i aktiveve të njësive të sektorit publik, Pika 26, 28 dhe 30, *më hollësisht trajtuar në faqet 24-28 të Raportit përfundimtar të Auditimit.*

12.1.Rekomandimi:

-AIDA të marrë masa për nxjerrjen e një regjistri të plotë të aktiveve që zotëron, sipas llojit, grupit dhe formatit të dispozitave ligjore në fuqi në funksion të evidentimit të jetëgjatësisë së përdorimit të aktiveve nga institucioni dhe monitorimit të llogaritjes së amortizimit vjetor

Menjëherë

13.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Pasqyrave financiare të vitit 2018, konstatohet një diferencë ne shumen 310 447 lekë si rezultat i gjendjes së inventarit.Diferenca e konstatuar nuk është i shoqëruar me spjegime përkatëse mbi origjinënën e diferencës dhe nuk rezulton të jenë marrë veprime e duhura të mëtejshme. Veprimi bie në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Pika 87, "NA me të marrë dokumentacionin e inventarizimit, nxjerr urdhrin për ndjekje nga Nëpunësi Zbatues në lidhje me masat për kompensimin dhe sistemimin e diferencave të rezultuara", *më hollësisht trajtuar në faqet 24-28 të Raportit përfundimtar të Auditimit.*

13.1.Rekomandimi:

-Nga AIDA të merren masat e mëtejshme për analizimin e vlerës origjinën e diferencës dhe të marrë veprimet e duhura të mëtejshme në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Pika 87, "NA me të marrë dokumentacionin e inventarizimit, nxjerr urdhrin për ndjekje nga Nëpunësi Zbatues në lidhje me masat për kompensimin dhe sistemimin e diferencave të rezultuara".

Menjëherë

14.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se AIDA nuk ka kryer procesin e inventarizimit përpara mbylljes së llogarive vjetore për vitin 2018, në bazë të të cilit të evidentohej gjendja fizike e aktiveve dhe krahasimi i tyre me gjendjen kontabël. Ndërsa për vitin 2019 procesi i inventarizimit nuk është kryer përfundimisht. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar Neni 7, Pika 1 dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeversijes së përgjithshme", Kreu 3.1, Pika 30, *më hollësisht trajtuar në faqet 24-28 të Raportit përfundimtar të Auditimit.*

14.1.Rekomandimi:

-AIDA të marrë masat që përpara raportimit të pasqyrave financiare të institucionit, të bëjë rakordimin e gjendjes fizike me gjendjen kontabël, në funksion të ruajtjes dhe mbrojtjes së aktiveve në pronësi të saj.

Në vijimësi

"*Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi*"

GRUPI I AUDITIMIT

1.M **LL**,
2.A **K**,
3.M **LL**
4.K. **F**

ANEKSI 1: MBI VLERËSIMIN E RISKUT.

Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (*analiza),* me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm morëm dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ja nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve.

- U krye planifikimi dhe identifikimi i riskut të auditimit. Njohja me subjektin që auditohet për të kuptuar të gjithë elementët e mjedisit të kontrollit. U identifikuan dhe vlerësuan zonat kryesore të llogarisë dhe shënimeve shpjeguese për të përcaktuar pohimet kryesore të auditimit në bazë të materialitetit të përcaktuar.
-U përcaktua strategjia dhe vlerësimi i riskut duke identifikuar klasat e transaksioneve dhe kontrolleve kyçe. Kuptimi i proceseve të rrjedhjes së punës dhe kontrollet bazë të aplikuara. U përcaktuan kontrollet kryesore për tu testuar dhe vlerësimi paraprak i kombinuar i riskut (*i rishikuar përgjatë gjithë punës audituese*). U përcaktuan testet e kontrolleve dhe testet thelbësore të auditimit që do të kryhen në bazë risku.
- U ekzekutuan procedurat e testimit si testimi i funksionimit të kontrolleve kryesore të entitetit, përfshirë zbatimin e kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe saktësia e veprimeve rregulluese dhe mbyllëse për paraqitjen e pasqyrave financiare.

ANEKSI 2: SQARIM RRETH LLOJEVE TË NDRYSHME TË OPINIONEVE TË APLIKUARA NGA KLSH.

A. Audituesi duhet të shprehë një **opinion të pamodifikuar** mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve kur audituesi konkludon se, transaksionet përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator që zbatohet për transaksione të tilla.
1. Një **opinion i pakualifikuar** (pa rezervë) jepet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se:

(a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi;
(b) pasqyrat janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse;
(c) situata e paraqitur nga pasqyrat financiare është në përputhje me njohuritë e audituesit mbi njësinë publike të audituar; dhe
(d) janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare.

1.1 Opinioni me theksim të cështjes. Opinioni me rezerve do të jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Formulimi i opinionit zakonisht tregon një rezultat të kënaqshëm të subjektit të auditimit në një deklaratë të qartë dhe koncize të çështjeve të mospajtimit ose të pasigurisë, duke çuar në opinionin me rezerve. Nëse efekti financiar i paqartësisë apo i mosmarrëveshjes është i përcaktuar si shumë nga audituesi, ndonëse nuk është gjithmonë e praktikuar ose e përshtatshme, atëherë kjo do të shërbente si ndihmë për përdoruesit e pasqyrave.

B. Audituesi e modifikon opinionin, duke shprehur:
1. Opinioni i kualifikuar. Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.
2. Opinioni negativ (kundërshtues). Opinioni negativ (kundërshtues) do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, si pasojë e mospërputhjes aq shumë vendimtare sa të përmbys situatën e paraqitur në atë masë që një opinion me rezerve në aspekte të caktuara nuk do të ishte i përshtatshëm. Formulimi i këtij opinioni qartëson faktin se pasqyrat financiare nuk janë deklaruar saktësisht duke specifikuar në mënyrë të thjeshtë dhe koncize të gjitha rastet e mospërputhjes. Gjithashtu, aty ku është me vend dhe është e mundur, do të ishte e dobishme sikur ndikimi financiar mbi pasqyrat financiare të përcaktohej në shumë.

3. Refuzim i opinionit. Refuzimi i opinionit do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur që të mbërrijë në një opinion për sa i përket pasqyrave financiare të marra në tërësi, si pasojë e pasigurisë apo e kufizimit të fushëveprimit aq shumë thelbësor, në mënyrë që një opinion me rezerve në disa aspekte të caktuara të mos jetë i përshtatshëm. Formulimi i refuzimit të opinionit qartëson faktin se është e pamundur të jepet një opinion duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha rastet e paqartësisë.

ANEKSI 3 -QASJA DHE METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 1% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka ulur gamën e gabimeve për tu konsideruar, dukemarrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 2%, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është konkluduar që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk tëulët. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti dhe verifikimin e tyre me evidencat periodike me Thesarin, si dhe dokumentacionin shoqërues (praktikën e urdhërshpeznimit). Konkretisht, mbi transaksionet u aplikuan:

- teste të kontrolleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (trajtuar gjerësisht ne pikën e programit mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin); dhe
- teste të detajeve.

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- ✓ Risku i lidhur me shpenzimin specifik, nga ku nën gjykimin profesional të audituesit niveli i riskut per shpenzime që lidhen me llogarinë 602 u vlerësua 0.7;
- ✓ Pesha specifike që ky zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Për të përzgjedhur minimumin e cështjeve për auditim, mbi këta zëra shpenzimesh, u aplikuan format e përllogaritjes si më poshtë:

1. Mbulimi me auditim i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore (llogaria 600 dhe 601)

Klasa 6 (llog 600 + 601)	Pagat faktike	Mbuluar me auditim (leke)	Mbuluar me auditim (%)
Viti 2018	21,230,225	21,230,225	100
Viti 2019	25,000.000	25,000.000	100

2.Mbulimi me auditim i shpenzimeve operative (llogaria 602)

Klasa 6 (llog 602)	Shpenzime operative faktike	Mbuluar me auditim (leke)	Mbuluar me auditim (%)
Viti 2018	7.377.413	7.377.413	100
Viti 2019	11,150.000	11,150.000	100

3. Mbulimi me auditim i shpenzimeve kapitale (llogaria 231)

Artikulli 231	Shpenzime kapitale faktike	Mbuluar me auditim (leke)	Mbuluar me auditim (%)
2018	34,355.086	34,355.086	100
2019	36.000.000	36.000.000	100

3. Mbulimi me auditim i prokurimeve:

Sa i takon auditimit të prokurimeve nën gjykimin profesional të audituesit, përzgjedhja e prokurimeve u krye nisur nga pesha specifike e secilës prej tyre ndaj total vlerës vjetore të prokurimeve të

realizuara, ku rezultoi se AIDA nuk ka kryer prokurime publike ,përvec blerjeve të vogla të cilat u audituan nëpërmjet veprimeve me bankë.

Aneks 4. Ankesa e depozituar pranë Kontrollit të Lartë të shtetit me nr.prot.904 dt 07.11.19

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
NR 904 DATË 7/11/2019

DREJTUAR Kryeministrit Z. Edi Rama

Zv. Kryeministrit Z. Erion Brace

Kryetarit te Kontrollit te Larte te Shtetit

Ambasades Amerikane Tirane

Ambasades Greke Tirane

Ambasades Gjermane

Ministrit te brendshem Z. Sander Lleshaj

Ministres se Financave dhe Ekonomise,Anila Denaj

Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise, Belina Balluku

Ministri i Bujqesise dhe Zhvillimit Rural, Blendi Cuci

Av. Pergjithshem I Shtetit Artur Metani

Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi

Sekretari teknis KIS, Sokol Nano

Sekretari I KKT-se, Ledia Toto

Prokurores se pergjitheshme, Arta Marku

Prokurosise Vlore, Drejtuesit Erjon Cela

Drejtorit te pergjithshem te policise se shtetit, Ardi Veliu

Kryetarit te KLP, Gent Brahimi

Sekretarit te pergjithshem te kryeministrise, Engjell Agaci

Bashkia Himare Krytarit Jorgo Goro

Operacinit Nderkombetar te Monitirimit {OMN}

Agjensis Shteterore te Kadastres Drejtorit Artan Lame

Quhem Kristo Gjoka. Nga fshati Vuno te Himares dhe me nenshtetsi Greke. Ne vitin 2008 I drejtohem komisionit te pronave per nje prone te trasheguar prej babit tim ne Jale Vuno per te cilen nuk kam marre asnje pergjigje deri ne vitin 2018. Ne vitin 2018 ATP morri ne shqyrtim dosjen time dhe pasi e shqyrtoj dhe pa qe ne dosje kisha gjithe dokumentacionin e duhur e shyqrtoj dhe ka bere nje realcion totalisht pozitiv, por per arsye te urdherave te nxjerra nga shteti dhe nga njerez me pushtet qe kane interesa direkt ne vjedhjen e pronave te minoritetit me refuzuan ta kthenin pronen. Ne kete menyre ju drejtova gjykates se Apelit Vlore, e cila morri ne shqyrtim dosjen dhe beri gjihe verifikimin e duhur dhe korrespodencen me te gjitha institucionet perkatese,me njohu dhe me ktheu nje pjese te prones dhe per pjesen tjeter vendosi per

kompesim pasi ishte e zene me rruge. Une kam shkuar kam rregjistruar vendimin dhe kam bere pjestim te prones prane Kadastres Vlore. Pasi kam bere keto veprime na del nje biznesmen I quajtur Alban Xhillari I cili prej vitesh nen kercenimin e kallashnikoveve ka terrorrizuar gjithe banoret e fshatit Vuno dhe ka zaptuar gjithe Jalen. Pervec badigardeve dhe bandave te armatosura ka arritur te rregjistroj edhe nje pjese toke ne emer te Sotir Andonit dhe me pas ta kaloj ne emer te Jani Kostes, prone e cila ka dal e falsifikuar nga hetimet e prokurorise dhe nga vet taks forca e kryeministrit actual, e cila del me relacioni, I cili mban nr. **Prot 5447 date 24.06.2014** ku ka vendosur bllokimin e prones se Sotir Andonit dhe Jani Kostes. Kjo prone de fakto e Alban Xhillarit qe dokumentacioni ti referohet gjykates dhe prona te fshihet dhe te kaloje ne favor te shtetit dhe ne gjykaten e apelit me vendimin **nr. 568 data 25.09.2019** eshte vendosur fshirja e prones dhe kalimi ne favor te shtetit. Nga ky moment konflikti ligjerisht ka mbaruar, por jo padrejtesia dhe presioni i Alban Xhillarit qe ka patur edhe mbeshtetjen e zyrtareve te korruptuar te asaj kohe dhe te sotem qe kane vetem nje qellim grabitjen e pronave te pronarve te ligjeshem dhe minoritareve Grek. Aktualisht sot ky person flet dhe shantazhon cdo zyrtar te cdo lloj niveli ne emer te kryeministrit Edi Rama dhe sek. Te pergjithshem Engjell Agaci. E gjitha kjo perputhet me padrejtesine qe po na behet prej drejtorit te pergjithshem te ASHK Artan Lame qe kercenon te gjithe institucionin e kadastres duke I detyruar te bllokonin pronen dhe ta fshihnin ate ne menyre te jashteligjshme duke perdorur si pretekst nje vendm pezullim ekzekutimi te gjykates se larte I cili eshte bere muaj me vone pasi vendimi I gjykates se Apelit eshte ekzekutuar,gje qe e bene vendimin e pezullimit te gjykates te larte te pavlefshem. Juristat dhe drejtuesit e ASHK Vlore duke njohur ligjin refuzonin vendosjen e kufizimit per pronen tone. Artan Lame pasi gjendej para refuzimit me argumenta ligjor ai fuste ne loje emrin e sek te pergjithshem Engjell Agaci dhe situata arriti deri aty sa shume prej punonjesve te ASHK Vlore u pushuan dhe dis ate tjere dhane doreheqje nga puna pasi ndiheshin te friksuar nga Artan Lame dhe Engjell Agaci qe flasin ne emer te kryeminstrit.. Punonjesit e kadastres jane ne presion te madh nga qeveritar qe jane ne dispozicion te grabitesve te pronave te cilet kerkojne ta marrin kete toke me lloj lloj menyrash duke perdorur te gjitha metodat deri sa kane arritur ti kercenojne me auditime te brendeshme dhe me ane te policis te shtetit. e clia eshte ne dispozicion te Alban Xhillarit**. I njojtur eshte dhe detyrymi qe I bene drejtoreshes te parafundit Elona [Hodaj]Kurti qe te japi doreheqjen pasi nuk pranoj te bllokoj pronen me urdherine jashte ligjshem te drejtorit Artan Lame,gjithe ashtu ajo anulloj dhe urdherin e bllokimit qe beri mbi pronen jashte cdo kopetence Zv.i saj Taulant Canameti qe u sull ne vlore I shoqeruar nga 20 Badigard vetem qe te bente bllokimin e kesaj prone.** Eshte e njohur miqesia midis drejtorit te policise Vlore Artion Duka me Alban Xhillarin pronarin de fakto te kompleksit ne jal dhe disa shoqerive de juro jane ne emer te personave te tjere. Emerimi I tij ne Vlore ishte I qellimshem ne periudhen qe filluan te kercenoheshin pronaret. Ju bej me dije se asnje punonjes I Kadastres nuk mori persiper te zbatoj urdherat e jashteligjshme te A. Lames Ata u detyruan te sjellin ne Vlore prane ASHK nje person kamikaz I ardhur nga jashte institucionit dhe ta emerojne drejtor per te vazhduar misionin e tyre per grabitje pronash. Nje person pa asnje kriter per ate pozicion eshte ish badigardi i Alban Xhillarit dhe bashkeshortja e tij paguhet prane kompanive te Personit ne fjale ne kundershtim total me ligjin ne bashkepunim me Artan Lamen jo vetem qe bllokoj pronen e familjes Gjoka por po vazhdon me falsifikim te rregjistrave hipotekore per te favorizuar Alban. Xhillarin qe te vazhdoj me mbulimin e gjurmeve dhe te

zaptoj gjithe Jalen. Edhe pse te njojtur me kallezimet e here pes hershme keta persona nuk ndalen duke vazhduar me tej me mashtrimin e bankave me shuma te medha miliona euro duke vendos kontrat ne prona qe jane fshire me vendim gjykate te formes se prere . Ju bej me dije se jemi ankuar ne cdo institucion dhe nuk po na japin zgjidhje per te drejten tone. Nen ze na thone se eshte kryeministri ketu dhe smund te bejme asgje. E vetmja zgjidhje qe na japin eshte te dorezojme pronen te Alban Xhillari, I cili eshte koka e nje grupi te mire organizuar kriminal me lidhje shume te forta ne qeveri dhe mbeshtetje te A. Lames, sek. E. Agaci dhe qe perdorin emrin e kryeministrit E. Rama. Alban xhillari ne bashkpunim me Ardit barajktarit,Arjan Stojka[kunati],Fabiola Jace,Silvana Sulejmani {ekonomiste}Sotir Andoni, Artan Shkembi, Eva Bashi, Jani Kosta e personave te tjere te cilet figurojn administrator fiktiv te disa prej shoqerive te Alban Xhillarit,konkretishte shoqerit Soleil, Kembrixh, Beta, Viki, Ida, Mumja, etj qe do I nxjeri nje hetim I paneshem dhe pa ndikime politike diten qe do krijohet **SPAK.** Keta persona ne bashkpinim me njeri tjetrin dhe me ndihmen e zyrtarve te ASHK Vlore nen urdherat e Artan Lames dhe zyrtarve me te larte se ai ka falsifikuar gjithe pronat ne Vuno, dhe disa prej tyre dhe I ka legalizuar ne kundershtim me ligjin ne emer te ketyre persona dhe shoqerive te regjistruara ne emer te tyre. Firma Soleli&Sea Shpk me nr nipti L21926005F me administrator fiktiv Ardit Bajraktari, person me profesion kamarier eshte I proceduar shume here ne polici dhe prokurori per falsifikim dokumentash dhe ndertim pa leje dhe pastrim parash. **Kjo shoqeri eshte pajisur me nje leje ndertimi dt 27.04.2018 me vendim nr. 14 prane KKT, institucion qe drejtohet nga kryeministri duke paraqitur vertetime hipotekore me nr.27.28.29.30.me dt.17.02.2011 ndodhur ne zonen kadastrale 3844 Jal Vuno Vlore me sip.4880.m,4970.m,1950m.4200m, nte cilat mbajn emrin e Jani Kosta. Vertetime te cilat jane totalisht te fallsifikuara dhe qe nuk kane dal prej hipotejes Vlore.** Per keto dhe cdo lloj dokumentacioni tjeter fallco, te cilat edhe aktualisht po hetoen nga prokuroria ,ju bej me dije se personat ne fjale jane proceduar disa here nga prokuroria dhe keto ceshtje te cilat i ka mbyllur prap duke cuar te njejtat vertetime te falsifikuar duke mashtruar prokurorine dhe duke mos bere dhe ata nje hetim te sakte. Aktualisht depozituar ne kallezimin penal nr.1359 te vitit 2018 e cila eshte bere mos fillim I kallzimit penal me dt.31.05.2018 mbi bazen e ketyre dokumentave te fallsifikuara paraqitur ne prokurori nga ana e tyre. Por guximi per vazhdimin e falsifikimeve te dokumentave dhe shkeljeve ligjore nuk e trembin as institucionet hetimore per aq kohe qe keta kane mbeshtetjen e qeverise dhe qeveria nuk u mjaftua me dhenien e lejes me dokumenta te falsifikuara te kesaj bande por I kane dhene statusin e investiroit strategjik me vendim nr. 20/5 me dt 01.08.2019 , vendim I dhene nga komiteti I investimeve strategjike te cilat kane qene ne dijeni te cdo fakti per parregullsite qe ai kishte duke shkelur cdo rregull dhe duke mos plotesuar asnje kriter.,Shoqerit dhe personat e mesiperm duke perfshir dhe firmen soleil dhe administratorin fiktiv Ardit Barajktari I cili po hetohet nga prokuroria per shume procedime penale si falsifikim dhe pastrim parash dhe ndertim pa leje dhe grup I strukturuar criminal, kallezim I bere nga ana e drejtoris se policis te qarkut Vlore,procedim I cili mbane nr.1181 dt.2018, si dhe kallzim I bere prej meje me nr1604 dt. 08.10.2018 etj. Kerkojne qe ta marrin kete prone ne lloj lloj menyrash me te gjithe metodat derisa kane marre dhe ne polici dhe kane kercenuar qe ti japin pronen Alban .Xhillarit. Duke pare qe Z. Xhillari nga ana ligjore ska gje ne rregull pasi ka cdo document fallco. Nga ana jone I jemi drejtuar oraganeve kopetente, Prokurorise Vlore duke depozituar kallezimin me nr 1605 dt 08.10..2019 per shperdorim detyre per drejtorin e kadastres Taulant Canametin. Ne dt

22.10.2019 eshte depozituar kallezimi tjeter me nr 1682 per shperdorim detyre per disa persona te kadastres dhe avokatures se shtetit si dhe per mashtrim per firmen Kemrixh pasi donin qe perseri me dokumenta te falsifikuara te linin pronen tone per kolateral ne bank per miliona euro. Po ne dt 08.10.2019 ku jane kallezuar te gjithe personat fiktiv te perdorur nga Alban Xhillari. Ne dt 24.10.2019 eshte depozituar nje memo me nr 1701 e cila per te vene ne dijeni me prokurorin me faktet rreth provave.Nje relacion tjeter ka dale nga ana e juristve te ASHK Vlore te cilet sot jane te pushuar nga puna dhe qe mban dt 02.05.2019 me shkresen me nr. 3692/1 ku sqarohet e gjithe situate e prones dhe fallsikimeve qe jane bere nga grupi I strukturuar I Alban Xhillarit. Ne dt 25.06.2019 me shkresen e kadastres me nr 1111/1 ku te gjithe juristet e kadastres kane firmos qe prona e A.Xhillarit eshte fallco dhe smund te kufizohet prona jone.. Sot ai prap me mbeshtetjen e disa zyrtarve te koruptuar si Z.Artan Lame ,dhe drejtues te Policis dhe gjithashtu te Bashkis Himare dhe qe vazhdojn permendin emrin e sek.te pergjithshem te kryeministris Z.Engjell Agaci dhe te vete kryeministrit Edi Rama vazhdon perseri te ndertoje pa leje dhe e justifikojn me dokumentat te lejes se dhene nga KKT institucion qe drejtohet nga Kryeministri leje e dhene me dokumenta te falsifikuara dhe kete gje e ben ne sy te policise ndertimore dhe bashkiake dhe policies se rendit duke mos patur shqetesimin me te vogel.Ne kontaktet qe kemi pasur me detyrim per shkak te kesaj situate me Alban Xhillarin dhe njerez te tij,ai na ka kercenuar ne emer te qeveris dhe hiqet sikur eshte I derguari atyre. Pervecse te tjerave ai me nje fare mburje tregon se nje nga miqte e tij te ngushte pervec te sipermendurve eshte min. actual I brendeshem Z.Sander LLeshi per te cilin ai thote qe shoqerohet me kunatin tim Arjan Stojka. Fal ketyre lidhjeve dhe disa medjave ai ka aritur qe situate ta kthej ne favor te tij dhe te dalin sikur pronaret e ligjeshem te jene nje grup qe kercenojn zyrtaret. Gje qe nuk eshte aspak e ligjshme. Duke qene se jemi ne te drejte tone kerkojme nga ana juaj mbeshtetjen sepse pervecse po na rrezikohet grabitja e prones na kercenohet edhe jeta.

Bashkengjitur te gjitha dokumentat qe vertetojne keto qe kam thene me siper.

1.Vendim Gjykate nr.18.dt.12.02.2019 qe ka kthyer pronen

2.Vendim Gjykates te larte nr.246.dt.23.04.2019 per pezullimin e ekzekurimit[Nul]mare 2 muaj pasi vendimi I apelit eshte ekzekutuar

3.Observacion mbi akt kontrollin nr.3692/1 dt.02.05.2019 drejtuar Kryeministris

4.Urdher nr.6891/1 dt.10.06.2019 per bllokimin e prones nga drejtori Pergjitheshem Artan Lame

5.Kthim pergjigje nr.931.dt 08.03.2019 kthyer perfaqsuesit te Jani Kosta [Alban Xhillari]

6.Raporti I Task Forces te Kryeministrit nr.3302.dt.06.08.2014 per kostatimin e fallsifikimit dhe kufizimin deri ne fshirjen e prones te Jani Kostes

7.Vendim Gjykate I apelit vlore nr.568.dt.25.09.2019 per urdherimin e fshirjes te prones te Jani Kostes

8.Vertetime hipotekore fallco te pa lesheuara nga institucioni ASHK pasi prona e tij ndodhej e kufizuar me nr.27.28.29.30 dt.17.02.2011 ne emer te Jani Kostes qe kane bere te mundur paisjen me leje ndertimi nga KKT organ qe varet nga Kryeministr

9.Dosje per pushimin e ceshtjeve penale per ndertime pa leje e tjera po mbi bazen e ketyre vertetimeve te fallcifikuara per kallzimin nr.1359.i vitit 2018 pushuar dt.29.05/2018

10.Vendim nr.26. dt16.10.2017 per dhenie te lejes te ndertimit nga KKT dhe Kryeministri

11.Vendim per dhenien e statusit strategjik nr.20/5dt.01.08.2018 per projektin jala

12.Urdhera te nxjere nga ASHK Vlore

13.Kallezime penale te bera prej meje

Kerkojme nga te siperpermendurit

Kryeministrit Z. Edi Rama

Zv. Kryeministrit Z. Erion Brace

Ministres se Financave dhe Ekonomise,Anila Denaj

Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise, Belina Balluku

Ministri i Bujqesise dhe Zhvillimit Rural, Blendi Cuci

Av. Pergjithshem I Shtetit Artur Metani

Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi

Sekretari teknis KIS, Sokol Nano

Sekretari I KKT-se, Ledia Toto

Sekretarit te pergjithshem te kryeministrise, Engjell Agaci

Bashkia Himare Krytarit Jorgo Goro

1.Te vazhdojne me procedurat e anullimit te lejes se zhvillimit per objektin

Kompleks turistik,hoteleri dhe sherbime me vendodhje ne Jale, Bashkia Himare pasi kjo leje eshte dhene mbi dokumenta te falsifikuara (vertetime hipotekore) me nr.27.28.29.30. dt 17.02.2011

Siperfaqe toke prej 16000 m2 e perfituar me dokumenta te falsifikuara e cila ne periudhen e dhenise se lejes se zhvillimit ka qene e bllokuar nga task forca e kryeministrit

nr. Prot 5447 date 24.06.2014. Prone e cila eshte crregjistruar me nje vendim nr.568 dt 25/09/2019 te gjykates se apelit Vlore.

2.Anullimin e vendimit te komitetit te investimeve strategjike nr.20/5 dt.01/08/2019 per projektin Entertainment Park pasi ky vendim eshte ne kundershtim me ligjin pasi

Ardit Bajraktari dhe shoqeria Soleil&Sea per statusin e investitorit strategjik nuk ploteson asnje kriter peervecse ky vendim bie ndesh me ligjin e prones, persona te cilet e perfitojne

jane nje grup i strukturuar kriminial dhe aktualisht po hetoet nga prokutroria prane rrethit gjyqesor Vlore per me shume se nje procedim penal dhe se shpejti nga struktura e posacme SPAK.

3.Te hetohet dhe te meren masa per bllokimin e ndertimeve pa leje ne jal deri ne prishjen e tyre dhe lirimin nga zaptuesit e pronave qe po behet.

4.Te hiqet urdheri I jashte ligjeshem per kufizimin e prones te familjes Gjoka.

Me Respekt dhe duke shpresuar per drejtesi Kristo Gjoka

Shënim: *Akt-konstatimi nr. 1, protokolluar nga DVASHK nr. 5559, datë 04.10.2019, referohet në këtë akt të mbajtur nga grupi i auditimit në Bashkinë Himarë vetëm për efekt të dokumentimit të problematikave të konstatuara nga ky grup për dosjen e subjektit J. L. K (K. SHPK) (Jalë, Himarë) dhe A. B. B. (S& S SHPK) (Jalë, Himarë).*

AKT KONSTATIM Nr. 1

(Mbi zbatimin verifikimin e ankesës të protokolluar në KLSh me nr. 436, datë 11.06.2019 dhe ankesës së protokolluar në KLSH me nr. 698, datë 18.09.2018)

Mbi auditimin e ushtruar në DVASHK Vlorë (ish-ALUIZNI Vlorë) në bazë të programit të auditimit nr.554/1, datë 30.07.2019, mbajtur në datë 04.10.2019

Në zbatim të pikës 6 të programit të auditimit "Nr. nr.554/1, datë 30.07.2019", në lidhje me verifikimin e ankesave të paraqitura për tjetërsimin e paligjshëm të pronave dhe lëshim të lejeve të legalizimit në kundërshtim me ligjin në zonën bregdetare të Jalës, u audituа dokumentacioni i vënë në dispozicion, nga i cili rezultoi si më poshtë:

*1.**Dosja nr. 3288, J. L. K (K. SHPK) (Jalë, Himarë)***

Sipas vetëdeklarimit nr.3288, datë 23.12.2014, poseduesi i objektit informal deklaron përfshirjen në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje.

-Vendimi për kualifikimin e ndërtimit informal me nr.9996, datë 06.03.2017 sipas të cilit legalizohen këto objekte pa leje është nënshkruar nga A. B, D. M. dhe E. V..

Leja e Legalizimit me nr.107008, në emër të J. L. K (K. shpk). Objekti "Objekt shërbimi 2 kate + dy objekte shërbimi 1 kat". Parcela ndërtimore 951m^2, sipërfaqja e bazës së ndërtimit është 317m^2 (232m^2 + 60m^2 + 25m^2), pasuri nr.1/137, ZK 3844. Leja e legalizimit është nënshkruar nga përgjegjësi i sektorit të legalizimit D. M dhe ish-Drejtori E. V. Parcela ndërtimore është në pritje të miratimit me VKM.

*-Sipas procesverbalit të verifikimit në terren, datë 21.12.2016 janë përcaktuar vetëm nr. e pasurive të kufitarëve (të pasaktësuara me shkrim) dhe nuk është përcaktuar distanca nga bregu i detit. Po ashtu, **nga shqyrtimi i skicës fushore rezulton se nuk është evidentuar dhe pasqyruar distanca e objektit nga bregu i detit, e cila rezulton më e vogël se 100m**.*

Procesverbali i verifikimit në terren nuk ka nënshkrimin e asnjë specialisti të terrenin dhe nga sektori i hartografisë pavarësisht se verifikimi në terren duhet të kryhet nga jo më pak se dy specialistë të ALUIZNI.

-Veprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me Urdhrin nr. 846, datë 11.10.2012 "Për miratimin e manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (gen-plani dhe planimetri) të objektit që legalizohet" shfuqizuar me Udhëzimin nr.30, datë 15.01.2016 "Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet".

-Në përpunimin hartografik të përpunuar nga ish-specialisti A. J dhe ish-përgjegjësi i sektorit të hartografisë A. Ll nuk është evidentuar dhe paraqitur distanca e objektit nga bregu i detit.

*-Nga verifikimi i hartës dixhitale në G. A. rezulton se **distanca e objektit të legalizuar me sipërfaqe 232m^2 nga shtrati i detit është 56m, ndërsa distanca e objektit tjetër me sipërfaqe prej 25m^2 nga shtrati i detit është 44m.***

-Vendimi "Për kualifikimin për legalizim, të Objektit informal" është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe në këtë rast objekti duhet të ishte skualifikuar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet e mëposhtme të Ligjit Nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar:

<u>Neni 4 pika 8:</u>

***"Brigjet" janë rripat anësorë të tokës përgjatë deteve**, liqeneve, rezervuarëve, lagunave dhe pellgjeve, si dhe përgjatë rrjedhës së shtratit të lumenjve e përrenjve që, në funksion të përdorimit, përfshijnë të paktën dy zona:*

a) me gjerësi 5 m në drejtim normal me tokën nga brinja e sipërme e shtratit natyror në brigjet e pjerrëta dhe 20 m nga vija e nivelit maksimal të plotave me probabilitet përsëritjeje, një herë në 25 vjet, të ujit në brigjet e sheshta, që përdoret për qëllime publike me dispozita të veçanta;

***b) me gjerësi 100 m** në drejtim normal me tokën nga brinja e sipërme e shtratit natyror në brigjet e pjerrëta dhe 200 m nga vija e nivelit maksimal të plotave me probabilitet përsëritjeje një herë në 25 vjet të ujit në brigjet e sheshta, në të cilën çdo veprimtari e zhvilluar përcaktohet nga organet e administrimit a menaxhimit të burimeve ujore. Kufiri i ndarjes së bregut të pjerrët me bregun e sheshtë është pjerrësia 10 për qind në drejtim normal me bregun.*

-neni 84, pika a dhe b, ku përcaktohet: "Në tokat, pronë private dhe shtetërore, përbri brigjeve të lumenjve, përrenjve, kanaleve, liqeneve, pellgjeve, rezervuarëve, lagunave bregdetare dhe deteve duhet, detyrimisht, të lihet:

***a) një sipërfaqe toke e lirë për përdorim publik, me gjerësi nga 5 deri në 100 metra nga këto brigje, sipas përkufizimit të bërë në këtë ligj.** Gjerësia e saj mund të shtrihet më tej në afërsi të grykës së lumenjve, në rrethinat e ngushta të rezervuarëve ose kur kushtet topografike dhe hidrologjike të lumenjve, liqeneve ose rezervuarëve e bëjnë të nevojshme për sigurimin e njerëzve dhe të pasurisë. Veprimtaritë në këto zona përcaktohen me akte të Këshillit Kombëtar të Ujit.*

*b) **një sipërfaqe toke e lirë** për zhvillimin e veprimtarive që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Ujit, **me gjerësi** nga 100 m deri në 200 m.*

<u>Neni 5 "Pronësia e burimeve ujore":</u>

1. Janë në pronësi të shtetit dhe në administrim të organeve shtetërore:

a) të gjitha burimet ujore të Republikës së Shqipërisë;

b) të gjithë shtretërit dhe brigjet e lumenjve, përrenjve dhe rrjedhave të tjera natyrore, qofshin të përkohshme apo të përhershme, ujërat kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale, kanalet, liqenet, pellgjet, lagunat dhe ujëmbledhësit natyrorë apo artificialë, ishujt dhe grumbullimet e rërës, gurëve dhe dherave në shtretërit e lumenjve, liqeneve dhe ujëmbledhësve, si dhe formacionet gjeologjike të ujërave nëntokësore;
c) toka e përftuar nga tërheqja e ujit ose nga përparimi i tokës në drejtim të ujit, kur ajo lidhet me tokën, që është në pronësi të shtetit;
ç) të gjitha strukturat dhe punimet hidroteknike të realizuara nga shteti, si digat, sistemet e ujitjes, kullimit dhe lundrimit, stacionet e ujit të pijshëm dhe kanalet, si dhe punimet që lidhen me to.
*2. **E drejta e pronësisë së shtetit, sipas përcaktimeve në shkronjat "a", "b" dhe "c" të pikës 1 të këtij neni, është e patjetërsueshme dhe paparashkrueshme.***
***-Mungon vërtetimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.** Në këtë rast Vendimi "Për kualifikimin për legalizim të objektit informal në posedim të shtetasve" është marrë në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, neni 27 "Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit", pika "ç" –"vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi" si dhe me VKM nr. 411, datë 19.05.2010 i ndryshuar "Për kriteret procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit" Kreu I, pikën 1,c ku përcaktohet –"c) për objektin/shtesën pa leje në ndërtime me leje është plotësuar dokumentacioni tekniko-ligjor, i parashikuar në nenet 27 e 37 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar; si dhe pika 2, ku përcaktohet se –"Drejtoritë e ALUIZNI-t pranë qarqeve, pas verifikimit të dokumentacionit dhe vlerësimit të përmbushjes ose jo të kushteve të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, për objektin informal/shtesën pa leje në ndërtime me leje, vendosin kualifikimin për legalizim ose përjashtimin nga legalizimi. Vendimi, i cili shoqërohet me aktin përkatës, të argumentuar, administrohet si pjesë përbërëse e dosjes së legalizimit.".*
Për sa më lartë mbajnë përgjegjësi ish-përgjegjësi i sektorit të legalizimit D. M., ish-Drejtori E. V.,specialisti A. B, specialisti i hartografisë A. J dhe përgjegjësi i hartografisë A. Ll.
2.Dosja nr. 3290, J. L. K (Kh shpk) (Jalë, Himarë)
Sipas vetëdeklarimit nr.3290, datë 23.12.2014, poseduesi i objektit informal deklaron përfshirjen në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje.
-Vendimi për kualifikimin e ndërtimit informal me nr.10201, datë 16.03.2017 sipas të cilit legalizohen këto objekte pa leje është nënshkruar nga A. B, D. M dhe E. V.
-Leja e Legalizimit me nr.107264, në emër të J. L. K. (K shpk). Objekti "3 objekte shërbimi 3 kate + 2 objekte shërbimi 2 kate + 3 objekte shërbimi 1 kat + 1 kat nëntokë + 1 objekt shërbimi 1 kat". Leja e legalizimit pasqyron parcelën ndërtimore 7494m^2 dhe sipërfaqen e ndërtimit 2498m^2, pasuri nr. 1/123, ZK 3844. Leja e legalizimit është nënshkruar nga përgjegjësi i sektorit të legalizimit D. M dhe ish-Drejtori E. V. Parcela ndërtimore është në pritje të miratimit me VKM.
*-Sipas procesverbalit të verifikimit në terren, pa datë janë përcaktuar vetëm nr. e pasurive të kufitarëve (të pasaktësuara me shkrim) dhe nuk është përcaktuar distanca nga bregu i detit. Po ashtu dhe **nga shqyrtimi i skicës fushore dhe përpunimi hartografik rezulton se nuk është evidentuar dhe pasqyruar distanca e objektit nga bregu i detit.***
Procesverbali i verifikimit në terren, pa datë është nënshkruar vetëm nga një ish-specialist terreni A. J., si dhe ka nënshkrimin e përgjegjësit të sektorit të hartografisë A. Ll. pavarësisht se verifikimi në terren duhet të kryhet nga jo më pak se dy specialistë të ALUIZNI.
-Veprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me VKM nr.589, datë 10.09.2014 "Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtime me leje, të organeve dhe dokumentacionit për propozimin dhe miratimin e zonave informale", i ndryshuar, Urdhrin nr. 846, datë 11.10.2012 "Për miratimin e manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (gen-plani dhe planimetri) të objektit që legalizohet" shfuqizuar me Udhëzimin nr.30, datë 15.01.2016 "Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet".
*-Nga verifikimi i hartës dixhitale në geoportalin A. dhe Google Earth rezulton se asnjë nga depot e ujit (të pasqyruara në lejen e legalizimit si objekte shërbimi), jo vetëm që nuk ka qenë e ndërtuar në datë 27.06.2014, por nuk duket të jenë ndërtuar as në hartën e vitit 2015. Këto objekte janë legalizuar në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, neni 2 "Fusha e zbatimit" ku citohet "1. Ky ligj zbatohet për ndërtimet pa leje të ndërtuara deri më 27.6.2014, me funksione banimi, veprimtari ekonomike apo funksione të tjera social-kulturore, dhe që disponohen nga individë apo persona juridikë të regjistruar, përfshirë dhe ndërtimet pa leje, për të cilat subjektet nuk kanë kryer procedurën e vetëdeklarimit për legalizim, sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj." **Për pasojë është tjetërsuar në mënyrë të paligjshme toka (433m^2 llogaritur mbi bazën e planimetrive të ndodhura në dosje) mbi të cilën***

ato objekte supozohet të jenë ndërtuar duke rritur fiktivisht sipërfaqen e parcelës ndërtimore për të kaluar në pronësi të subjektit privat "K. shpk".

-Nga shqyrtimi i planimetrive të nënshkruara për 6 objektet e shërbimit (hotele) (pa përfshirë depot e ujit) rezultoi si më poshtë:

1. Objekt me dy kate me sipërfaqe të bazës së ndërtimit 66m^2, e cila po aq është evidentuar në planimetri

2. Objekt me 2 kate me sipërfaqe të bazës së ndërtimit 317m^2, e cila po aq është evidentuar në planimetri

3. Objekt me sipërfaqe të bazës së ndërtimit prej 236m^2, e cila po aq është evidentuar në planimetri

4. Objekt me sipërfaqe të bazës së ndërtimit prej 202m^2, e cila po aq është evidentuar në planimetri

*5. Objekt të pasqyruar në planimetrinë e katit të parë me sipërfaqe të ndërtimit prej 452m^2, ndërkohë që në planimetrinë e katit përdhe baza e ndërtimit është pasqyruar 773m^2 (**pjesa e mbetur prej 321m^2** (773-452) në katin përdhe, **në hartën dixhitale të A. G rezulton që të mos jetë e zënë me ndërtim**). Planimetria është punuar dhe përditësuar nga ish-specialisti A. J., nënshkruar nga ish-përgjegjësi i sektorit të legalizimit A. Ll. dhe nga ish-Drejtori E. V.*

*6. Objekt me sipërfaqe faktike të bazës së ndërtimit prej 172m^2 (sipas matjes nga planimetria e ndodhur në dosje dhe krahasimi me hartën dixhitale të vitit 2015), ndërkohë që në planimetri është evidentuar 472m^2 (**pjesa e mbetur prej 300m^2, në hartën dixhitale të vitit 2015 të A. G. rezulton që të mos jetë e zënë me ndërtim**)), punuar dhe përditësuar nga ish-specialisti A. J., nënshkruar nga ish-përgjegjësi i sektorit të legalizimit A. Ll dhe nga ish-Drejtori E. V.*

*-Nga sa më sipër rezulton se sipërfaqja totale e bazës së ndërtimit është 1445m^2 (66 m^2 + 317 m^2 + 236m^2 + 202m^2 + 452m^2 + 172m^2) dhe jo 2498m^2 sa është dhënë me lejen e legalizimit. Pra, **kemi të bëjmë me një rritje fiktive të bazës së ndërtimit me një sipërfaqe prej 1053m^2, si pasojë e të cilës është rritur fiktivisht edhe sipërfaqja e parcelës ndërtimore me 3159m^2.***

-Në përpunimin hartografik të përpunuar nga A. J dhe A. Ll nuk është evidentuar dhe paraqitur distanca e objektit nga bregu i detit.

*-Nga verifikimi i hartës dixhitale në G. A rezulton se **distanca e objekteve të legalizuara nga shtrati i detit (nisur nga më i afërti) është 9m, 9.5m, 20m, 21m, 22m, dhe 39m.***

-Vendimi "Për kualifikimin për legalizim, të Objektit informal" është dhënë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe në këtë rast objekti duhet të ishte skualifikuar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet e mëposhtme të Ligjit Nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar:

<u>Neni 4 pika 8:</u>

***"Brigjet" janë rripat anësorë të tokës përgjatë deteve**, liqeneve, rezervuarëve, lagunave dhe pellgjeve, si dhe përgjatë rrjedhës së shtratit të lumenjve e përrenjve që, në funksion të përdorimit, përfshijnë të paktën dy zona:*

a) me gjerësi 5 m në drejtim normal me tokën nga brinja e sipërme e shtratit natyror në brigjet e pjerrëta dhe 20 m nga vija e nivelit maksimal të plotave me probabilitet përsëritjeje, një herë në 25 vjet, të ujit në brigjet e sheshta, që përdoret për qëllime publike me dispozita të veçanta;

***b) me gjerësi 100m** në drejtim normal me tokën nga brinja e sipërme e shtratit natyror në brigjet e pjerrëta dhe 200m nga vija e nivelit maksimal të plotave me probabilitet përsëritjeje një herë në 25 vjet të ujit në brigjet e sheshta, në të cilën çdo veprimtari e zhvilluar përcaktohet nga organet e administrimit a menaxhimit të burimeve ujore. Kufiri i ndarjes së bregut të pjerrët me bregun e sheshtë është pjerrësia 10% në drejtim normal me bregun.*

-neni 84, pika a dhe b, ku përcaktohet: "Në tokat, pronë private dhe shtetërore, përbri brigjeve të lumenjve, përrenjve, kanaleve, liqeneve, pellgjeve, rezervuarëve, lagunave bregdetare dhe deteve duhet, detyrimisht, të lihet:

***a) një sipërfaqe toke e lirë për përdorim publik, me gjerësi nga 5 deri në 100 metra nga këto brigje, sipas përkufizimit të bërë në këtë ligj.** Gjerësia e saj mund të shtrihet më tej në afërsi të grykës së lumenjve, në rrethinat e ngushta të rezervuarëve ose kur kushtet topografike dhe hidrologjike të lumenjve, liqeneve ose rezervuarëve e bëjnë të nevojshme për sigurimin e njerëzve dhe të pasurisë. Veprimtaritë në këto zona përcaktohen me akte të Këshillit Kombëtar të Ujit.*

*b) **një sipërfaqe toke e lirë** për zhvillimin e veprimtarive që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Ujit, **me gjerësi** nga 100 m deri në 200 m.*

<u>Neni 5 "Pronësia e burimeve ujore":</u>

1. Janë në pronësi të shtetit dhe në administrim të organeve shtetërore:

a) të gjitha burimet ujore të Republikës së Shqipërisë;

b) të gjithë shtretërit dhe brigjet e lumenjve, përrenjve dhe rrjedhave të tjera natyrore, qofshin të përkohshme apo të përhershme, ujërat kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale, kanalet, liqenet, pellgjet, lagunat dhe ujëmbledhësit natyrorë apo artificialë, ishujt dhe grumbullimet e rërës, gurëve dhe dherave në shtretërit e lumenjve, liqeneve dhe ujëmbledhësve, si dhe formacionet gjeologjike të ujërave nëntokësore;

c) toka e përftuar nga tërheqja e ujit ose nga përparimi i tokës në drejtim të ujit, kur ajo lidhet me tokën, që është në pronësi të shtetit;
ç) të gjitha strukturat dhe punimet hidroteknike të realizuara nga shteti, si digat, sistemet e ujitjes, kullimit dhe lundrimit, stacionet e ujit të pijshëm dhe kanalet, si dhe punimet që lidhen me to.
*2. **E drejta e pronësisë së shtetit, sipas përcaktimeve në shkronjat "a", "b" dhe "c" të pikës 1 të këtij neni, është e patjetërsueshme dhe paparashkrueshme.***
Për sa më lartë mbajnë përgjegjësi ish-përgjegjësi i sektorit të legalizimit D.M, ish-Drejtori E. V, ish-specialisti A. B, ish-specialisti i hartografisë A. J dhe ish-përgjegjësi i hartografisë A. Ll.
1.Dosja nr. 3289, A. B. B (S & S SHPK) (Jalë, Himarë)
Sipas vetëdeklarimit nr.3289, datë 23.12.2014, poseduesi i objektit informal deklaron përfshirjen në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje.
Leja e Legalizimit me nr.106707, në emër të A. B. B. (S & S SHPK). Objekti "Kompleks shërbimi me 24 objekte shërbimi 3 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë". Parcela ndërtimore 6300m^2, sipërfaqja e ndërtimit është 2100m^2, pasuri nr. 1/129, ZK 3844. Leja e legalizimit është nënshkruar nga përgjegjësi i sektorit të legalizimit D. M dhe ish-Drejtori E. V. Parcela ndërtimore është në pritje të miratimit me VKM.
-Sipas procesverbalit të verifikimit në terren, datë 21.12.2016 janë përcaktuar vetëm nr. e pasurive të kufitarëve (të pasaktësuara me shkrim).
-Në skicën fushore të përgatitur nga V. S. më datë 21.12.2016 janë pasqyruar në total 26 objekte (2 prej të cilave janë depo uji të cilat ndodhen në taracën e objektit impianti i ujërave të zeza) ndërkohë që faktikisht janë 24 objekte.
-Veprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me Urdhrin nr. 846, datë 11.10.2012 "Për miratimin e manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (gen-plani dhe planimetri) të objektit që legalizohet" shfuqizuar me Udhëzimin nr.30, datë 15.01.2016 "Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet", përsa më lart ky procesverbal është nënshkruar nga ish-specialistët e terrenit V. S. dhe A. J. si dhe ish-përgjegjësi i sektorit të hartografisë A. Ll..
-Vendimi për kualifikimin e ndërtimit informal me nr.9540, datë 06.02.2017 sipas të cilit legalizohen këto objekte pa leje është nënshkruar nga A. B., D. M. dhe E. V.
-Në një planvendosje të panënshkruar dhe pa datë, objekti pasqyrohet si objekt me dy kate, ndërsa në një planvendosje tjetër pasqyrohet si objekt ende në ndërtim (pra i papërfunduar).
-Nga verifikimi i hartës dixhitale në geoportalin A. dhe Google Earth rezulton se objekti i mësipërm, nuk ka qenë i përfunduar si karabina në hartën e vitit 2015 sepse duken qartë konturet e mureve të objektit dhe objekti nuk është i mbuluar.
Pra ky objekt është legalizuar në kundërshtim me:
*- Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, neni 2 "Fusha e zbatimit" ku citohet "1. **Ky ligj zbatohet për ndërtimet pa leje të ndërtuara deri më 27.06.2014**, me funksione banimi, veprimtari ekonomike apo funksione të tjera social-kulturore, dhe që disponohen nga individë apo persona juridikë të regjistruar, përfshirë dhe ndërtimet pa leje, për të cilat subjektet nuk kanë kryer procedurën e vetëdeklarimit për legalizim, sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj." dhe nenin 3, gërma a ku citohet **"Ndërtim pa leje" është objekti, për të cilin është përfunduar karabinaja**, i destinuar për banim, veprimtari ekonomike dhe/ose funksione të tjera, (si, për shembull, social-kulturor, arsim, shëndetësi e të tjera të këtij lloji), për të cilin nuk janë respektuar procedurat e përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi për planifikimin e territorit.";*
-VKM nr.589, datë 10.09.2014 "Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtime me leje, të organeve dhe dokumentacionit për propozimin dhe miratimin e zonave informale", pika 3 ku përcaktohet "Verifikimi i ndërtimeve informale, brenda periudhave kohore të përcaktuara në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, bëhet nëpërmjet të paktën njërës prej formave të mëposhtme:
a)Përdorimit të produktit të fotografimit ajror të territorit të Republikës së Shqipërisë, për periudhën kohore që ai mbulon.
b)Imazheve satelitore ose ajrore të përdorimit të përgjithshëm, sipas kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara nga subjektet disponuese.
c)Përdorimit të planrilevimeve në kuadër të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme, të administruara nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.
ç)Vërtetimit me mënyra alternative, nëpërmjet çdo dokumenti tjetër, juridikisht të vlefshëm, që provon ekzistencën e ndërtimit informal në momentin kohor të dhënë (në një datë dhe vend të caktuar).
Dokumentacioni, i cili provon periudhën në të cilën është ngritur ndërtimi informal, administrohet në praktikën dokumentare të legalizimit."

Pra, leja e legalizimit paraqet në mënyrë fiktive një deri në dy kate më tepër të objektit nga gjendja reale, duke dhënë pronësinë në mënyrë të paligjshme për katet të pandërtuara ende.

-Për sa më lart, nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se realisht deri në vitin 2015 (sipas hartës A. G.) nuk ka patur të ndërtuar asnjë objekt me 3 kate. Gjithsesi, kjo leje e legalizimit është lëshuar edhe në mënyrë evazive për faktin se nuk ka të cilësuar për secilin objekt katet mbi tokë apo nën tokë, duke nënkuptuar kështu sikur të gjitha objektet janë 3 kate mbi tokë dhe një nëntokë, pavarësisht faktit se shumica e objekteve janë vetëm 1 kat. Kjo praktikë lë hapësirë për vazhdimësinë e paligjshmërisë për shkak se subjekti përfitues mundet të bëj shtesa të paligjshme në lartësi të objekteve (tashmë të ligjëruara) nga leja e legalizimit e cila paraqet në mënyrë fiktive deri në dy kate më tepër të objekteve nga gjendja reale.

-Nga shqyrtimi i planimetrive të nënshkruara për 24 objektet e shërbimit, rezultoi se në kundërshtim me Ligjin nr.9482, datë 03.04.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, në sipërfaqen totale të bazës së ndërtimit është përfshirë edhe sipërfaqja e katit nëntokë të "Impiantit të Pastrimit të UZ" me sipërfaqe prej 464m^2.

*-Objekti i pasqyruar në planimetrinë e katit përdhe me sipërfaqe të bazës së ndërtimit prej 387m^2 (fleta me nr.56 sipas inventarit), nga verifikimi **në hartën dixhitale të A. G. rezulton që të mos jetë ndërtuar pjesa veri-perëndimore e saj me sipërfaqe 84m^2**). Planimetria është punuar nga ish-specialisti Arbër Jaupi, përditësuar nga ish-specialisti V. S, ish-përgjegjësi i sektorit të legalizimit A. Ll dhe nga ish-Drejtori E. V*

*-Nga shqyrtimi i planimetrive dhe hartës dixhitale A. G. rezulton se sipërfaqja totale e bazës së ndërtimit është 1552m^2 dhe jo 2100m^2 sa është dhënë me lejen e legalizimit. Pra, **kemi të bëjmë me një rritje fiktive të bazës së ndërtimit me një sipërfaqe prej 548m^2, si pasojë e të cilës është rritur fiktivisht edhe sipërfaqja e parcelës ndërtimore me 1644m^2.***

*-Nga verifikimi i hartës dixhitale në G. A. rezulton se objekti nr.12 i pasqyruar në planvendosje si **"Impianti i Pastrimit të UZ" dhe objekti nr.16 me sipërfaqe 23m^2 i pasqyruar si "ambient shërbimi", janë ndërtuar mbi rrjedhën natyrore të ujit që zbret nga mali.***

-Vendimi "Për kualifikimin për legalizim, të Objektit informal" është dhënë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe në këtë rast objekti duhet të ishte skualifikuar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet e mëposhtme të Ligjit Nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar:

Neni 5 "Pronësia e burimeve ujore":

1. Janë në pronësi të shtetit dhe në administrim të organeve shtetërore:

a) të gjitha burimet ujore të Republikës së Shqipërisë;

*b**) të gjithë shtretërit dhe brigjet e** lumenjve, përrenjve dhe **rrjedhave të tjera natyrore**, qofshin të përkohshme apo të përhershme, ujërat kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale, kanalet, liqenet, pellgjet, lagunat dhe ujëmbledhësit natyrorë apo artificialë, ishujt dhe grumbullimet e rërës, gurëve dhe dherave në shtretërit e lumenjve, liqeneve dhe ujëmbledhësve, si dhe formacionet gjeologjike të ujërave nëntokësore;*

c) toka e përftuar nga tërheqja e ujit ose nga përparimi i tokës në drejtim të ujit, kur ajo lidhet me tokën, që është në pronësi të shtetit;

ç) të gjitha strukturat dhe punimet hidroteknike të realizuara nga shteti, si digat, sistemet e ujitjes, kullimit dhe lundrimit, stacionet e ujit të pijshëm dhe kanalet, si dhe punimet që lidhen me to.

*2. **E drejta e pronësisë së shtetit, sipas përcaktimeve në shkronjat "a", "b" dhe "c" të pikës 1 të këtij neni, është e patjetërsueshme dhe paparashkrueshme.***

Për sa më lartë mbajnë përgjegjësi ish-përgjegjësi i sektorit të legalizimit D. M, ish-Drejtori E. V, ish-specialisti A. B, ish-specialisti i hartografisë A. J, ish-specialisti V. S dhe ish-përgjegjësi i hartografisë A. Ll..

-Si konkluzion, të gjitha objektet e legalizuara [me Leje Legalizimi nr.107008, në emër të J. L. K. (K. shpk), Leje Legalizimi nr.107264, në emër të J. L. K. (K.shpk) dhe Leje Legalizimi nr.106707, në emër të A. B. B (S&S SHPK)] ndodhen brenda kufirit të brezit bregdetar të miratuar me Vendim nr. 1, datë 08.10.2013, të KKT-së. Këto leje legalizimi janë dhënë në kundërshtim me VKM nr.280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje", i ndryshuar me VKM Nr. 756 datë 26.10.2016, pika 6 ku citohet "Ndërtime informale brenda kufirit të vijës turistike, në kuptim të nenit 38/1, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, janë ato të ngritura brenda "vijës bregdetare" (jashtë qendrave urbane), të miratuar me Vendimin nr. 1, datë 8.10.2013, të KKT-së. Këto ndërtime u nënshtrohen kritereve të legalizimit sipas këtij vendimi dhe projekteve të infrastrukturës rrugore, të parashikuara në dokumentet e miratuara të planifikimit të territorit. Në pikën 4 të Vendimit nr. 1, datë 8.10.2013, të KKT-së përcaktohet se brenda brezit bregdetar (bashkëlidhur këtij vendimi) lejohen ndërtime vetëm për interes publik, shtetëror dhe kombëtar.

-Lejet e legalizimit janë dhënë në kundërshtim flagrant me ligjin duke rritur fiktivisht (në total) sipërfaqen e bazës së ndërtimit me 1601m^2 (548m^2 për S & S SHPK + 1053m^2 për K. SHPK) dhe si pasojë është rritur

fiktivisht edhe sipërfaqja e parcelës ndërtimore me 4803m^2 (1644m^2 për S & S SHPK + 3159m^2 për K. SHPK), duke mundësuar kështu tjetërsimin e paligjshëm të këtyre sipërfaqeve në favor të këtyre subjekteve private.
-Leje Legalizimi nr.107008, Leje Legalizimi nr.107264 dhe Leje Legalizimi nr.106707 duhet të konsiderohen si akte absolutisht të pavlefshme të nxjerrë në kundërshtim me:
-Ligj nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar.
- VKM nr.280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje", i ndryshuar me VKM Nr. 756 datë 26.10.2016.
- Vendim nr. 1, datë 08.10.2013, të KKT-së "Masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese mjedisore në disa zona me rëndësi kombëtare dhe procedurën e hartimit të planit të integruar sektorial për bregdetin"
-Ligjit Nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar-VKM nr.589, datë 10.09.2014 "Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtime me leje, të organeve dhe dokumentacionit për propozimin dhe miratimin e zonave informale", i ndryshuar
-Ligj nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të RSh", i ndryshuar.
Nga verifikimi i problematikave të paraqitura si në ankesën e protokolluar në KLSh me nr.436, datë 11.06.2019 dhe në ankesën së protokolluar në KLSH me nr.698, datë 18.09.2018 për regjistrimin e paligjshëm të pronës në emër të shtetasit S. A dhe J. K, u verifikua deri në origjinë nga ku rezulton se në Zonën Kadastrale 3844, Jalë, në emër të J. K janë regjistruar dhe lëshuar vërtetime hipotekore (VH) në emër të S. A me nr.28, datë 13.02.2007. Kjo pasuri më pas ka kaluar në pronësi të J. K sipas VH nr.110, datë 18.04.2008 me sipërfaqe 16000m^2 dhe më pas është ndarë më datë 17.02.2011 për pasuritë e llojit "Kullotë" me sipërfaqe totale prej 16000m^2 si më poshtë:
-VH nr.27 me sipërfaqe 4880m^2
-VH nr.28 me sipërfaqe 4970m^2
-VH nr.29 me sipërfaqe 1950m^2
-VH nr.30 me sipërfaqe 4200m^2
Nga Taskforca e Kryeministrisë me shkresë nr.5447, datë 24.06.2014 është kufizuar në origjinë (VH nr.27, datë 13.02.2007) prona me sipërfaqe 16000m^2 kullotë.
Përsa i përket regjistrimit të kësaj prone në emër të S. A, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë në Vendimin me nr.119, datë 06.02.2013 për pushimin e çështjes për procedimin penal nr.494, ka konstatuar se prona është regjistruar në emër të S. A me dokumente që "përmbajnë të dhëna të rreme, pra të falsifikuar".

Shënim: *Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet përkatëse, referohen në këtë akt të mbajtur nga grupi i auditimit në Bashkinë Himarë (mbajtur Procesverbali nr. 20, datë 12.11.2014, Protokolluar nga Bashkia Himarë me nr. 1758, datë 12.11.2014 dhe nr. 23, datë 12.11.2014, Protokolluar me nr. 1761, datë 12.11.2014), vetëm për efekt të dokumentimit të problematikave të konstatuara edhe më parë nga KLSH për ndërtimet e kryera në zonën e Jalës (faqet 130-132 dhe 180-192 të Raportit të Auditimit, si dhe rekomandimi nr. 23, faqe 203).*

VIII/3. Plani i Detajuar Vendor Jalë Zona T.1.1, T.1.2 dhe S2
Në mbledhjen Nr. 1 të Këshillit Teknik të Bashkisë Himarë, më datë 06.08.2013, është propozuar për miratim dhe më pas janë miratuar nga Kryetari i Bashkisë Himarë z. J. G, Plani i Detajuar Jalë (Njësia strukturore II.3.a, Zonat T.1.1, T.1.2 dhe S2) është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Himarë Nr. 26, Datë 14.10.2013, me Nr. 1561 Prot. Shpallja e Nismës së Hartimit të PDV-së, është bërë me Nr. Prot. 0037, Datë 02.05.2013 nga Bashkia Himarë për shoqëritë K. ShPK. dhe Hasani Konstruksion ShPK. Njoftimi për fillimin e përgatitjes së Instrumentit të Detajuar Vendor nga Shoqëria K. ShPK. Nr. 17 Prot. Datë 17.07.2013. Është paraqitur për shqyrtim dhe miratim me shkresë përcjellëse dokumentacioni Nr. 30 Prot. Datë 16.08.2013 dhe Plani i Detajuar Vendor është miratuar me Vendim Nr. 1561 Prot. Datë 14.10.2013.
Nga hulumtimi i materialit është konstatuar se:
Materiali i PDV në dosje përbëhet nga Relacioni Teknik i Instrumentit të Detajuar Vendor; Harta e koncept masterplan; Harta e nënndarjeve dhe rregulloret e zhvillimit; Harta e kuotave ë pjesëmarrjes së parcelave; Harta e infrastrukturës së ujit të pijshëm; Harta e infrastrukturës së ujërave të zeza; Harta për ujërat e shiut; Prerje e planeve 1,2,3 dhe 4; CD;
Dosja nuk ka inventar;

Mungon licenca e projektuesit në kundërshtim me Ligjin Nr. 10119, datë 23.04.2009 "për Planifikimin e Territorit", të ndryshuar, Neni 45/1, Pika 1c) *Instrumenti i detajuar vendor hartohet nga subjekte të licencuara, të kontraktuara nga palë të interesuara për zhvillimin e një njësie urbane*.
Mungon kontrata e palës së interesuar për zhvillimin e njësisë urbane me subjektin e licencuar;
Njoftimi Publik për fillim procedure miratimi akti zhvillimor urban nuk ka as numër as datë;
Në Deklaratën për nisjen e procesit për hartimin e PDV-së mungojnë:
kufijtë e territorit, për të cilin hartohet PDV-ja, të cilat paraqiten në sistemet e gjeoreferimit, të përcaktuara në vendimin nr. 459, datë 16.6.2010 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e standardeve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS", për regjistrin e territorit;
plani i veprimeve për sigurimin e bashkërendimit horizontal dhe përfshirjen e palëve të interesuara në procesin e hartimit të PDV-së.
Mungon raporti i organizimit të Këshillimeve Publike, konform Nenit 21/4, të VKM Nr. 481, *datë 22.6.2011, të ndryshuar*;
Nuk është publikuar në Regjistrin e Planifikimit deklarata për shprehje interesi për hartimin e PDV-së nga pala e interesuar konform Nenit 21/3 të VKM Nr. 481, *datë 22.6.2011, të ndryshuar*;
Vendimi i Kryetarit të Njësisë së Qeverisjes Vendore, Bashkia Himarë Nr. 26, Datë 14.10.2013 për Miratimin e PDV në Nën njësitë Strukturore T1.1, T.1.2 dhe S.2 nuk është botuar në Regjistrin e Planifikimit siç parashikohet në Nenin 21/5, pika 3 të VKM Nr. 481, *datë 22.6.2011, të ndryshuar.*
Në materialin e dosjes në trajtë elektronike, mungojnë hartat në format ArcGIS, shapefile apo XLM, siç parashikohet në Nenin 21/8 pika 2, të VKM Nr. 481, *datë 22.6.2011, të ndryshuar.*
Është plotësuar Plani i Vendosjes së Strukturës me Infrastrukturat në Zonë, i cili sipas VKM 502 është i parashikuar për Leje Zhvillimi, jo për Plan të Detajuar Vendor;
PDV për Nën njësitë Strukturore T1.1, T.1.2 dhe S.2, është trajtuar në mbledhjen e Këshillit Teknik Nr. Prot. 001, Datë 06.08.2013. Pala e interesuar ka paraqitur për shqyrtim e miratim PDV në 16.08.2013, 10 ditë pasi Plani është miratuar në Këshill Teknik;
Për zonën S2, e cila në Planin e Përgjithshëm Vendor, Bashkia Himarë dhe Rregulloren e tij është përcaktuar si zonë e gjelbër ku nuk janë parashikuar ndërtime, as të përkohshme, Plani i Detajuar Vendor Jalë ka parashikuar zonë ndërtimi B. me sipërfaqe 3 933 m². Kjo në kundërshtim me VKM Nr.481, datë 22.6.2011 të ndryshuar, Neni 21/1, Pika 1 dhe 2, 1.
Plani i detajuar vendor (PDV) është instrumenti i detajuar vendor, që hartohet si detajim i PPV-së, mbi bazën dhe sipas përcaktimeve të tij.
Një plan i detajuar vendor, në formën e tij të përgjithshme, ka për qëllim:
a.të zbërthejë në detaje të përshtatshme për zbatim planin e përgjithshëm vendor dhe të detajojë për çdo nënnjësi strukturore parametrat e zhvillimit të përcaktuar në PPV
Nga evidentimi i kryer në terren më 09.10.2014 nga audituesit e KLSH në bashkëpunim me përfaqësuesit e DPZHT e INUV të Bashkisë Himarë, dhe vendimet për dënim me gjobë dhe pezullim punimesh të INUV, si edhe nga Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Himarë konstatohet se në momentin e hartimit të Planit të Detajuar Vendor, Bungalot kanë qenë të ndërtuara pa leje. **<u>Për rrjedhojë hartimi në kundërshtim me ligjin dhe PPV është një veprim i qëllimshëm për të pajisur me leje ndërtimi dhe për të legalizuar në mënyrë të jashtëligjshme këto ndërtime pa leje</u>**
Po kështu është vepruar me të gjitha ndërtimet pa leje të **F.M** në këtë zonë

XII. Probleme të ndryshme të dala gjatë auditimit dhe verifikimi i ankesave që kanë ardhur në KLSH.
<u>XII/2- Në lidhje me ndërtimet pa leje dhe që bien ndesh me PPV</u>
Nga evidentimi në terren i datës 09.10.2014 të objekteve të ndërtuara dhe në proces ndërtimi në hapsirën bregdetare Qeparo-Drimadhë, në kuadër të zbatimit të programit të KLSH për Auditimit të Ligjshmërisë, Rregullshmërisë, Vlerësimit Financiar dhe Menaxhimit të Aseteve të Qëndrueshme nr. 770/1, datë 01.08.2014 (të ndryshuar), u identifikuan **48 objekte** apo komplekse ndërtimi, për të cilat me shkresë nr. 1580, datë 14.10.2014 u kërkua nga DPZHT dhe INUV e Bashkisë Himarë, të përcaktohej statusi i tyre si dhe të vihej në dispozicion dokumentacioni i mbajtur për secilin rast.
Nga përgjigjet e mara nga DPZHT Bashkia Himarë, me shkresë Nr. Prot. 1580/1, Datë 22.10.2014 dhe nga INUV me Nr. 1580/1 Prot. Datë 22.10.2014, *rezulton se*:
Për 14 (katërmbëdhjetë) objekte INUV nuk ka kryer detyrën, veprime në kundërshtim të plotë me nenin 4 dhe 5, të ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 "*Për Inspektimin e Ndërtimit"*, të ndryshuar, neni 4 *"Përgjegjësitë e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës",* ***duke lejuar ngritjen e ndërtimeve të kundërligjshme, në një zonë të rëndësisë kombëtare, siç është zona bregdetare e përfshirë në territorin e***

Bashkisë Himarë dhe duke sjellë dëme përsa i përket zhvillimit të këtyre zonave, konform instrumenteve dhe politikave planifikuese si dhe duke shkaktuar mungesë të ardhurash në buxhetin vendor.

Për gjashtë objekte pa leje, procedurat e kryera nga INUV konsistojnë vetëm në mbajtje Proces-Verbalesh, Vendime për Dënim me Gjobë dhe Vendime për Pezullimin e Punimeve në ndërtim **dhe në asnjë rast nuk janë shoqëruar me Vendime për Prishjen e Ndërtimit të kundërligjshëm, Informimin e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar (INUK), përgatitja e Kallëzimit Penal për kundërvajtësin, paraqitje pranë organeve përkatëse të kërkesës për heqje të licencës profesionale ose të shoqërisë,** këto në kundërshtim me nenin 5, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "*Për Inspektimin e Ndërtimit"*, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 862, Datë 5.12.2007, të ndryshuar, pika 8.

DPZHT Bashkia Himarë, për një pjesë të objekteve të evidentuara nga ana jonë, të cilat janë ndërtuar apo janë në ndërtim, shprehet duke përdorur termin "***objekt pa informacion"*** apo ***"mendohet se objekti është me leje legalizimi"***, duke konfirmuar kështu se Bashkia Himarë nuk disponon asnjë dokument në lidhje me këto objekte, gjë e cila tregon se DPZHT nuk ka kryer detyrën për evidentimin e tyre dhe marrjen e informacionit për zhvillimet në territorin që ka nën administrim nëpërmjet bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me autoritetet e tjera të planifikimit, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 *"Për Planifikimin e Territorit"*, Seksioni VII *Vëzhgimi, Inspektimi, Kundravajtjet e Dënimet*, Neni 80 *Vëzhgimi i Zhvillimeve në Terren*, pika 1 dhe 2.

X/1.1. *Evidentimi i objekteve të ndërtuara dhe në ndërtim në hapësirën bregdetare Qeparo-Himarë, datë 09.10.2014*

Në kuadër të zbatimit të programit të KLSH për Auditimit të Ligjshmërisë, Rregullshmërisë, Vlerësimit Financiar dhe Menaxhimit të Aseteve të Qëndrueshme nr. 770/1 prot, datë 01.08.2014 (të ndryshuar), në datë 09.10.2014, u krye evidentimi i objekteve të ndërtuara dhe në proces ndërtimi në hapësirën bregdetare Qeparo-Drimadhë.

Grupi i evidentimit përbëhej nga:
R. Xh, auditues KLSH;
E. S, auditues KLSH;
Si edhe:
A. Th, specialist në DPZHT Bashkia Himarë;
A. D Kryeinspektor i INUV Bashkia Himarë;

Me shkresë nr. 1580 Prot, datë 14.10.2014 u kërkua nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor të Bashkisë Himarë, të përcaktojnë statusin e këtyre objekteve.

Për këtë:

Për objekte të cilat janë të pajisura me leje zhvillimi ose ndërtimi, të na vihen në dispozicion dosjet përkatëse, edhe nëse disponohen nga organe të tjerë vendimmarrës, si edhe dokumentacioni shkresor;

Për objektet e ndërtuara pa leje, të na vihet në dispozicion dokumentacioni dhe vendimmarrja për zbatimin e ligjit.

Nga DPZHT, Bashkia Himarë, me shkresë Nr. Prot. 1580/1, Datë 22.10.2014, na është vënë në dispozicion lista e identifikimit të objekteve. Nga shkresa e DPZHT konstatohet se për një pjesë të objekteve të evidentuara nga ana jonë, të cilat janë ndërtuar apo janë në ndërtim, është përdorur termi "***objekt pa informacion"*** apo ***"mendohet se objekti është me leje legalizimi"***, duke konfirmuar se Bashkia Himarë nuk disponon asnjë dokument në lidhje me këto objekte.

Për sa më sipër, INUV Bashkia Himarë, me Nr. 1580/1 Prot. Datë 22.10.2014, iu përgjigj kërkesës tonë, me informacion vetëm për një pjesë të **48 objekteve** apo kompleksëve, të evidentuara, për të cilat është kërkuar informacioni.

Për objektet pa leje si më poshtë:

INUV ka ndjekur procedura për objektet pa leje:

Fig. 28,30,31,33 - Objektet pa leje në pronësi të F. M;





Fig. 28 – Kompleks Jalë



Fig. 30 – Kompleks Jalë



Fig. 31 – Kompleks Jalë

Fig. 33 – Kompleks Jalë

Konstatojmë se këto procedura konsistojnë vetëm në mbajtje Proces-Verbalesh, Vendime për Dënim me Gjobë dhe Vendime për Pezullimin e Punimeve në Ndërtim dhe në asnjë rast nuk janë shoqëruar me Vendime për Prishjen e Ndërtimit të Kundërligjshëm, Informimin e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, përgatitja e Kallëzimit Penal për kundërvajtësin, paraqitje pranë organeve përkatëse të kërkesës për heqje të licencës profesionale ose të shoqërisë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 "*Për Inspektimin e Ndërtimit"*, të ndryshuar, Neni 5 "*Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës"* si dhe VKM Nr. 862, Datë 5.12.2007, të ndryshuar, Pika 8.

Për objektet pa leje, të sipërcituara, të ndërtuara apo në ndërtim e sipër, DPZHT nuk ka kryer detyrën për evidentimin e tyre dhe marrjen e informacionit për zhvillimet në territorin që ka nën administrim nëpërmjet bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me autoritetet e tjera të planifikimit, në kundërshtim me ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 *"Për Planifikimin e Territorit"*, Seksioni VII *Vëzhgimi, Inspektimi, Kundërvajtjet e Dënimet*, Neni 80 *Vëzhgimi i Zhvillimeve në Terren*, pika 1 dhe 2;
Çdo autoritet i planifikimit, në përputhje me sferën e tij të juridiksionit dhe të përgjegjësive, kryen vëzhgime për zhvillimet në territor, me qëllim studimin dhe vlerësimin e këtyre zhvillimeve, parashikimin e rreziqeve apo të tendencave, parandalimin e zhvillimeve të dëmshme apo për ndërmarrjen e politikave, miratimin e instrumenteve apo të kryerjes së veprimeve të përshtatshme, për sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm të territorit.
Autoritetet e planifikimit bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë veprimet ndërmjet tyre dhe bashkëveprojnë e shkëmbejnë informacione e të dhëna.
Ndërsa INUV i Bashkisë Himarë nuk ka ushtruar përgjegjësitë e kontrollit dhe zbatimit të ligjshmërisë e të standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës dhe ato të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera, për territorit administrativ të Bashkisë Himarë, në kundërshtim të plotë me Ligjin Nr. 9780, datë 16.7.2007 "*Për Inspektimin e Ndërtimit"*, të ndryshuar, neni 4 *"Përgjegjësitë e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës"*, si dhe në kundërshtim të plotë me nenin 5 të këtij ligji "*Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës"* sipas të cilit është detyrë e këtij inspektorati të:
a) vendos përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës;
b) vendos gjoba sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës;
c) paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të licencës profesionale personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit pa leje, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të punimeve të ndërtimit;
ç) vendos pezullimin e punimeve në ndërtim në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës;
d) vendos prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm;
dh) përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi;
e) jep informacionin e kërkuar Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar brenda një afati kalendarik 10-ditor, si dhe krijon të gjitha lehtësitë për përmbushjen e detyrave të këtij Inspektorati.

Me veprimet dhe mosveprimet e INUV të Bashkisë Himarë është lejuar ngritja e ndërtimeve të kundërligjshme, në një zonë të rëndësisë kombëtare, siç është zona bregdetare e përfshirë në territorin e Bashkisë Himarë, duke sjellë dëme përsa i përket zhvillimit të këtyre zonave, të një rëndësie strategjike

kombëtare, konform instrumenteve dhe politikave planifikuese si dhe të ardhurave të munguara në buxhetin vendor për këto objekte...

Gjetje nga auditimi:

23.*INUV i Bashkisë Himarë ka aplikuar gjoba për ndërtime të paligjshme që bien në kundërshtim me planin urbanistik vendor të miratuar, gjoba të cilat as nuk rezultojnë të jenë kontabilizuar në kontabilitetin e Bashkisë Himarë dhe as të jenë ndjekur ndonjë procedurë ligjore për arkëtimin e tyre, veprime në kundërshtim me nenin 22. 30 e 44, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël" dhe Kap. III-të të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".*

(**AKT KONSTATIMI Nr. 21**

Për zbatimin e programit të auditimit nr. 366/5, datë 06.8.2019, ndryshuar me nr. 366/6, datë 07.11.2019, pika (E) "Auditim në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Organizimi dhe funksionimi i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në Njësisë Vendore (IMTV), për periudhën nga data 01.01.2019 deri më 30.09.2019" dhe pikës H "Të ndryshme të dala gjatë auditimit (verifikimi i ankesave të protokolluara në KLSH me nr. 698, datë 18.09.2018, nr. 436, datë 11.06.2019, nr. 840, datë 22.10.2019 dhe nr 904, datë 07.11.2019)".

Objekti i këtij akt konstatimi është: Aktiviteti i Bashkisë Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Himarë, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, lidhur me procedurat e kryera nga këto struktura për subjektin "S&S" shpk, si dhe verifikimi i ankesave drejtuar KLSH-së për problematikën e konstatuar në territorin pjesë e të cilit ngrihen objektet e zhvilluara nga shoqëria "S&S".**Komente paraprake nga grupi i auditimi lidhur me ankesën nr. 904 (***Më poshtë paraqitet e skanuar ankesa e fundit drejtuar KLSH-së, por që rezulton të jetë drejtuar edhe 21 institucioneve të tjera)*

Pavarësisht referimeve të bëra nga subjekti ankues lidhur me shkeljet dhe parregullsitë e prezurmuara për drejtues të institucioneve të ndryshme shtetërore por dhe subjekte private apo përfaqësues të tyre, fakte të cilat sipas ankuesit janë në vlerësim nga organet kompetente; referimit në vendimin gjyqësor nr. 568, datë 25.09.2019, sipas të cilit është vendosur fshirja e pasurive të qytetarit "S. A" dhe "J. K", dhe kalimi i tyre në pronësi shtet për një sipërfaqe prej 16000 m^2;

Problematikës me ASHK Vlorë lidhur me ekzekutimin apo jo të vendimit të Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil nr. 246, datë 23.04.2019, për pezullimin e vendimit nr. 18, datë 12.02.2019 të Gjykatës së Apelit Vlorë, vendim i cili rezulton i pa aplikueshëm përsa vendimi nr. 18, datë 12.02.2019 ka prodhuar efektet duke u regjistruar nga ASHK Vlorë (vërtetimi pronësor nr. 141, datë 27.02.2019 nga trashëgimtarët e G. Gj);

Përdorimi nga subjekti i dokumenteve të falsifikuara dhe të pa dala nga ish-ZVRPP Vlorë me nr. 27, 28, 29 dhe 30, datë 17.02.2011, për sipërfaqet prej 4880 m^2, 4970 m^2, 1950 m^2, 4200 m^2 në zonën kadastrale 3844, Jal, Vuno, në emër të J.K, dokumente për të cilat pretendohet edhe se janë përdorur për të marrë miratimin nga KKT për lejen e ndërtimit nr. 14, datë 27.04.2018;

Grupi i auditimit rezervon të drejtë për tu shprehur mbi saktësinë dhe rregullshmërinë e veprimeve apo mosveprimeve të institucioneve shtetërore, vetëm pas ushtrimit të auditimit mbi procedurat dhe dokumentacionin e disponuar nga këto institucione apo edhe instritucione të tjera të cilësuara në ankesë, edhe pse për një pjesë të dokumenteve dhe këtu referimi është për aktet e prodhuara nga organet gjyqësore, shkeljet dhe parregullsitë janë lehtësisht të provueshme dhe dokumentueshme.

Aneksi 5.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE

Nr. _____ Prot. Tiranë, më 23/12/2019

Lënda: *Kthim përgjigjëe për projekt raportin e auditimit*
Drejtuar: KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TE INSTITUCIONEVE QENDRORE

I nderuar z. Leskaj,

Në vijim të shkresës tuaj Nr. 801/4 Prot., datë 29.11.2019 me lëndë "Dërgohet Projekt Raporti i Auditimit" protokolluar pranë AIDA me Nr. 348/7 Prot. datë: 03.12.2019, ku shpreheni se *"Lidhur me observacionet e akt konstatimeve të cilat nuk u paraqitën në afatin ligjor te parashikuar prej 1 jave, duke mirëkuptuar situatën e gjëndjes së fatkeqësisë natyrore në vend, do të trajtohen në raportin përfundimtar të auditimit"* ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Referuar Akt Konstatimit Nr.1, 2 dhe 3, AIDA i është përgjigjur me shkresë Nr. 348/5 dhe Nr. 348/6 prot., datë 27.11.2019, brenda afatit ligjor të parashikuar prej një jave.

Në lidhje me gjetjen nr. 1 se Agjencisë Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve i mungojnë raportet periodike katër mujore për monitorimin e buxhetit për vitin 2018 dhe tetë mujorin e vitit 2019 si dhe nuk janë të plotësuara me një informacion të plotë më shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimin e buxhetit nga plani fillestar në atë përfundimtar në nivel programi dhe artikulli, ju bëjmë me dije se në bazë të rekomandimit tuaj AIDA do të marrë masa që për periudhën në vijim Raportet e Monitorimit të buxhetit të hartohen me informacion të plotë dhe shpjegimet përkatëse për cdo ndryshim në përputhje me Udhëzimin nr. 9 dt 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".

Në lidhje me gjetjen nr. 2 ku nga auditimi i kryer konstatohet se AIDA nuk ka hartuar "Deklaratën për cilësinë e sistemit të kontrollit të brëndshëm", mbi zbatimin e sistemeve dhe komponentëve të menaxhimit financiar, ju bëjmë me dije se Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve do të marrë të gjitha masat për hartimin e Deklaratës për cilësinë dhe kontrollin e brëndshëm në përputhje dhe në zbatimm të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Në lidhje me gjetjen nr. 3 se Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) nuk ka hartuar "Kodin e Brendshëm Etik", dhe rekomandimin që AIDA të hartojë dhe miratojë këtë kod, ju bëjmë me dije se, ndërkohë, AIDA, e ka hartuar Kodin e Brendshëm Etik dhe me Urdhrin nr. 172 datë 18.12.2019 të Drejtorit Ekzekutiv, është bërë edhe miratimi i tij (bashkëngjitur urdhri nr. 172 datë 18.12.2019).

Në lidhje me gjetjen nr. 4, mbi rregullat e funksionimit të brendshëm lidhur me strukturën organike dhe rekomandimin për të përditësuar rregulloren e brendshme dhe përshtatjen e saj me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe strukturën e miratuar nga bordi drejtues, si dhe rekomandimin për të bërë vlerësimin vjetor të punonjësve, ju bëjmë me dije se AIDA e ka hartuar si draft-rregulloren e brendshme, ashtu edhe draft-statutin e ri të Agjencisë, me qëllim përshtatjen e tyre me strukturën e re organizative.

Por, duke qenë se, aktualisht, është duke u konsultuar edhe projekt-ligji i ri "Për investimet", i cili do të zbatohet, mbi të gjitha, për investimet direkte të kryera nga investitorë vendas ose të huaj në territorin e RSH, është konsideruar mundësia e miratimit dhe, eventualisht, hyrjes së tij në fuqi, si dhe, për rrjedhojë, shfuqizimit të Ligjit nr.7764, datë 2.11. 1993 "Për investimet e huaja", të ndryshuar dhe ligjit nr.55/ 2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë".
Për këtë arsye, me qëllim hartimin dhe miratimin e akteve afatgjata, AIDA ka konsideruar pasqyrimin, në draft-aktet në fjalë, të çdo ndryshimi në funksione, kompetenca apo objektiva që do të sillte miratimi i ligjit të ri dhe shfuqizimi i dy ligjeve aktualë.
Pavarësisht sa më sipër, draft-aktet e hartuara nga AIDA i janë dërguar për mendim Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe, në rast të shtyrjes së miratimit dhe hyrjes në fuqi të projekt-ligjit të ri "Për investimet", ato do të jenë pjesë e rendit të ditës në mbledhjen e radhës të Bordit Drejtues të Agjencisë.
Njëkohësisht me miratimin e këtyre akteve, AIDA do të procedojë menjëherë edhe me vlerësimin vjetor të punonjësve sipas përcaktimeve të reja.

Në lidhje me gjetjen nr. 5 ku nga auditimi i kryer është konstatuar se institucioni nuk ka hartuar strategjinë për menaxhimin e riskut dhe se institucioni nuk ka regjistër risku, AIDA do të hartojë regjistrin dhe strategjinë për menaxhimin e riskut në përputhje me ligjin nr. 10296 dt 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dheKontrollin".

Përsa i përket gjetjes nr. 6 se agjencia jonë nuk ka të dokumentuar ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS), AIDA do të marrë të gjitha masat për të dokumentuar vijimësinë e këtij grupi pune në përpthje me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin". Ne lidhje me piken e publikimit te raporteve dhe materilaeve te tjera te parashkikuara me ligj per t'u perfshire ne faqen ëeb të AIDA-s, bëjmë me dije se: Për një periudhë më shumë se 6-mujore faqja zyrtare e AIDA-s në ëeb ka qene në ristrukturim, nga ana e konceptimit/ layout etj. Për këtë arsye ka patur momente ku për arsye teknike nuk kanë qënë të disponueshmë në ëeb. Në vazhdim të gjitha materialet do të jenë në faqen ëeb si është parashikuar nga ligji Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", rubrikat të cilat kanë informacion të detyrueshëm për t'u paraqitur janë tashmë të përfshira në menune kryesore dhe në nmenutë e faqes ëëë.aida.gov.al.

Për gjetjen nr. 7 ku është konstatuar se zyra e financës nuk ka rakorduar me klientët dhe furnitorët, gjë e cila mund të riskojë pagesat. Agjencia jonë ju bën me dije se ka rakorduar me furnitorët me anë të telefonit për të marrë informacion nëse pagesa ka mbëritur në destinacion, por nuk ka mundësi për ta dokumentuar (pasi është telefonatë). Në bazë të rekomandimit tuaj, AIDA dhe përkatësisht zyra e financës, do të rakordojë me të gjithë furnitorët me anë të emailit në mënyrë që pjesa e mbërritjes së pagesës në destinacion të vërtetohet në mënyrë të dokumentuar.

Për gjetjen nr.8 ku rekomandohet se tepricat e llogarisë 520 "Disponiblitete në thesar" dhe të llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" duhet të vërtetohen me anën e aktrakordimit me thesarin, ku një kopje duhet t'i bashkëngjitet llogarisë vjetore; AIDA do të marrë të gjitha masat për të paraqitur në këtë aktrakordim të ardhurat e papërdorura si ato të celura dhe të pacelura, mjetet në ruajtje dhe sponsorizimet në formën e granteve.

Përsa i përket gjetjes nr. 9, në lidhje me plotësimin me të gjitha informacionet shpjeguese për relacionin e Pasqyrës Financiare për vitin ushtrimor 2018, Formati 5 "Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raprotimin e pasqyrave financiare vjetore " ju bëj me dije se AIDA do të marrë të gjitha masat për plotësimin e këtij relacioni me të gjithë informacionin sqarues.

Në lidhje me gjetjen nr. 10 ku gjatë procesit të auditimit u konstatua se Komisioni i Inventarizimit për vitin 2019 ngritur me Urdhërin e Titullarit të AIDA-s "Për inventarizimin e vlerave materiale" anëtarët e komisionit nuk kanë nënshkruar formularin e konfliktit të interesit. Titullari i AIDA-s morri masat në lidhje me këtë gjetje duke ngritur një Urdhër të ri nr.112/2. Prot., datë:16.12.2019 "Për

ngritjen e Komisionit të Inventarizimit fizik dhe ekonomik të aseteve të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve" (shkresa bashkëlidhur), ku të gjithë anëtarët e komisionit nënshkruan formularin e konfliktit të interesit për të vërtetuar paanësinë e tyre (kopje e këtyre shkresave bashkëlidhur).

Në lidhje me gjetjen nr. 11 ku grupi auditues ka konstatuar se regjistri i aktiveve për institucionin tonë rezulton jo i plotë, agjencia jonë ka marrë masa të menjëhershme për plotësimin e këtij regjistri duke evidentuar të gjitha aktivet në pronësi të AIDA-s, dhe duke skontuar vlerën në bazë të vjetërsisë dhe normës së amortizimit vjetor në përputhje me Udhëzimin nr. 30 të datës 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Për gjetjen nr. 12 ku nga auditimi i Pasqyrave Financiare konstatohet një diferencë në shumën 310 447 si rezultat i gjëndjes së iventarit por diferenca e konstatuar nuk është shoqëruar me shpjegimin përkatës; Titullari i institucionit me anë të Urdhërit nr. 179 të datës 18.12.2019 (shkresa bashkëlidhur), morri masa të menjëherëshme ku ngarkoi Nëpunësin Zbatues për të sistemuar diferencën financiare të vitit ushtrimor 2018.

Në lidhje me gjetjen nr. 13 ku konstatohet se AIDA nuk ka kryer procesin e iventarizimit përpara mbylljes së llogarive vjetore për 2018-tën, në bazë të të cilit duhej të evidentohej gjëndja fizike dhe krahasimi i tyre me gjëndjen kontabël; agjencia jonë morri masa të menjëhershme dhe në bazë të raportit nr.112/3 date 19.12.2019, raport i mbajtur nga Nëpunësi Zbatues, është kryer i plotë gjithë procesi i inventarizimit si dhe rakordimi i gjëndjes fizike me atë kontabël.

Përsa i përket raportit të auditit në faqet 11-14 ku ju konstatoni se *"…Institucioni nuk ka bërë asnjë likuidum të shpenzimeve për llogarinë 602.2001 Elektricitet, dhe në llogarinë 602.2002 Ujë"*, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve e kundërshton këtë konstatim pas sipas urdhërit nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë nr.242 datë 14.09.2018 zyrat që ne kemi në përdorim për vitin 2018-2019 nuk janë në pronësi të institucionit tonë (AIDA-s), por në pronësi të Kryeministrisë dhe për pasojë nuk mund të paguajmë ujë dhe energji elektrike sepse këto paguhen nga buxheti i Kryeministrisë.

Si dhe *"…Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit… Në lidhje me ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit nuk është aplikuar ajo formë, në mënyrë që I njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin. Konstatohet se Nëpunësi Zbatues, ish Përgjergjësja e Sektorit të Financës ka kryer njëkohësisht edhe detyrën e përgjegjësit të materialeve (magazinierit)" në kundërshtim me ligjin 102096 dt. 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin...",* Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve e pranon këtë konstatim por ju bën me dije se janë marrë masa për shmangien e këtij konflikti interesi sipas urdhërit nr. 13/3 Dt: 25/09/2019 detyra e mbajtjes së magazinës i ngarkohet znj. Geraldina Fejzaj.

Referuar Akt Konstatimi Nr. 3 (Mbi Investimet Strategjike, AIDA në përgjigjen e saj, sqaroi se auditimi u realizua në zbatim të pikës Nr. 8 të Programit të Auditimit Nr. 801/2 Prot., datë 15.10.2019.
Pika 8 e programit të auditimit, i cili iu vu Agjencisë në dispozicion nga ana juaj, parashikonte shprehimisht se: *në drejtimet kryesore të auditimit… hynë dhe probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit, në lidhje me organizimin, funskionimin e veprimtarisë së Agjenicë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe statutin e saj*.
Programi juaj i auditimit specifikonte llojin e auditimit "*financiar dhe përpuethshmërie*" ndaj dhe pika 8 e këtij programi auditimi interpretohet në përmbushje të të njëjtit objektiv tuajit. Edhe pse gjatë periudhës së audimit pranë AIDA, 16.10.2019 – 25.11.2019, Agjencisë nuk i është bërë asgjë me dije zyrtarisht nëse gjatë auditimit kanë dalë probleme të cilat legjitimojnë kërkesën tuaj për të dalë jashtë objektit të auditimit, nëpunësit përgjegjës të institucionit nuk janë kursyer duke ju kanë vënë në

dispozicion të gjithë materialin e nevojshëm, mbi projektin e investimit "J. E. P", ashtu si dhe shpjegimet respektive lidhur me procedurën e ndjekur dhe çdo detaj tjetër të këtij projekti investimi, ashtu si dhe vendimit të marrë në Komitetin e Investimeve Strategjike, respektivisht Vendim Nr. 20/5, datë 01.08.2019.

Në përfundim të auditimit, shpreheni në Akt Konstatimi Nr.3 se: "*projekti strategjik "J. E. P" nuk ka plotësuar kushtet, kapacitetet dhe kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për miratimin e statusit investitor strategjik, duke lënë gjithashtu shënim për subjektin e auditur që duhen njoftuar të gjithë përfaqësuesit e grupit operacional, dhe nëse nuk paraqiten komente/prova të reja ng ana e tyre, akt konstatimi konsiderohet i mirëqenë".*

Referuar në sa më sipër, gjykojmë të arsyeshme që t'ju paraqesim edhe një herë disa shpjegime lidhur me këtë proces:

Përgjegjësitë institucionale/proceduriale/administrative të AIDA dhe instituconeve të përfshira në trajtimin e një projekti potencial strategjik parashikohen në legjislacionin e investimeve strategjike, respektivisht Ligj Nr. 55/2015, i ndryshuar, dhe 10 (dhjetë) akteve nënligjore në zbatim të tij, respektivisht:

- *Ligj nr. 55/2015, "Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;*
- *Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1023, datë 16.12.2015, "Për nënsektorët strategjikë dhe zonat me përparësi zhvillimi";*
- *Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1024, datë 16.12.2015, "Për miratimin e projekteve me statusin Projekt me potencial strategjik";*
- *Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1025, datë 16.12.2015, "Për shërbimet e promovimit dhe përfaqësimit të investimeve strategjike";*
- *Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1026, datë 16.12.2015 "Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike";*
- *Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1027, datë 16.12.2015, "Për tarifat e shërbimeve për investimet strategjike";*
- *Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1028, datë 16.12.2015, "Për përcaktimin e marzheve, rregullave dhe dokumentacionit të garancive financiare të investimeve strategjike";*
- *Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1029, datë 16.12.2015, "Për bashkëpunimin ndërinstitucional në procedurat e investimeve strategjike";*
- *Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1030, datë 16.12.2015, "Për organizimin dhe formën e pjesëmarrjes së shtetit në investimet strategjike dhe rregullat për krijimin, funksionimin e administrimin e fondit të pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike";*
- *Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1031, datë 16.12.2015, "Për përcaktimin e rregullave për funksionimin, krijimin, administrimin dhe për formatin, përmbajtjen e procedurat për sigurinë e Regjistrit të Investimeve Strategjike";*
- *Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1032, datë 16.12.2015, "Për dokumentimin e marrëveshjeve të investitorëve strategjikë me pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private"*

Në mënyrë të përmbledhur ju bëjmë me dije se në ndjekjen e procedurave të investimeve strategjike, AIDA ka tre funksione:

1. O S Sh për aplikimet;
2. Sekretariat Teknik i Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS);
3. Agjent asistues i subjektit që përfiton status strategjik.

<u>Sa i përket funksionit të AIDA si O S Sh:</u>

Çdo subjekt investues i interesuar, person juridik privat, vendas ose i huaj, në përputhje me parashikimet e legjislacionit për investimet strategjike, ka të drejtën për të kërkuar përfshirjen e një projekti investues në procedurat administrative të investimeve strategjike, me qëllim marrjen e statusit "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar" apo "Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë". **Këto procedura u ofrohen projekteve konkrete të investimit, të cilat janë përgatitur dhe detajuar plotësisht nga propozuesi.**

AIDA, në cilësinë e One Stop Shop, në momentin e paraqitjes së **dosjes së plotë** të një projekti investimi, vlerëson fillimisht dy kritere bazë:

- **nëse projekti i paraqitur i përket sektorëve dhe nën sektorëve strategjike;**
- **nëse investimi i kalon vlerat minimale të investimit**

Gjithashtu, AIDA verifikon nëse projekti mbivendoset me projekte investimi të miratuara më parë nga KIS. Pas këtij hapi, realizohet aplikimi. Në momentin që dosja e një projekti merr një numër protokolli, atëherë projekti plotëson kriteret bazë të vlerës së investimit dhe përkatësisë së tij në një nga sektorët strategjike të parashikuar nga legjislacioni. Pra, dosja e projektit është plotësuar me të gjithë dokumentacionin shterues që parashikon **Neni 13 i Ligjit Nr. 55/2015, i ndryshuar, ashtu si dhe VKM Nr.1026 , datë 16.12.2015 "Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike".**

Në këtë kontekts, **subjekti aplikues S & S SHPK me NIPT L21926005F ka plotësuar kriteret paraprake për të aplikuar pranë O S Sh (vlerë investimi; sektor strategjik) dhe ka dorëzuar një dosje të plotë pranë AIDA, e cila ju është vënë në dispozicion.**

Konkretisht:

- Projekti i paraqitur i përket sektorëve dhe nënsektorëve strategjike – në përputhje me Nenin 8 të Ligjit Nr.55/2015 dhe Kreu I, pika 3/c të VKM Nr. 1023, datë 16.12.2015;
- Investimi i kalon vlerat minimale të investimit të përcaktuara nga neni 8, pika 3/c e Ligjit Nr. 55/2015. Vlera e këtij projekti investimi parashikohet të jetë € 62 000.000.
- Projekti aktual parashikon hapjen e 620 vendeve të punës.
- Koha e realizmit e cila është 3 vjet.

Sqarojmë se në kuptim të nenit 3, pika 18 e Ligjit Nr. 55/2015, i ndryshuar, vlera e investimit është vlera totale e investuar nga investitori deri në momentin që projekti bëhet operacional.

Pra, subjekti në fjalë plotësn kriterin sektorial; kriterin e vlerës së investimit dhe ka dorëzuar një dosje të plotë me dokumentacion të formës së duhur ligjore.

Hapi i dytë i procesit është mbledhja e rekomandimeve në terma financiarë, sektorialë dhe teknikë nga grupi operacional (i përbërë nga ekspertë të ministrive të linjës, sipas fushave të përkatëse).

Vlerësimi në terma financiarë

Grupit operacional, bazon rekomandimet e veta mbi anën financiare në zbatim të **VKM Nr. 1028, datë 16.12.2015 "Për përcaktimin e marzheve, rregullave dhe dokumentacionit të garancive financiare të investimeve strategjike".**

Gjatë shqyrtimi të profilit të investitorit, grupit operacional i lind e drejta që t'i kërkojë investitorit informacione lidhur me kapacitetin financiar dhe aftësinë e tij për të gjeneruar fonde të mjaftueshme për financimin e investimit, deklaratat financiare, strukturën menaxheriale, pronësinë, pozicionimin në treg, eksperiencat e mëparshme lidhur me fushën e investimit, projekte të ngjashme, si dhe komponentë të tjerë të nevojshëm për të provuar aftësitë e tij investuese dhe potencialin për të qenë investitor strategjik për projektet e investimeve strategjike, sipas përcaktimeve në ligjin e investimeve strategjike.

Në bazë të pikës 2 të VKM Nr. 1028, datë 16.12.2015, kufiri minimal i garancive financiare të kërkuara, për vlerësim nga grupi operacional, është në masën jo më pak se 10 % të vlerës totale të investimit. Nga ana tjetër, **vetëm Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS) ka të drejtë që:**

- në varësi të karakteristikave, përmasave dhe kompleksitetit të projektit, eksperiencës dhe kapaciteteve të investitorit si dhe në varësi të interesit publik, mund të kërkojë nivele më të larta të përqindjes së kapaciteteve financiare të kërkuara, por jo më tepër se 20 % të vlerës totale të investimit, **bazuar kjo e drejtë në pikën 4 të VKM Nr. 1028, datë 16.12.2015;**
- të konsiderojë të arsyeshme mosparaqitjen e garancisë financiare nga ana e investitorit, në raste se investitori ka realizuar mbi 10 % të vlerës së investimit, **bazuar kjo e drejtë në pikën 12 të VKM Nr. 1028, datë 16.12.2015;**

Referuar rastit konkret, edhe pse subjekti ka realizuar mbi 10% të vlerës së investimit të projektit në vlerësim, grupi operacional, me objektiv paraqitjen e rekomandimeve sa më të plota për KIS, sërish i ka kërkuar dokumentacion shtesë subjektit aplikues, ashtu si jeni vënë në dijeni nëpërmjet gjithë dokumnetacionit që ju është vënë në dispozicion. **Pra, edhe vlerësimi në terma financiarë është bërë i plotë dhe është përgatitur rekomandimi respektiv për KIS.**

Vlerësimi në terma teknikë dhe sektorialë

Vlerësimi në terma teknikë dhe sektorialë, ashtu si jeni informuar nga dokumentacioni i dosjes së projektit dhe çdo dokument/përgjigje shtesë zyrtare që AIDA ka kërkuar nga një sërë institucionesh, dokumentohet se gjithçka është përfshirë në rekomandimet finale për KIS.

Raporti i vlerësimit të grupit operacional që AIDA i komunikon KIS, në thelb është një përmbledhje e çdo informacioni dhe vlerësimi zyrtar të bazuar në legjisalcione sektoriale; plane kombëtar/vendore të planifikimit të territorit, ashtu si dhe akte të tjera administrative të cilat subjekti ka përfituar (leje/licenca).

Raporti i vlerësimit nga grupi operacional detajon situatën e plotë teknike e sektoriale ashtu si dhe rekomandon pozitivisht/negativisht dhe/ose me kusht masat mbështetëse që kërkon realizmi i projektit të investimit.

Ashtu si jeni njohur me dosjen, raporti I vlerësimit është i plotë, përfshirë rekoamndime zyrtare dhe problematika të ngritura për KIS.

Sa i përket funksionit të AIDA si Sekretariat Teknik i KIS:

Pas përgatitjes së raportit final të vlerësimit, është Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS), organi kolegjial i vetëm, i ngarkuar me të drejtën e një vendimi në lidhje me pranimin/ refuzmin/apo pranimin me kusht të kërkesës nga ana e investitorit.

Vendimi i KIS bazohet në nenin 18 dhe nenin 9/c të Ligjit Nr. 55/2015, i ndryshuar. Pra një vendim i KIS përveç se duhet të përmbajtë : *titullin e projektit investues; vlerën e parashikuar të kapitalit që do të investohet;emrin e investitorit të interesuar dhe partnerëve të tij; llojin e projektit investues; vendin/zonën ku do të zhvillohet ky projekt investues; afatin për të cilin jepet statusi "Investim/investitor strategjik",* ***duhet të miratojë edhe planin e veprimit për masat, procedurat dhe afatet, në lidhje me shërbimet dhe lehtësimin e procedurave për hartimin dhe zbatimin e një projekti investues strategjik, në të cilin përcaktohen angazhime, detyra dhe afate konkrete për institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore, për të gjitha fazat e realizimit dhe zbatimit të projektit;***

Ndërkohë masat mbështetëse për një projekt investimi të cilat merren në konsideratë nga KIS janë ato të përcaktuara në Kreun VII të Ligj Nr. 55.2015, i ndryshuar.

Konkretisht mbi Vendim të KIS Nr. 20/5, datë 01.08.2019:

- Sa i përket formës së vendimit, është tërësisht **në përputhje me nenin 18 të Ligj Nr. 55/2015, Iindryshuar;**
- Sa i përket masave mbështetëse të cilat janë marrë në shqyrtim nëpërmjet këtij vendimi, janë **tërësisht në përputhje me Kreun VII të Ligj Nr. 55/2015, i ndryshuar,** pra:
  - Konsolidim toke me kusht rregjistrimin fillestar të zonës. Pasi të realizohet ky kusht, vendimi i KIS orienton zgjidhjen e rasteve nëse dalin probleme pronësie dhe/ose mbivendosje. Duke qenë se vendimi i KIS nuk është titull ekzekutiv, kjo masë mbështetëse, pasi të plotësohet kushti i rregjistrimit fillestar të zonës, do të kalojë në procesin tjetër e vënies në përdorim të tokës nëpërmjet një Vendimi të Këshillit të Ministrave.;
  - Vënie në përdorim e bregut të detit, masë mbështetëse e cila vihet sërish në dispozicion të investitorit vetëm pas një Vendimi të Këshillit të Ministrave.
  - Infrastrukturë ndihmëse për nevojat e projektit (energji; ujë), masë e cila mundësohet vetëm pasi subjekti të jetë pajisur me lejet përkatëse të zhvillimit dhe ndërtimit (çka na kthen tek kushti fillestar, që duhet të jetë bërë rregjstrimi fillestar i zonës, të të jetë konsoliduar toka për realizmin e projektit dhe të jetë përditësuar plani I detajuar vendor për zhvillimin e zonës).
  - procedura të përshpejtuara për leje/ licenca/autorizime
- Sa i përket planit të veprimit mbi masat mbështetëse, ai i bashkëlidhet vendimit të KIS dhe është **tërësisht në përputhje me nenin 9/c të Ligj nr. 55/2015, I ndryshuar.**

Referuar në sa më sipër, lutemi për sqarime të mëtejshme nga ana juaj:

4. Referenca e saktë ligjiore se ku bazohet auditimi juaj;
5. Arsyetime të dejatuara ligjore/proceduriale dhe teknike se ku bazohet konstatimi juaj se projekti strategjik "J. E.P." nuk ka plotësuar kushtet, kapacitetet dhe kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për miratimin e statusit investitor strategjik;

6. Orientimin e qartë të aktit tuaj të konstatimit, pasi në akt konstatimi vlerësoni të gabuar vendimin për miratimin e statusit strategjik, por i'a komunikoni këtë konstatim sekretariatit teknik dhe grupit operacional, struktura të cilat nuk kanë tagër vendimarrjeje.
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin1,

DREJTOR EKZEKUTIV

S. N